



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 24, 29 DHE 30 NËNTOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. 24. 29. I 30. NOVEMBRA 2017. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizim,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për infrastrukturën kritike,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë,
16. Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
17. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
19. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016,
20. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,
21. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa,
22. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve,
23. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Prvo razmatranje N/zakona o glavnom gradu Republike Kosovo/Prištini,
6. Prvo razmatranje N/zakona o porezu na nepokretnu imovinu,
7. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/26 o nasleđu na Kosovu,
8. Prvo razmatranje N/zakona o izmena i dopunama Zakona br. 03/L-094 o predsedniku Republike Kosova,
9. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-007 o van parničnom postupku,
10. Prvo razmatranje N/zakona o posredništvu,
11. Prvo razmatranje N/zakona o trgovačkim društvima,
12. Prvo razmatranje N/zakona o standardizaciji,
13. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br.04/L-072 o kontroli i nadzoru državne granice, izmenjen i dopunjen Zakonom br.04/L-214,
14. Prvo razmatranje N/zakona o kritičnoj infrastrukturi,
15. Prvo razmatranje N/zakona o beležništvu,
16. Preporuka Komisije za javnu administraciju, Lokalnu upravu i medije za razrešenje jednog člana Odbora Radio-televizije Kosova,
17. Razmatranje godišnjeg izveštaja Centralne banke Kosova za 2016 godinu,
18. Razmatranje godišnjeg izveštaja o budžetu Republike Kosova za 2016 godinu,
19. Razmatranje godišnjeg izveštaja o funkcionisanju Sistema unutrašnje kontrole javnih finansija javnog sektoru Kosova za 2016 godinu,
20. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana borda RTK-a, iz redova srpske zajednice,
21. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana Borda za žalbe,
22. Izbor jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije, i
23. Izbor dva (2) člana Rukovodećeg borda Fonda penzijske štednje Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e grupeve parlamentare në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Ndërkohë e ka kërkuar fjalën Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

E ka dërguar me shkrim.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës shpreh këtu indinjatën dhe shqetësimin tonë të thellë në lidhje me raportimet e fundit në media ndërkombëtare dhe vendore që flasin për një qasje diskriminuese dhe paragjyquese në zyrtarët e EULEX-it ndaj ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët janë gjykuar në procese të ndryshme nga prokurorë dhe gjyqtarë të këtij misioni.

Ish-kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, ka deklaruar zyrtarisht dhe publikisht se gjykatësit e EULEX-it kanë pasur qasje manipulative në rastet që ndërlidhen me ish-ushtarët e UÇK-së.

Për më tepër, në dëshmitë e tij ai ka përfshirë edhe gjykatësin kryesor të rastit “Drenica 2”, Dariusz Sielicki, për të cilin ka deklaruar se të akuzuarit i ka fyer vazhdimisht, duke i quajtur

edhe “kafshë”. Kjo është më shumë se e turpshme dhe ofenduese për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Për neve është e papranueshme dhe jashtëzakonisht joprofesionale nëse një qasje e tillë manipulative vërtet ka qenë mënyra e trajtimit të rasteve në fjalë.

Andaj, ne kërkojmë urgjentisht nga udhëheqësit e EULEX-it që t’i ofrojnë Kuvendit dhe institucioneve tona një përgjigje zyrtare dhe të detajuar në lidhje me këto pretendime shumë serioze.

Konsiderojmë se një akuzë kaq e rëndë nuk mund të lihet pa marrë përgjigjen dhe sqarimin e plotë, sepse edhe ne, edhe qytetarët tanë, duhet ta dimë të vërtetën rreth kësaj çështjeje.

Në fund, si shprehje e protestës dhe revoltës në lidhje me këtë, ne sot do të lëshojmë sallën e Kuvendit dhe kërkojmë që të gjithë deputetët të na bashkëngjiten në këtë veprim.

Propozojmë që seanca e planifikuar për sot të vazhdojë nesër, nga ora 10:00. Faleminderit!

(Pauzë)

KRYETARI: Jemi edhe pak drejt konsultimeve, përndryshe, dikush nga kolegët nënkryetarë e merr kryesimin. E kam edhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila ndërkohë ka kërkuar të kishte qenë e njoftuar paraprakisht për vendimin e grupeve parlamentare PDK, AAK dhe “Nisma”, është duke marrë qëndrim.

Ju lutem, Lëvizja “Vetëvendosje” dëshiron të vazhdojë seancën.

Nënkryetarja e Kuvendit, zonja Aida Dërguti, e merr kryesimin. Të lutem, zonja Dërguti.

(Pauzë)

Ndërkohë Grupi Parlamentar i LDK-së ka kërkuar pesë minuta pauzë, kryetari i Kuvendit tërhiqet, në qoftë se dëshirohet të vazhdohet, atëherë nënkryetarja, zonja Dërguti, ose nënkryetari, zoti Shala, e merr kryesimin. Faleminderit!

Pesë minuta pauzë!

* * *

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarija e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,
Po vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Ju e dini që koha për deklarime jashtë rendit të ditës është 30 minuta, dhe po jua rikujtoj që diskutimi në emër të grupit është pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Zonja dhe zotërinj,
Kadri Veseli nuk ka pasur nevojë të na tregojë nëpërmjet këtyre vendimeve se është i Partisë Demokratike, ne e dimë që është publikisht kryetar i Partisë Demokratike. Nuk ka pasur nevojë të na e sjellë edhe këtu në vendime të Kuvendit këtë gjë për të na dëshmuar se është kryetar i PDK-së, së pari, pastaj edhe kryetar i Kuvendit.

Mirëpo, vetë fakti që ia dha së pari fjalën Partisë Demokratike, e jo grupit më të madh parlamentar, që veç ata të flasin dhe të gjithë ne t’u bindemi ta lëshojmë seancën, kjo është e padrejtë dhe nuk kemi kurrfarë obligimi ndaj kësaj, aq më tepër për temën të cilën e ngritën.

Folën kundër EULEX-it, çka i bie kjo? Kjo i bie që po afrohet Gjykata Speciale, dhe kur “Vetëvendosja” në parim fliste kundër EULEX-it dhe e ftonte Partinë Demokratike që ta kuptonin se kemi të bëjmë me një mision, i cili ka kompetenca ekzekutive në Kosovë dhe që nuk mund të jemi Republikë e plotë, shtet i vërtetë përderisa e kemi EULEX-in këtu, ata e urdhëronin Policinë të na ngrehnin zvarrë dhe të na çonin në burg. Tash po na ftojnë t’i bashkohemi betejës së tyre kundër EULEX-it dhe kundër Gjykatës Speciale.

A është Partia Demokratike e Kosovës, a po më duket, që në këtë Kuvend ka qenë e gatshme të na nxjerrë në mënyrë të dhunshme prej seancave kur ne tentonim ta bllokonim Gjykatën Speciale. Kurse tash është ajo që po do t’i prijë valles për kundërshtimin e Gjykatës Speciale. Çka i bie kjo punë? Kjo punë i bie që ata nuk janë parimorë. Ata e kanë personale, individuale, secili prej tyre.

Dhe tash kur ka ardhur momenti, po e shohin stuhinë e Gjykatës Speciale, tash janë në gjendje edhe ta kallin krejt Kosovën, edhe ta çrregullojë krejt jetën institucionale në Kosovë, vetëm e

vetëm për të ngadhënjyer agjenda e tyre. Ne nuk kemi pse të bëhemi pjesë e kësaj. Por, dola këtu për t'ia bërë disa pyetje gjyqtarit Beqir Kalludra: Beqir Kalludra, ju ia dhatë Frashër Krasniqit tetë vjet burg; ia dhatë Atdhe Arifit gjashtë vjet burg, Egzon Halitit pesë vjet e gjysmë dhe Adea Batushës dy vjet burg.

Pyetja ime është: Zoti Kalludra, po të ishte gjallë Astrit Dehari, sa vite burg do t'ia jepje atij?!

Ju jeni ata që të mbytni, e pastaj të dënoni edhe për së vdekuri.

Zonja dhe zotërinj,

Vendimi i gjyqtarit Beqir Kalludra po e çon Republikën e Kosovës drejt një faze të re shumë të rrezikshme të raportit mes drejtësisë dhe pushtetit. Ne kemi parë gjithmonë që në Kosovë ka pasur persekutime politike. E kemi ditur që Gjyqësori është i politizuar dhe i kapur nga krimi i organizuar. Gjithmonë e kemi përjetuar, sidomos aktivistët e “Vetëvendosjes”, Gjyqësorin e kapur nga pushteti që shpërdorohet si mjet për goditjen jokonvencionale të kundërshtarëve politikë, por ama verdikti i gjyqtarit Kalludra ditën e premte e hap një epokë të re në gjyqësi. Kjo është epoka e dënimit pa prova.

Kur ka qenë puna e kriminelëve, ku provat ekzistojnë qysh është rasti me Emin Beqirin, provat në Polici zhduken, Dhoma e Provave vidhet, por kur është puna për ta dënuar “Vetëvendosjen”, edhe po të mos ketë asnjë provë, ato shpiken dhe montohen. Pra, asnjë fakt, asnjë argument për dënimin e aktivistëve të “Vetëvendosjes”, por këta pse kanë nevojë për fakte, pse kanë nevojë për prova? S'kanë nevojë as për argumente, kanë nevojë vetëm për gjyqtarë si Beqir Kalludra dhe kryhet krejt puna.

Pra, si u bë që ky njeri, pasi shpërndau 21 vjet burgim për aktivistët e “Vetëvendosjes”, pesë ditë pas kësaj në ditën e djeshme dha urdhër për bastisjen e shtëpive të deputetëve Albin Kurti, Albulena Haxhiut, Donika Kadaj, Faton Topalli dhe dha urdhër për arrestimin e tyre. Ky njeri nuk po e fsheh fytyrën fare, po thotë “unë jam pushteti, unë jam këtu”, por çka pritet prej një gjyqtari, i cili e ka falsifikuar edhe datën e lindjes. Pushteti ia ka falsifikuar për ta futur në sistemin e gjyqësisë. Me gjyqtarë të tillë, të shantazhuar, ky pushtet është në gjendje të bëjë gjithçka.

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputeti Haxhi Avdyli, ju lutem le të deklarohet nëse këtë deklaram e bën në emër të grupit, apo personal.

HAXHI AVDYLI: E nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që sot para jush dhe opinionit të shpreh shqetësimin qytetar për diskriminimin e qytetarëve të Kosovës nga Kompania KEDS.

KEDS, një kompani e falur, apo e privatizuar në mënyrë korruptive po vazhdon të sillet me qytetarin si qytetar jetim, duke vjedhur dhe duke e plaçkitur nëpërmjet faturave të tyre, i ndihmuar edhe nga shteti dhe pasiviteti i tij. Vjedhja e KEDS-it ka filluar me njehsorët elektrikë tani po vazhdon edhe më shumë në emër të humbjeve komerciale dhe po vidhet qytetari i ndershëm, ai i cili po i paguan faturat dhe sipas një statistike në 100 euro, 22 euro janë në emër të shfrytëzimit të rrymës nga njerëzit e papërgjegjshëm. I njëjti KEDS, i cili qytetarëve të përgjegjshëm edhe me një vonesë të vogël në pagesë ua ndërpret rrymën në mes të dimrit, kurse hajnave të rrymës nga veriu dhe në jug që plot 17 vjet, edhe pse në gjendje të varfër nuk ka mëshirë që t'i ngarkojë edhe me tarifa jo të drejta, por edhe të faturojë edhe faturat të cilat nuk i takojnë atij.

Dhe, një kompani e shitur për 27 milionë e ka vjedhur qytetarin e Kosovës deri në 280 milionë dhe nga kjo vjedhje e paturpshme kërkojmë dhe i bashkohemi thirrjes që ky borxh t'i kthehet qytetarit të Kosovës nëpërmjet faturave, apo nëpërmjet investimeve. Dëmet e KEDS-it në ekonominë familjare janë të mëdha, dëmet e KEDS-it në kompanitë nëpërmjet ndërprerjeve të punëve të makinave dhe aparaturave në ekonominë familjare janë të mëdha dhe po vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sot qytetari i ndershëm po penalizohet nga KEDS-i dhe pasiviteti i tij. Këta janë të aftë ta gjejnë fajtorin të ZRRE-ja, të OSSH-ja, të situata politike, por sot kemi krahina, qytete dhe fshatra, në të cilat rrjeti është i stërvjetruar, e kemi krahinën e Hasit ku tensioni është më se i ulët dhe ka ndërprerje të përditshme të rrymës, veçanërisht në këto kohë dimri. Kurse ka zona në Kosovë, të cilat, edhe pse s'paguajnë, e shfrytëzojnë rrymën në mënyrë të padinjitetshme.

Prandaj, është koha që ne t'i themi stop, sepse KEDS-i i dërgon teknikët e shkëputjes së rrymës në mes të dimrit, ndërsa ne si institucione duhet t'i japim afat që ta ndërpresë këtë vjedhje të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Milaim Zeka, ju lutem deklarohuni në çfarë cilësie do të flisni. Atëherë, tre minuta!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Pikërisht pse Partia Demokratike e Kosovës e lëshoi seancën, unë në shenjë proteste qëndrova këtu t'i them nja dy llafe pikërisht rreth EULEX-it.

Krejt piramida e krimit të EULEX-it në Kosovë që është bërë që prej ka ardhur ky mision këtu, është bërë në koordinim absolut me udhëheqjen e Partisë Demokratike të Kosovës. Dhe, në qoftë

se dikush nuk ka fytyrë e moral që ta lëshojë sallën për shkak të veprimeve e antidemokratike të EULEX-it, është pikërisht Partia Demokratike e Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Kosovës dhe deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Në vitin 2012, nëpërmjet Radiotelevizionit të Kosovës kam transmetuar intervista të të burgosurve nga EULEX-i, kur i burgosuri Blerim Kiçina deklaroi që kryeprokurori Salustro i hidhte këmbët mbi tavolinë dhe i fyente të burgosurit shqiptarë. Asnjë njeri në atë kohë nuk ka reaguar. Krerët e Partisë Demokratike të Kosovës e kanë ditur fare mirë se Salustro ka qenë kryeprokuror në bashkëpunim me Partinë Demokratike të Kosovës dhe me Beogradin. Krerët e Partisë Demokratike të Kosovës e dinë se prokurorja e EULEX-it, zonja Arnal, ka marrë vendim në një vilë në Brezovicë, në takim me krerët e Partisë Demokratike të Kosovës, për t'ia ngrehur aktakuzën kryetarit të "Nismës", zotit Fatmir Limaj.

Në qoftë se Partia Demokratike dëshiron të vendosë drejtësi në këtë vend, atëherë duhet të thërrasë seancë të jashtëzakonshme që të flasin për krimet e Prokurorisë së Kosovës dhe për krimet e EULEX-it që janë duke i bërë në Kosovë. Ne e dimë se edhe Bashkimi Evropian, edhe institucionet ndërkombëtare, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po na thonë vazhdimisht se sistemi i drejtësisë në Kosovë është i kapur nga mafia.

Për këtë duhet të diskutojmë këtu, e jo ta lëshojmë sallën e Parlamentit.

Prandaj, ta thërrasim një seancë të veçantë, të jashtëzakonshme, që të flasin për punën e Prokurorisë së Kosovës, të Gjyqësisë së Kosovës, por edhe të EULEX-it, edhe të UNMIK-ut. Ata njerëz që kanë dënuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pala shqiptare, sot janë në piramidat e drejtësisë të Kosovës.

Prandaj, në shenjë proteste, unë do të vazhdoj të qëndroj këtu në këtë seancë dhe të flas brenda Parlamentit për atë që neve na dhemb. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: E nderuara kryesuese!

Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Për sot, në orën 12:00, është paralajmëruar numërimi i votave me kusht, i cili do ta përmbyllë procesin e zgjedhjeve lokale. Tashmë është e qartë se kush do të udhëheqë me komunat e Kosovës. Qytetarët e Republikës kanë vendosur të dielën e 19 nëntorit.

Por, prej të hënës, regjimi e filloi fushatën e tij. U bënë bashkë Veseli dhe Haradinaj, Thaçi e Mustafa, mafia e ndërtimit, e uzurpatorët, të korruptuarit e të dëshpëruarit.

Që ta luftojnë qytetarin. Duke ia sulmuar votën. Si gjithnjë.

Nuk mund të ketë rezultat tjetër, as në Prishtinë, e as në Prizren, përveç atij për të cilin kanë vendosur qytetarët. Gara elektorale fitohet duke i bindur qytetarët me program në terren. Jo me manipulime në tavolinë, me koalicione nën tavolinë, me shpifje e gënjeshtër, duke përdorur e keqpërdorur ato medie që janë themeluar për t'u shërbyer këtyre manipulatorëve.

Nuk mund ta vidhni votën e qytetarit. Këto zgjedhje treguan se as nuk keni mundur ta blini vullnetin e qytetarëve. Nuk mund ta ktheni mbrapsht fitoren e qytetarëve. Vota e qytetarëve vendosi që Prishtina ta vazhdojë mirëqeverisjen me Shpend Ahmetin, që Prizreni ta fillojë mëkëmbjen e zhvillimin nën drejtimin e Mytaher Haskukës dhe që Dardana ta nisë rrugën e të bërit komunë e qytetarëve me kryetar Qëndron Kastratin.

Nuk mund ta vidhni këtë fitore, nuk mund t'ua vidhni këtë të ardhme qytetarëve tonë, këtë nuk ua lejojmë. Bëhuni bashkë sa të doni. Shtini sa të doni para, kërcënoni sa të doni, koha juaj ka përfunduar. Nuk mund të kthehemi para 11 qershorit 2017.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit të LDK-së, fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Unë sot jam përgatitur të flas për një temë zhvillimore që ka të bëjë me heqjen nga agjenda legislative e Ligjit për arsimin e lartë, propozim-ndryshimin e atij ligji dhe të ecim tutje dhe ky vend t'i kthehet normalitetit, ky Parlament të vazhdojë të punojë në mënyrë normale. Por, definitivisht, nuk po mund ta gjejmë atë konsensusin edhe si të zgjedhur të popullit, dhe tani kur i dëgjojmë edhe diskutimet e fundit, fushata elektorale ka mbaruar, balotazhi për zgjedhjet lokale ka mbaruar, nuk duhet ta keqpërdorim këtë foltore dhe të shpallim heronj e tradhtarë, kriminelë dhe njerëz "të ndershëm", e tjera, e tjera.

Unë dua t'i referohem tani bojkotit të kësaj seance nga Partia Demokratike e Kosovës, por edhe kolegëve nga ana ime e djathtë e opozitës. Dje e ka pasur përvjetorin e vrasjes ish-këshilltari i presidentit Rugova, Xhemajl Mustafa, një intelektual, një veprimtar. Pse nuk e ngrehni çështjen për vrasjet politike në Kosovë? Dikujt mbase është duke i djegur diçka tjetër, e janë disa elemente dhe disa vizita që kanë të bëjnë me ata që e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje. Tani flasim për EULEX-in, për Gjyqësorin... Ju lutem, si të zgjedhur të popullit, nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në drejtësi. Ne kemi të drejtë të komentojmë, të japim vlerësime dhe të ngremë çështje që kanë të bëjnë me Legjislativin. E drejta dhe drejtësia kanë për të ardhur në sipërfaqe.

A e ngriti dikush zërin, pos njerëzve të LDK-së? E kanë përgjakur Parlamentin, ish-komandantin e FARK-ut për Rugovë, Smajl Hajdarin, deputet i zgjedhur! Atëherë ku është morali këtu për

drejtësi? Kush e ka përmendur vrasjen e kryetarit të Klinës, i zgjedhur në mënyrë plebishitare, Ismet Rraci? Ç'është kjo demagogji?!

Dhe, kush e ka ngrehur zërin për vrasjen e kryetarit të Suharekës, i zgjedhur në mënyrë plebishitare, Ukë Bytyçi? Kush e ka ngrehur çështjen e vrasjes së Shaban Manajt, një veprimtar i çështjes kombëtare i të gjitha periudhave. Ju lutem, duhet të jemi parimorë. Kur shesim moral politik, të mos përdorim demagogji, po thjesht të sillemi si njerëz të zgjedhur. T'ia kthejmë vlerën e deputetit, e të të zgjedhurit të popullit vetvetes dhe këtij institucioni.

Në këtë kuptim, kush është bërë bashkë? Në Kamenicë zoti Kurti është koalicioni me Listën serbe dhe trumbetoni... Ju lutem, ju kemi ndihmuar në disa komuna, nuk jemi penduar. Është çështje e marrëveshjeve politike dhe duhet të jemi të përgjegjshëm, tani janë mjetet e informimit, është teknologjia informative dhe kurrkush nuk ha barë, këtë duheni ta dini.

Jemi këtu për garë politike, për platforma politike, kemi dallime të mëdha konceptuale e ideologjike, por duhet të sillemi në mënyrë intelektuale, në mënyrë politike, në mënyrë institucionale dhe t'i kemi vlerat dhe parimet e një përfaqësuesi dhe të të zgjedhurit të popullit. Drejtësia do të zbardhet, do të hapen ama bash të gjitha rastet. Jemi të përgatitur t'i hapim të gjitha temat.

Po jua them edhe një herë, të sillemi si kolegë, si të zgjedhur të popullit, të flasim për tema zhvillimore e nacionale, jo të dalë dikush këtu dhe të trumbetojë, të bëjë propagandë, e atje bën koalicion me Listën serbe. Jemi shumë krenarë si LDK, po edhe si grup parlamentar, për të gjitha veprimet, koalicionet dhe garën dinjitoze zgjedhore. Janë këtu edhe disa të tjerë që kanë blerë vota dhe kanë bërë pazare me Listën serbe, të gjitha në vazhdim të punës së këtij Parlamenti do t'i bëjmë publike. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Më rastisi ta marr fjalën pas Naserit dhe sigurisht se nuk mund të mos përgjigjem në këto akuza që i bëri kundrejt Lëvizjes “Vetëvendosje”. E para, zoti Rugova, ju keni qenë në Qeveri tre vjetët e fundit. Domethënë, Qeveria e kaluar tre vjet ka qenë në krye me Isa Mustafën dhe LDK-në. Pse nuk ndërmerrenit veprime për të hetuar vrasjen e aktivistëve politikë të LDK-së dhe aktivistëve të tjerë? Dhe, tjetra, unë sot edhe një herë po ju bëj publikisht thirrje, jepni nënshkrimet për hetimin e SHIK-ut. Ne 32 deputetët e “Vetëvendosjes” në zyrë i kemi nënshkrimet, në zyrë e kemi kërkesën për hetimin e SHIK-ut. Pse po hezitoni të hetohet SHIK-u?

Çdo ditë flisni se si SHIK-u ka qenë organizatë kriminale dhe ilegale dhe unë pajtohem me këtë, mirëpo hajde, nëse jeni për ta hetuar SHIK-un, ta bëjmë bashkë Komisionin Hetimor, i cili i heton të gjitha pretendimet.

Pra, unë sot po ju bëj thirrje dhe po ju njoftoj, zoti Rugova, se në alternativën tonë qeverisëse kanë qenë të parapara 40 pikat për qeverisjen e ardhshme që i kemi pasur në zgjedhjet e 11 qershorit, ka qenë e paraparë themelimi i departamentit që i heton të gjitha vrasjet politike. Dhe, pse s'u bë Qeveria, i ka fajet LDK-ja dhe këtë e dini shumë mirë. Me theks të veçantë, i ka fajet Isa Mustafa dhe këtë e dini shumë mirë, sepse ai s'e duron "Vetëvendosjen" në krye të institucioneve të vendit, sepse e di se do të japë edhe ai llogari për të gjitha krimet që i ka bërë në Komunën e Prishtinës, lëndët që i ka dërguar "Vetëvendosja" në Komunën e Prishtinës.

Andaj, lërimi hipokrizitë, mjaft! Lërimi hipokrizitë, është e papranueshme! Dhe, po, kur në krye të qeverisë do të jetë "Vetëvendosja" do të hetohet edhe vrasja e Astrit Deharit apo vdekja e dhunshme e tij në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, por edhe e të gjithë aktivistët politikë, në këtë rast që kanë qenë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ajo kohë do të jetë shumë shpejt.

Në qoftë se kam minutë tash po e marr arsyen të diskutoj atë që e kisha për qëllim. Jemi afër 100-ditëshit të Qeverisë së Haradinajt dhe shihet hapur se Qeveria Haradinaj ka mendësi të njëjtë, mendësi të mbrapshtë të qeverisjes. Po flitet shumë se si kjo Qeveri përbrenda këtij mujori ka arritur të bëjë shumë punë, por në fakt ajo çfarë kanë në mendje qytetarët në vazhdimësi është se si çdo ditë rritet numri i zëvendësministrave. Deri më tani ka arritur që ky numër të jetë diku 70 zëvendësministra dhe ka pretendime të rritet ende më shumë, për shkak të pazareve që i kanë bërë edhe ndërmjet partive të koalicionit, por edhe me njerëz që i kanë ndihmuar për ta krijuar këtë qeveri të pazareve, edhe me Listën serbe, por edhe qeveri të pazareve ndërmjet partive politike.

Kjo është barrë tepër e rëndë për qytetarët e Republikës, kur dihet se qytetarët po vuajnë nga papunësia dhe varfëria dhe sigurisht se Lëvizja "Vetëvendosje" kundërshton këtë mendësi të mbrapshtë...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESJA: E dini që replikë në këtë pikë nuk ka. 30-minutëshi për deklarime jashtë rendit të ditës ka kaluar. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

2. Koha për pyetjet parlamentare

Para se të vazhdojmë me këtë pikë kisha kërkuar mendimin e shefave të grupeve parlamentare nëse dëshirojnë të vazhdojmë, meqenëse, siç po e shihni, nuk e kemi prezent asnjë anëtar të Qeverisë.

Në emër të “Vetëvendosjes” fjalën e ka Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Kjo seancë do të duhej të vazhdonte, për shkak se ne nuk tash nuk mund t’u bindemi tekeve të PDK-së dhe keqllogaritjeve dhe matematikave të tyre që nuk po u dalin lidhur me proceset që po zhvillohen me EULEX-in, me drejtësinë, me Gjykatën Speciale e me krejt këto. Mirëpo, konsideroj se meqenëse nuk është kurrkush prej Qeverisë dhe duket se nuk do të vijë, e këtu e kam një vërejtje serioze për kryeministrin Haradinaj. Ai nuk mund t’u përgjigjet thirrjeve të Grupit Parlamentar të PDK-së. Ai faktikisht, nëse është kryeministër i Kosovës, nuk është kryeministër i PDK-së. Edhe ky Kuvend nuk është i reduktueshëm në PDK, këtu ka “Vetëvendosje”, këtu ka LDK, këtu ka grupe të tjera parlamentare, ata i kanë pyetjet e tyre. Ai është këtu për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe për të diskutuar me të gjithë deputetët. E nëse është kryeministër i PDK-së dhe veç i PDK-së, atëherë le t’i shkojë mbas Memli Krasniqit.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: E nderuar kryesuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Ne sot erdhëm në seancë të përgatitur për të diskutuar për rendin e ditës.

Ky Kuvend është shndërruar në arenë të përplasjeve për interesa të ngushta politike dhe individuale, shpeshherë. Grupi Parlamentar i PDK-së doli nga salla pa asnjë konsultim paraprak dhe pa na e dhënë fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare se çka mendojmë për çështjen që u ngrit nga grupi i tyre parlamentar. Pas kësaj, grupi tjetër parlamentar këtu i opozitës, prapë po e shfrytëzon foltoren për të promovuar agjenda të ngushta politike. Po harroni që dje është marrë një vendim në Hagë për dënimin e një kriminelit serb për krimet që kanë ndodhur në Bosnjë.

Në vend se ne sot të diskutonim për iniciativat demokratike, ligjore, parlamentare, që duhet t’i artikulojmë si shtet, si shoqëri demokratike, se si të shkojmë përpara në dënimin e gjenocidit që ka ndodhur në Kosovë, kapen deputetët të caktuar për çështje që përzihen, që janë shkelje ligjore, faktikisht. Kuvendi nuk përzihet dot në vendimet e gjykatave.

Këtu është shndërruar kjo foltore e Kuvendit dhe ky Kuvend në arenë të përplasjeve se kush po e fyen e po e nënçmon tjetrin më shumë se tjetri. Kjo nuk ka asnjë kuptim, nuk ka asnjë kuptim të

vazhdojë seanca në këtë mënyrë, pa praninë e Qeverisë dhe të pozitës. Edhe ashtu nuk kemi kuorum.

Unë lus deputetët, edhe të pozitës, edhe të opozitës, të jenë të arsyeshëm. Kemi çështje shumë më të mëdha për të diskutuar se sa agjenda të ngushta individuale. Do të vijë koha kur do të zbardhen rastet e vrasjeve politike që kanë ndodhur në Kosovë pas lufte, ju garantoj për këtë. Do të vijë koha kur do të zbardhen edhe rastet që po hetohen tash, që janë nëpër procedura gjyqësore, ku kërcënohen gjyqtarë nga ana e deputetëve dhe aktivistëve politikë. Por, nuk mund ta shndërrojmë Kuvendin në një arenë të përplasjeve politike për agjenda të ngushta.

Duhet ta dinë deputetët e Kosovës dhe të gjithë vendimmarrësit politikë në Kosovë që pavarësia e Kosovës nuk është e konsoliduar ende, prandaj kemi agjenda shtetërore që duhet çuar përpara. Pavarësisht faktit që pozita është plotësisht e papërgjegjshme, ne nuk guxojmë të lejojmë që një pozitë e papërgjegjshme të determinojë punën e Kuvendit dhe të institucioneve të vendit. Duhet të bëhemi bashkë për agjenda shtetërore, për të konsoliduar shtetësinë e Kosovës. Unë ju garantoj, kur të konsolidohet shtetësia e Kosovës, ne do të jemi të zotët e shtëpisë plotësisht, të mos e kemi EULEX-in, por t'i marrim në dorë me kredibilitet organet e drejtësisë dhe të shkojnë deri në fund hetimet me të gjitha rastet që kanë ndodhur.

Unë propozoj, kryesuese e seancës, që ne ta ndërpresim seancën e të vazhdojmë nesër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Meqenëse, para tërheqjes kryetari i Kuvendit e dha si propozim në emër të PAN-it që seanca e sotme të vazhdohet nesër në orën 10:00 dhe të pranishëm në sallë janë vetëm 44 deputetë, kisha kërkuar edhe një herë deklarinimin e shefave të grupeve parlamentare që janë prezentë në sallë, të deklarohen nëse janë të pajtimit që nesër të vazhdohet kjo seancë në orën 10:00?

Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” fjalën e ka shefi i grupit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Kjo lojë e Partisë Demokratike të Kosovës po kërkon që edhe Kuvendi të mbetet peng i veprimeve të tyre të papërgjegjshme. Mendoj se nuk duhet t'i bindemi, prandaj propozoj që seanca të vazhdojë javën tjetër.

KRYESUESJA: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Unë propozoj që seanca të vazhdojë të hënën, në orën 10:00.

KRYESUESJA: Atëherë, e ndërpresim seancën në këtë pikë dhe ju njoftojmë për vazhdimin e seancës.

E premte, më 24 nëntor 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 nëntor 2017

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 23. 11. 2017.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së, u lajmërua ndërkohë. Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Mua më vjen keq për mënyrën se si po zhvillohen punimet në Kuvendin e Kosovës. Dje kishim 23 pika të rendit të ditës dhe ne po presim të fillojë seanca normalisht. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së doli e dha një propozim, as fjalën nuk ua dha kryetarëve të grupeve të tjera parlamentare për të dhënë vlerësimin për atë propozim dhe u ndërpre seanca.

Pasdite në Kryesinë e Kuvendit ju e përdorët fuqinë e votës për ta caktuar sot seancën në orën 10:00, edhe pse ky është një precedent i llojit të vet, sepse mbledhjet e seancës caktohen me një farë konsensusi brenda Kryesisë së Kuvendit. Prandaj, në shenjë të saj, të mospajtimit tonë me këtë sjellje, ne do ta lëshojmë seancën e sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hoti!

Për korrektësi, seanca nuk është ndërprerë, ka vazhduar pastaj me praninë tuaj dhe ju e keni ndërprerë. Pastaj kemi vepruar në bazë të procedurave, më vjen keq për këtë situatë.

Atëherë, e vazhdojmë seancën:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta, janë gjithsej të parashtruara 36 pyetje parlamentare.

Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin Flamur Sefaj. Nuk është.

Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për kryeministrin Ramush Hardinaj. Nuk është.

Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për zëvendëskryeministrin Dardan Gashi. Nuk është.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Nuk është.

Çdo herë kur them “nuk është”, në rend të parë u referohem deputetëve, të cilët kanë bërë pyetje, pastaj Kabinetit qeveritar përgjithësisht.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Nuk është.

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është.

Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Nuk është.

Deputeti Fadil Beka, pyetje për ministrin Skender Reçica.

Urdhëro, zoti deputet.

FADIL BEKA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë rreth Komisionit Mjekësor për Përcaktimin e Shkallës së Invaliditetit të Invalidëve të Luftës.

Ju tashmë e keni formuar këtë komision dhe për këtë ju përgëzoj, mirëpo unë kisha dashur të di kur pritet të fillojë punën ky komision mjekësor? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI SKENDER REÇICA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Beka,

Faleminderit për pyetjen tuaj,

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, statusi i dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së dhe të internuarit të UÇK-së konstatohet nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e

Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit të UÇK-së, Veteranit, Pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo të Internuarit të UÇK-së.

Me një vendim të vitit 2011 të ministrit të asaj kohe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është pezulluar e drejta e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së për të aplikuar në realizimin e të drejtës në pension dhe beneficione të parapara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Pas vendimit të Qeverisë me nr. 07/10 të datës 27.10.2017, për raportin e Zyrës për çështjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së në lidhje me listën e invalidëve të UÇK-së, sipas regjistrimit të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëmarrësit apo të Internuarit të UÇK-së, si dhe pas vendimit të Qeverisë nr. 11/13, të datës 10.11.2017, për raportin e zyrës për çështjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së në lidhje me listën e dëshmorëve të kombit kemi marrë vendim për themelimin e komisionit mjekësor për vlerësimin e shkallës së invaliditetit sipas legjislacionit në fuqi.

Aktualisht jemi duke finalizuar procedurat për themelimin e këtij komisioni mjekësor, i cili do të formohet në marrëveshje edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe do të jetë në përbërje nga mjekë të fushave të përcaktuara me ligj. Ju informoj se invalidët e luftës nga 1 dhjetori mund të aplikojnë për realizimin e të drejtës në pension dhe beneficione të parapara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Nuk ka pyetje tjetër.

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Zonja deputete, fjala për ju!

Regjia, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përsëritje kryeministër,

Ministra, kolegë deputetë,

Pyetja ime, i nderuar ministër, ka të bëjë me Ligjin për punëtorët e arsimit shqip të viteve të '90-ta. Është përmendur që ky ligj vërtet është me nevojë të veçantë për punëtorët, duke e ditur edhe sakrificën e tyre ndër vite. Pyetja ime është se a është e gatshme ministria juaj që të nxjerrë këtë ligj, ngase qysh në mbledhjen e komisionit të vitit 2013 është nxjerrë një përfundim edhe nga Kryesia e Kuvendit me nr. 04 P/140 dhe ka nxjerrë rekomandimet, ku obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë ligjin dhe njëkohësisht t'u njihet stazhi i punës së mësimdhënësve dhe personelit të punësuar në arsimin shqip nga vitet 1990-1991.

Ndërsa, për të njëjtën çështje ky Kuvend, po ashtu në vitin 2013, nxori tri rekomandime, ndër të tjera, pra ishte obligimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta hartojë ligjin në afat kohor prej tre muajsh. Sot, pra, kanë kaluar katër vjet që nga viti 2013 dhe ai afat prej 3 muajsh është stërzgjatur. Pra, kur do ta sjellë këtë ligj ministria juaj? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit dhe faktikisht ajo çka u tha nga e nderuara deputete Haxhiu, se ky ligj ka qenë kërkesë nga Parlamenti i Kosovës që të kemi një projektligj dhe të vijë në parlament në kohë sa më të shkurtër, siç ishte paraparë në atë kohë për tre muaj, ekziston një draft ligj për ligjin shqip, për një ligj me rëndësi për mësimdhënësit e viteve '90-'98, por që për shkaqe të kostos së lartë ka mbetur vetëm si procedurë qeveritare dhe asnjëherë nuk ka ardhur në parlament për miratim.

Duke u nisur edhe nga zotimi që kryeministri ka bërë së bashku me SBASHK-un, të njëjtën gjë kemi pasur edhe ne takim direkt me SBASHK-un dhe jemi dakorduar që ky projektligj në fillimin e muajit të ardhshëm, pra 1 dhjetor të vijë në Qeveri për procedurë, më tutje pastaj në procedura të parlamentit. Ne e kemi ngritur grupin punues për projektligjin, sepse ekziston si projektligj. Jemi duke e rishikuar për ndonjë nen të caktuar, a ka nevojë të ketë ndryshime apo jo dhe jemi të gatshëm që në pjesën e parë të muajit dhjetor ta procedojmë në Qeveri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Nuk ka pyetje tjetër.

Deputeti Lumir Abdixhiku, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Deputeti nuk është.

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, po ashtu deputetja nuk është.

Vazhdojmë me pyetjet e parashtruara për herë të parë. Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputeti Andin Hoti, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Urdhëro, zoti deputet!

ANDIN HOTI: Faleminderit! I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Kujtim Gashi, ashtu qysh e kam shprehur edhe herën e kaluar shqetësimin rreth Ligjit për rininë, prandaj sot kam ardhur këtu që t’jua bëj pyetjen parlamentare në lidhje me Ligjin për rininë. Me ligjin aktual për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë janë disa mangësi, të cilat mendoj që duhet të ndryshohen. E para, mosha e rinisë llogaritet nga mosha 15 deri 25-vjeçare, ndërsa pjesa tjetër e rinisë që është nga mosha 25 deri në moshën 30-vjeçare nuk parashihet në këtë ligj dhe rrjedhimisht është një diskriminim i kësaj moshe, do të thotë e cila mbetet jashtë mundësisë për të fituar projekte, për të bërë praktikë dhe po ashtu punë vullnetare.

E dyta, e cila është me rëndësi të veçantë për të rinjtë e Kosovës, është puna vullnetare dhe praktika në institucionet dhe ndërmarrjet publike. Kërkoj të faktorizohet dhe të njihet edhe si përvojë e punës puna vullnetare, pasi që shumë të rinj në mungesë të përvojës së punës diskualifikohen në fillim nga e drejta për punësim, pasi që njëri ndër kriteret në konkurse për punësim është edhe përvoja e punës. Prandaj, kërkoj që të krijohet mekanizëm që të kenë lehtësi në lidhje me këtë kriter. Një i ri nuk ka ku të bëjë përvojën e punës nëse ligji nuk ia njeh këto dy kategori, do të thotë punën praktike dhe punën vullnetare. Faleminderit!

Do të kërkoj që me plotësim-ndryshim të Ligjit për rininë të ndërhyjmë dhe t’i rregullojmë të dyja kërkesa që i kam parashtruar.

KRYETARI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Hoti, ju falënderoj për pyetjen që e keni ngritur, e që ndërlidhet me pjesën më vitale të shoqërisë sonë për rininë.

Duke qenë se Ligji nr. 03/ L-145, për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë është miratuar në vitin 2009, ky ligj në ditët e sotme nuk po gjen zbatim të plotë për shkak të pengesave dhe mangësive që përkojnë me realitetin e ditëve të sotme. Me marrjen e mandatit si ministër i kulturës, unë kam filluar të analizoj legjislacionin që rregullon fushën e rinisë së kulturës, rinisë dhe sportit dhe kam vendosur që ligjet, të cilat nuk i kryejnë funksionin në shërbim të shoqërisë dhe grupeve të interesit në përgjithësi, të cilave u dedikohen, t’i plotësoj dhe t’i ndryshoj dhe një nga ligjet që do të hyjë në strategjinë legjislative të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018, është pikërisht dhe Ligji për fuqizim dhe pjesëmarrjen e rinisë. Dy nga çështjet kryesore që do të plotësohen dhe ndryshohen me këtë ligj janë pikërisht zgjerimi i moshës së rinisë që rregullohet me ligj, i cili aktualisht është 15 deri 24 vjeç, por edhe puna vullnetare. Edhe përkundër faktit që ka kufizime

në moshë të rinisë, shumë të rinj përtej moshës 24-vjeçare në vazhdimësi kanë përfituar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Sa i përket punës vullnetare, Ministria e Kulturës është në proces të funksionalizimit të platformës elektronike për njohjen e punës vullnetare, por që si platformë involvon edhe institucionet e tjera, të cilat do të kryejnë punën e tyre. Madje, këtë vit edhe me mbështetjen e Komisionit Parlamentar që e mbulon fushën e rinisë dhe me Zyrën e Kryeministrit kemi filluar të diskutojmë mundësitë e inicimit të miratimit të një ligji të veçantë për punën vullnetare, e cila besojmë që do të rregullojë njëherë e mirë çështjen e punës vullnetare dhe në të njëjtën kohë përvojës së punës për të gjithë të rinjtë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Ministri nuk qenka këtu. Zonja deputete, a dëshironi ta bëni pyetjen pa prezencën e ministrit. Më falni, as deputetja, as ministri nuk janë këtu.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

Deputeti Arbër Rexha, pyetje për ministri Kujtim Gashi.

Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Skender Reçica.

Do të thotë, në të gjitha këto raste deputetët nuk janë.

Jemi te deputetja Evgjëni Thaçi-Dragusha, pyetje për zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli. Zonja deputete, zëvendëskryeministri nuk është këtu, a dëshiron ta bësh pyetjen apo ta lësh kur të vijë? Kur të vijë zëvendëskryeministri.

Atëherë, vazhdojmë. Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

Deputetja Vjosa Osmani-Sadriu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

Ganimete? Nuk është. Prapë është Ganimetja, edhe dy pyetje i ka pasur për ministrin Uran Ismajli, nuk është e pranishme.

Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputeti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin Abelard Tahiri.

Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kërkoj falje, për besë!

ZAFIR BERISHA: Jo, jo, s'ke faj. Faleminderit!

Zoti kryeministër, në raportin vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 janë konstatuar shumë rekomandime të pazbatueshme nga njësitë buxhetore. Gjithashtu, është konstatuar se disa ndërmarrje publike vazhdojnë të operojnë me humbje financiare, me ç' rast vazhdimisht mbështeten nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët.

Cilat janë ato ndërmarrje publike që punojnë me humbje financiare dhe çfarë masash keni ndërmarrë për bordet dhe menaxhmentin e këtyre ndërmarrjeve?

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Kryeministri Ramush Haradinaj e ka fjalën. Është në konsultim me ministrin e Financave, ose vetë e merr fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Deputetë të nderuar!

Kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,
Kolegë të Kabinetit qeveritar,
I nderuar deputet Berisha,

Në një kohë të caktuar do të përgatisim një raport preciz për pyetjen tuaj. Mund të jap sot disa informata, por po pres që t'i kemi të përgatitura që t'i keni në dispozicion. Faleminderit për pyetjen!

KRYETARI: Faleminderit, zoti kryeministër! Ka pyetje plotësuese zoti Zafir Berisha?

ZAFIR BERISHA: Jo, në fakt, jo pyetje plotësuese, se kam mirëkuptim për qëndrimin e kryeministrit. Besoj se meqë do të përgatitet, e ka nënkuptuar edhe qëllimin e kësaj pyetjeje. Në Kosovë tashmë nuk është ndonjë zbulim epokal se kemi ndërmarrje publike dhe bordet e atyre ndërmarrjeve që kanë tejkaluar çdo që është përgjegjësi.

Unë mendoj se me këtë pyetje kam dashur që nga kryeministri, po kërkoj edhe publikisht nga të gjitha institucionet, ato ndërmarrje ato njësi buxhetore të cilat operojnë me humbje dhe e keqpërdorin paratë publike, duhet dikush nga ta të japë përgjegjësi dhe llogari.

Ideja është që kryeministri, meqë ende i ri, po them kushtimisht, të mendojë në këtë drejtim, për shkak se në fund të fundit ne si qeverisje duhet të kemi një dallim nga...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër...? Në rregull është?
Atëherë, vazhdojmë. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

Deputetja Drita Millaku, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Në sallë janë të pranishëm 43 deputetë. Nuk mund ta miratojmë procesverbalin. Në rrethana të tilla, për mungesë të kuorumit nuk mund të vazhdojmë as me seancën. Vazhdimi i seancës do të bëhet të mërkurën, në orën 10:00. Faleminderit!

* * *

E mërkurë, më 29 nëntor 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23, 24 nëntor

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë seancën e rregullt, kryetarja e Grupit joformal të grave, zonja Blerta Deliu, me rastin e Ditës kundër dhunës ndaj gruas ka kërkuar një fjalë si përfaqësuese e grave deputete dhe dëshiron që në emër tuajin ta bëjë një mesazh për të gjitha gratë e Kosovës.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Të nderuar përfaqësues të Korit diplomatik të akredituar në Kosovë,

Përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që sot jeni të pranishëm në këtë seancë.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka caktuar datën 25 nëntor si Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe kështu ka ftuar qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që të organizojnë aktivitetet për të ngritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë problem.

Kjo fushatë globale më pas është zgjeruar në 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.

Me moton globale “Të mos e lëmë askënd prapa kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave” po shënojmë këtë aktivitet të sotëm, të iniciuar nga Grupi i grave deputete, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës si dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave.

Fushata synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të nxisë veprime për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave jo vetëm në Kosovë, po në mbarë botën.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dy ditë para shënimit të Ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas 25 nëntori, në Kosovë u shënuar edhe një viktimë e tillë. Sevdije Berisha u vra mizorisht me sëpatë nga bashkëshorti i saj.

Rasti i Diana Kastratit, i Zejnepe Bytyqit dhe së fundi i gruas nga Peja, Sevdije Berisha, dëshmojnë për shkallëzimin e dhunës kundër gruas në Kosovë.

Në të gjitha këto raste këto gra e kanë raportuar dhunën, por institucionet nuk kanë arritur të reagojnë mjaftueshëm.

Rasti si ky i fundit na detyron të reagojmë fuqishëm dhe të kërkojmë nga të gjitha institucionet që të merren seriozisht me dhunën dhe vrasjet që po bëhen ndaj grave, dukuri kjo e cila kohët e fundit ka tendencë rritjeje.

Prandaj, bëjmë thirrje që organet e drejtësisë të reagojnë sa më shpejt në hetimin dhe zbardhjen e këtyre rasteve dhe kryesit e dhunës dhe vrasësi të ndëshkohen me dënimin e merituar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përtej kësaj, këtë fushatë dua që t'ua dedikojmë edhe grave, vajzave si dhe burrave që padrejtësisht janë stigmatizuar dhe fajësuar për dhunën seksuale të ushtruar ndaj tyre.

Ato ishin të pafuqishme në këtë kohë për t'u mbrojtur dhe trupi i tyre u shfrytëzua si betejë e luftës dhe si krimi më i rëndë i luftës, duke i lënë ato të pazëshme dhe duke bartur me vete sekrete, të cilat nuk mund të ndaheshin as me familjarët e tyre.

Kjo heshtje e viktimave të dhunës seksuale të luftës favorizonte mosndëshkimin dhe pllakoste edhe më tej stigmatizimin ndaj tyre, por edhe ndaj familjeve të tyre.

Prandaj, pa asnjë përkuqdesje të gjatë që këto gra kanë marrë nga shoqatat e grave, dua edhe një herë që në emër të Grave deputete t'i përgëzoj institucionet që kanë arritur të realizojnë përkuqdesje dhe vëmendje ndaj kësaj plage të luftës, siç janë të mbijetuarat nga dhuna seksuale e luftës.

Në emër të Grupit të grave, të organizatave joqeveritare Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, dua që edhe një herë të bëj thirrje që ato të pranohen nga shoqëria pa paragjykuar e stigmatizuar, pasi ato tanimë kanë përkuqdesjen e shtetit dhe kjo u mundëson që sa më shpejt të gëzojnë beneficionet që ua garanton ligji.

Ftoj institucionet e vendit, shoqërinë kosovare, familjarët që t'i përkrahin këto gra dhe vajza, në mënyrë që të kenë kurajën që të aplikojnë pranë Komisionit qeveritar për njohjen e statusit të tyre dhe të mos stigmatizohen e të paragjykojnë për një krim të luftës, për të cilin këto nuk ishin fajtores.

Këto gra, vajza dhe nëna meritojnë përkrahjen dhe respektin e shoqërisë kosovare, pasi që janë vetë simbol i mbijetesës, qëndresës dhe lirisë, të cilën ne sot e gëzojmë.

Prandaj, nën moton "Të mos e lëmë askënd prapa kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave", dua të përgëzoj Qeverinë e Kosovës që këtë kategori të luftës do ta trajtojë sikurse edhe të gjitha grupet e tjera të dala nga lufta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po futemi në seancën plenare, të filluar më 23 dhe 24 nëntor 2017.

Të nderuar deputetë,
Zonja deputete,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,
Zëvendësministra,
Zëvendëskryeministra,
I vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 23 dhe 24 nëntor.

Në sallë janë 81 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për punë.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet nga seancat e mbajtura më 25, 26 dhe 31 tetor 2017?
Nuk ka vërejtje.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 25, 26 dhe 31 tetor 2017.

Zoti Petroviq, keni vërejtje?
Zoti Petroviq e ka kërkuar fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Pa ja sam se javio pre neko što je glasao, nego niste videli.

Zahvaljujem se predsedavajući,
Uvaženi premijeru,
Članovi Vlade,
Uvaženi narodni poslanici,
Želeo sam još jednom da skrenem pažnju, na ime, na sednici Skupštine Kosova održanog 10. septembra ove godine ukazao sam na kršenju Ustava člana 78. o izboru članova Komisije o pravima interesima zajednica.

Na ime, tada je konstatovano da je moj tumačenje u redu, da će se na narednoj sednici to rešiti, tako što ću u Komisiji biti i član ispred Srpske zajednice, jer Komisija za interese zajednice, broj 4. predstavnika iz srpske zajednice, ne iz političke stranaka, s obzirom da ova sadašnja garnitura ima dve političke stranke koje dolazi iz srpske zajednice, tako da oba predstavnika treba da budu

uključeni u rad Komisije. Tako da od četiri člana, jedan član treba da bude iz druge političke opcije koje dolazi iz Srpske zajednice.

Naime, ono što je situacije danas, do dan danas to nije regulisano, i ako Ustav jasno nalaže da to bude regulisano, i pored toga što smo na toj sednici se dogovorili da će se to regulisati, tražim od ovog parlamenta da poštuje Ustav i da reguliše članove Komisije o pravima i interesima zajednice, jer u suprotnom ja u ovom Komisiji koje sada u ovom sastavu smatram nelegitimno i ništavnom i sve one odluke koje dolaze iz te Komisije smatraću uništavu.

Tako još jednom želim da parlamentu iskrenem pažnju da će se obratim i međunarodnim institucijama i još jednom da vam kažem, dokle god se ne bude rešilo ovo pitanje moj učešće na sednicama biće do dalje.

Još jednom kažem da ovo je Ustav, ovo nije dobrovolja ničija, ukoliko želite da zajednički kršite Ustav, ja ne želim da učestvujem u to. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe pse realisht me vonesë në procedurë jeni paraqitur, është dashur të paraqiteni më herët, por unë nuk desha t'jua marr fjalën.

Unë ju kam dëgjuar edhe më herët sa i përket kësaj çështjeje, mendoj që duhet të procedojmë kërkesën tënde në komisionet përkatëse dhe në Kryesi dhe pastaj të shohim se si jepen orientimet ose si merret vendimi në Kryesi ose në Kuvend. Unë nuk jam kundër të shqyrtohet mundësia dhe e drejta kushtetuese e secilit deputet, edhe juaja personale. Faleminderit!

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryesues,

Në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës para jush paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë është miratua nga Qeveria e Kosovës me Vendimin nr. 03/03 të datës 18. 9. 2017. Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në avancimin e kornizës ligjore, e cila e rregullon statusin juridik së bashkësive fetare, organin kompetent për regjistrimin, përkatësisht çregjistrimin e bashkësive fetare në Kosovë, pozitën e tyre juridike, fondet dhe donacionet e tyre.

Me Ligjin në fuqi njihen pesë bashkësi fetare në Kosovë, të cilat e përbëjnë edhe trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit. Këto bashkësi janë: Bashkësia Islame e Kosovës, Kisha Ortodokse Serbe, Kisha Katolike, Bashkësia e Besimit Hebrej dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës. Në projektligj është shtuar edhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës si bashkësi që përbën trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit.

Për më tepër është e rëndësishme të theksohet që ky projektligj është hartuar duke u bazuar në konventat ndërkombëtare, si dhe opinionin e Komisionit Venedikut nr. 743/2013I, i miratuar në sesionin e 98-të plenar. Gjithashtu, lidhur me këtë projektligj propozoj që neni 6 i projektligjit, në të cilin shtohet neni 7b, regjistrimi i bashkësive fetare, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2., riformulohet si në vijim. Pra, “me rastin e themelimit të paraqesin listën e anëtarëve shtetas, të moshës madhore të Republikës së Kosovës”. Më herët ka qenë “numri 50”, tani nuk është më numri, por mbetet përmbajtja, dhe paragrafi 3 i nenit të ri 12a te fondet, pra te financimet, fshihet në tërësi.

Kam nderin që pata rastin pra të ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet që rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Dua vetëm ta shtoj një argument, janë dy ligje, të cilat e aftësojnë ose i plotësojnë kriteret e Kosovës për anëtarësim në UNESCO, e ky është njëri nga këto dy ligje. Faleminderit!

KRYESUESI:Faleminderit, zoti kryeministër!

Tani e ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Duda Balje, që ta marrë fjalën.

DUDA BALJE: Faleminderit!

Komisija za ljudska prava, rodno ravnopravnost, nestalih lica i peticija, shodno člana 56, tačka 2 Poslovnika, na sednici održanog 18. 10. 2017. godine razmatrala je Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona verskim slobodama na Kosovu, i odlučila da Skupštini dostavlja preporuku da se isti usvoji u prvom čitanju. Na osnovu člana 56, stava 2 Poslanika, Funkcionalna komisija pre prvog razmatranja Nacrta zakona na plenarnoj sednici, nacrt zakona je prošlo u načelo i dostavljen izveštaj sa preporukama.

Komisija nakon načelnog razmatranja Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o verskim slobodama na Kosovu ocenila da isti ispunjava uslove predviđene člana 54 Poslovnika i

preporučila Skupštine ne njegovu načelna razmatranje. Nacrt zakona će procesirati na plenarnoj sednicu u skladu sa članom 81 i amandmana 2 Ustava Republike Kosovo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosja”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, ky është një ligj shumë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës. Një ligj i tillë ka ekzistuar, por kemi të bëjmë me plotësimin dhe ndryshimin e tij, i cili është sjellë si propozim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne e dimë tashmë që Kosova edhe me nenin 8 të Kushtetutës së vet si shtet përcaktohet si shtet laik dhe neni 8 i Kushtetutës thotë që Republika e Kosovës është shtet neutral në çështjet e besimeve fetare.

Prej këtij neni të Kushtetutës më pastaj rrjedhin edhe të gjitha ligjet që e rregullojnë këtë fushë dhe që duhet të jenë patjetër në përputhje me Kushtetutën si akti më i lartë juridik, me të cilën qeveriset Kosova, mirëpo sa u përket ndryshimeve që kanë ardhur si propozime të Qeverisë për ligjin rreth të cilit po diskutojmë, desha t’i them disa fjalë. Këtu në arsyetimet të cilat i lexova sa i përket harmonizimit të këtij ligji me të gjitha, le të themi atë korpusin legjislativ të Bashkimit Evropian, nuk e pashë kurrkund një mendim të Komisionit të Venedikut. Është mendim shumë i rëndësishëm që e ka dhënë për lirinë fetare në përgjithësi nëpër vendet e Bashkimit Evropian, dhe sidomos e ka dhënë sa i përket raportit të kësaj lirie me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Siç e dini, Konventa Evropiane të drejtave të njeriut është e zbatueshme në Kosovë, meqenëse është në kuadër të konventave të cilat janë të përfshira në Kushtetutën e Republikën së Kosovës si korpusi i instrumentarimeve ndërkombëtare, të cilat Kosova e ka obligim për t’i zbatuar, sepse ka marrë përgjegjësi me rastin e miratimit të Kushtetutës në prill të vitit 2008 dhe njëra prej dokumenteve më të rëndësishme është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në një mendim shumë të rëndësishëm të Komisionit të Venedikut për Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, thuhet që neni 11 i saj, i cili është nen që merret me të drejtën e asociimit dhe të drejtën e krijimit të organizatave, të drejtën e grumbullimit dhe të asociimit, duhet të interpretohet në përputhje të plotë me nenin 9 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që drejtpërdrejt merret me lirinë fetare dhe aty thuhet që nuk mjafton e drejta e mendimit, apo e drejta thjesht e besimit, pra liria e besimit, nëse nuk është në të njëjtën kohë e manifestuar dhe e bashkëngjitur me të drejtën e organizimit të jetës fetare.

Pra, nëse një shtet e ndalon organizimin e jetës fetare, është njëjtë sikur ta prekë drejtpërdrejt lirinë e besimit, lirinë e fesë dhe mendoj që ky opinion i Komisionit të Venedikut do të duhej të ishte përfshirë në arsyetimet e Qeverisë që i ka dhënë këtu sa i përket harmonizimit të këtij ligji me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, pra me ‘acquis communautaire’.

Kështu që është shumë mirë që më në fund në Kosovë po vjen një ligj, i cili po ua njeh statusin juridik entiteteve fetare, pra bashkësive fetare, mirëpo një problem që na shfaqet menjëherë në fillim të ligjit, e ka të bëjë me faktin që nuk ekziston kurrfarë dallimi ligjor të paktën unë nuk kam mundur ta vërej. Ndoshta kryeministri apo ai që i ka ngarkuar me kompetencë për këtë punë mund të na e shpjegojë, mirëpo nuk ekziston kurrfarë dallimi ndërmjet këtyre gjashtë bashkësive fetare, të cilat ju i keni vendosur si bashkësi fetare tradicionale dhe historike, pra me karakter historik në Kosovë, të cilat e kanë një kohëzgjatje të veprimtarisë në Kosovë, e kanë një organizim tashmë të etabluar dhe të mirënjohur, i cili është pjesë e ekzistencës sonë shoqërore dhe historike. Pesë bashkësive fetare ekzistuese, të cilat kanë qenë të parapara edhe me ligjin paraparak i është shtuar edhe bashkësia e gjashtë tradicionalisht historike në Kosovë, që është Bashkësia e Tarikateve.

Mirëpo, tash me këto rregullat se si të formohen bashkësitë e reja fetare në Kosovë, nuk ka kurrfarë dallimi ndërmjet këtyre bashkësive tradicionale historike dhe të këtyre bashkësive të reja tash, të cilat do të krijohen. Atëherë ku është dallimi, po pyes unë. Ku është dallimi ligjor? Nëse s'ka dallim ligjor, pse i keni dalluar në tekst, pse ekzistojnë bashkësitë fetare tradicionalisht historike në Kosovë dhe ato të cilat kanë të drejtë të krijohen tash e tutje dhe për të cilat ka edhe rregulla të përcaktuara me këtë ligj. Prej rregullave të përcaktuara, e që ka qenë më problematikja, bile kjo ka qenë edhe arsyeja pse Lëvizja "Vetëvendosje" do të kishte abstenuar sa i përket këtij ligji, po të mos ndryshohej nga kryeministri, është kuota e numrit për regjistrim, pra kuota prej 50 anëtarëve.

Shtetet e Bashkimit Evropian, me sa i kam lexuar ato mënyrat se si e rregullojnë këtë punë, variojnë. Kuotat që janë të nevojshme për regjistrimin e një bashkësie të re fetare variojnë, meqë ka shtete që t e kanë më të ulët se 50 numrin, kurse shumica e shteteve e kanë më të lartë se 50 kuotën e nevojshme për regjistrimin e bashkësive të reja fetare. Për shembull, Hungaria e ka 100, është minimumi i nevojshëm i atyre që duhet të mblidhen për ta regjistruar një bashkësi të re fetare. Mirëpo, maksimumi në shtetet e Bashkimit Evropian është shteti i Sllovakisë, për shembull, i cili e ka kuotën prej 20 mijë anëtarëve, të cilët mund ta themelojnë një bashkësi të re fetare. Domethënë, ka kushte më strikte dhe më konservative për krijimin e bashkësive të reja fetare.

Kosova duhet ta shikojë me shumë vëmendje këtë dhe me shumë kujdes përpara se të vendosë se cila do të jetë masa e arsyeshme, pra kuota e arsyeshme e njerëzve të nevojshëm për ta themeluar një bashkësi të re fetare dhe është shumë mirë që kryeministri e tërhoqi nga Qeveria pikërisht këtë pikë, sepse kjo do ta ndërlikonte mendoj gjendjen aktuale në të cilën ndodhet organizimi i jetës fetare, meqë është mjaft e ndërlikuar dhe mendoj që do ta komplikonte edhe më tej dhe do të paraqiste pakënaqësi të mëdha lidhur me këtë kuotë shumë të ulët dhe problematike sa i përket krijimit të bashkësive të reja fetare.

E fundit që dua të them është kjo: Nuk e di sa është menaxhuar mirë procedura e konsultimit të bashkësive fetare. Për shembull, nuk është mirë që Kosova ta miratojë një ligj kaq të rëndësishëm dhe më pastaj të kemi reagimin e bashkësive fetare dhe ato të shprehin pakënaqësi pasi ne ta miratojmë këtë ligj në këtë seancë. Pra, nëse tash ne me këtë ligj, në mënyrën se si po e votojmë, nxisim një debat edhe më të madh fetar në Kosovë, unë mendoj që kjo nuk do t'i kontribuonte një ambienti që ka qenë dhe një tolerance fetare e ndërfitare në Kosovë, që ka qenë njëfarë lloj tipari shumë i vlefshëm karakterizues i jetës fetare në Kosovë dhe i jetës sonë shoqërore në përgjithësi, që ka qenë diçka me të cilën gjithmonë jemi mburrur, por edhe jemi lavdëruar prej të tjerëve. Nëse kjo preket me pakujdesi në trajtim, atëherë unë mendoj që i kemi bërë dëm Republikës së Kosovës. Kështu që nuk e di sa janë konsultuar deri në fund bashkësitë fetare, sepse unë kam parë nëpër debate që ato janë shumë të zjarrta ndërmjet bashkësive fetare dhe le të themi ato kanë pasur vërejtje në drejtim të Qeverisë që nuk janë konsultuar ashtu siç duhet.

Kjo përgjegjësi i bie edhe Qeverisë së kaluar, sepse në kohën e saj, ky ligj është tërhequr njëherë, nëse ju kujtohet. Nuk e di edhe sa Qeveria e kaluar sa i ka konsultuar bashkësitë fetare për të ardhur deri te një version, siç është ky i tanishmi, sepse ky i tanishmi është përgatitur edhe më herët, pra nuk është punë ekskluzive e kësaj Qeverie, por unë do të bëja thirrje që të kemi më shumë kujdes edhe në konsultimin e bashkësive fetare, që të mos të na ndodhin debate të padëshirueshme, të cilat na çojnë në drejtime jo të duhura.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, Glauk!

Edhe për diskutuesit tjerë, se kisha mundur që të pres edhe në fund, por tek kjo e kuotës ishte shumë e vështirë për ta përcaktuar një kuotë për këtë temë. Pra, edhe nëse e bën më të madhe, prapë është njëfarë vështirësie për ta gjetur cila është realja, sepse kishte praktika të ndryshme, por fakti që s'ke fare kuotë nuk thotë që gjithkush mund të regjistrohet. Pra, ekziston një procedurë e caktuar, mënyra e vlerësimit, pesha e asaj kërkesë.

Beso që deri diku më mirë që s'e ke fare një numër të caktuar, se dikush mund të thotë ja i kam këto dhe kaq, dhe tani ti ke arsye për ta diskutuar seriozitetin e kërkesës, parametrat tjerë. Njëkohësisht, te konsultimet me bashkësitë fetare, unë kam pasur nderin ta ftoj në fillim Bashkësinë Islame, myftiun Tërrnava dhe disa kolegë, i kemi diskutuar plot aspekte të ligjit. Kuptohet, ata e kanë pasur një mendim se situata nuk është krejt e barabartë. Për shembull, një bashkësi është më e madhe, ka një situatë tjetër, tjetra kështu... por, megjithatë e kemi arritur një dakordim, pra që është më mirë ta kemi ligjin kështu si e kemi, se sa të mos e kemi fare.

Kam biseduar edhe me tarikatet, edhe ato janë dakord në këtë perspektivë që është paraparë në ligj. Kam pasur rast të flas me Ipeshkvinë e Kosovës, jo me ipeshkvin se ishte jashtë vendit disa ditë, por me zyrtarë të tjerë të Ipeshkvisë, edhe me Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, që janë dakord të gjithë me këtë ligj.

Tani, ne e kemi një ligj që është shumë më i vështirë për të arritur dakordim, është ai për trashëgiminë kulturore. Kur të vijë ai do të jetë shumë më zor, por do të ishte me rëndësi që Kosova ta kalojë këtë ligj për shkak se procedurat e anëtarësimit drejt UNESCO-s u pa që s'janë të lehta herën para kësaj. Me këtë ligj ju siguroj që Bashkësia Islame, e ky ka qenë edhe premtimi i myftiut dhe i kolegëve që janë dakord, dhe njëkohësisht bashkësitë tjera fetare, edhe Ipeshkvia dhe bashkësitë tjera janë dakord. Të paktën, publikisht kështu ma kanë thënë në takime.

Ndërsa, te financimi, aty thuhej që Qeveria nuk financon. S'kemi pse ta kemi një klauzolë që të pengon, nëse në një rast të caktuar vlerësohet një përkrahje për çfarëdo qoftë, për shembull, mund të jetë një ngjarje e përbashkët, një temë apo situatë e përbashkët... Këtë kemi kërkuar të hiqet, sepse nuk është praktikë e mirë. Ka plot vende që shtetet kanë marrë obligime, për shembull, në Kroaci e në vende tjera, ku bashkësitë fetare e marrin një shumë të caktuar, ose një kuotë, ose një situatë, por ajo është në vullnetin, që do të thotë me ligj nuk është paraparë financimi, por në një situatë të caktuar nëse Parlamenti, ose... Urdhëro?

Është hequr klauzola që e ndalon financimin. Pra, ka qenë e paraparë që Qeveria nuk financon, tani është hequr 12-shi, që e ceka më herët. Pra, aty ku ka qenë neni 12/a te fondet, ka qenë "Qeveria nuk financon". E, atë kemi kërkuar ta heqim, ta fshijmë, nuk ekziston ai nen. Pra "nuk financon", ose "financon", nuk është e rregulluar me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do ta përcjell mendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, natyrisht pa përfunduar këtu, me kujdesin në vazhdim që gjatë amendamentimit ky ligj të pasurohet më shumë.

Ky projektligj vjen si pjesë e politikës së përgjithshme për promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Kosova si shtet laik, edhe me Kushtetutën e saj njezh dhe respekton ushtrimin e lirisë fetare, edhe pse shumë shtete të BE-së mjaftohen me garantimin kushtetues të lirisë fetare, shumica prej tyre nuk e rregullojnë me ligj. Mjafton, siç thashë, pra rregullimi kushtetues. Rregullimin me ligj të së drejtës dhe ushtrimit të lirisë fetare ne e bëjmë si shkak i një

varg faktorësh specifike që ka Republika jonë, ku përfshihet konteksti historik e politik i krijimit të shtetësisë, si dhe si pjesë e plotësim-ndryshimit të ligjeve të cilat kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Republika e Kosovës do t'i respektojë bashkësitë dhe komunitetet fetare, duke u bërë thirrje që të regjistrohen me qëllim të marrjes së statusit të subjektit juridik dhe që të sigurojë që të gjitha grupet e regjistruara të jenë të barabarta para ligjit, të ndara nga shteti. Pa marrjen e statusit ligjor nuk do të mund ta ushtrojnë edhe veprimtarinë e tyre. Gjatë amendamentimit, projektligji do t'i qartësojë disa çështje që e kompletojnë dhe e bëjnë të aplikueshëm këtë ligj, e që, sipas mendimit tonë, kemi evidentuar disa nga ato: kriteret për regjistrim; të definohet mënyra se si do të zgjidhet komisioni për regjistrimin e bashkësive fetare; qartësimi më i thuktë i nenit 4.3, që e rregullon mënyrën se si bashkësitë fetare kanë të drejtë për themelimin e institucioneve të ndryshme edukative arsimore. Kjo çështje është e ndjeshme, prandaj ligji duhet ta rregullojë mënyrën e qartë të qëllimit të aktiviteteve të këtyre institucioneve. Pastaj: mënyra dhe kushtet e regjistrimit; saktësimi i paragrafit të parë të nenit 7/b, ku flitet për vullnet apo mos vullnet për regjistrim; mënyra dhe instrumentet e kufizimit të së drejtës së ushtrimit të aktiviteteve të bashkësive fetare, të cilat nuk regjistrohen; saktësimi se personi që aplikon për regjistrimin e bashkësisë fetare duhet të jetë edhe shtetas i Kosovës.

Për këto dhe shumë çështje tjera do të kontribuojmë gjatë amendamentimit të projektligjit, në mënyrë që të gjitha bashkësive fetare t'u ofrohet mbrojtja dhe mundësia për t'i gëzuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, ligje dhe instrumente ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, pa e diskriminuar, por njëkohësisht pa e privilegjuar ndonjërin.

Për fund, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e voton Projektligjin për lirinë fetare për të vazhduar me kontributin e tij gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ne e përkrahim në parim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Gjatë analizës që i kemi bërë si grup parlamentar ne kemi parë që ky projektligj parasheh përcaktimin e statusit juridik të gjashtë bashkësive fetare të Kosovës, të cilat përbëjnë edhe

trashëgiminë kulturore, historike dhe shoqërore të vendit. Po ashtu, projektligji parasheh edhe pasqyrim të fushës normative për rregullimin e lirisë së besimit dhe themelimit të bashkësive fetare, e cila konsiston në eliminimin e zbrazësive ligjore që janë në ligjin aktual. Po ashtu, e rregullon mënyrën dhe kushtet e regjistrimit të bashkësive të reja fetare në Kosovë, shqyrtimin e kërkesave të regjistrimit dhe çregjistrimin e bashkësive fetare në Republikën e Kosovës dhe krijon komisione për regjistrimin e bashkësive të reja fetare. Krahas kësaj, projektligji po ashtu parasheh edhe rregullimin e çështjes së varrezave dhe riteve të varrimit.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës konfirmoj përkrahjen tonë për projektligjin si një obligim që e afirmon progresin e vendit tonë, gjithmonë duke pasur parasysh se shteti i Kosovës duhet t'i respektojë institucionet e bashkësive fetare, por gjithnjë duke e ruajtur laicizmin.

Ne vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim gjatë procedimit të amendamentimit që do të bëhet në periudhën e paraparë kohore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, zoti Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpska lista je razmatrala Nacrt zakona o verskoj slobodi. Mi ćemo ovaj zakon podržati u načelu a naš doprinos ćemo dati kroz Funkcionalnu komisiju i kroz stalne komisije. Hvala!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Plotësim-ndryshimi i Ligjit për lirinë fetare ka qenë edhe në mandatin e kaluar. Është nevojë dhe interes i Republikës së Kosovës, mbi të gjitha, që në Kosovë ekzistojnë bashkësitë fetare, të cilat de facto ekzistojnë, por de jure nuk janë të regjistruara. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim dhe kontributin tonë, normalisht sepse kemi edhe shumë kërkesa të tjera, që gjatë punës në komision do të shohim se ku do t'i bëjmë ndryshimet e nevojshme, duke i përkrahur edhe të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga Qeveria, edhe kërkesat të cilat kanë qenë edhe në mandatin e kaluar nga Komisioni Funkcional pikërisht rreth numrit të regjistrimit të bashkësive fetare.

Unë e përshëndes këtë kërkesë, ngase kështu i ndihmojmë edhe bërjes së ligjeve, që do të jenë në interes, jo vetëm të bashkësive fetare, por të qytetarëve në përgjithësi dhe të jenë sa më të zbatueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”, Kinolli apo Damka, cili? Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj, gjë që është evidente se hap rrugën apo mundësinë ligjore për formimin dhe regjistrimin e një bashkësie fetare, përkatësisht bashkësisë fetare të tarikateve.

Grupi Parlamentar “6+” si shqetësim e ka pasur numrin e nevojshëm për themelimin e bashkësisë së re fetare, e po ashtu edhe çështjen e financimit. Dua të theksoj se Grupi Parlamentar “6+” nuk ka qëndrim të unifikuar rreth këtij projektligji, prandaj qëndrimin do ta japë secili në mënyrë individuale nëpërmjet deklarimit të votës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën” i jep mbështetje këtij ligji dhe në procesin e amendamentimit ndërmjet dy leximeve, leximit të parë dhe leximit të dytë, ftoj deputetët që ta japin kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjala e grupeve parlamentare është shteruar. Vazhdojmë me fjalën e deputetëve, sipas paraqitjes së tyre. Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Unë kam bërë përpjekje që me vëmendje ta lexoj këtë projektligj. I dëgjova edhe vërejtjet e të gjithë kolegeve dhe kolegëve, shumica prej tyre janë vërejtje shumë me vend. Unë kam disa çështje që dua t’i prek në këtë ligj dhe mendoj se të gjithë kolegët dhe koleget do t’i kenë parasysh edhe gjatë leximit të dytë.

Në çdo ligj ne i kemi pikat themeltare, që janë: mënyra e krijimit, statusi që u jepet, prona dhe qasja e shtetit ndaj këtyre subjekteve. Ne këtu i kemi disa çështje, që unë dua t’i theksoj:

Nën një, ne po e bëjmë një ligj që është i domosdoshëm për Kosovën, ka qenë gjatë kohë i domosdoshëm, mirëpo e kemi një dallim që e bëjmë nga personat juridikë që krijohen në Kosovë. Këtu e kemi një numër, që është 50, mandej zoti kryeministër tha “numri hiqet”, që është e drejtë në këtë moment, sepse duhet t’i lihet një diskutimi. Por, e kishim dhe vërejtjen se cili do të jetë ai numër adekuat?

Unë mendoj se ne duhet të shikojmë se si janë krijuar subjektet, ose personat juridikë, që në Kosovë marrin zotësi juridike. Këtu nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndalim, ose me ndonjë kufizim të lirisë së besimit dhe të manifestimit, por e kemi fjalën për krijimin e personit juridik. Edhe ne kemi shembuj në legjislacionin e Kosovës me sindikatat dhe partitë politike, që e krijojnë zotësinë juridike, marrin zotësi juridike. Prandaj, unë mendoj se në këtë drejtim duhet të diskutohet dhe ne do ta japim kontributin tonë më vonë.

Një çështje tjetër është te trashëgimia. Kjo çështje nuk është rregulluar, ky është neni 7, prona në rast të shuarjes së aktiviteteve. Në të vërtetë, problemet kryesore, edhe të personave fizikë, edhe të personave juridikë, është te çështja e pronës. Ku mbetet prona nëse nuk ekziston? Aty janë konfliktet më të mëdha në të vërtetë, edhe në shoqëri. Prandaj, unë mendoj se ky nen është defekt dhe duhet të diskutohet me vëmendje të madhe dhe të rregullohet. E ka shumë shembuj të mirë se si mund të rregullohet bartja e pronës në rast të shuarjes së një subjekti juridik, jo të një bashkësie që nuk e ka karakterin e subjektit juridik.

Edhe një çështje tjetër, krejt në fund, është çështja e kërkesës së kryeministrit që të hiqet paragrafi 3 nga neni 12, te fondet, “Qeveria nuk e financon asnjërën nga bashkësitë fetare...”. Me gjithë afinitetin që të përpiqemi t’i ndihmojmë në këtë rast, unë mendoj se Kosova si shtet laik duhet ta ketë një qëndrim të qartë në lidhje me financimin e subjekteve ose personave juridikë, në këtë rast, të bashkësive fetare.

Unë mund ta marr me mend se ka shumë mendime pro dhe kundër, po ne duhet ta kemi parasysh bazën e krijimit të ligjeve dhe ajo është Kushtetuta, e në bazë të Kushtetutës megjithatë shteti nëpërmjet Qeverisë duhet ta ketë një qëndrim të qartë dhe të saktë në lidhje me financimin e bashkësive fetare.

Sigurisht në leximin e dytë do të jepen edhe argumente të tjera edhe në aspektin gjuhësor, por edhe në aspektin teknik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurtoshi! Fjalën e ka zonja Kalludra.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në rend dite kemi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Mendoj se ky projektligj është njëri nga projektligjet shumë të ndjeshme, të cilat rregullojnë çështjet e ndjeshme, sidomos duke pasur parasysh edhe aktualitetin tonë.

Nevoja për plotësimin e Ligjit për lirinë fetare konsiston eliminimin e zbrazëtive ligjore, të cilat ekzistojnë në ligjin aktual.

Siç e dimë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, te neni 8 përcakton se Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare.

Kurse te neni 9, Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

Kushtetuta pohon të drejtën e lirisë e ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për të ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fetar, për të ushtruar apo për të mos e ushtruar fenë, për t'iu bashkuar apo refuzuar për t'iu bashkuar një bashkësie fetare.

Kushtetuta garanton të drejtat e barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, përcakton që vendi është shtet laik dhe neutral lidhur me fenë. Siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së vet fetare dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe.

Me qëllim të ruajtjes së ekzistencës të tolerancës fetare në Kosovës dhe të kemi një rregullim më të mirë ligjor, ne duhet të trajtojmë me kujdes të shtuar këtë projektligj, që ta përmbushim edhe qëllimin për çka edhe është ndryshuar.

Pra, të qartësohen kriteret sa i përket themelimit të bashkësive të reja fetare, duke saktësuar kushtet për njohjen e statusit juridik të një bashkësie fetare, sepse një grup fetar pa statusin e personit juridik nuk mund të zotërojë ose të ushtrorjë të drejtat që lidhen me statusin juridik të entitetit.

Të drejtën e zotërimit të pronës ose marrja me qira e pronës, mbajtja e llogarisë bankare, punësimin e punëtorëve, të sigurojë mbrojtje ligjore të komunitetit, anëtarëve dhe pasurisë së saj.

Po ashtu të shqyrtohet edhe çështje e kuotës. Komisioni të kërkojë nga sponsorizuesi i projektligjit të shpjegojë se si është bërë përcaktimi i kuotës së paraqitur. Konsiderojmë se çdokujt i jepet mundësia që nëpërmjet këtij numri kaq të vogël të anëtarësisë të themelojë bashkësi të reja fetare, siç është paraparë me këtë projektligj.

Pra, shumë lehtë do të mund të themelohen bashkësi të reja fetare në vend, të cilat do ta dëmtonin imazhin tonë karshi botës së qytetëruar dhe të civilizuar demokratike.

Po ashtu të parashihet edhe mundësia që gjatë fazës së regjistrimit të bashkësive fetare të verifikohen aktet e brendshme të tyre, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të bien ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Një çështje tjetër, të shqyrtohet mundësia, pra, të parashihet një mbështetje financiare shtetërore e bashkësive fetare të regjistruara, në proporcion me numrin e anëtarësisë së tyre.

Në këtë rast, të zvogëlohet anëtarësia të cilën e paguajnë qytetarët të bashkësitë e tyre fetare. Po ashtu, nëse parashihet mbështetja financiare shtetërore, besoj se do të kemi një stabilitet financiar. Në këtë rast, nëse edhe në të ardhmen bashkësitë fetare vazhdojnë të shikojnë mundësinë e mbijetesës dhe aktivitetet e tyre vetëm nëpërmjet donacioneve të jashtme, atëherë pengimi i ndikimit të jashtëm fetar dhe politik do të jetë i pamundur.

Çështje tjetër që duhet të shikohet është të përcaktohen qartë edhe kompetencat, fushëveprimi si dhe përbërja e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin dhe çregjistrimin e bashkësive fetare në Republikën e Kosovës.

Kjo çështje të rregullohet me këtë ligj, apo të parashihet që të rregullohet me ndonjë akt nënligjor.

Po besojmë se ndryshimi i Ligjit për lirinë fetare ka qëllim eliminimin e zbrazëtive ligjore, të cilat ekzistojnë në ligjin aktual.

Në këtë projektligj ceket se shteti nuk e financon asnjë bashkësi fetare. Po bashkësitë fetare mund të konkurrojnë në oferta të Qeverisë për marrjen e fondeve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e monumenteve kulturore, që janë në pronësi të bashkësive fetare. Edhe kjo pjesë konsideroj se duhet të rregullohet apo të qartësohet më tepër gjatë fazës së amendamentimit.

Siç e keni vërejtur, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë ka dhënë opinion edhe Komisioni Evropian për Demokracinë nëpërmjet ligjit, opinionit të Komisionit të 25-të të Venedikut, me numër 743/2013, i miratuar në sesionin e 98-të plenar.

Në këtë rast duhet të shqyrtojmë me vëmendje se a janë marrë parasysh dhe a janë inkorporuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga ky komision.

Unë besoj se komisioni do të organizojë dëgjim publik dhe po ashtu do t'i ftojë përfaqësuesit e bashkësive fetare gjatë shqyrtimit në grupe punuese dhe do të bashkëpunojë me të gjitha bashkësitë në Kosovë që të sjellë në seancë një ligj, i cili është në harmoni me tolerancën dhe bashkëjetesën fetare të të gjitha komuniteteve fetare në Kosovë dhe të mos shkaktojë pakënaqësi tek qytetarët e ndryshëm apo të bashkësitë fetare.

Pra, të jenë të kënaqura të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë dhe të mos shkaktojë pakënaqësi apo turbullira të ndryshme brenda komuniteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Respekt dhe përsëritje për kolegë të nderuar deputetë!

Mirë që ka ardhur ligji në lexim të parë dhe mirë që ky ligj është në drejtim të aprovimit.

Është një ligj që i ka munguar realisht shtetit tonë, duke marrë parasysh relacionet e bashkësive fetare në Kosovë me shtetin.

Mirëpo ka disa mangësi të propozuara, të cilat duhet të trajtohen seriozisht, në mënyrë që të mos krijojmë një ligj që krijon relacione kontradiktore dhe konfliktuoze brenda vetë ligjit me bashkësitë fetare.

Paradoksi i parë është te regjistrimi. Shihet në ligj që thotë mund të regjistrohen edhe duhet të regjistrohen, por jep mundësinë edhe të mos regjistrohen si entitete juridike bashkësitë fetare. E ato në qoftë se nuk dëshirojnë të regjistrohen, a do të aplikohet ligji, a do të jenë të obliguara ta zbatojnë ligjin, edhe pse ata nuk regjistrohen si entitet juridik. Kjo është e para dhe më e rëndësishmja.

E dyta, një farë mënyre, një koleg e përmendi që është çështja e shuarjes. Shuarja e bashkësive fetare të definohet mirë, mënyra, kriteret e shuarjes. Çka me pasurinë të cilën e ka ajo bashkësi fetare dhe kush do ta trashëgojë atë pasuri dhe këtu nuk do të ndalem më gjatë.

Po dal edhe te formimi i entiteteve brenda bashkësive fetare, institucionet arsimore, tregtare, edukative, e të tjera. Ato entitete dhe institucione që do të krijohen në kuadër të bashkësive fetare a do t'u nënshtrohen ligjeve të përgjithshme të Kosovës, apo do të punojnë me akte normative, të cilat ata vetë i hartojnë. Pastaj ato akte normative a do t'i mbikëqyrë ndonjë komision që të jenë konform ligjeve të zbatueshme të Kosovës, kjo është shumë e rëndësishme.

Gjithashtu edhe krijimi i marrëdhënieve të punës brenda bashkësive fetare në ato institucione të cilat krijohen. Aty propozohet që t'u pranohet stazhi i punës, po çka me të ardhurat, a do të tatimohen, a do të paguajnë Trustin, a do t'u nënshtrohen ligjeve të tjera dhe çka në qoftë se vjen deri te relacionet kundërthënëse të marrëdhënieve të punës ose humbja e marrëdhënies së punës? Instancat gjyqësore do të merren me ato procese, apo do të rregullohen vetëm me akte normative brenda bashkësive fetare?

Te procesi i auditimit: a do të jenë ato të obliguara të kenë pasqyra financiare, të hartojnë raporte financiare dhe kush do ta bëjë auditimin e bashkësive fetare? A do të bëjnë auditimet e brendshme brenda bashkësive fetare, apo do t'i nënshtrohen auditimit të Auditorit Gjeneral apo auditorëve të jashtëm.

Është edhe një mosdefinim apo një gjerësi e mundësisë së importit, gjegjësisht mosdoganimit të shumë mallrave dhe shumë gjërave që besoj është një hapësirë e madhe, ku pa dashur të keqkuptohem, mund të bëhen keqpërdorime të shumta. Ne e dimë që edhe importi i shumë mjeteve që janë të nevojshme për shëndetësi, e tjera, u nënshtrohen doganave, pse të lirohen bashkësitë fetare prej një numri kaq të madh dhe kaq të gjerë të produkteve, të cilat mund të importohen pa doganë.

Po kthehem edhe te një segment, te segmenti i taksave dhe tatimeve të patundshmërisë. Është propozuar në projektligji të mos tatimohet e gjithë prona e paluajtshme dhe pronat që ekonomizojnë. Unë mendoj që prona e paluajtshme duhet të tatimohet, mirëpo ajo pronë që shfrytëzohet për ekonomizim mund të lirohet, por produkti i ekonomizimit të këtyre, në qoftë se ato çelin institucione brenda bashkësive fetare për përfitim, atëherë përfitimi i tyre duhet të tatimohet.

E kisha përmbyllur fjalimin tim me lutje që grupi punues t'i trajtojë seriozisht të gjitha këto dhe po më vjen mirë prej deputetëve që po adresohen disa gjëra më qartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit!

Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkan yardımcım

Değerli Hükümet temsilcileri, Bakanlar, Milletvekilleri

Şimdiki dönemde Prizrenin diğer bölgelerindeki İslam Birliklerine bir haksızlık yapılacağı endişesi taşımaktadır. Çünkü Vakıf malları o yerin insanları tarafından vakfedilmiş ve o insanlar tarafından vakfedildiği kişiler tarafından kullanılması gerekmektedir, aksi takdirde hiçbir şekliyle merkezi düzeyde kurulması ve toplanması doğru olmayacağını ifade etmektedir. O yüzden daha diğer şekliyle bu Yasada eksiklikler gözümüze çarpmaktadır, çünkü bu Yasa tamamıyla Kosovadaki dini birlikleri düzenlemesi gerekir iken çok yüzeysel kaldığını görmekteyiz, sadece

Yasa olsun dije bu Yasanin geçmesini çok da doğru olacağını düşünmemekteyiz, dolayısıyla iki Türk milletvekilinin bu Yasaya karşı olduğunu bir daha ifade etmek istiyorum.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slavko Simiq.)

KRYESUESI: Hvala kolega! Za reč se javio Arbër Rexhaj. Izlovite!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Përshëndetje të nderuar qytetarë,

Është mirë që ky projektligj të parashohë që bashkësitë fetare të kenë një status juridik dhe të veprojnë sipas një statusi juridik, i cili u ka munguar që një kohë të gjatë.

Ky projektligj ka marrë për bazë hartat e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian, pra gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit dhe bindjeve, lirinë që njeriu qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët dhe në publik ose privatisht për të manifestuar fenë apo besimin në adhurim, në mësim, në praktikë dhe në respektim.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë janë lirit themelore individuale, të cilat janë të mbrojtura në nivel kushtetues dhe ndërkombëtar. Ato mund t'u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve të paracaktuara në nenin 9.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ligji në fuqi njih pesë bashkësi fetare në Kosovë, të cilat përbëjnë edhe trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit tonë.

Këto bashkësi janë: Bashkësia Islame e Kosovës, Kisha Katolike, Kisha Ortodokse Serbe, Bashkësia e Besimit Hebrej dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës, po ashtu edhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës.

Në këtë projektligj nuk u njihet e drejta e themelimit mbi bazën e statusit juridik të Kishës Ortodokse Shqiptare, ku dhjetëra e qindra qytetarë në Kosovë e kanë këtë fe dhe mendojnë që edhe kjo do të duhet të njihet si kategori juridike, sepse edhe historikisht shqiptarët kanë qenë ortodoksë dhe një pjesë e monumenteve kulturore dhe historike, të cilat padrejtësisht quhen si 'Kisha Ortodokse Serbe', ato nuk janë kisha ortodokse serbe dhe nuk duhet t'u themi ashtu, sepse ato janë kisha ortodokse shqiptare.

Sa i përket numrit të asaj që u tha këtu, sigurisht që dy familje ose tri do të mund ta përbënin një fe dhe kjo do të ishte ndoshta demokratike sa u përket lirive dhe të drejtave të njeriut, mirëpo do të kishte atë elementin përballë rrezikut të krijimit të sekteve dhe feve të ndryshme, të cilat po them në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut janë të drejta, mirëpo megjithatë, besoj që këtu

duhet të ketë një status, një kategori dhe një veçanti se si do të duhej të ndërmerrej puna deri në krijimin e një statusi juridik të një bashkësie fetare.

Prandaj, edhe një herë po kthehem aty ku e pata. Ky ligj do të duhej të parashihte edhe statusin juridik të Kishës Ortodokse Shqiptare, sepse Kisha Ortodokse Shqiptare edhe historikisht, edhe kulturalisht në këto troje, në Kosovë, ka qenë e pranishme, edhe sot kemi praktikantë shqiptarë ortodoksë në Kosovë.

Jashtë kësaj e shoh si pozitive shtimin e një neni në përmbajtje, siç është projektligji: “Ndalohej aktiviteti i organizatave dhe shoqatave joqeveritare për çështje fetare pa leje paraprake nga bashkësia fetare në Kosovë”. Kjo është e mirë, sepse megjithatë aktivitetet e tyre do të duhej të merreshin drejtpërdrejt me leje nga institucionet relevante.

Praktikë ngelet ndryshimi i nenit 5, paragrafi 4, të gjitha feve, besimeve dhe bashkësive në Kosovë u ofrohet çdo lloj mbrojtje për të gëzuar të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kushtetuta, ligji dhe marrëveshja.

Ndërsa sa i përket financimit, mendoj se çështja nuk është shtruar keq. Megjithatë bashkësitë fetare në Kosovë është mirë të financohen, sepse në njëfarë forme kemi edhe dorën e shtetit brenda bashkësive fetare. Pra, kur dora e shtetit në mënyrë demokratike u ndihmon atyre, ato megjithatë do të duhej të raportonin për të gjitha aktivitetet e tyre, po ashtu përsëri në shtet, kjo domethënë është dikonomia e bashkësive fetare dhe shtetit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Më shumë e mora fjalën për të sqaruar disa procedura, meqenëse kryeministri sot i propozoi edhe dy amendamente gojore këtu në seancë lidhur me këtë ligj.

E para që ka të bëjë me 50 nënshkrime për regjistrim dhe e dyta që ka të bëjë me financimin.

Megjithatë, besoj që deputetët kanë nevojë për një sqarim nga ana e administratës, sepse në bazë të Rregullores së Punës dhe praktikës parlamentare, si rregull në lexim të parë nuk mund të bëhen amendamente të tilla gojore. Pra, kur votohet ligji sot, votohet me ato dy nene dhe jo pa ato.

Kryeministri nuk është këtu, por ndoshta dikush nga Qeveria mund ta sqarojë a do të sillen ato ndërkohë me shkrim apo thjesht, shpresoni që ato si amendamente do të propozohen nga deputetët, sepse përndryshe mund të mbetet ligji kështu si është.

Por duke supozuar që do të hiqet neni që ka të bëjë me 50 nënshkrimet, atëherë neve na duhet sqarimi se cili është numri tjetër që po propozohet, sepse nuk mund të hiqet 50-shi dhe të mos propozohet ose 100 ose 200 ose 1 000, sepse kështu si është, munden edhe me 5 të regjistrohen. Pra, pa tjetër kjo është çështje që duhet të rregullohet me ligj dhe jo t'u lihet akteve nënligjore.

E dyta, ndryshimi i dytë që e propozoi kryeministri kishte të bënte me nenin 12, megjithatë mbeti pak e paqartë, së paku për grupin tonë parlamentar, në qoftë se po propozohet heqja e nenit në tërësi, që ka të bëjë me fondet dhe financimin, siç e tha ai për herë të parë, apo siç e tha për herë të dytë, kur iu referua vetëm paragrafit 3 që ka të bëjë me financimin nga ana e Qeverisë.

Sërish po shpresoj që ndoshta dikush nga Qeveria mund ta sqarojë, pra a po propozohet të hiqet komplet neni 12 apo vetëm paragrafi 3.

Dhe, në qoftë se po propozohet të hiqet vetëm paragrafi 3, atëherë këtu sërish është çështje që patjetër duhet të rregullohet me ligj, sepse deri diku është edhe kërkesë kushtetuese, siç u tha nga kolegët të tjerë, për shkak të përcaktimit të Kosovës si shtet që qëndron neutral ndaj feve në Republikën e Kosovës dhe kështu do t'i lihej hapësirë cilësdo Qeveri në të ardhmen që në bazë të afiniteteve që mund t'i ketë ndaj feve të caktuara, t'i përcaktojë pastaj edhe financimet apo edhe në bazë të zhvillimeve politike që mund të jenë. Prandaj, kjo çështje duhet të rregullohet me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe jo t'u lihet akteve nënligjore apo edhe vendimeve të kohëpaskohshme që ndikohen nga zhvillime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

E di që ky ligj është shumë i rëndësishëm pikërisht për shkak të mënyrës së financimit që kanë bërë organizatat e ndryshme joqeveritare, pasi në Kosovë i kemi 9 500 organizata të regjistruara si organizata joqeveritare, e që janë të shumtën e rasteve, shumica prej tyre kanë ushtruar edhe aktivitete që kanë rënë edhe në kundërshtim me ligjet e Kosovës. E dyta, si deputet kam vetëm një shqetësim. Për mendimin tim, në ligj do të duhej të theksohej “Kisha Ortodokse e Kosovës”, jo “Kisha Ortodokse Serbe”, pasi që dihet në bazë të krejt historiografisë, ata që kanë lexuar pak a shumë që ndërtues, arkitektë të këtyre kishave jemi pikërisht ne shqiptarët. Në qoftë se ne e definojmë me ligj si “Kisha Ortodokse Serbe”, atëherë në mënyrë automatike i përjashtojmë, i fyejmë dhe i diskriminojmë pjesëtarët e kombit shqiptar që kanë fe ortodokse. Kjo është e vetmja vërejtje imja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Për kolegët deputetë,

Ne sot po diskutojmë për një ligj që është me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj, për Ligjin nr. 02/L-31 për lirinë fetare.

Ne këtë ligj e kemi shqyrtuar edhe më herët, është punuar nga Qeveria dhe nga përfaqësues të feve. Do të thotë, kemi pasur propozime konkrete. Ne kemi biseduar edhe në legjislaturën paraprake, në legjislaturën e kaluar që është shtuar edhe Bashkësia e Tarikateve, e përgëzoj në këtë rast edhe Qeverinë që edhe me këtë draftligj e ka sjellë Bashkësinë e Tarikateve, duke pasur parasysh historikun e tyre, kontributin e tyre edhe për kombin, edhe për fenë, por edhe për të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur gjatë historisë në të gjitha trojet shqiptare.

Janë disa konfuzitete në këtë ligj, të cilat konsideroj se duhet të plotësohen mes dy leximeve dhe duhet ta japim kontributin edhe ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe komisioni përkatës. Realisht, një sqarim që u tha edhe prej kolegëve, bashkësitë fetare nuk janë të detyruara të regjistrohen dhe të pranojnë statusin e personit juridik kundër vullnetit të tyre. Ne nuk po flasim kundër vullnetit të tyre, por konsideroj që duhet të jetë më preciz në ligj që a janë të obliguara bashkësitë fetare të regjistrohen në ligj. Në bazë të këtij neni lë të kuptohet që dikush, një bashkësi fetare thotë se unë dua të bëj veprimtarinë time në Republikën e Kosovës, por nuk dua të regjistrohem dhe ligji ia mundëson të ushtrojë veprimtarinë.

Ne e dimë që me Kushtetutë jemi shtet laik dhe çdo fe apo çdo qytetari i lejohet të besojë në formën e vet. Në këtë rast u përmend numri 50, këtu shumica te neni 2.2 me rastin e themelimit të kenë të paktën 50 anëtarë shtetas të moshës madhore të Republikës së Kosovës. Konsideroj se edhe te numri duhet të jemi të qartë, realisht kryeministri propozoi të hiqet numri. Mendoj që ndoshta numri normal duhet të jetë më i madh se 50, apo të hiqet krejt e të mbetet në kompetenca të komisionit që paraprakisht nëse regjistrohet një bashkësi fetare, të mos e bëjmë ndonjë zbulim të ndonjë feje të re, por të jetë një fe ekzistuese, normalisht, pasi ta ketë shtruar kërkesën për regjistrim, se në bazë të kësaj mund të krijojmë ndoshta edhe konfuzion në lirinë e tepërt fetare.

Unë konsideroj që ky ligj i plotëson kriteret. Sa i përket financimit megjithatë mendoj që edhe atë duhet ta shqyrtojë edhe një herë komisioni dhe të konsultohet me bashkësitë fetare. Në këtë rast ne i dimë edhe mundësitë buxhetore të Republikës së Kosovës, është e pamundur ndoshta të kemi një financim në atë kuptimin e plotë të fjalës, por megjithatë, duhet të ketë mbështetje financiare. Unë edhe një herë e përgëzoj qeverinë që e ka bërë këtë propozim dhe konsideroj që në këtë rast duhet ta aprovojmë në parim, kurse plotësim-ndryshimet duhet të bëhen mes dy leximeve.

Sa i përket numrit, mendoj që duhet të jetë më i qartë propozuesi ose ta bëjmë në një propozim konkret mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismajl Kurteshi, përgatitet Haxhi Avdyli.

ISMAJL KURTESHI: Të nderuar deputetë!

Trajtimi i barabartë i të gjitha feve dhe sanksionimi me ligj i lirive fetare në Kosovë, si dhe kultivimi i tolerancës në mes të komuniteteve të ndryshme fetare janë pa dyshim të arritura të mëdha që duhet të kultivohen dhe të avancohen në Republikën e Kosovës.

Siç ndodh në të gjitha fushat e jetës që të drejtat prodhojnë edhe obligime, është krejt e natyrshme që e njëjta gjë të vlejë edhe për këtë fushë. Përkundër traditës së mirë shekullore të tolerancës ndërfetare dhe ushtrimit pa pengesë të riteve fetare, viteve të fundit, bazuar në vlerësimin e mekanizmave të sigurisë, por edhe të qytetarëve, madje edhe të vetë bashkësive fetare, është konstatuar se në vend të përhapjes së tolerancës, harmonisë dhe dashurisë në mes të njerëzve, po ashtu edhe të komuniteteve fetare, po përhapet mosdurimi, urrejtja dhe thirrja e hapur në konflikt, qoftë ndërfetar, qoftë brenda sekteve të së njëjtës fe. Besoj që ju kujtohet të gjithëve se me rastin e aprovimit të Ligjit për Trepçën, atëherë kreu i Kishës ortodokse shpallte luftë për Republikën e Kosovës.

Kjo situatë kërkon mobilizim të institucioneve të shtetit, parandalimin e konflikteve dhe përhapjes së urrejtjes mes komuniteteve fetare. Ndërhyrja e shtetit nuk duhet t'i kufizojë të drejtat fetare, as t'i përndjekë dhe t'i dënojë me burg të rinjtë që janë viktimat të propagandës që po zhvillohet pa penguar para syve të institucioneve të shtetit brenda bashkësive fetare, ndonjëherë madje edhe nga krerët e tyre. Ndërhyrja e shtetit duhet të ndodhë në radhë të parë si angazhim për edukimin e drejtë të gjeneratave të reja, sidomos kultivimin e tolerancës dhe respektimit të diversitetit fetar, por edhe diversiteteve të tjera.

Shteti duhet të angazhohet për risocializimin e atyre që tanimë janë të ndikuar nga propagandat që kultivon mosdurim dhe urrejtje. Shteti, po ashtu, është i obliguar të ketë nën vëzhgim aktivitetet e të gjithë atyre që në emër të fesë nxisin konflikte dhe urrejtje nëpërmjet mediave, kurseve të palicencuara në tubime të ndryshme me besimtarë, ndonjëherë edhe brenda tempujve fetarë. Për pengimin e këtyre dukurive në rritje brenda këtij ligji që i sanksionon të drejtat fetare, duhet të sanksionohen edhe përgjegjësitë e të gjitha bashkësive fetare, të cilat e kontrollojnë aktivitetin fetar brenda bashkësive të veta.

Kryesitë e bashkësive fetare duhet të hartojnë plan-programe, ku do të përfshihen çështje, temat për të cilët do të ligjërojnë prijësit lokalë fetarë si në xhami, po ashtu edhe në kisha, kështu ndërpritet praktika e ligjërimit pa asnjë kontroll, sipas dëshirës së prijësve lokalë fetarë. Kryesitë e bashkësive fetare duhet të përcjellin punën e prijësve lokalë fetarë dhe të inspektojnë kohë pas

kohe, t'i shpërblejnë, por edhe t'i sanksionojnë ata që i shkelin rregullat e bashkësive fetare që duhet të jenë në harmoni të plotë me Kushtetutën e Kosovës sa i përket tolerancës fetare.

Edhe në këtë ligj duhet të ndalohet përhapja e urrejtjes ndërfitare, duhet të ndalohet me ligj mbajtja e kurseve të palicencuara, sidomos për fëmijët e moshës jomadhore. Kryesitë e bashkësive fetare duhet të merren me nostrifikimin e diplomave dhe gjatë caktimit të prijësve lokalë fetarë duhet t'u jepet përparësi të diplomuarve në Kosovë. Kontrolli i aktivitetit të bashkësive fetare në të gjitha nivelet, ndarja e përgjegjësive në mes të institucioneve të shtetit dhe kryesive të bashkësive fetare, risocializimi i atyre që janë të përfshirë në përhapjen e urrejtjes fetare, është mënyra më e mirë e parandalimit të keqpërdorimit të feve, të cilat mision e kanë paqen, harmoninë dhe dashurinë në mes të njerëzve, e jo urrejtjen, e aq më pak gjakderdhjen.

Po ashtu, i bashkëngjitëm propozimit të deputetëve, të cilët diskutuan dhe kërkuan që të përcaktohet numri, pa të cilin nuk mund të regjistrohen në bashkësi fetare, gjithashtu jam për atë që të diskutohet në lidhje me nenin për financimin e feve dhe sidomos për emërtimin e "Kishës Ortodokse të Kosovës", e cila në ligjin që është propozuar ka një emërtim të gabuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji për bashkësitë fetare është një lajm i mirë për organizimin e funksionimit të bashkësive fetare, sepse po futen nën ombrellën e statusit juridik. Njohja, roli i tyre dhe futja në një ndërvarësi krijon normalisht edhe një përgjegjësi shtesë, edhe në mes të bashkësive fetare, edhe në mes të qytetarëve, por edhe shtetit dhe bashkësive fetare.

Në këtë rast kërkoj që nëpërmjet Kuvendit ta njohim rolin konstruktiv të krerëve të bashkësive fetare edhe gjatë hartimit të ligjit, por edhe në gjithë këto vite të krijimit të një atmosfere tolerante në Kosovë dhe shi për këtë, meritë e tyre është edhe toleranca e shumënjohur fetare që po mbretëron në Kosovë dhe në të gjitha trevat shqiptare. Prandaj, mendoj që me anë të këtij ligji, duke e njohur rolin konstruktiv të bashkësive fetare, mendoj që shteti duhet të ketë një ndihmë financiare për bashkësitë fetare. Ndhma financiare për bashkësitë fetare mund të organizohet në atë mënyrë që të përkrahen projektet e ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me luftimin e ekstremizmit, kanë të bëjnë në ngritjen edhe të mëtutjeshme të tolerancës ndërfitare në Kosovë dhe krijimit apo të largimit të keqkuptimeve që mund të jenë te fetë e ndryshme.

Unë dua t'i përshëndes dhe t'i përgëzoj hartuesit e këtij ligji edhe për faktin që për herë të parë në Kosovë po njihet Bashkësia e Tarikateve të Kosovës si një entitet shumëshekullor i Kosovës dhe mendoj që është një njohje e realitetit që ka mbretëruar në këto troje. Unë u bashkohem edhe

shumë deputetëve të tjerë, të cilët dhanë vërejtjet e tyre rreth regjistrimit të bashkësive të reja fetare, të cilat duhet të qartësohen saktë sipas numrit, por normalisht unë u bashkohem edhe thirrjeve që të krijohen edhe kritere të qarta ligjore se kush, si dhe pse, çfarë roli duhet të kenë bashkësitë e reja fetare, sepse ka pasur raste në botë që janë regjistruar apo kanë vepruar edhe të paregjistruara bashkësitë fetare, të cilat kanë proklamuar dhunë, por kanë shkaktuar edhe probleme në tolerancën ndërfetare, edhe në funksionimin e shoqërive në përgjithësi.

Unë e përkrah këtë ligj dhe mendoj që është një hap përpara në krijimin e marrëdhënieve të reja shtet-bashkësi fetare-qytetarë dhe njerëzve, të cilët e praktikojnë fenë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Përsëritje për të gjithë!

Është për t'u tumirur ky ligj dhe faktikisht pajtohemi në përgjithësi në diskutimet që u bënë deri tash. Kam dy-tri çështje që mund t' i shtrojmë këtu, e që janë disa kapituj që barten me formën e rëndësishme të definimit të këtyre besimeve fetare.

Shikoni, ne i kemi të formuluarat, madje të definuarat, madje edhe të përkufizuarat: si do të jetë Bashkësia Islame dhe si është çështja institucionale e tyre? Si do të jenë bashkësitë e tjera fetare, siç është ortodoksia, madje tarikatet, madje edhe ortodoksia në qoftë se e themi në baza etnike që diku-diku është e përkufizuar gabimisht dhe diku-diku ka mbetur anash, për shembull e ortodoksisë shqiptare, që do të duhej të ishte e trajtuar si besim, si trajtim fetar, por jo kurrsesi edhe në atë kuptimin etnik. Prandaj definimi i Kishës Ortodokse Serbe, e cila është bartur nga kapitulli i gabuar i një pjese, e cila ka pasur kritika minimale të Planit të Ahtisarit dhe ka sjellë probleme të mëdha në funksionim të sistemeve lokale dhe qendrore, madje të institucioneve qendrore, ku Ministria e Kulturës, e cila do të kishte edhe në mbrojtje institucionet fetare, sigurisht, shpesh janë ngatërruar në funksionim dhe ky ligj duhet t' i rregullojë këto dhe do përkrahje.

Megjithatë, formulimet me baza etnike të religjioneve a besimeve, siç është bartja tash këtu gabimisht, e më herët po ashtu gabimisht, e formulimit të besimit ortodoks serb, njëkohësisht i është dhënë edhe mundësia e pronësisë që një shtet tjetër të marrë ndoshta menaxhimin e këtyre pronave. Ne të kemi kujdes që këto t' i definojmë qartë, kishat, xhamitë dhe institucionet fetare janë të Republikës së Kosovës të besimit mysliman ose ortodoks e tjera, por jo të një komuniteti, siç ishte në këtë rast, marrja e ortodoksisë vetëm nga serbët, kurse njëkohësisht marrja dhe e objekteve fetare me rrethe dhe me prona në menaxhim ndoshta të shtetit tjetër. Në këtë rast, është mirë që kjo të kulmohet, të zërë vend, të stabilizohet mirë në këtë ligj, i cili është mjaft i rëndësishëm.

Çështja e financimit po ashtu është njëra prej çështjeve, të cilën duhet të kemi kujdes dhe mirë është atje nisma që të mund të ingranohet në sisteme institucionale, sepse ndodh shpesh nëpërmjet financave mund të depërtojnë edhe lloj-lloj ekstremesh, apo qasjesh, të cilat faktikisht në mënyrë joligjore, ilegale e tjera kontrabandohen dhe shtrijnë një besim, i cili nuk është krejt kompatibil me programet, zhvillimet dhe besimin tradicional të një feje, e cila është e çmuar, e respektuar te ne. Prandaj, edhe kjo do një vëmendje të veçantë, vëmendje në konstituimin, formimin dhe në kushtin e regjistrimit të këtyre besimeve, sigurisht ishte mirë e menduar atje, unë mendoj në projektligjin, që duhet të jenë disa kushte të tjera, por të mos jetë edhe numri strikt, sepse edhe numri strikt mund të plotësohet apo jo, por duhet të jenë disa kushte që synohen nga projektligji atje, të jenë mu ato dhe faktikisht të normëzojnë, të standardizojnë një besim fetar, i cili faktikisht do mbrojtje prej një ligji, i cili po synon të bëhet dhe do përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Që të jemi më të saktë, ne nuk kemi para një tekst bazë të një ligji të ri, por një projektligj për ndryshim dhe plotësim dhe kjo është hera e dytë që plotësohet dhe ndryshohet teksti bazë.

E dyta, ky tekst është saktësisht ai që është refuzuar dy herë në legjislaturën e kaluar pas shumë debatesh dhe unë sot habitem, sepse shoh që i njëjti tekst sot po diskutohet ndryshe, si të ishte një tekst i ri.

Tani ligjet e kësaj natyre patjetër që janë të rëndësishme, por po e përsëris që s'kemi përpara një ligj, kemi 3-4 propozime që kanë fuqi amendamenti, të cilat do t'i bashkohen ligjit, të cilin ne e kemi. Çka do të thotë kjo? Që Kosova ka ligj për liritë fetare, sikurse që Kosova ka ligj për trashëgiminë kulturore. Ky shpjegim është i domosdoshëm, meqë këto po përmenden si kushte të UNESCO-s për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Po të ishin kushte, ne këto dy kushte do t'i kishim të plotësuara, të llogaritura. E vërteta është që UNESCO nuk ka kushte të tilla, UNESCO nuk ka kërkuar që ne të miratojmë ligje të tilla, jo vetëm pse e di që i kemi, por sepse UNESCO s'paraqet standarde të tilla.

E vërteta në këtë rast, meqë atë proces e njoh dhe unë po flas për këtë, sepse e rihapi kryeministri prapë, kushtet për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji dhe për një ligj të ri për trashëgiminë kulturore janë të partnerëve tanë, të cilët e kushtëzojnë mbështetjen e Kosovës në këtë proces me këtë plotësim-ndryshim dhe me një ligj të ri për trashëgiminë kulturore. Edhe unë pajtohem që Ligji për trashëgiminë kulturore është më i ndjeshmi, ndoshta më i ndjeshëm se ky, por ajo është një fushë tjetër dhe këto dy fusha askush nuk i ngatërron, me përjashtim të Kushtetutës sonë. Madje, edhe me të gjitha konventat ndërkombëtare dhe me konventat e UNESCO-s trashëgimia

religjioze dhe trashëgimia kulturore s'mund të ngatërrohen, s'mund të trajtohen si të njëjta, s'mund të trajtohen si një.

Tani, për tekstin që kemi edhe unë kam disa komente, lidhen edhe me ato që tha kryeministri. Pajtohem që kryeministri nuk mund ta amendamentojë tekstin, projektligjin, plotësimet, ndryshimet sot, por duhet t'i paraqesë për leximin e dytë, edhe unë mendoj si problematik çështjen e financimit dhe mendoj që shteti s'duhet të financojë bashkësitë religjioze, e para. Por, kryesorja, sepse nuk dëshiroj ta zgjas, është neni i cili përcakton bashkësitë fetare dhe që mua më duket që është kundër logjikës juridike të këtij teksti dhe kundër logjikës juridike të tekstit bazë, sepse ai s'i ka kështu dhe më shumë duken si qëndrime politike.

Unë propozoj që ky nen, i cili saktësisht është neni 4a, do të thotë bashkësitë fetare në Kosovë, të mos i japë nominalisht bashkësitë fetare. Mendoj që ky nen është dhënë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me parimin e lirisë së asocimit. Ne nuk mund të përcaktojmë se cilat janë bashkësitë fetare dhe as të vëmë emra. Bashkësitë, të cilat ekzistojnë dhe funksionojnë, duhet të rregullohen, të regjistrohen në procedurën të cilën do të regjistrohen edhe bashkësitë e reja të mundshme.

Po ashtu, çështja e numrit, unë mendoj që numri prej 50 është shumë i vogël, sidomos për rrethanat tona, për kontekstin tonë, por nuk pajtohem që të hiqet. Duhet të saktësohet, duhet të vendoset me ligj dhe duhet të mendohet mirë. Komente të tjera nuk kam, edhe unë si kolegët e mi në parim do ta mbështes këtë ligj, por për këto çështje, për komentet që i kemi, ne do të propozojmë amendamente të veçanta, të caktuara dhe pastaj, në bazë të tyre do të vendosim dhe për miratimin përfundimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Kujtim! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi, pa grup parlamentar.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

I ako je jedan od najvećih, odnosno najvažniji zakona za našu državu, nacrt zakonu o versku slobodu na Kosovu ne predviđa decidno tačno ili nije tačno definisano oko registracije različitih grupacija verskih zajednica.

Zakon ne predviđa tačno koliki je broj osoba potrebno za registraciju, počevno od 50 potpisa pa nadalje.

Versko uvođenje, osnovno ljudsko demokratsku pravo je individualno i pravo svake osobe je da se izjašnjava onako kako ono želi, ali to ne znači da država nema uvidu to ili nema uvid u način finansiranja tih organizacija. Odakle dolaze finansijska sredstva, dali neko to kontroliše, da li

postojëce razne verske grupacije država kontroliše, ili one dalje funkcionišu kao nevladin sektor, koje mogu na razne načine ugroziti sistem određenih vrednosti verskih zajednica koje su legitimne na ovim prostorima.

Pojedine verske zajednice nisu registrovane u opšte, što može doći do raznih zloupotreba i malverzacija. A po meni najveći problem je što naša omladina jako lako prihvata razne verske sekte, i može se poremetiti opšta društvena odnosno verska vrednost.

Takođe mene puno zabrinjava Vakuvsko nasledstvo. Zajednica koju ja predstavlja, u većini živi po ruralnim mestima gde godinama, odnosno vekovima unazad naši ljudi poklanjaju svoje privatne parcele za džamije ili seoska groblja. U Zakonu o verskoj slobodi nije precizirano ko će da kontroliše, ili ko ima pravo da to uradi. Ako su to dve ili tri osobe sa centralnog nivoa, onda već u samom startu imamo određene probleme.

Ono što je najbitnije u ovom zakonu je da zakon jasno ne predviđa finansiranje postojećih verskih naših institucija, što je po meni jedan od većih problema ovog zakona. Ukoliko Vlada ne promeni ovaj predlog Nacrta zakona o verskoj slobodi, ja neću glasati za ovaj zakon. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Valon Ramadani e ka fjalën.

VALON RAMADANI: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ky projektligj është kthyer e rikthyer në Kuvendin e Kosovës. Të gjithë e dimë tashmë se sponsorizuesit çdo herë, si edhe tash, nuk janë nisur nga interesi shtetëror e kombëtar për ta rregulluar këtë fushë të veprimit njerëzor, por për ta nxjerrë prej andej përfitimin e radhës. Plotësimi i Projektligjit për lirinë fetare që po paraqitet sot këtu në seancë është më se i nevojshëm, por duke marrë parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë që ndërlidhet me të, ndryshimi i tij tashmë është i vonuar. Por, edhe tash, ende sponsorizuesi, pra Qeveria e Kosovës, nuk ia ka dalë ta hartojë atë siç duhet.

Bëhet fjalë për kushtin që është vendosur për regjistrimin apo njohjen e bashkësive fetare të reja. Ai kusht në projektligj është numri prej 50 anëtarëve. Edhe pse sot kryeministri tha që ky numër është hequr, prapë mendoj se është gabim, sepse çdo veprimtari kolektive që vepron në shoqëri që të regjistrohet e të njihet si palë juridike nga shteti i Kosovës ka tjera kushte për anëtarësinë dhe numrin e mbështetësve. Për shembull, që të regjistrohet një grup si federatë duhet të ketë së paku dy bashkësi sindikale dhe 10% anëtarë të punëtorëve të atij sektori. Që të regjistrohet si konfederatë duhet, përveç tjerash, të ketë anëtarësi 10% anëtarë të punëtorëve në gjithë territorin e Kosovës. Për ta regjistruar një parti politike apo një nismë qytetare për në zgjedhje duhen jo më pak se 500 nënshkrime. Nuk e dimë çka ka dashur të thotë sponsorizuesi kur ka vendosur vetëm

këtë numër, pra “50 nënshkrime”. Çdokush mund ta regjistrojë një bashkësi të re fetare. Çdokush prej nesh dhe çdo qytetar e ka shumë të qartë se çfarë hapësire për probleme të reja artificiale krijohen nga ky lloj i liberalizimit në një fushë, ku institucionet vërtet duhet të jenë të kujdesshme dhe të rezervuara.

Qeveritë në këtë Kuvend nuk e sollën asnjëherë një projektligj me të cilin ulet numri i anëtarësisë për ta bërë një federatë sindikale, pra për t’u krijuar kushte punëtorëve që të organizohen. Tash, edhe pse në të njëjtin ligj flitet për bashkësitë fetare në Kosovë, janë ato të traditës, por pak rreshta më poshtë shfaqet neni, që me 50 të njohur e themelon një bashkësi të re fetare.

Një fakt tjetër, që është shqetësues, është se Qeveria e ka sjellë këtë projektligj duke i pranuar 90% të propozimeve të eksponentëve nga Kisha Ortodokse e Serbisë, kurse propozimet e bëra nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe nga Kisha Katolike kryesisht janë refuzuar. Nëse kjo është bërë në emër të rendit kushtetues dhe rregullave institucionale, a mund të ma shpjegoni se si kanë gjetur vend kërkesat çdoherë kundër shtetësisë së Kosovës nga Kisha Ortodokse e Serbisë në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të flas vetëm shkurt për pjesën financiare të buxhetit.

Në parim, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe unë jemi në përkrahje të ligjit në fjalë, por nuk jemi në përkrahje të propozimit nga kryeministri, që të hiqet paragrafi 3 i nenit 12, ku thotë që “Qeveria nuk e financon asnjëherë prej bashkësive fetare”.

Pra, konsiderojmë se një ndryshim i tillë eventual e bën fillimisht të pavlefshme deklaratën financiare të këtij projektligji, por gjithashtu e hap një derë të pakontrollueshme nëpërmjet këtij ligji. Pra, në qoftë se ne e hapim derën e shpërndarjes së parave buxhetore nëpërmjet këtij ligji, por pa i kontrolluar edhe shpenzimet e subjekteve që rregullojnë, kemi bërë zgjidhje gjysmake.

Prandaj, unë, në emër të LDK-së, kërkoj edhe një herë sqarim se a do ta votojmë, kryesues, ligjin që na është propozuar si i tillë në formë të shkruar, apo amendamentet e dhëna në formë gojore përfshihen në votimin në fjalë? Sepse, në qoftë se është kjo e fundit, LDK-ja nuk do ta përkrahë një ligj të tillë, sepse po them edhe një herë bën ndryshime enorme në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe në shpenzimet dhe formën se si e menaxhojmë paratë publike të Kosovës. Është diçka e pakontrollueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për sqarim, ne e kemi ligjin e Qeverisë së Kosovës dhe për atë ligj po flasim. Nuk po flasim për diskutimet me diskutime të reja, kështu që mendoj se ata që e kanë lexuar ligjin duhet të përqendrohen te ligji, e jo te diskutuesit. Por, pasi fola, unë ju kisha lutur që ta keni parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe të bisedoni seriozisht në grupet tuaja parlamentare para se të diskutohet në komisione, që t'i merrni qëndrimet që duhet të merren në interes të asaj që e tha edhe kryeministri, edhe pse pati diskutime që s'është kusht. Në qoftë se ne pretendojmë që duam të shkojmë në Evropë, duhet që edhe ligjet t'i kemi të përafuara me legjislacionin evropian, e jo me ligjet të cilat ndoshta nuk u pëlqejnë disave dhe s'kemi çfarë të bëjmë me ta.

Unë e kuptoj lobimin që e kanë bërë, sepse ka dy a tre vjet që llojnë komunitete të ndryshme nga bashkësitë fetare, por shteti është shtet dhe duhet t'i ndërmarrë masat dhe duhet ta miratojë ligjin që është në përputhje me legjislacionin evropian, e jo me dëshirat e njërit apo tjetrit prej nesh.

Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë!

Projektligji për ndryshimin e lirive fetare është qe disa vjet këtu në Kuvendin e Kosovës. Kam qenë edhe pjesë e komisionit dhe kryetar i komisionit kur ka ardhur ky projektligj, e kemi diskutuar disa herë dhe në Kuvend është tërhequr, ose Kuvendi ka shkuar në zgjedhje dhe ka mbetur pa u shqyrtuar.

Kemi pasur takime të shumta dhe me Bashkësinë Islame, Kishën Ortodokse, që nuk ka marrë pjesë, ose nuk ka qenë e interesuar, edhe me Kishën Katolike, kemi pasur takime edhe me Bashkësinë e Tarikateve, protestantët nuk kanë qenë të interesuar, ndërsa është diskutuar edhe gjithë ajo që ta kemi një ligj të mirëfilltë.

Për ta pasur një ligj të mirëfilltë mendoj që paragrafët që janë këtu dhe u desh të plotësohen, ose u desh të ndryshohen më herët, nuk i kanë mundësuar, ose nuk i mundësojnë. Ne kemi pasur probleme me Bashkësinë Islame, e cila deri më tash nuk është konsideruar si person juridik dhe kjo ka qenë një nga ato që ata kanë pasur probleme deri më tash. Përveç Kishës Ortodokse dhe Kishës Katolike që kanë qenë të regjistruara si persona juridikë deri më tash, edhe regjistrimi me anë të këtij projektligji i plotëson, besoj që e plotëson këtë normë, po në këtë normë mendoj që te bashkësitë fetare duhet të shtohet. Duhet të shtohet, përveç Bashkësisë së Tarikateve, që është bërë mirë që është shtuar, se është një grup mjaft i rëndësishëm në Kosovë, është i shtrirë në gjithë Kosovën dhe po ashtu, nëse diku krenohemi ne si shqiptarë në përgjithësi, e kemi Bashkësinë e Tarikateve, ose Kryegjyshatën në Shqipëri, në Baba Tomor atje. Kjo do të thotë që të paktën në botë jemi të parët për një bashkësi fetare.

Për këtë tjetrën, që unë kërkoj, ashtu këtu përmendet Bashkësia Islame, Kisha Ortodokse, Kisha Katolike, Bashkësia e Besimit Hebrenj, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës, Bashkësia e Tarikateve, por mungon Kisha Ortodokse Shqiptare. Cila është arsyeja që të mos e kemi Kishën Ortodokse Shqiptare, po ashtu si njërën nga bashkësitë, që është mjaft e rëndësishme? Nëse nuk e kemi Kishën Ortodokse Shqiptare, ku do të jenë ortodoksët shqiptarë që jetojnë në Kosovë? Kujt do t'i nënshtrohen? Apo do ta krijojnë edhe ata vetë një bashkësi tjetër?

Prandaj, unë kërkoj që në nenin 4/a Bashkësitë Fetare, të shtohet në fund atje, ose në rend aty ku është tek kishat, edhe Kisha Ortodokse Shqiptare si bashkësi më vete në Kosovë, për shkak se një trashëgimi mjaft e madhe ortodokse është shqiptare dhe kështu që ajo duhet të jetë si element.

Tjetra është që në paragrafin, po ashtu 4/5 te neni 4/a, thotë: “Lirinë për të manifestuar fenë, ose besimin e kanë të gjithë individët”. Kjo është një e vërtetë, është edhe në bazë të Kushtetutës - liria individuale e besimit, po vetëm ose në komunitet me të tjerët. Edhe kjo është tamam, por thotë: “...edhe në qoftë se ata nuk regjistrohen dhe nuk e marrin statusin e personit juridik”. Nëse këta nuk regjistrohen, nuk e marrin statusin e personit juridik, cila është arsyeja të ekzistojnë, cila është arsyeja që të jetë ky ligj? Ne po kërkojmë që me anë të këtij ligji t'i regjistrojmë të gjitha bashkësitë fetare, ose grupet ekzistuese. Në anën tjetër, kjo i bie që çdokush mund të thotë “unë e kam këtë bashkësi në mënyrë individuale dhe veproj në mënyra të ndryshme...”.

Ne i njohim grupet fetare apo sektet e ndryshme nëpër botë, të cilat prezantojnë ekstreme të ndryshme të rrezikshmërisë në formën individuale që kanë krijuar, edhe grupe deri me nga 500 veta, sikur rasti i Japonisë, kur kanë qenë ato masakrat e tyre nga një grup i caktuar, që nuk kanë qenë të regjistruar asnjëherë. Ose, i kemi rastet në Amerikë, të cilat janë po ashtu nga individë të caktuar që kanë krijuar një rrjet të vetin dhe e kanë prezantuar dhunën ekstreme, nga e cila kemi viktima të shumta. Prandaj, nëse nuk regjistrohen, atëherë cila është arsyeja që të ekzistojnë? Nëse regjistrohen, pse nuk duhet të kontrollohen? Pse nuk duhet të auditohen? Cilat janë të hyrat e tyre dhe kah i marrin ato ndihma?

Ne sot përballemi me terrorizmin në të gjitha anët, prandaj të lejohet edhe kjo formë do të thotë që ne apo ky Kuvend po e manifestojmë një formë të tillë të ekstremit, që t'u lejojmë mundësitë ekstremistëve të ndryshëm të bashkësive të ndryshme fetare ta japin edhe ata një ekstrem që neve na e rrezikon shëndetin dhe jetën e njerëzve tanë.

Prandaj, për t'i mbrojtur ata, unë kërkoj që ose të jenë të regjistruar me ligj, ose të ndalohen ata që nuk regjistrohen. Prandaj, nëse nuk regjistrohet, pse është arsyeja për të ekzistuar? Do të thotë, shteti ua jep mundësinë të veprojnë në mënyrë të pavarur. Dhe, kjo pavarësi e tyre na shkakton rrezikshmërinë që mund ta kemi sikur shtetet që janë. Ne jemi një popull i vogël dhe nëse hyjmë në këtë ekstrem, atëherë ne do ta kemi një tragjedi tonën. Për ta mbrojtur këtë, unë

kërkoj që të gjithë ata që janë si bashkësi të regjistruhen, individualisht apo çfarëdo forme tjetër, në bazë të ligjit. Ata që janë kundër ligjit, të ndalohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Qëndrimin e “Vetëvendosjes” sigurisht se e paraqiti shefi i grupit, zoti Konjufca.

Po e ndaj shqetësimin e njëjtë me deputetin Lumirin për çështjen e nenit 12, paragrafi 3, sa i përket asaj që tha kryeministri.

Zoti kryesues, nuk ishte qëndrim i njërit prej deputetëve, por ishte qëndrim i kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe po dua ta shpjegoj përse “Vetëvendosje” ka problem nëse ky nen, përkatësisht ky paragraf hiqet, për shkak se është në dy drejtime.

E para, ne në “Vetëvendosje” kemi diskutuar gjatë që një prej mënyrave të rregullimit ndoshta të çështjes së problemeve të mundshme që dalin nga çështjet fetare ka qenë që të kontrollohen financat e të gjitha bashkësive fetare, duke u rregulluar nëpërmjet financimit shtetëror, por në të njëjtën kohë ato të jenë edhe subjekte të cilat u raportojnë institucioneve, siç janë edhe institucionet tjera.

Në këtë formë çfarë e prezantoi kryeministri është shumë problematike, për shkak se e heq një paragraf i cili ia ndalon Qeverisë të ndajë para, sepse mënyra qysh po prezantohet nga kryeministri është problem edhe për faktin se tashmë kryeministri e ka vendosur një praktikë, për mendimin tim, shumë ad hoc dhe në mënyrë shumë arbitrare të ndarjes së fondeve nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Dhe, heqja e këtij paragrafi e kthen “Vetëvendosjen” në pozicionin që nuk do ta votojë këtë ligj, për shkak se ia mundëson këtij kryeministri, por ndoshta edhe kryeministrave të ardhshëm, që të shpërndajnë para në bashkësi të ndryshme fetare, për ndihma të ndryshme, të cilat mund të keqpërdoren në të gjitha drejtimet.

Kështu që është mirë nëse ju e merrni përsipër si kryesues i seancës që nëse e votojmë ligjin me këtë paragraf, atëherë “Vetëvendosje” e voton ligjin, nëse ligji pëson ndryshim në këtë paragraf për ne është shumë i ndjeshëm dhe si “Vetëvendosje” po ashtu nuk e votojmë këtë projektligj, për shkak se e krijon një hapësirë shumë të madhe, përveç dëmtimit të buxhetit, që tha zoti Abdixhiku, për mendimin tim, edhe më të madhe të keqpërdorimeve të ndryshme dhe financimeve të ndryshme të bashkësive të ndryshme fetare, në mënyrë krejtësisht ad hoc dhe të parregulluar me buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë, proceduralisht Qeveria ka të drejtë ta tërheqë ligjin. Nuk ka të drejtë ta ndryshojë ligjin kur është në shqyrtim. Për të mos e zgjatur më shumë, fjalën e ka zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Në fakt, kur e kam kërkuar fjalën ka qenë pikërisht për çështjen që qe dy-tri herë po diskutohet, cili është teksti? Ne e falënderojmë kryeministrin edhe për ekspozenë, edhe për propozimet që i dha. Po besoj që tashmë është e qartë edhe për të gjithë deputetët, veçanërisht për ata që s'e kanë mandatin e parë, që teksti kur të vijë në seancë nuk mund të ndryshohet ad hoc. Andaj, besoj që e sqaruar shumë mirë, që ne po votojmë për projektligjin, i cili në tekstin e tij i ka edhe këta dy paragrafë, të cilat kryeministri i propozoi. Nëse kryeministri në procedurë të mëtutjeshme propozon vetë apo nëpërmjet deputetëve të caktuar që këto të hiqen, ato do të shqyrtohen në procedurën e ardhshme nëse sot e kalojmë këtë ligj në parim, për çka besoj që qëndrimin e PDK-së e dini, se do ta votojë parimisht, për ta dhënë pastaj kontributin në fazat e ardhshme.

Meqenëse e mora fjalën, po i them vetëm edhe nja dy fjali. Sot dominon në këtë seancë për këtë projektligj debati për bashkësitë fetare, ndërsa ligji nuk është ligj për bashkësitë fetare, por për lirinë fetare. Dhe, para së gjithash, liria është individuale, është një e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Para se të flasim për lirinë kolektive të besimit dhe të asocimit e të grupimit në fe apo religjione, apo në besime të ndryshme, bashkësi fetare, ne po flasim për lirinë e secilit individ, e secilit person në Kosovë, që të besojnë ashtu siç ata besojnë dhe ashtu siç ata duan.

Mendoj që në fazën e ardhshme, kushdo që të jetë në komision, po edhe në komisionet funksionale, duhet ta kenë parasysh që po flasim për të drejtat dhe lirinë e secilit qytetar të Kosovës dhe këto liri nuk do të duhej të cenoheshin pavarësisht qëndrimeve që mund t'i kenë bashkësitë e caktuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Në emër të komisionit, prapë e ka kërkuar fjalën zonja Balje.

DUDA BALJE: Hvala!

Otprilike ste rekli ono što je i pravilo, i ono što sam ja htela da kažem. Ono što je premijer danas rekao, oni će u ime Vlade doneti napismeno u Funkcionalnoj komisiji kao amandman za moguću promenu zakona.

Danas trebamo da glasamo zakon onakav kakav je ispred nas. Sve ono što smo danas pričali, normalno čekamo u komisiji, i očekujemo da ćemo imati podršku u komisiji, a i za drugo čitanje. Hvala!

KRYESUESI: Atëherë, në fund u paraqitën edhe dy, ne deshëm ta ndërpresim debatin dhe kur flet i fundit, kryetari i komisionit, të tjerët pastaj s'ka nevojë të flasin. Kështu që jeni paraqitur me vonesë, zoti Topalli dhe Mikullovc.

Si është çështja e numrave?

Atëherë, dua të ju them se në sallë janë 84 deputetë. Kemi më shumë se 2/3-at për votim. Kemi 17 pjesëtarë të komuniteteve, që sipas rregullave kushtetuese duhet të marrin pjesë në votim për këtë ligj dhe duhet t'i kemi 2/3-at. Domethënë, 61 duhet të votojnë, dhe të tjerët prej pakicave, prej komuniteteve, duhet të votojnë 11.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, por para se të votojmë dua të pyes nëse ka dikush që nuk ka kartelë? Të gjithë keni kartela.

Votojmë tani!

Konstatohet se kanë votuar 78 deputetë. 61 kanë votuar për, 4 kundër dhe 13 kanë abstenuar.

Tani presim njoftimin e regjisë sa i përket votimit të komuniteteve. Regjia, ju lutem, numërojini votat e komuniteteve!

Atëherë e kemi një problem të vogël sa i përket kartelës së Korab Sejdiut, s'i ka funksionuar, mbeten 62 vota, por kjo nuk e ndryshon rezultatin. Votimi nuk ndryshon diçka, sepse janë 61 vota, prej këtyre 15 nga pakicat dhe konstatohet që Kuvendi me 61 vota për, 13 abstenime dhe 4 kundër, prej tyre 15 vota nga komunitetet, e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk është këtu, kryeministri e ka autorizuar zotin Kujtim Gashi që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Gashi, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Në mungesë të kryeministrit, më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj, pasi që i njëjti ka kaluar edhe në procedura të tjera të parapara dhe i plotëson të gjitha kushtet për votim.

Ky ligj është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Prishtina si kryeqytet për herë të parë do të trajtohet me ligj të veçantë, i cili do të jetë në funksion të zhvillimit të gjithanshëm të kryeqytetit të Republikës së Kosovës/Prishtinës.

Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta votoni në parim këtë ligj dhe t'i mundësoni plotësimet eventuale deri te miratimi final i këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zoti Nait Hasani, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje ministra,

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 27. 10. 2017, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin numër 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

Mendoj që ky projektligj duhet të kalojë në parim, si komision kemi mundësinë ta ndryshojmë, ta plotësojmë, ta amendamentojmë.

Ky projektligj në përgjithësi nuk i plotëson të gjitha ato kërkesa për një kryeqytet të Republikës së Kosovës, ky projektligj i ka disa të meta, të cilat ndoshta nuk ka qenë e mundur t'i përmirësojmë, për shkak se trajtimi i tij nuk është bërë ashtu si duhet në plotësim.

Një nga gabimet që është bërë që ky projektligj nuk është marrë si model nga ligjet e kryeqyteteve të ndryshme të Evropës apo të rajonit, po është bërë bashkim modelesh të kryeqyteteve, të cilët e bëjnë jofunksional.

E para është që nuk ka një shtrirje;

E dyta, në aspektin e kryetarit vetëm i ndërrohet emri, se është i njëjti kryetar dhe

E treta, ky e ka çështjen e Policisë, Drejtorisë së Policisë, po ashtu edhe të çështjes së shëndetësisë, të cilat trajtohen në mënyra të ndryshme në raport me kryeqytetet e tjera që i kanë.

Një gabim tjetër që duhet të eliminohet është çështja e licencimit të operatorëve shëndetësorë, të cilët i kalojnë kryetarit të kryeqytetit, ku është shkelje e Ligjit të shëndetësisë, sepse atje i lëshon licencat Ministria e Shëndetësisë.

Prandaj, ne do të angazhohemi që më tutje të bëjmë amendamente të plotësim- ndryshimit të ligjit në të ardhmen në afatin kohor që e kemi sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Falënderojmë edhe Qeverinë që më në fund e solli në Kuvend Ligjin për kryeqytetin, një nga ligjet më të diskutuara dhe të debatuar në publik, po që asnjëherë deri më tash nuk u ishte dhënë mundësia deputetëve të diskutojnë për përmbajtjen e këtij ligji.

Po ashtu, unë dua të besoj se edhe diskutimi për përmbajtjen e projektligjit sot do ta ketë parasysh interesin e qytetarëve të Prishtinës dhe jo kush e qeveris atë, ndonëse unë i uroj kryetarit të rizgjedhur të Prishtinës punë të mbarë.

Sa i përket projektligjit, në fakt, ky projektligj në përgjithësi është i mirë dhe janë katër risi apo katër çështje që rregullon dhe janë të reja, e të cilat nuk i ka gëzuar kryeqyteti deri tani.

E para, është ndarja e një granti shtesë prej 4% nga granti total për komunat. Ndonëse mendoj se shuma duhet të diskutohet dhe për mendimin tim nuk është e mjaftueshme, megjithatë është më se e nevojshme dhe e drejtë që kryeqyteti të ketë një grant shtesë që të ofrojë me cilësi shërbimet e nevojshme, jo vetëm për banorët e përhershëm, në bazë të të cilit ndahet granti qeveritar për komuna, por për faktin se Prishtina ofron shërbime për një numër shumë më të madh të banorëve se sa numrin e banorëve të përhershëm apo banorëve rezidentë, si quhen në ligj.

Sepse në Prishtinë jeton një numër i madh i stafit diplomatik, të cilët nuk konsiderohen dhe nuk janë banorë të përhershëm të Prishtinës, jeton një numër i madh i studentëve, të cilët pjesën më të madhe të vitit, pothuaj nëntë muaj të vitit i kalojnë në Prishtinë dhe vetëm tre muajt e vitit jetojnë në komunat prej nga vijnë dhe po ashtu është një numër i madh i qytetarëve, të cilët ditën e kalojnë në Prishtinë, për shkak se punojnë nëpër institucione të ndryshme qoftë publike, qoftë private dhe vetëm në mbrëmje kthehen në komunat e tyre dhe për të gjithë këta banorë, për të

gjithë këta qytetarë që nuk janë banorë të përhershëm, Komuna e Prishtinës, në këtë rast kryeqyteti, duhet të ofrojë shërbime.

Prandaj, besoj se ky grant shtesë do t'i mundësojë kryeqytetit të rrisë kapacitetet e tij, në mënyrë që të rrisë po ashtu cilësinë e shërbimeve që ofron për qytetarët e vet.

Çështja e dytë ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Prishtina është ndër qytetet e vetme të mëdha, e cila nuk ofron shërbime dytësore apo shërbime sekondare mjekësore dhe të gjitha këto shërbime janë kryer nga Qendra e Shërbimit Klinik Universitar, e cila është e thirrur të ofrojë shërbime terciare. Prandaj, edhe kjo është një e mirë, me të cilën shpresojmë se Komuna do të mund ta themelojë dhe kur të themi të themelojë spitalin, nuk do të thotë vetëm ta ndërtojë ndërtesën e spitalit, por ta bëjë atë funksional, në mënyrë që të ofrojë shërbime sekondare për banorët e kryeqytetit.

Dhe, çështja e tretë, e cila ka ngjallur më së shumti edhe diskutim në komision, është ajo e ofrimit të sigurisë dhe rendit publik në kryeqytet.

Shqetësimet e Policisë së Kosovës mendoj se janë të paqëndrueshme, kur thonë se me këtë ligj cenohet vija e tyre komanduese.

Në shumë kryeqytete të Evropës, por edhe më gjerë, kryeqytetet e kanë policinë e vet. Në disa raste, është polici metropolitane apo policia bashkiake, gjë të cilën në fakt nuk e rregullon, nuk e ofron ky ligj.

Megjithatë, ky ligj i mundëson kryeqytetit, qeverisë së Prishtinës, që të ketë një departament të veçantë, i cili ndodhet dhe do të jetë në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila do të mund të ofronte siguri dhe rend në kryeqytet.

Në takimin e Komisionit Parlamentar me rastin e shqyrtimit të këtij projektligji zyrtarët e Policisë së Kosovës në veçanti kanë shprehur shqetësim për emërimin e komandantit të Policisë për Prishtinën, por kjo sipas këtij projektligji nuk e cenon aspak vijën komanduese, pasi që komandanti i policisë do të propozohet nga kryetari i Komunës, por ai do të emërohet nga drejtori i përgjithshëm.

Por, është një çështje tjetër, e cila nuk rregullohet dhe nuk përmendet fare në këtë projektligj dhe unë shpresoj se nëse nuk rregullohet me këtë projektligj, atëherë Ministria e Administratës Publike do ta ketë parasysh me rastin e hartimit të Ligjit për pagat, sepse është e padrejtë që ta zëmë një drejtor i Urbanizmit të paguhet njëjtë sikur në Prishtinë e sikur, për shembull, në komunat si Juniku, Klllokoti apo Parteshi, ngjashëm është.

Është po ashtu e padrejtë që një drejtor, ta zëmë i Shërbimeve Publike i Komunës së Prishtinës, i cili duhet të ofrojë shërbime përreth gjysmë milioni banorë, të paguhet njëjtë si një drejtor i Drejtorisë së dikasterit të njëjtë, ta zëmë, në një komunë, e cila shërbimet i ofron përreth 5000 banorë dhe po ashtu e njëjtë, nuk është përgjegjësia e njëjtë si e kryetarit të Komunës së Prishtinës, gjegjësisht kryeqytetit dhe si e kryetarit të Komunës, ta zëmë, Parteshit, Junikut apo Mamushës, komuna që menaxhojnë me një numër rreth 3 000 deri në 5 000 banorë. Prandaj edhe kompensimi për punën dhe përgjegjësinë e tyre duhet të jetë meritore në bazë të përgjegjësisë, punës, vëllimit të punës që ata kanë, e jo thjesht në bazë të titullit të pozitës që ata e mbajnë.

Edhe një herë unë i bëj thirrje Ministrisë së Administratës Publike që me rastin e hartimit të Ligjit për pagat ta ketë parasysh edhe këtë fakt.

Në parim Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë Ligjin për kryeqytetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Zharku, po më duket është paraqitur... Imet Rrahmani e ka fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes edhe opinionin, mendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Komuna e Prishtinës aktualisht posedon statusin ligjor që nuk dallon nga statusi ligjor i komunave të tjera në Republikën e Kosovës, bile disa nga kompetencat shtesë që u njihen disa komunave në sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës, sigurisë e të tjera, nuk i njihen edhe Prishtinës.

Pra, Ligji për vetëqeverisje lokale nuk adreson sfidat e shumta të organizimit, funksionimit dhe administrimit efikas të jetës publike në kryeqytet.

Gjithashtu është e ditur se në fund të vitit 2015 është miratuar nga Qeveria e atëhershme koncept-dokumenti për ligjin për kryeqytetin.

Ky hap është pasuar nga hapa të tjerë të domosdoshëm në procesin e hartimit të ligjit, përkundër vështirësive prej atyre normale, të kuptueshme, procedurale, deri te ato më të pakuptimtat, projektligji është nxjerrë në diskutim publik javën e dytë të nëntorit të vitit 2016.

Në javën e parë të dhjetorit të vitit 2016 janë mbajtur këshillimet finale me ekspertë dhe shoqërinë civile për harmonizimin e draftit final. Pas kësaj, drafti final është dërguar në ministri

të linjës, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Financave, për komentet përfundimtare të bëhet dakordimi final.

Krejt kjo punë është bërë edhe me përkrahjen e Qeverisë zvicerane, respektivisht projekti DEMOS.

Ekspertët e angazhuar, përpos të tjerash, kanë pasur për obligim që të përpilojnë edhe një material plotësues, ku do të specifikoheshin të gjitha aktivitetet shtesë të kryeqytetit që bëjnë të dallojnë nga qytetet e tjera, veprimet e administratës komunale lidhur me këto aktivitete, përfshirë edhe koston financiare të tyre.

Nga drafti që ne e kemi marrë shihet se zgjidhjet që ofrohen nuk janë të dakorduara dhe të harmonizuara deri në fund, krijojnë konfuzion dhe sigurisht që shtrojnë pyetjen e pashmangshme sa e po bëjmë ligj për kryeqytetin apo po bëjmë një ligj, i cili ia shton disa kompetenca Komunës së Prishtinës, ia rrit pak buxhetin dhe shkakton një mori problemesh me zbatimin e ligjeve aktuale që rregullojnë shumë fusha të jetës publike.

Të nderuar deputetë,

Me draftin e ofruar dhe materialin që kemi pasur përpara dhe që e kemi shqyrtuar, ende nuk jemi të sigurt se granti shtesë në lartësinë jo më pak se 4% e grantit të përgjithshëm të komunave është i duhuri për të gjitha specifikat që ka Komuna e Prishtinës.

E dyta, nuk janë harmonizuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme çështjet e kompetencave të sigurisë publike, pa cenuar kushtetutshmërinë dhe Ligjin për policinë.

Siç u cek edhe më herët, problematika e organizimit unik të Policisë së Republikës së Kosovës, emërtimi i drejtorit të Policisë së kryeqytetit dhe raporti i kompetencave dhe përgjegjësi të drejtorit të policisë së kryeqytetit me drejtorin e përgjithshëm të Policisë, në njërin anë, dhe me Kuvendin Komunal dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, në anën tjetër.

E treta, si do të tejkalohen problemet dhe shqetësimet e ngritura edhe në komision për kompetenca shtesë në sferën e shëndetësisë, nëse nuk janë të mbyllura dhe të dakorduara deri në detaje me Ministrinë e Shëndetësisë këto dilema.

A është propozuar zgjidhja e duhur për çështjen e licencimit të institucioneve shëndetësore në territorin e kryeqytetit dhe nën kompetencën e kujt do të jetë spitali i ardhshëm i përgjithshëm i kryeqytetit.

Dhe, cila do të jetë lidhja ligjore me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Këto çështje, dilema, rreth fushës së shëndetësisë ndoshta do të harmonizohen më lehtë, sepse është kaluar në Qeverinë e kaluar edhe koncept-dokumenti apo plotësim-ndryshimi i Ligjit për shëndetësi dhe sigurisht që aty do të duhet të kihet parasysh edhe këto kompetenca shtesë për kryeqytetin.

Të nderuar kolegë,

Gjithashtu Ligji për kryeqytetin do të duhet të adresojë qartë se cila është kompetenca e kryeqytetit, respektivisht Prishtinës, për themelimin e ndërmarrjeve publike komunale. Sikurse që duhet të qartësohet me ligj raporti, respektivisht bashkëpunimi ndërmjet kryeqytetit dhe autoriteteve qendrore në të ardhmen, pa lënë mundësi për keqkuptime dhe kundërshti.

Duke u nisur nga kjo që thamë, po shihet se të gjitha këto dilema duhet të adresohen në mes të dy leximeve dhe se Lidhja Demokratike e Kosovës do të jetë serioze, do të jetë konkrete dhe shumë e përkushtuar që të nxjerrim një ligj, i cili do të jetë ligj vërtet për kryeqytetin e Prishtinës dhe me këtë i japim fund një çështjeje të ngritur që disa herë dhe që buron edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për ministrat e Kabinetit,

Përsëritje për të gjithë kolegët deputetë dhe qytetarët, të cilët janë duke na përcjellë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për kryeqytetin e Prishtinës dhe përsëritet sigurisht vendimin e Qeverisë për të sjellë në miratim.

Po ashtu, do të jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të gjitha komisionet kur do të silltet ky ligj, edhe pse deri sot nuk kemi pasur, përveç Ligjit për qeverisjen lokale, nuk kemi pasur një ligj, i cili rregullon mënyrën e funksionimit të kryeqytetit.

Të gjitha vërejtjet që u thanë, përfshirë edhe kryetarin e komisionit dhe kolegët nga grupet e tjera parlamentare, edhe Grupi i Partisë Demokratike i ka pasur si të arsyeshme t'i diskutojë, mirëpo besoj që në komisionet përkatëse do të kemi mundësi t'i shqyrtojmë edhe gabimet apo lëshimet, të cilat kanë ndodhur dhe gjatë amendamentimit të përmirësohen.

Nuk mund të përjashtojmë faktin që kemi ndërhyrje në disa ligje, i përmendën edhe kolegët e nderuar, që në çështjen e sferës së shëndetësisë, kompetencave në mënyrën se si trajtohet çështja e shëndetësisë, pastaj kemi te fakti që interferon edhe në Ligjin për organizimin dhe hierarkinë e Policisë së Kosovës, ku zyrtarë policorë kanë dhënë vërejtjet e tyre, ne i kemi pasur parasysh si

anëtarë të komisionit, meqenëse vetëm është në parim, ne do të kemi mundësi, pra, të diskutojmë dhe nuk mund të anashkalojmë faktin që ka interferime.

Më lejoni të theksoj që për neve është shumë e rëndësishme si deputetë që po diskutojmë për herë të parë, do të mundohemi të bëjmë një ligj të mirë, kemi obligime të bëjmë një ligj të mirë, duke marrë shembuj edhe nga ligjet e tjera, të cilat mund të jenë përafërsisht të njëjta me karakteristika në rajon që të bëjmë rregullimin dhe organizimin në mënyrën më të mirë të funksionimit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Ligji për kryeqytetin, si projektligj ka interferime edhe në ligje të tjera, për shembull, edhe në Ligjin për administratën shtetërore, ku kemi mënyrë se si funksion pra organogrami i pozicioneve brenda komunës. Ligji i ri, projektligji thotë që do të ketë kryetarin dhe dy nënkryetarë, ndërsa deri tani me organizim të Ligji për qeverisje lokale kemi një nënkryetar, që i bie komunitetit shumicë dhe një tjetër nga komunitetet e tjera. Pra, në këtë drejtim, kemi arsye të kërkojmë sqarime, sepse nëse ne do të bëjmë një nënkryetar të dytë, atëherë patjetër duhet të kemi një bashkëpunim edhe me Agjencinë e Statistikave për numrin e banorëve, përkatësisht edhe numrin e komuniteteve të tjera, pra këtu nuk kemi sqarime.

Gjithashtu, ne gjatë punës në komisione të tjera kemi nevojë të konsultohemi me ekspertë të fushave përgjegjëse për të gjithë sektorët, të cilët mbulojnë kryeqytetin, meqenëse për herë të parë po bëjmë ligj për kryeqytetin.

Sigurisht që ne si grup parlamentar jemi pro miratimit në parim dhe urojmë që të kemi një punë të mbarë deri në versionin final, e shihet që do të ketë një punë goxha të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e ka adresuar projektligjin në Kuvend sipas strategjisë legjislative.

Gjithashtu Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin para miratimit në parim sipas Rregullores së Kuvendit.

Me këtë projektligj parashihet që Prishtina, si kryeqytet i Kosovës, të ketë status të veçantë juridik.

Territori i Prishtinës mbetet i njëjtë sipas Ligjit për kufijtë administrativë të komunave.

Ky projektligj ka rëndësi, sepse me të rregullohet organizimi dhe funksionimi i kryeqytetit dhe kompetencat shtesë, të cilat komunës i caktohen me këtë projektligj.

Si kompetencë shtesë kryeqyteti ka grant të veçantë, ka policinë komunale, spitalin si dhe ndërmarrjet publike komunale, “Termokosin”, “Pastrimin” dhe Ujësjellësin.

Mbi bazën e këtij projektligji kryeqyteti gjithashtu i nënshtrohet mbikëqyrjes nga autoritetet qendrore në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Prishtina me këtë projektligj do ta ketë përkrahjen e autoriteteve qendrore për ushtrimin e funksioneve dhe veprimtarisë së vet.

Të nderuar koleg deputetë,

Ky projektligj, edhe pse i vonuar, po i domosdoshëm, është i mirëpritur nga të gjithë, në veçanti nga qytetarët e Prishtinës.

Asnjë parti politike, e aq më pak Parlamenti i Republikës së Kosovës duhet ta shohë këtë projektligj në prizmin se kush do ta udhëheqë sot Prishtinën apo në të ardhmen.

Ky projektligj nuk është një projektligj politik, por është në të mirë të Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës.

I vlerësoj angazhimet e legjislativave të mëparshme për ta shtyrë përpara këtë projektligj, por mbase ka munguar vullneti politik që ky projektligj të jetë i përfunduar.

Unë dua të besoj që këtë herë projektligji i proceduar në Kuvend nga Qeveria e udhëhequr nga zoti Ramush Haradinaj do ta ketë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, duke respektuar afatet e parapara me rregullore deri te fillimi i implementimit, e që besojmë se do të ndodhë në vitin 2018, kjo është në vullnetin tonë të përbashkët.

Prandaj, kolegë të nderuar të të gjitha grupeve parlamentare, ju ftoj që bashkë ta bëjmë ligjin e shumëpritur dhe të domosdoshëm për Prishtinën.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim miratimin e projektligjit si dhe do të kontribuojë gjatë fazës së amendamentimit për ndryshimet eventuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Nuk po e zgjas, besoj që do të marrim pauzë, jemi lodhur të gjithë deputetët, por në parim “Nisma” konsideron që më mirë është t’i kemi 10 euro në xhep se sa 0 euro dhe këtu debatet shpeshherë po bëhen, ende po mendojnë që jemi në fushata. Është së pari turp që nuk ekziston deri më sot ligji për kryeqytetin, për Prishtinën. Këtë është më mirë ta diskutojmë, pse s’kemi pasur ligj deri tani?

E dyta, ne nuk po zbulojmë kurrgjë, se të gjitha ligjet i kemi ‘copy past’ prej Zagrebit ose prej Lubjanës, kështu që edhe Tirana e ka Ligjin për kryeqytetin e vendit, edhe Shkupi e ka Ligjin për kryeqytetin, edhe ne duhet ta kemi atë ligj dhe në emër të Grupit Parlamentar të “Nismës” e mbështesim fuqishëm këtë ligj. Më mirë të kemi një ligj të keq për kryeqytetin, se sa të mos kemi ligj fare dhe ky ligj nuk është bërë deri më tani vetëm për shkak të inateve dhe ndërskamcave politike. Këtu nuk flitet për ligje, por flitet për politikë. Nuk ekziston te shumica e deputetëve në Parlamentin e Kosovës interesi për krijimin e shtetit, për forcimin e shtetit, të institucioneve, por për forcimin e kapricioziteteve të ndryshme dhe inateve të ndryshme politike. Po të ekzistonte minimumi i vullnetit për krijimin e institucioneve shtetërore, Prishtina nuk do të ishte deri sot pa ligjin për kryeqytet.

Prandaj, mbi bazën e kësaj dhe i lus kolegët e mi deputetë të mendojnë pak te ritmi i punës së Kuvendit. Me sa unë gjykoj, qofsha i gabuar, por nuk shoh deri më sot që ne në Parlament kemi mbajtur ndonjë seancë normale parlamentare. Të shpresojmë se prej sot e tutje Parlamenti të normalizohet, gjendja në Parlament të normalizohet dhe ligjet nuk do t’i shikojmë me dioptrinë e politikës, por me dioptrinë e interesit të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Milaim! Shpresoj portalet do të shkruajnë menjëherë çfarë the. Fjalën e ka zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Prishtinën, pa dashur që t’i përsëris ato që u thanë nga kolegët e mi paraprakisht, ne në parim e përkrahim këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim në punën nëpërmjet komisioneve parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve, fjalën e ka zoti Sami Kurteshi, s’është këtu. Atëherë, zoti Topalli, a është këtu?

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I dëgjova vërejtjet e grupeve të tjera parlamentare deri tani, posaçërisht të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe pajtohem me disa vërejtje që kanë të bëjnë me përcaktimin e çështjeve që kanë të bëjnë me raportin me autoritetet qendrore. Por nuk pajtohem me atë që i përket hierarkisë së policisë. Çështja e policive komunale është një çështje, e cila është e rregulluar në shumicën e vendeve evropiane, madje në disa shtete, si në Gjermani, ekziston policia komunale qysh prej themelimit të Republikës së parë parlamentare në vitin 1918.

Unë kam shikuar kryesisht ligjet, të cilat janë në Austri, Zvicër e Gjermani, nuk ka ndonjë problem sa i përket zinxhirit komandues, për arsye se detyrat që merr Policia komunale janë kryesisht detyra, të cilat i bën edhe ashtu policia dhe kjo çështje është e rregulluar me Ligjin e policisë. Kjo thuhet edhe në ligj, kështu që në këtë drejtim nuk ka asnjë problem, për arsye se krijimi i policisë, respektivisht funksionalizimi i policisë komunale i sjell, respektivisht, i ndihmon edhe vetë policisë së përgjithshme, për arsye se detyra të caktuara të cilat kanë të bëjnë me sigurinë publike, me qetësinë dhe rregullin, janë çështje të cilat pastaj i merr përsipër policia komunale, por në të përgjithshmen nuk ndryshon asgjë.

Prandaj dhe kjo çështje e zinxhirit komandues po shtrohet kot si problem, sepse në këtë kuptim nuk ndryshon asgjë, sepse kjo çështje është e rregulluar me ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua ta trajtoj çështjen e Ligjit për kryeqytetin pa ndonjë ngjyrim politik, vetëm si çështje të kryeqytetit si qytetit më të madh dhe në vijë me fjalën e përfaqësuesit tonë, zotit Rrahmani, dua të them se është ligj i domosdoshëm, por kam frikën që po i rregullojmë pak ose fare çështjet thelbësore që ndërlidhen me kryeqytetin e Kosovës.

Dua ta fokusoj shkurtimisht diskutimin në dy çështje: në të parën, në idenë që Prishtina është natyrisht kontribuuesi më i madh dhe kryesor i Buxhetit të Republikës, me 1/3 e parave të kontribuara në buxhet dhe po aq me kontribut në bruto-produktin vendor të Kosovës. Njëkohësisht Prishtina është konsumuesi më i madh i aktiviteteve publike në vend dhe administrative, si qendër gravituese e shumë qytetarëve të Kosovës. Pra, në thelb të zgjidhjes së problemeve të kryeqytetit është financimi. Thënë të drejtën, ligji sado që bën një përparim të lehtë nëpërmjet rritjes së grantit ose ndarjes së grantit të veçantë prej 4%, si prag minimal, natyrisht, është i pamjaftueshëm, sepse granti i përgjithshëm i komunave sot në Buxhetin e Republikës, ministër, më korrigjo nëse jam gabim, është diku rreth 179 milionë euro në vit dhe i bie që 4% e 179 milionë eurove në vit është jo më shumë se 7 milionë euro në vit që po i shtohen Prishtinës.

Pra, po, i japim kompetenca, po i japim obligime të reja, por me të gjitha problemet që po i theksojmë në Prishtinë, me zgjidhje prej 7 milionë shtesë në buxhet, dorën në zemër është josinjifikante, është e parëndësishme, sado që është pozitive. Pra, unë po kërkoj që të trajtojmë këtë problem të kryeqytetit dhe që këtë vlerë ta trajtojmë me seriozitet pak më të madh. Unë edhe në buxhet kam vërejtur se projektet më të mëdha kapitale shkojnë larg Prishtinës, ama dje edhe stadiumin që e patëm në kryeqytet e larguam prej Prishtinës. Pra, ka mungesë serioze të investimeve qendrore, përkundër po themi 1/3 të kontributit financiar në buxhet dhe po besoj që do të ishte e drejtë si kryeqytet, me të gjitha nevojat që i ka, jo vetëm të banorëve të Prishtinës, por të gjithë atyre që i shfrytëzojnë shërbimet e kryeqytetit, që këtë grant ta kemi më të lartë se sa vlera reale 7 milionë euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Do të mundohem të bëj një shpjegim se çka nënkupton ky ligj. E para, domethënë ky e rregullon statusin e kryeqytetit në bazë të Kushtetutës së Kosovës, edhe mirë që po bëhet.

Do të thotë, ky i jep përgjegjësinë si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale kryeqytetit. Kryetari të komunës ose kryetari të bashkisë i jep kompetenca shtesë, por natyrisht që i jep kompetenca shtesë edhe Asamblesë ose Kuvendit Komunal, do të thotë do t'i rriten kapacitetet Kuvendit Komunal.

Çfarë përgjegjësie shtesë mund t'u japim? E kemi sigurinë publike, u diskutua prej parafolësve, do të thotë policia themelon Drejtorinë e Policisë për kryeqytetin, ndërsa kryetari i komunës ose kryetari i bashkisë i propozon drejtorit të Policisë dy emra, njëri prej tyre edhe e merr detyrën. Po ashtu, kryetari i kryeqytetit, pas aprovimit nga Kuvendi Komunal, i propozon minimum dy kandidatë. Do të thotë, është e zgjidhur kjo temë, po tash se sa kompetenca do të kenë ata drejtorë të policisë, kryesisht janë për sigurinë e zonës territoriale sa e menaxhon kryetari edhe kuvendi i kryeqytetit.

Kuvendi i kryeqytetit ka të drejtë të kërkojë nga drejtori i policisë së kryeqytetit të informojë lidhur me gjendjen e sigurisë. Me kërkesë të kryetarit të kryeqytetit, Policia e Kosovës, në pajtim me ligjet për policinë themelon njësi të veçanta duke u bazuar në nevoja të kryeqytetit. Do të thotë, është e shpjeguar deri diku. Përgjegjësi shtesë që ka kryetari i kryeqytetit është shëndetësia, krijimi i spitalit të kryeqytetit, nuk po bëhet fjalë për spitalin e përgjithshëm, por për spitalin e kryeqytetit. Cilat janë organet e kryeqytetit? E kemi Kuvendin e kryeqytetit, kryetari i kryeqytetit. Kuvendi i kryeqytetit ka të drejtë përpos kompetencave aktuale që i ka, të krijojë edhe mekanizma të tjerë funksionalë, ka të drejtë të krijojë ndërmarrje komunale, do të thotë, me Ligjin për vetëqeverisjet lokale komunat e zakonshme nuk kanë pasur të drejtë t'i kenë.

Kryetari i rriten kapacitetet në kuadër të kabinetit të tij, po ashtu kryetari ka të drejtë të lidhë marrëveshje buxhetore me Qeverinë e Republikës së Kosovës, në varësi prej projekteve që i ofron. E ka pronën e kryeqytetit, specifikisht domethënë saktësohet prona e kryeqytetit. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, siç e tha edhe Lumiri, shumë mirë e tha, ndoshta edhe kjo do të rritet, sepse është 4% e granteve në total që do t'u jepen të gjitha komunave, kjo edhe mund të rritet, por meqenëse është në fazën fillestare, prapëseprapë gjatë amendamentimit besoj që do të ketë edhe ndryshime.

Në tërësi, i tërë ky ligj i ka 21 nene dhe besoj që kryetari i ardhshëm, cilido të jetë, do ta ketë më të lehtë menaxhimin e të gjitha resurseve që i ka kryeqyteti, gjithsesi e përsëritës këtë projektligj dhe besoj që do ta votojmë bashkarish pa dallime politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Duke marrë parasysh përvojën që kam pasur në kryeqytet, do të thotë duke punuar në kryeqytet, unë mendoj që ky ligj nuk është i mjaftueshëm, edhe pse është jashtëzakonisht i nevojshëm.

Sidomos në pikën e çështjes së sigurisë, për shembull, aty përmendet se kryetari i komunës ka të drejtë të propozojë dy emra për emërimin e drejtorit të Policisë së kryeqytetit, por nuk përmendet asesi se çfarë mund të bëjë kryetari i komunës nëse nuk has në bashkëpunim ndërmjet komunës dhe policisë, meqenëse edhe ashtu ai drejtor do të jetë nën komandën e drejtorit të Policisë. Do të thotë, është e udhës të përcaktohet jo vetëm çështja e emërimit, por po ashtu edhe çështja e suspendimit apo shkarkimit të këtij drejtori.

Tash kur po flasim për Drejtorinë e Policisë së kryeqytetit, kam përshtypjen se prej nivelit të Drejtorisë së rajonit, tash po krijojmë edhe një drejtori, e cila është pak më e vogël në aspektin territorial, por nuk jemi të qartë në lidhje me kompetencat dhe detyrat e kësaj drejtorie, përveç çështjes së emërimit, do të thotë çështjes së propozimit të kryetarit me dy emra. Kur kemi të bëjmë për buxhetin, u përmend këtu edhe më herët, unë plotësisht pajtohem se nuk korrespondon fare me nevojat apo obligimet që kryeqyteti ka, duke marrë parasysh numrin e banorëve dhe shërbimet apo detyrat që ka ndaj qytetarëve të vet, por edhe ndaj institucioneve qendrore, si dhe të gjithë qytetarëve, të cilët marrin shërbime nga kryeqyteti.

Po ashtu, për mua nuk është e duhur pika ku thuhet: “Ndërmarrjet publike lokale duhet të krijohen pas miratimit të 2/3 të asamblistëve të Kuvendit të Prishtinës, meqenëse kjo shumë shpesh nuk është zgjidhje, është mjet i bllokadave të ndryshme, bazuar në preferencat politike apo pazareve ditore. Do të thotë, nuk është një instrument, i cili cilido kryetar të kryeqytetit, qoftë tani, qoftë në të ardhmen, i lë duar e lira për t'i shërbyer qytetarit, e normalisht në kuadër të

këtij shërbimi pastaj dhe të japë përgjegjësinë për shërbimet e duhura apo për dështimin në ofrimin e këtyre shërbimeve të qytetarëve.

Prandaj, po e ritheksoj edhe një herë, është një ligj jashtëzakonisht i nevojshëm, fatkeqësisht shumë i vonshëm, por po ashtu nuk mendoj që i plotëson të gjitha ato nevoja, të cilat i ka kryeqyteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Disa çështje në lidhje me projektligjin që kanë të bëjnë më shumë të natyrës pak edhe politike, por natyrisht edhe rregullimin e çështjes së kryeqytetit. E para, është e logjikshme se s'mund t'i ikim, apo të themi të gjithë jemi pak subjektivë kur bisedojmë për këtë ligj, se prej 2007-ës ose Qeveria, ose Prishtina kurrë s'kanë qenë të partisë së njëjtë, kështu që është normale të themi që kur bisedohet për këtë ligj shikohet edhe aspekti partiak.

Do të kthehem te ajo që janë tri ligje që cenohen apo thjesht që preken që nuk e shoh të arsyeshme, duke filluar prej Ligjit të policisë, Ligjin për themelimin e ndërmarrjeve publike dhe e përmendëm shumë shëndetësinë. Besoj se nuk ka nevojë të preket Ligji për policinë, që të ketë një drejtori të posaçme për Komunën e Prishtinës, kur kjo çështje mund të rregullohet shumë thjesht nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe natyrisht rregullimin nga ana e vetë Policisë së Kosovës, por që me një bashkëpunim shumë më të afërt mes komunave, në rastin konkret dhe natyrisht, edhe Policisë së Kosovës.

Për mua, së paku nuk shoh asnjë arsye logjike pse duhet një komunë, në këtë rast Prishtina, të përjashtohet nga marrja e pëlqimit nga qeveria qendrore për themelimin e ndërmarrjeve lokale. Së paku, nuk shoh arsye logjike, nëse ka diçka logjike në këtë çështje, kisha dashur prej dikujt të dëgjoj pse duhet një komunë të përjashtohet nga marrja e pëlqimit për ndërmarrjet publike lokale. Nga aspekti politik, dorën në zemër, unë besoj se cenimi i këtyre ligjeve apo fillimi i rregullimit parcial sipas komunave mund të jetë precedent për raste të tjera që në këtë rast nuk po i paragjykoj se çfarë mund të jenë në këtë situatë politike që e ka Kosova.

Janë disa çështje që nuk besoj që është dashur të jenë hiq në ligj, për shkak se janë të rregulluara me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Organizimi i Kuvendit Komunal s'ka nevojë të jetë në këtë ligj dhe, natyrisht çështja e këshilltarëve, kryetarit, bash s'ka lidhje të jetë në ligj. Kjo është çështje tipike i një kryetari të komunës sa këshilltarë i mban, por nuk ka nevojë të jenë në Ligj për kryeqytetin, por për asnjë komunë.

Do të dal pak te çështja e nenit 17.7, ku thuhet: “Selia e institucioneve qendrore duhet të jenë në Prishtinë”. E kemi ministrin e Kulturës këtu, sa është një vendim i qeverisë më duket që të bartet selia e Ministrisë së Kulturës në Prizren, tash nuk e di qysh do të veprojë qeveria në lidhje me këtë çështje. Ishte dashur së paku të koordinohet para se të vijë ligji.

Është prapë një nen, për mua i palogjikshëm, është obligimi për njoftim për ngjarje publike. Unë nuk di, nëse ka logjikë të jetë në ligj një obligim nëse nuk ka sanksione për mosrespektim të atij obligimi. Çka nëse nuk e njofton kryetari i kryeqytetit Qeverinë që e ka një ngjarje publike, apo çka nëse nuk e njofton Qeveria kryetarin e Prishtinës për një ngjarje publike. Cili është sanksioni? Apo çka bëhet? Domethënë, s’ka logjikë të kesh një obligim nëse nuk ka sanksione.

Te çështja e 4% të grantit shtesë për komuna, nuk po besoj që është mirë të ketë një numër të caktuar, një shifër të caktuar. Unë po pajtohem me Lumirin që momentalisht kjo shifër është e vogël, por që ndoshta pas 5 apo 10 vjetëve kjo shifër mund të jetë e madhe. Kjo i bie që një komunë, në rastin konkret e ka Komuna e Prishtinës, e ka një grant të caktuar, pavarësisht asaj se a ka nevojë apo nuk ka nevojë për ato para. Kështu që në vend që të kemi një minimum, unë jam për caktimin e një forme tjetër apo një bashkëpunimi, të sanksionohet një bashkëpunim mes Komunës së Prishtinës, rastin konkret po flasim për kryeqytetin, se sa që të jemi me shifra konkrete.

Në fund, personalisht nuk jam bash i sigurt a kemi pasur nevojë për këtë ligj, por që do të shohim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje ministra,

Projektligji për kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, është e drejtë kushtetuese dhe kërkesë e Kushtetutës që të themelohet një ligj për kryeqytetin, siç e kanë edhe kryeqytetet e tjera të Evropës.

Mendoj që në këtë projektligj nuk janë trajtuar ose nuk janë qartësuar gjërat, për të cilat kërkohet. Unë e kam lexuar këtë projektligj, kam lexuar dhe materiale të tjera, të cilat janë trajtuar pikërisht për këtë projektligj, kam shikuar edhe modelet e shteteve të tjera, të cilat i kanë po ashtu ligjet për kryeqytetet dhe kam parë që ligji ynë është një kombinim i ligjeve, të cilat nuk kanë mundur ta japin atë për të cilën është kërkuar të nxirret ligji. Ky ligj më së paku i ofrohet Ligjit për kryeqytetin, më së paku ka të drejta për kryeqytetin, ky ligj vetëm e jep një ligj për vetëqeverisjen lokale, vetëm e trajton kryetarin e kryeqytetit si kryetar, përndryshe asgjë tjetër nuk ndryshon nga ligjet e tjera. Me kompetencat e policisë, kompetencat e shëndetësisë,

kompetencat e krijimit të ndërmarrjeve publike dhe formën e organizimit të zgjedhjes së nënkryetarëve, këshilltarëve, e tjerë.

Mendoj që me Projektligjin për kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, ne duhet të kemi një model nga ligjet e shteteve të rajonit, apo shteteve të Evropës që ta kemi si model dhe ta krijojmë sikurse e kanë ata. Ne nuk kemi nevojë të zbulojmë sikur që kanë bërë përpjekje të zbulojnë duke marrë ligj nga Gjermania, nga Berlina, nga Vjena, nga Sllovenia, nga Kroacia, edhe askund nuk kanë mundur ta trajtojnë në formën e duhur. Për të pasur një ligj të mirëfilltë nuk është bërë as ndarja e niveleve të pushtetit në bashki apo në komuna. Të gjitha shtetet e kanë ndryshe, do të thotë ata e kanë të ndarë me nivele, dy-tre nivele e kanë të ndarë domethënë kryeqytetin. Ata i kanë disa komuna, për shembull, Bashkia e Tiranës i ka disa komuna, të cilat e krijojnë bashkinë dhe kryetarin e bashkisë, ose Shkupi që i ka 11 komuna, po ashtu e ka edhe kryetarin e Shkupit, ka nënkryetarin e Shkupit, i ka edhe kryetarët e komunave, ka dhe formën e organizimit të policisë.

Është e nevojshme të ketë një drejtori, por jo një ndarje nga Ligji për policinë. Po ashtu, edhe për shëndetësinë, ata i kanë të përkufizuara drejtpërdrejt në formën që Ligji për shëndetësi, ministria i ndan këto certifikatat apo licencimet e tyre dhe ndërmarrjet publike. Te na është një problem vetëm ndërmarrja publike, krijimi i ndërmarrjeve të reja ose ndërmarrjeve ekzistuese si dhe cilët, kush do t'i trajtojë ato. A do të kenë pëlqime nga Qeveria apo nuk do të kenë pëlqime nga Qeveria. Çështja është te Pallati i Rinisë dhe kjo është një nga temat që ka qenë pengesë sa e sa herë të krijohet ky ligj për kryeqytetin e Kosovës. Edhe nëse Kuvendi i Kosovës, nëse Qeveria e Kosovës duhet ta kenë një projektligj të tillë të mirëfilltë për një kryeqytet siç e kanë shtetet e tjera, atëherë ata duhet t'i heqin ato brengat e tyre, e kujt është prona?

Prona e kryeqytetit është pronë e kryeqytetit apo është pronë e Qeverisë, apo është pronë e Agjencisë së Privatizimit, e kujt, por megjithatë mendoj që Pallati i Rinisë i takon Komunës së Prishtinës dhe ajo duhet të menaxhojë me atë pallat, për shkak se është objektiv i zhvillimit të kryeqytetit. Të tjerat janë elemente që unë kam biseduar edhe Ministrinë e Pushtetit Lokal, kam biseduar edhe me kryeministrin, edhe me shumë pjesëmarrës, të cilët janë të interesuar që ne duhet ta trajtojmë këtë ligj dhe ta marrim një nga modelet që ta zgjidhim një herë e mirë këtë çështje të kryeqytetit.

Kryeqyteti i Kosovës i ka përfaqësitë diplomatike, i ka studentët që i përmendi edhe Shqipja. I ka edhe të gjithë të tjerët që janë këtu, e që duhet ta kenë një trajtim të veçantë.

Trajtimi i veçantë është bërë pikërisht edhe me ngritjen e buxhetit me grantin për 4%, që do të thotë nga trajtimet e të gjitha komunave të tjera. E tash, a do të vlejë Ligji për vetëqeverisjen lokale për kryeqytetin? Nëse po, atëherë cili është dallimi në mes të ligjit për komunat tjera dhe ligjit për kryeqytetin?

Ligji për kryeqytetin duhet të jetë i veçantë, edhe me statusin juridik, po ashtu. Atëherë, nuk do të jetë i barabartë me komunat tjera. Nëse e kemi dhe e bëjmë të pabarabartë, në këtë rast Komunën e Prishtinës e nxjerrim dhe e bëjmë me ligj të veçantë për kryeqytetin, atëherë e kemi një status juridik ndryshe, dhe ai 4%-shi si grant që është, nuk është nga trajtimi i granteve për komunat që merret, por është shtesë grant vetëm për kryeqytetin për shkak të përfaqësive diplomatike, organizimeve shtetërore, organizimeve tjera, që do t'i marrë, mbrojtjen e sigurinë dhe shëndetësinë.

Një nga çështjet tjera që është përmendur këtu është po ashtu edhe çështja e një spitali rajonal, ose spitalit të Prishtinës, e që komunat tjera e kanë, ndërsa Prishtina trajtohet në spitalin e klinikës, dhe klinika aty sot është shndërruar në një klinikë emergjente. Domethënë, spital emergjent nuk është një klinikë që trajtohet, ose që duhet të trajtohet. Prandaj, krijimi i një spitali brenda apo jashtë klinikës, kudo, do ta krijonte mundësinë që klinika universitare të jetë ashtu si e ka emrin dhe autoritetin që duhet ta ketë.

Prandaj, të gjitha janë probleme që duhet të trajtohen. Besoj që në afatin kohor në bazë të Rregullores së Kuvendit, mund ta trajtojmë, mund ta plotësojmë, mund ta ndryshojmë, varet nga vullneti që e kanë deputetët, varet nga vullneti që e ka Qeveria, po ashtu edhe nga interesat e grupeve, ose interesat grupore politike. Kosova ka nevojë për një ligj për kryeqytetin dhe kryeqyteti ka nevojë për kompetenca që i kanë kryeqytetet tjera të Evropës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të kryeqytetit të Republikës së Kosovës,

Në fakt, ky ligj është i vonuar dhe ka vite tashmë prej momentit kur është aprovuar, apo kur u votuar Kushtetuta e kësaj Republike, jemi në pritje të Ligjit për Prishtinën.

Mendoj që ligji lë shumë hapësirë për diskutim dhe për të dëshiruar, por gjithashtu mendoj se është një nismë e mirë dhe e mbarë, e vonuar, po e përsëris, për t'i zgjidhur disa prej problemeve fundamentale që i ka kryeqyteti i kësaj Republike.

E para, meqë unë jam deputetë për herë të parë, të themi kështu, qëndroj në sallë për herë të parë, këtu thuhet në opinion, ministër, për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga organi propozues dhe dikush, po supozoj nga Ministria e Financave është bërë ky vlerësim, thotë: “për t'u zbatuar ky ligj kushton 222 milionë euro”, më poshtë thotë: “31 milionë euro.” Pra, për dikë që nuk është i mirë me numra mendon se kostoja e zbatimit të këtij projektligji është plot 222 milionë euro, e në fakt, edhe Lumiri e bëri një kalkulim të shpejtë, nuk është kështu. Kjo është shumë më e

vogël, pra 4% e grantit të përgjithshëm buxhetor, që kur e kalkulon këtu po del pak më e vogël si total i numrave ekzistues pa grant të përgjithshëm.

Tjetra që kisha pasur dëshirë ta trajtoj janë disa elemente. Komuna e Prishtinës ka nevojë për politikë komunale, si kryeqytet. Në Republikën e Kosovës, në kryeqytet, kryeqyteti, rendi publik dhe siguria publike menaxhohen me një numër jashtëzakonisht të vogël të policëve. Kur flas edhe për siguri publike dhe për rend publik, nuk mendoj vetëm për rregullim të trafikut dhe nuk mendoj vetëm për parandalim dhe luftim të krimit, por mendoj edhe për nevojat që i ka një kryeqytet si Prishtina për ta pasur përkrah vetes një polici komunale, e cila sigurohet për ta zbatuar ligjin, e kështu të ruhet rendi publik.

Po e marr një shembull përshkrues, nëse sot e kemi një ndërtim që fillon pa leje të organeve kompetente, Inspektorati i Komunës duhet ta paralajmërojë me një afat të caktuar kohor policinë, e policia më pastaj duhet të ndajë resurse, e tek atëherë të bëhet intervenimi për ta ndaluar një ndërtim. Dhe, nëse paramendoni dinamikën e ndërtimeve në Republikë të Kosovës, për 24 orë mund të kryhen goxha shumë punë.

Kështu që mendoj se vetëm në këtë përshkrim të vogël e shihni domosdoshmërinë që kryeqyteti ta ketë një polici komunale, e të mos flas edhe për uzurpime e trajtime të hapësirave publike, që bëhen me shpejtësi marramendëse, e që bëhen edhe kështu, si të them - pa leje.

Pra, nevoja për polici komunale mendoj se është temë që duhet shqyrtuar. Këtu në propozim flitet për një “vijë hierarkike” në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila do të ishte përgjegjëse për trajtimin e problemeve të sigurisë në Komunën e Prishtinës, por jo domosdoshmërisht edhe hierarkisht e lidhur drejtpërdrejt me Komunën. Mendoj se kjo është tepër e rëndësishme.

E dyta, që gjithashtu duhet të shqyrtohet me këtë projektligj janë autorizimet për taksa shtesë, që mund t'i përcaktojë apo mund të mendojë për t'i caktuar Komuna e Prishtinës. Ka shumë shembuj të kryeqyteteve, edhe në rajon e gjetiu, që kryeqyteti cakton taksa shtesë, duke u siguruar që të ketë edhe një të hyrë për shërbimet që ofron.

Tjetra, që do të ishte e rëndësishme ta ketë ky ligj, është që dispozitat për kredimarrje, ministër, kryeqyteti të ketë mundësi më të mëdha, më lehtësuese për kredimarrje. Ligji për borxhet publike e trajton njëjtë si Komunën e Parteshit, si kryeqytetin, dhe mendoj se këtu duhet të gjejmë një hapësirë, e cila i krijon kryeqytetit mundësi që të ecën përpara, sikur e kemi në ligj çështjen e ndërmarrjeve publike, duhet të mendojmë mirë për çështjen e borxheve publike.

Kapaciteti i kryeqytetit për të absorbuar dhe për të trajtuar kredi është shumë më i madh e shumë më i mirë sesa shumica, të mos them të gjitha komunat tjera.

Gjithashtu, duhet të sigurohemi që Ligji për Prishtinën, përveç diskutimeve që do t'i kemi në Kuvendin e Kosovës, të jetë sa më shpejt i inkorporuar edhe në diskutimet financiare buxhetore, meqë, sa më shumë që zgjat procesi i diskutimit të këtij ligji, aq më problem do ta kemi, ju si ministër këtë e dini, inkorporimin e kostos, ashtu siç e keni përshkruar në buxhetet e ardhshme.

Ky ligj rregullon në vete shumë çështje, që janë me rëndësi të veçantë për Prishtinën. Po e theksoj, e theksuan edhe disa kolegë deputetë, spitalin e qytetit. Mendoj se është e rëndësishme të kuptohet që diku 85% e vizitave që bëhen në qendrat e mjekësisë familjare në komunën e Prishtinës nuk vazhdojnë në Qendrën Klinike Universitare, por një 15%-sh vazhdon. E duke e pasur parasysh që kemi mbi 1 200 000 vizita në vit, pra numri 15% në 1 200 000 vizitave është numër i madh që shkon në Qendrën Klinike Universitare, kështu që domosdoshmëria për një spital rajonal në Prishtinë është edhe imediate, edhe diçka që duhet të ecim përpara me të. Dhe, Ligji i Prishtinës besoj që na e krijon këtë hapësirë.

Gjithashtu, themelimi i ndërmarrjeve publike, këtu kisha pasur dëshirë të kuptoj nga ata që e kanë draftuar ligjin, apo edhe nga ministri përgjegjës, se përse është vendosur që duhen 2/3-at e Kuvendit Komunal për themelimin e një ndërmarrjeje publike? A ka ndonjë logjikë në këtë? Cila është logjika? Thjesht, sepse në nenin i cili ka të bëjë me themelimin e ndërmarrjeve publike thuhet që Komuna e Prishtinës ka të drejtë për të themeluar ndërmarrje publike dhe që për ta themeluar një ndërmarrje publike duhen 2/3-at e votës në Kuvendin Komunal. Mendoj që duhet sqaruar përse duhet kështu, përse është vendosur kështu? Mendoj që një shumicë e thjeshtë mjafton për të ecur përpara. Në fund të ditës, organizimi që e kemi me Ligjin për vetëqeverisje lokale në këtë republikë është goxha i qartë sa u përket kompetencave të kryetarit dhe të Ekzekutivit, si dhe të Kuvendit Komunal.

Në fund fare, më vjen jashtëzakonisht mirë që kjo Qeveri ka vazhduar me procedimin e këtij ligji me një afat kaq të shpejtë. E përgëzoj për këtë, sepse kemi pasur qeveri të kaluara që për vite e vite të tëra, ndonëse e kanë pasur në sirtarë, nuk e kanë sjellë para Kuvendit. Ky ligj ka hapësirë për përmirësime, ka hapësirë për shtesa, të cilat do ta bëjnë Prishtinën si kryeqytet më lehtë dhe më mirë të organizuar, por gjithsesi faleminderit për ecje të shpejtë. Shpresoj që edhe me këtë ritëm do të vazhdojmë dhe me leximet e tjera dhe aprovimin, e gjithsesi edhe buxhetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, e mbështes dhe e përkrah pa rezervë ardhjen e Ligjit për kryeqytetin, që thjesht t'i kalojë procedurat e nevojshme, sepse, tek e fundit, kemi pasur obligim kushtetues.

E kam analizuar mirë këtë ligj dhe me ato 21 nene që i ka ky ligj, më tepër ka aspekt përshkrues apo deskriptiv edhe të ligjeve që kanë të bëjnë me pushtetin lokal. Janë atje disa nene të panevojshme, që e përshkruajnë organizimin e Kuvendit Komunal, i përshkruajnë detyrat e kryetarit të Komunës. Ato janë mirë dhe saktë të precizuara në ligjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale.

Unë dua të ndalem në dy-tri çështje kryesore. Dua të precizojmë në këtë ligj gjatë amendamentimit të mëtutjeshëm, gjatë debatit, me të gjitha fokus-grupet, grupet e interesit, me qytetarët, e të involvojmë edhe njerëz të tjerë që kanë përvoja, sepse për herë të parë po e draftojmë një ligj për kryeqytetin. Thjesht, te aspekti i sigurisë të mos bëjmë subordinim jo konform ligjeve, Ligjit për Policinë në këtë rast, apo edhe të qartësohet dhe të precizohet aspekti i ligjit bazik për shëndetësinë rreth spitalit të kryeqytetit.

A është i nevojshëm një spital i kryeqytetit? Definitivisht po, dhe unë vlerësoj që duhet ta amandamentojmë në mënyrë precize, sepse këtij ligji i duhen disa akte nënligjore apo udhëzime administrative, sepse vetëm po të bazohemi në nenet bazike të këtij ligji, ky ligj vështirë se do të gjejë zbatim.

Konsideroj që mungesë e këtij ligji janë zonat metropolitane të kryeqytetit, zonat me interes të veçantë zhvillimor për kryeqytetin, duke e ditur që hapësira publike, zonat e tilla të nevojshme për zhvillimin e kryeqytetit, sepse ne nuk duhet të mendojmë vetëm për një mandat qeverisës, por duhet ta bëjmë një ligj që mendon, vlerëson dhe ka vizion për zhvillimin e kryeqytetit minimum për nja 50 vjetët e ardhshme.

Konsideroj se ne duhet të angazhohemi që disa nene të këtij ligji të precizohen, mbase edhe zona të caktuara administrative, që i subordinohen territorit të kryeqytetit. Po ashtu, duhet ta precizojmë saktë, se pati vërejtje të kolegëve deputetë në organizimet e ndryshme të nivelit nacional, që i bëjnë institucionet qendrore të vendit në kryeqytet. Domosdo duhet të ketë koordinim institucioni i Presidentit, Kuvendi i Republikës, Qeveria, apo edhe ministritë e linjës për festa të ndryshme, për pritje të ndryshme, për organizime të ndryshme të nivelit nacional. Absolutisht që duhet të ketë koordinim të mirë me të gjitha strukturat e kryeqytetit, duke filluar prej kryetarit dhe mekanizmave tjerë.

Në këtë kuptim, duhet që këtë ligj të mos e shikojmë nëpërmjet filtrave politikë dhe partiakë, apo edhe të fushatave të mundshme politike. Ne duhet ta shohim këtë ligj për kryeqytetin e vendit tonë si qendër politike, kulturore, diplomatike, universitare, tek e fundit si adresa kryesore nacionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë kam dy-tri çështje që dua t'i theksoj këtu.

Çështja e parë është pikërisht kjo për të cilën folën shumica e kolegëve dhe kolegeve këtu. Ne e kemi një projektligj, një tekst përpara, që përpiket të bëjë njëfarë decentralizimi, tash po e themi, dhe kjo vuan nga çështja kryesore, se decentralizimi te ne, decentralizimi demokratik dhe financiar, që nënkupton kompetenca për të mirën e bashkësisë, është shumë vështirë të bëhet, sepse te ne është bërë një decentralizim, por ai ka qenë vetëm etnik dhe ka mbetur si i tillë. Në vend se të flitet për caktimin, qartësimin, dhe legalizimin e kompetencave, këtu flitet vetëm për mënyrën e kufizimit të kompetencave. A ka të drejtë kryeqyteti apo kryetari i kryeqytetit të caktojë policë, të caktojë drejtorin të policisë apo të propozojë kandidatë për drejtorë të njëfarë policie komunale apo jo, në vend se të bëhet qartësimi edhe saktësimi i kompetencave ligjore, që është i domosdoshëm. Kjo është e domosdoshme. Bartja e kompetencave nuk mund të bëhet në mënyrë paushalle, e kemi një drejtor ose s'e kemi një drejtor. Po e prekim Ligjin për Policinë, ose s'po e prekim Ligjin për Policinë.

Nuk ka ligj në Republikën e Kosovës dhe në asnjë vend tjetër që nuk ka ndërlidhje me ligjet tjera, prandaj të gjitha këto duhet të harmonizohen, por jo të kihet frikë, "po e prekim një ligj, a guxojmë t a s'guxojmë ta prekim...". Një kërkesë kushtetuese është krijimi i një ligji për kryeqytetin dhe nëse kemi një kërkesë kushtetuese, të gjitha ligjet duhet të harmonizohen dhe detyrë e ligjit është që të caktohen dhe të saktësohen kompetencat që subjektet apo personat e ndryshëm juridikë i kanë në kuadër të ligjit. Kjo nuk bëhet. Kjo bëhet edhe më e rëndë kur e shohim se si përpiluesit, hartuesit e këtij ligji shkruajnë, për shembull, "sipas ligjeve përkatëse". Një ligj e ka për detyrë të caktojë sipas cilave ligjeve bartet, ose kufizohet një kompetencë dhe ligji duhet të thuhet saktësisht, cili është ligji, cili është numri i ligjit dhe cilat kompetenca barten ose kufizohen në bazë të një ligji, por jo në bazë të ligjeve përkatëse, ku e di unë, për vetëqeverisje lokale apo ku ta di çka.

Ne i kemi këtu edhe pjesë që janë kundër logjikës së shëndoshë. Kemi norma, për shembull, te krijimi i ndërmarrjeve publike dhe e shohim përnjëherë "kërkohen 2/3-at e anëtarëve të Kuvendit". Asnjë arsytim nuk ka pse po u kërkuan 2/3-at e anëtarëve të një Kuvendi për krijimin e një kompanie publike. Nëse një legjislativ e ka për detyrë ta bëjë punën e ekzekutivit, ta kontrollojë punën e ekzekutivit, këtu në të vërtetë i jepet një detyrë ekzekutive, ose një detyrë primare që të lejojë ose të mos lejojë krijimin e një kompanie publike apo diçka tjetër, që vërtet nuk mund të kuptohet shumë lehtë.

Ne kemi këtu edhe çështje të tjera. Shumë veta e hapën çështjen e një kopjimi të shumë ligjeve në mënyrë të paharmonizuar. Vetëm çështje të caktuara janë kopjuar nga ligje të caktuara dhe

janë bërë bashkë në një tekst, që mandej del i pakuptueshëm. Kjo mund të bëhet, nëse merret për bazë së paku një ligj i një kryeqyteti.

Ne duhet të gëzohemi se po e bëjmë një ligj për një kryeqytet dhe po bëjmë kryeqytet të bazuar në Kushtetutë dhe në ligj, mirëpo kjo duhet ta ketë një normë të caktuar, e jo të marrim pjesë të caktuara, nga ligje të caktuara e të mos i harmonizojmë ato, as me ato ligj, e të mos i harmonizojmë as me legjislacionin tonë.

Unë pajtohem në fund se granti shuma prej 4% për një kryeqytet nga grantet që ndahen është jashtëzakonisht i vogël. Ne në Prishtinë e shohim se brenda ditës gravitojnë diku 30-35 mijë njerëz, që punojnë në institucione qeveritare, graviton një numër jashtëzakonisht i madh i studentëve dhe gjithë personat tjerë, që janë gati si banorë të përhershëm, dhe të gjithë personat tjerë që gravitojnë në Prishtinë, shpenzojnë në Prishtinë, kërkojnë shërbime në Prishtinë gjatë tërë ditës dhe mandej disa largohen, disa edhe mbeten këtu. Edhe nëse konsiderojmë se brenda ditës në qytetin e Prishtinës, në kryeqytet, gravitojnë diku rreth 1/3-a e banorëve, Prishtina po ashtu ka në duar, ose në qarkullim 1/3-ën e të gjitha mjeteve financiare të Republikës së Kosovës.

Unë mendoj dhe e kam bindjen se një grant prej 4%, ashtu siç është caktuar dhe siç e thanë kolegët që nuk e arrin shumë as prej 8 milionëve, është jashtëzakonisht i kufizuar dhe unë mendoj se është krejtësisht e pamundur që të gjitha këto shërbime që kërkojnë në nivelin e një kryeqyteti të kryhen vetëm me këto mjete.

Unë e kam bërë edhe një analizë gjuhësore dhe logjike të ligjit dhe këto do t'i dërgoj në mënyrë të shkruar me rastin e hartimit të projektligjit për leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga diskutimet e deritanishme për Projektligjin për kryeqytetin mua më erdhi mirë që të gjithë, pothuajse ata që diskutuan, por po besoj se edhe ata që nuk e morën fjalën, janë të pajtimit se është një projektligj i vonuar për Prishtinën dhe është një projektligj që i duhet kryeqytetit tonë, Prishtinës.

Tek e fundit, e kemi obligim kushtetues, sepse neni 13 i Kushtetutës së Kosovës na obligon që kryeqyteti ynë Prishtina të ketë status të veçantë me ligj të veçantë. Arsyeja që e mora fjalën është se u tha në diskutime të shumta nga dy deputetët, nga deputeti Zharku dhe nga deputeti Hasani, se ky ligj, kur është fjala te neni 7, që ka të bëjë me themelimin e spitalit të përgjithshëm të kryeqytetit, bie ndesh me ligjet tjera, përkatësisht me Ligjin për shëndetësi.

Unë po ju them se ligji bazik për shëndetësi, jo vetëm për kryeqytetin, e parasheh që edhe qytetet tjera mund të themelojnë spitale të përgjithshme, konkretisht neni 20 i Ligjit për shëndetësi thotë: “Kujdesi dytësor shëndetësor mund të organizohet edhe në nivelin komunal me kërkesën e Kuvendit Komunal përkatës dhe në pajtim me vendimin e ministrit të Shëndetësisë”, që do të thotë se nuk ka të bëjë që ky ligj, Ligji për kryeqytetin, që ka të bëjë me nenin 7 për themelimin e spitalit të përgjithshëm, një spital që është më se i nevojshëm, sidomos për kryeqytetin, nuk bie ndesh me ligjin bazik të shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, s’ka diskutues të tjerë. Qeveria nuk ka ndonjë vërejtje, nuk dëshiron të debatojë.

Po hyjmë në fazën e votimit. Në sallë janë 79 deputetë. Ju lus që të përgatitemi për votim! Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 76 deputetë. 67 janë për, 1 kundër, 8 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Amendamentet i bëjmë, Nait, qysh të doni. Faleminderit!

Atëherë, shkojmë në pauzë drekte deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhaivt Haliti

KRYESUESI: Debatin mund ta zhvillojmë, të gjitha partitë paskan përfaqësues këtu.

Atëherë po fillojmë, sepse kanë kaluar 20 minuta, kështu që mjafton për të filluar, po debatojmë, pastaj në votim shohim e bëjmë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hamza, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave ka ndërmarrë një reformë të rëndësishme që ka qëllim fillimin e implementimit të tatimit në tokë dhe krijimin e sistemit modern dhe efikas për administrimin e tatimit në pronë.

Ky lloj tatimi paraqet burim të rëndësishëm të financave lokale, kjo është dëshmuar edhe viteve të fundit në vendin tonë, prandaj, përpjekjet tona janë që të avancojë tutje përmirësimin dhe përsosjen e administrimit për t'u shërbyer forcimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të komunave të Kosovës.

Kjo nismë pa dyshim kërkon përmirësimin dhe përshtatjen e bazës ligjore, e cila rregullon procesin e tatimit në pronë, për të mundësuar realizimin e objektivave të sipërshënuara.

Ky projektligj që po e shqyrtojmë sot do të vendosë këto themele dhe do t'i hapë rrugë materializimit të kësaj reforme, e cila ka një rëndësi jetike për shëndetin fiskal të komunave të Kosovës.

Pa u lëshuar më tej në detaje shumë të vogla, më lejoni t'ju paraqes një përmbledhje të shkurtër të elementeve kryesore, të cilat i përmban projektligji, ku do të veçoja:

Përshtatjen e infrastrukturës ligjore me qëllim implementimin e tatimit në tokë dhe krijimin e stimujve për shfrytëzimin produktiv të tokës.

Zbritjen e shkallëzuar nga baza e tatimit për tokën në vitet e para të implementimit të ligjit. Kjo zbritje e përgjithshme në vlerën e vlerësuar të tokave do të ndodhë gjatë viteve të para të implementimit të tatimit në tokë, më pas, me kalimin e viteve, kjo zbritje e përgjithshme do të njohë rritje graduale. Kjo e bën më të lehtë fillimin e aplikimit të tatimit për tokën.

Qartësimi i përgjegjësisë për pagesën e tatimit në pronë përcakton se cili subjekt e bart përgjegjësinë e obligimit të pagimit të tatimit në pronë në raste të ndryshme, kompetencat e qartësuara të komunave dhe Ministrisë së Financave.

Përmirësimi cilësor i procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme, rregullat e reja për regjistrimin e pronave të paluajtshme, të cilat do të na mundësojnë zgjerimin dhe përmirësimin e regjistrave të tatimit në pronë, bazës së të dhënave, me prona të reja të regjistruar si dhe regjistrimet më të plota e të përditësuara.

Për caktimin e rregullave mbi faturimin e pagesës së detyrimeve tatimore, shpërndarjen e pagesave dhe shtyrjen e pagesës së detyrimeve tatimore.

Mekanizmat e rinj për blerjen e detyrimeve tatimore të papaguara, duke përfshirë edhe procedura të reja për rritjen e efektshmërisë në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, ndër to përfshirjen e shërbimit përmbartimor.

Procedurën e ankimimit të qartë dhe afatet e ankimimit më të gjata.

Informacionin lehtësisht të ngjashëm, ku Ministria e Financave për hir të transparencës do të jetë e obliguar në të ardhmen të publikojë një faqe elektronike në dispozicion të publikut, informatat lidhur me tatimin në pronë.

Mbrojtjen e shtresave në nevojë. Në këtë pjesë parashihet një rritje e shumës së zbritjes për vendbanimin primar dhe rregullat e reja për shtyrjen e pagesës së tatimit në pronë dhe mënyrat dhe procedurat e reja të njoftimit.

Projektligji është konsultuar gjerësisht me komunitat, si përfituese kryesore, publikun dhe grupe të tjera të interesit. Ai përbën, për mendimin tonë, një bazë rregullative të parashikueshme dhe të qartë, e cila është mjaftueshëm e detajuar për t'u dhënë qartësinë e nevojshme elementeve kyçe dhe risive të reformës.

Për këto arsye, kërkojmë të aprovohet në parim ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Hamza!

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit. Zoti Lumir, e ke fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme rregullon çështjen e vendosjes së tatimit mbi pronën e paluajtshme dhe përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin e tij nga komunitat dhe Ministria e Financave.

Vëmendje e veçantë në këtë projektligj i është kushtuar çështjes së tatimit në pronë, ku kërkohet, mes të tjerash, fillimi i aplikimit të tatimit në toka, përmirësimi cilësor i procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme, përcaktimi i mekanizmave të rinj shtrëngues për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave dhe interesave të tatimpaguesve dhe shtresave në nevojë.

Si synim i veçantë është forcimi dhe konsolidimi i komunave të Kosovës, me një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, qeverisjen e mirë dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2017 ka shqyrtuar në parim Projektligjin për tatim në pronë dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet formale-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë në lexim të parë këtë projektligj.

Gjithashtu në komision janë ngritur disa çështje në disa nene të projektligjit, të cilat kanë nevojë për ndryshim dhe plotësim, e të cilat do të trajtohen gjatë amendamentit të projektligjit.

Njëkohësisht vërejtjet dhe rekomandimet që mund të bëhen gjatë leximit të parë do të konsiderohen me kujdes.

Meqenëse jam këtu, i nderuar kryesues, më lejo të shpreh edhe mbështetjen për arsye të lartcekura të Grupit Parlamentar të LDK-së për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju kisha lutur ta dëgjojmë njëri-tjetrin, të mos injorohen diskutimet. Faleminderit, zoti Lumir!

Ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, është paraqitur Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përveç në Komisionin për Buxhet dhe Financa që e kemi shqyrtuar projektligjin, po ashtu edhe si subjekt politik e kemi shqyrtuar këtë projektligj.

Qëndrimi ynë në leximin e parë do të jetë abstenim, ashtu siç ka qenë edhe në mbledhjen e komisionit për disa prej vërejtjeve dhe sugjerimeve që i kemi paraqitur atë ditë, e disa prej atyre do t'i paraqes edhe sot këtu.

Vërejtja më e madhe dhe thelbësore për ne është që pjesa më e rëndësishme e këtij draftligji është pjesa e vlerësimit të pronës dhe aty mungon përbërja e komunave.

Pra, përfaqësues nga komunat në këtë komision mungojnë dhe për neve është e padrejtë, për shkak se çdo vendim që e merr ky këshill ose ky komision si vlerësues i pronës, ka implikime më të mëdha drejtpërdrejt për komunat dhe pa përfaqësues të komunave, ne nuk mendojmë që është as e drejtë, as e duhur një çështje e tillë.

Kështu që nëpërmjet plotësimit të ligjit para leximit të dytë besoj që në bashkëpunim edhe me ministrin do të rekomandojmë se si duhet të jetë ajo, ose nëpërmjet Asociacionit të komunave, apo rotacionit të ndryshëm, kur diskutohet komunë për komunë.

Çështja e dytë që ne besojmë se duhet të rregullohet më ndryshe se sa është në ligj, është çështja e pronave bujqësore. Besojmë që tatimi për prona bujqësore të papunuara ose të pashfrytëzuara duhet të jetë shumë më i lartë. Një praktikë e tillë është përdorur nëpër shumë vende dhe ka pasur edhe efekt drejtpërdrejt edhe në shfrytëzimin e tokave bujqësore, por edhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet bujqësisë.

Kështu që besojmë që edhe këtë çështje duhet rregulluar dhe ndryshuar, nuk e di nëse do të hasim për këtë pikën e dytë në bashkëpunim edhe me Qeverinë, nëse jo, atëherë do të jetë si propozim i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”.

Çështja e tretë që është po ashtu me rëndësi për ne, besojmë që të çështja e banimit, përkatësisht banimi primar, si e kemi quajtur, mendojmë se duhet të jetë më i ulët tatimi në pronë dhe të rritet te ata të cilët kanë objekte banuese, po të cilat nuk i kanë në banim primar, përkatësisht i kanë me qira. Pra, ose nuk i lëshojnë fare me qira, po i mbajnë të papërdorura.

Kjo rregullon po ashtu çështjen e mbindërtimeve në raport me kërkesat që i ka, për shkak se rrit koston e atyre që donë të mbajnë prona të banimit, të cilat nuk janë as me qira dhe as të shfrytëzueshme.

Janë edhe disa çështje të tjera, të cilat ne i kemi diskutuar, është edhe çështja e definimeve të ndryshme në këtë ligj. Te çështja, për shembull, pronë rezidenciale, mendojmë që duhet ndarë, sepse edhe shteti ka pronë rezidenciale, pastaj janë futur edhe hotelet, edhe vilat, edhe të tjera në kuadër të kësaj dhe mendojmë që duhet ndërruar këtë çështje.

Diku tjetër besojmë që duhet zëvendësuar emërtimet e tyre dhe të ngjashme, të cilat ndonëse në fillim mund të duken të parëndësishme, besoj që përbëjnë dallim goxha të madh, për shkak të mënyrës se si tatimohen ato dhe po ashtu mendojmë që duhet shtirë disa nënkategori të rëndësishme sa i përket qirasë, pra ndërtesat e shfrytëzueshme nga pronari, edhe në këtë rast besojmë që tatimi duhet të jetë shumë më i lirë, kur ato ndërtesa përdoren nga pronari qoftë për biznes, ose të ngjashme.

Ndërtesa të dhëna me qira dhe ndërtesa të pashfrytëzuara, për ato që i thamë edhe më herët, për shkak të rregullimit të kërkesës dhe ofertës dhe të mos ketë mbindërtime në kuptimin e panevojshëm të tregut. Po, të njëjtën kohë, edhe të shfrytëzohet maksimalisht ai kapital, të cilën e kanë investuar qoftë sektori privat, apo publik, po në këtë rast sektori privat.

Për këto arsye dhe disa të tjera, të cilat unë sot nuk po marr kohë, për shkak se janë më shumë të natyrës përmirësuese të ligjit, ne kemi vendosur të abstenojmë në leximin e parë, ndërsa nëse bashkë me Qeverinë ose kalojnë amendamentet e tjera, të cilat do t'i propozojmë, në rundin e dytë edhe mund ta votojmë këtë projektligj, se është edhe i nevojshëm, po edhe ka pjesë të mira, të cilat i ka rregulluar ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Dardan! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: I nderuar kryesues,
Unë e thashë qëndrimin e LDK-së në proces të leximit të raportit, por po e kuptoj që nuk bën të ngatërrohen kështu dy proceset.

Për arsyet e thëna më herët, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet projektligjin në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, i cili ka të bëjë me rregullimin e procedurave dhe rregullave të tatimit në pronë dhe ka ardhur në përfundim se ky projektligj është i hartuar mirë. Dhe, si grup parlamentar do ta përkrahim.

Projektligji për pronën e paluajtshme është me rëndësi të veçantë, sepse përbën bazën për fillimin e implementimit të tatimit për tokën dhe pronën, duke qartësuar se cili nga subjektet e bart përgjegjësinë e obligimit të tatimit në pronë, përmirësimin e procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe rregullave të reja për regjistrimin e pronave të paluajtshme.

Në këtë projektligj krijohet mundësia e krijimit dhe përmirësimit të regjistrave të pronave të paluajtshme, rregullat e faturimit, e të tjera.

Projektligji i është bashkangjitur edhe deklarata financiare si dhe deklarata për harmonizimin me direktivat e Bashkimit Evropian, ku shohim se nuk bie në kontradiktë me këto direktiva. Prandaj, ne si grup parlamentar do ta përkrahim këtë projektligj, kurse kontributin tonë të mëtutjeshëm për përmirësimin eventual të këtij projektligji do ta japim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Grupi ynë parlamentar këtë ligj e sheh si orientim të Qeverisë drejt një reforme të plotë që synon vendosjen e tatimit në të gjitha llojet e pronës.

Nëpërmjet këtij ligji synon:

1. të hyrat e rritura nga tatimi në pronë,
2. sistem të përmirësuar të tatimit në pronë dhe
3. një ekonomi që funksionon më mirë.

Duke u bazuar në këto tri çështje, grupi ynë parlamentar do ta votojë në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i “Nismës”, fjalën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme Grupi Parlamentar “Nisma” e ka trajtuar dhe jemi në konstatim se ky ligj është në të njëjtin kuadër ligjor aktual që është në fuqi në Kosovë. Po ashtu është me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe përcakton rregulla dhe procedura të hollësishme për administrimin e tatimit në pronë me qëllim të procesit administrativ me të drejtë, transparent dhe efikas.

Kështu që kontributin e mëtutjeshëm do ta japim ndërmjet dy leximeve dhe do ta mbështesim në këtë fazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, zoti Damka e ka fjalën.

Faleminderit, i nderuar kryesues. Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim projektligjin dhe kontributin e vet do ta japë në komision gjatë leximit të dytë.

Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve, zoti Qëndron Kastrati e ka fjalën.

QËNDRON KASTRATI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ministra,

Deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Në vitin 2011 është aprovuar Ligji nr. 04/L-054 që është për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Mirëpo ky ligj, përveç kontributit në pensione, asnjëherë nuk është zbatuar plotësisht. Për shembull, nuk janë respektuar beneficionet e veçanta për ndarjen e bursave në shkollim, shërbime shëndetësore spitalore jashtë vendit, riaftësimin profesional, përparësitë në punësim, përkujdesje në banim, lirimi nga pagesa me trafikun publik urban dhe ndërurban, e të tjera.

Neni 20 i këtij ligji ka obliguar Qeverinë që të nxjerrë aktet nënligjore brenda gjashtë muajsh dhe kjo ende nuk është bërë as pas gjashtë vjetësh.

Përderisa në këtë pikë jemi duke trajtuar Projektligjin për tatime në pronën e paluajtshme, te neni 10 i këtij projektligji që flet për kategori që lirohen nga tatimi në pronën e paluajtshme, askund nuk figurojnë kategoritë e liruara sipas ligjit të veçantë, domethënë që flet për statusin e këtyre kategorive.

Sipas ligjit për kategoritë e luftës, të nenit 6, që përcakton beneficione të veçanta, sipas paragrafit 4 parashihet lirimin nga tatimi në pronë si të drejtë që realizojnë familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civilë të luftës dhe familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Kështu që unë propozoj në këtë projektligj në nenin 10, ku flet për kategoritë që lirohen nga tatimi në pronën e paluajtshme, të përfshihen edhe kategoritë e luftës, të rregulluara sipas Ligjit nr. 4/L-054.

Ligji nr. 4/L-054 është i veçantë, prandaj është mbi Ligjin për tatime në pronën e paluajtshme, mirëpo prapë mendoj që lirimi për këto kategori duhet të përfshihet edhe në këtë ligj që po e diskutojmë sot, sepse fatkeqësisht shumica e institucioneve nuk e respektojnë në praktikë këtë të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Po filloj nga disa vërejtje parimore, besoj se ministri në fund, nëse ka mundësi, na i sqaron pak më në detaje.

Po nisem prej nenit 6.4, tatimpaguesi që është person që ka në pronësi apo në disponim 30 nëntor! Nuk po di kah është marrë 30 nëntori, një datë apo në mënyrë hipotetike apo çka ka pasur, thjesht, një logjikë të asaj.

Neni 9 është më diskutabil te norma tatimore, posaçërisht po flasim për norma rezidenciale dhe norma biznesore.

Nëse e marrim prej 0,15 deri në 1%, po supozojmë 1% maksimumin, i bie që dikush në vit duhet të paguajë për një banesë që e ka 100 mijë euro, duhet të paguajë 1000 euro në vit. Nëse 1000 euro në vit, i bie mbi 90 euro në muaj. Tash ta di që ne kemi arsimtarë, mjekë, kemi shërbyes civilë, të cilët kanë rrogën 400 euro, mund t'i vijë puna dikujt që për shkak të tatimit ta shesë banesën dhe të dalë tjetërkund të banojë. Kështu që qëndrimi im personal është që kjo normë të zvogëlohet, të mos jetë 1%, por të jetë më e ulët, 0,5 maksimumi.

Të njëjtën gjë e kemi, të themi, edhe për aspektin e bizneseve. Nëse flasim për politika të djathta që të kemi norma të ulëta tatimore, kjo shkon në kundërshtim me logjikën e përkrahjes së bizneseve me tatime të ulëta.

Lirimi nga tatimi janë OJQ-të, të liruar për përfitues publikë. Në parim nuk di OJQ-të qysh kishin mundur të përfitonin po të kenë pronë, po që në realitet është problem të lirohet një OJQ prej tatimit, kështu që duhet pasur shumë kujdes, lirimi i OJQ-ve, pavarësisht si përfitues publik, nuk po flas për OJQ të tjera nga tatimi në pronë.

Neni 11.1, zbritja për vendbanim është marrë parësor, është marrë 15 mijë euro, është marrë si shumë fikse, nuk është marrë si përqindje. 15 mijë euro, nëse flasim për një pronë të ulët, ndoshta e rrok 50-60% të pronës, po në realitet, për vendet e tjera për një pronë tjetër mund të jetë 1%. Kështu që unë preferoj të jetë përqindje, zbritja me përqindje për banim parësor, por jo me shumë nominale apo jo me shumë fikse.

Te Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësimeve të Pronave të Paluajtshme, të gjitha janë në rregull, në fund janë dy anëtarë nga BQK-ja, Banka Qendrore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave.

Unë besoj se shumë më mirë në vend të këtyre dy anëtarëve do të ishte të ishte Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Asociacioni i Komunave, se sa që dy përfaqësues të Bankës Qendrore dhe Shoqatave të Bankave, për shkak se Ministria e Financave nga aspekti financiar ishte dashur t' i mbulojë edhe këto.

Prapë te Këshilli Mbikëqyrës, emërimin e bën ministri, por po më duket ai emërim është formal, nëse kemi propozime që vijnë nga ana e institucioneve të caktuara, kështu që do të duhej të ishte ose emërimi real, po të mos jetë një emërim formal që vetëm të aprovohen individë apo persona që i dërgojnë institucionet e caktuara.

Te neni 25, interesi mbi tatimin e papaguar, përmendet që është mesatarja e normës së BQK-së, po në realitet nuk dimë a po flasim për normën në depozita apo në kredi, veç përmendet mesatarja e normës së Bankës Qendrore, por cila jo, kështu që është dashur të përmendet.

Dhe, në fund, mendoj që është një çështje, pezullimi i shërbimeve komunale, që do të duhej të shqyrtohej. Në parim, unë e di, krejt e dimë që është mënyrë e thjeshtë për t' i mbledhur paratë, nëse dikujt tatimi ia ndal shërbimet komunale dhe ka obligim për t' i paguar, po që, në fakt, është cenim i të drejtave njerëzore.

Unë pajtohem nëse dikush do të regjistrojë veturën, duhet të paguajë tatimin në pronë, po nëse dikush duhet të marrë certifikatën e lindjes, për çfarëdo çështje dhe nuk e paguan tatimin në pronë, ajo është veç çështje tjetër. Kështu që duhet pasur kujdes që kjo çështja e pezullimit të shërbimeve komunale derisa nuk paguhet tatimi në pronë të rregullohet në mënyrë të saktë, në cilat raste ajo mund të zbatohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zharku! E fundit është paraqitur zonja Evgjeni Thaçi-Dragusha.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Ministra,

Deputetë,

Duke hartuar bazën ligjore për tatimin në pronë, me anë të këtij projektligji synohet të krijohet një sistem modern efikas dhe i përshtatshëm për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë.

Meqenëse Buxheti i Kosovës mbështetet shumë në të hyrat nga tatimi, atëherë edhe reformimi i sistemit të administrimit të tatimeve duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, ashtu që t'u përshtatet rrethanave shoqërore, e po ashtu të jetë një shtyllë e fortë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.

Një nga çështjet më të rëndësishme, u tha edhe nga kolegë të tjerë, që ky ligj prezanton, është fillimi i tatimit në tokë, i cili është një nga hapat më të rëndësishëm në stimulimin e pronarëve të tokave që t'i përdorin pronat e veta në mënyrë pragmatike dhe më fitimprurëse.

Posaçërisht është inkurajues fakti që tokat, të cilat do të punohen, do të tatóhen më pak se sa ato që lihen djerrë.

Kjo është shumë e rëndësishme, kur dihet se një pjesë shumë e madhe e tokës së territorit të Republikës së Kosovës i përket kategorisë 'tokë bujqësore' dhe ky ligj kontribuon në shfrytëzimin produktiv të saj.

Gjithashtu vlerësoj se ky projektligj është në përputhje me parimet e strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore, e cila kërkon krijimin e stimujve për shfrytëzimin produktiv të tokës, përmirësimin cilësor të procesit të vlerësimit të pronës së paluajtshme si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tatimpaguesve dhe personave në nevojë, apo vulnerabël, si është përdorur ky term në projektligj.

Po ashtu çështje me rëndësi që trajtohet këtu është vlerësimi për qëllime tatimi. Mendoj që ky projektligj i plotëson standardet për përmirësimin e procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme si një mekanizëm kyç për përcaktimin e tatimit në pronë.

Për herë të parë, duke bërë vlerësimin masiv të pronave të paluajtshme për qëllime tatimi, do të kemi harta të vlerës së pronave në gjithë territorin e Kosovës.

Mendoj se vlerësuesit e certifikuar kanë arsye për t'u gëzuar, sepse do të jenë ata të cilët do të angazhohen nga Ministria e Financave për të vlerësuar paluajtshmëritë.

Një e arritur tjetër në këtë fushë është edhe themelimi i Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme, gjë që rregullon edhe organizimin dhe funksionimin institucional të veprimtarisë së vlerësuesve.

Si përfundim, ky projektligj paraqet një nga reformat më të rëndësishme tatimore në Kosovës dhe një ndihmesë të madhe për komunat, të cilat do të jenë edhe përfitueset më të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë diskutues të paraqitur. Nëse do kryetari i Komisionit Funkcional për të diskutuar diçka, zoti Abdixhiku. A do diçka të thuash, si përfundim?

LUMIR ABDIXHIKU: I nderuar kryesues, jo.

Do t'i shqyrtoj më të gjitha komentet e dhëna në shqyrtimin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë? Jo.

Atëherë, në sallë kemi 64 deputetë dhe kërkohet të procedojmë me votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

A ka pa kartelë, Ganja, pa kartelë, tjetërkush? A je për a kundër, zonja Musliu? Për. Ok-ej!
Faleminderit!

Atëherë kanë votuar 60 deputetë, 60 me kartelë, një pa kartelë.

Për kanë votuar 48,

Një ka votuar kundër,

11 kanë abstenuar.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Tahiri, ministër i Drejtësisë, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Para jush sot paraqes plotësim-ndryshimet e Projektligjit për trashëgiminë.

Ndryshimet e propozuara adresojnë pengesa që janë hasur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues për trashëgimi.

Gjithashtu dua të cek që qëllim kryesor këto ndryshime kanë pasur fuqizimin e të drejtave të grave në pronësi.

Në një hulumtim të realizuar së fundi nga USAID-i dhe Ministria e Drejtësisë rezulton se 62% e qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk njohin ndonjë rast ku një grua apo vajzë ka trashëguar pronë. Dhe, në realitet, më pak se 5% të grave në Republikën e Kosovës kanë trashëguar pronë deri më tani, të tjerat heqin dorë nga e drejta e tyre për të trashëguar.

Plotësimi i legjislacionit është një ndër instrumentet kyçe për të ngritur numrin e grave dhe vajzave që trashëgojnë.

Prandaj, edhe kemi punuar në këtë plotësim-ndryshim për fuqizimin e të drejtës së gruas.

Gjithashtu gjatë procesit kemi analizuar gjendjen faktike dhe praktikat tona tradicionale për të siguruar zbatim të mirëfilltë të Ligjit për trashëgimi, duke synuar mënjanimin e fenomeneve, ku një numër i konsiderueshëm i çifteve në Kosovë nuk i formalizojnë martesat e tyre me certifikatë të kurorëzimit dhe, si rrjedhojë, kjo ndikon në të drejtat e tyre ligjore për të trashëguar nga njëri-tjetri.

Për t'u ofruar mbrojtje çifteve, sidomos grave, projektligji propozon uljen e viteve të njohjes së bashkësisë jashtëmartesore. Që nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, nga 10 vjet, në 5 vjet, kurse kur çiftet kanë fëmijë, njohja e bashkësisë jashtëmartesore ulet nga 5 vjet në 3 vjet.

Martestat pa kurorë e vendosin gruan në pozitë të ndjeshme në raport me kërkesat e saj me pronësinë juridike.

Mirëpo, me këtë ndryshim, ato nuk do të përjashtohen nga e drejta e tyre për trashëgimi.

Pra, nga 5 vjet sa është aktualisht me ligjin aktual, do të zbritet në 3 vjet.

Projektligji gjithashtu ofron masa mbrojtëse për trashëgimtarët fëmijë. Në qoftë se trashëgimtarët janë të mitur, heqja dorë nga këta pasardhës nuk do të mund të bëhet pa lejen e organit kujdestar.

Të nderuar deputetë,

Ju kërkoj që t'i përkrahni këto plotësim-ndryshime, sepse konsiderojmë që avancojnë të drejtën e gruas dhe kjo ndihmon realisht me barabarësinë mes grave dhe në këtë rast burrave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 1. 11. 2017, e shqyrtoi Projektligjin Nr. 06 L- 008 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe me shumicë votash e ka përkrahur këtë projektligj, ndonëse në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion ka pasur diskutime në lidhje me atë se a i adreson ky projektligj problemet me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë në çështjet e trashëgimisë.

Sigurisht që ka pasur mendime të ndryshme në komision, mirëpo megjithatë i njëjti në fund është aprovuar, andaj Komisioni për Legjislacion i rekomandon Kuvendit që ta aprovojë këtë projektligj.

Në anën tjetër, po e marr të drejtën edhe në emër të grupit parlamentar, meqë pas fjalës sime është edhe “Vetëvendosja”, kështu po e shfrytëzoj këtë rast. Ne si grup parlamentar e kemi analizuar këtë projektligj dhe gjatë këtyre ditëve kemi pasur shumë thirrje në media që Kuvendi ta përkrahë këtë projektligj. Unë kam lexuar disa herë të njëjtin projektligj për ta kuptuar se a janë adresuar ndryshimet me anë të këtij projektligji, domethënë a janë adresuar problemet me anë të këtij projektligji dhe unë besoj që Ministria e Drejtësisë ka dështuar t’i adresojë të gjitha problemet me të cilat gratë dhe vajzat ballafaqohen, sidomos për çështjet trashëgimore.

Pra, qëllimi i këtij është transferimi i çështjeve të trashëgimisë, domethënë jokontestimore në kompetencë të noterëve, kjo për t’i shkarkuar gjykatat për shkak të grumbullimit të lëndëve. Pra, i njëjti përmban dhjetë nene, të cilat për bindjen tonë nuk arrijnë t’i zgjidhin problemet e grave dhe vajzave. Së pari, ne besojmë që është tepër e rëndësishme dhe në ndërhyrje të ligjit aktual. E di që procedurat apo Rregullorja e Punës së Kuvendit këtë nuk e lejon, mirëpo ka pasur tashmë precedent edhe më parë kur Kuvendi ka ndërhyrë në ligjin aktual. Për shembull, neni 13 i ligjit nuk lejon që bashkëshortja të jetë trashëgimtare e burrit të vdekur. Për shembull, këtu e kemi rastin e zonjës Shyhrete Berisha, e cila ka pasur një proces të gjatë e të mundimshëm për të fituar të drejtën e saj dhe sigurisht nuk e ka fituar ashtu siç është dashur për shkak të pengesave nga familjarët e bashkëshortit, mirëpo e njëjta është ballafaquar me sulme, paragjykitime dhe shumë probleme për të fituar të drejtën e saj. Pra, në mungesë të dispozitave ligjore, pastaj edhe gjykata në diskrecionin e saj vendos vetë.

Mendoj që ky projektligj duhet të parashohë një dispozitë, e cila për qëllim që në rast të vdekjes së trashëgimtarit, bashkëshortja e tij të jetë pjesë e trashëgimisë. Po ashtu, përjashtohen nga trashëgimia gratë, të cilat domethënë nga bashkësia jashtëmartesore nuk kanë fëmijë. Mendoj që pavarësisht se a ka apo s’ka fëmijë, nuk guxon që gruaja të përjashtohet nga trashëgimia vetëm pse s’ka fëmijë, nga bashkësia jashtëmartesore prej pesë vjetëve.

Po ashtu, e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar, sepse ky projektligj ka mbetur nga mandati i kaluar, Ministria e Drejtësisë po ashtu ka dështuar ta heqë këtë dispozitë nga ligji aktual, e cila

thotë kështu: “Trashëgimtari mund të përjashtohet nga trashëgimia nëse është plangprishës ose i është dhënë jetës së pandershme”. A më tregoni, i nderuar ministër, çka nënkupton me “jetë të pandershme”, sepse nëse diçka për dikë është e ndershme, diçka për dikë tjetër mund të jetë e pandershme dhe anasjelltas. Kjo, pastaj po keqpërdoret në masë të madhe nga djemtë dhe bashkëshortët, ose nga prindi, andaj është tepër e rëndësishme që kjo të adresohet dhe të mos lihet kështu siç është.

Duke marrë parasysh problemet e vazhdueshme të vajzave dhe grave në çështjet trashëgimore, mendoj po ashtu që duhet ta bëjmë një diskutim edhe në komision që ta adresojmë ndalimin e heqjes dorë nga trashëgimia, ndoshta për disa vjet. Sepse, në një proces ku ndahet trashëgimia, në qoftë se fillimisht u ndahet në mënyrë të barabartë edhe djemve, edhe vajzave, atëherë ndoshta është më vështirë të heqim dorë nga trashëgimia kur fillimisht më është dhënë ajo. Pra, duhet ta analizojmë edhe ndalimin për të hequr dorë nga trashëgimia, sidomos për rastet sociale sot për shkak të mentalitetit patriarkal gratë që janë në gjendje të vështirë ekonomike detyrohen të heqin dorë nga trashëgimia pikërisht për shkak të paragjytimeve, mendësisë patriarkale dhe sidomos presioneve mbi të.

Po ashtu, në qoftë se ndodh që mbetet të ekzistojë heqja dorë nga trashëgimia, kjo duhet të fuqizohet pikërisht duke marrë parasysh presionin që bëhet mbi gratë dhe vajzat, duhet të jenë prezentë dy dëshmitarë dhe ata jofamiljarë, por po ashtu edhe kjo duhet të ketë apo të bëhet me audio dhe video incizim, pikërisht për të parë në qoftë se ka pasur presion mbi të njëjtët. Ne kemi marrë shumë rekomandime edhe nga shoqëria civile si komision për këtë projektligj dhe, edhe një herë unë u bëj thirrje edhe deputetëve të Kuvendit, por edhe grupeve të tjera të interesit që të adresojnë shqetësimet e tyre, sepse Komisioni për Legjislacion me intensitet do të punojë në adresimin e këtyre problemeve.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” në këtë fazë nuk mund të votojë për, i përmenda disa prej arsyeve pse, shumë të tjera ekzistojnë, por që do t’i adresojmë në grupe punuese, mirëpo në qoftë se adresohen të gjitha këto të cilat i potencova, atëherë sigurisht që do ta marrë përkrahjen edhe të “Vetëvendosjes”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,
Kryesues i nderuar,
Kabinet qeveritar,
Kolegë të nderuar,

Grupi ynë parlamentar ka adresuar dhe ka trajtuar ligjin në fjalë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë dhe mendojmë se në parim i plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Vërejtjet eventuale, të cilat u përmendën edhe nga kryetarja e komisionit, por edhe vërejtjet e tjera, të cilat i kemi pasur në kuadër të diskutimit brenda grupit parlamentar, besoj se janë të mundshme të adresohen nëpërmjet amendamenteve që mund t'i propozojmë. Këtu i kemi parë, do të thotë, dy qëllime primare, një është çështja e trashëgimisë, po flas si pako, do të thotë edhe ky ligj së bashku me dy ligjet e tjera, të cilat do t'i procedojmë sot më vonë, do të thotë që të zhvendoset nga gjykata te noterët dhe, çështja e dytë, dhe më e rëndësishme, pra është barazia gjinore në kuadër të procedurës së trashëgimisë. Besoj që projektligji aktual është një nismë e mirë në atë drejtim dhe pa dashur të themi se nuk mund të përmirësohet, sepse këtë mund ta bëjmë edhe nëpërmes amendamenteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 6/L-008 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe Kuvendit i rekomandon për miratimin e tij në parim, duke pasur parasysh se me këtë projektligj, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgimitë të Kosovës që ka vetëm dhjetë nene, është paraparë autorizimi i noterëve në kryerjen e disa funksioneve në trashëgimi: ulja e viteve për njohjen e trashëgimisë në mes të bashkëshortëve jashtëmartesorë, është fshirë dispozita për parashkrimin e të drejtës për të kërkuar pasuri trashëgimore, si dhe është përcaktuar përfshirja e organit të kujdestarisë në dhënien e lejes sa i përket heqjes dorë në emër të të miturve.

Andaj, ne si grup parlamentar rekomandojmë miratimin e projektligjit në parim dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të projektligjit gjatë shqyrtimit edhe në komisione si grup parlamentar. Ne edhe në Komisionin për Legjislacion kemi diskutuar gjatë për këtë ligj më 1.11.2017, kemi pasur debat, do të thotë, ka hapësirë për plotësim ende, ndoshta edhe nga sponsorizuesi, por edhe ne si deputetë, por në këtë fazë i rekomandoj kolegët që ta aprovojnë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqa! Grupi Parlamentar Lista serbe, zoti Igor Simiq.

IGOR SIMIĆ: Poštovani predsedavajući!

I parlamentarna grupe Srpske Liste možemo reći da će podržati u načelu ovaj zakon, smatramo da zakon zahteva da dobije podršku i da ču u neku delu doprineti ravnopravnosti polova. Za druge strane mi čemo svoj doprinos dati u radu komisija, pri tom konkretnu mislim i to i na sam

naziv zakona napravljena je greška i napisano da ovaj zakon o nasleđu, u mesto zakon o nasleđivanju, što srpskom jeziku predstavlja dve odvojene stvari. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Si anëtar i komisionit, por njëherësh edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahim në parim Projektligjin për plotësim- ndryshimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë, duke mos dashur t'i përsëris ato çka i thanë edhe kolegët më herët. Besoj se për vërejtjet dhe të arriturat e këtij projektligji të gjithë ata që janë skeptikë se nuk mund të ndodhë, meqenëse është në lexim të parë, mund të ofrojnë vërejtjet, sugjerimet, por në periudhën e amendamentimit në qoftë se ato janë në masën e dëshiruar dhe i plotësojnë ato vërejtjet që i kanë besoj se do të kalojnë në seancë plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues! Edhe “Nisma për Kosovën” pajtohet me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë. Për vetë faktin që ky ligj ka ardhur në Kuvend për ndryshim tregon se ka ndryshime të situatës aktuale në vend në raport mes gjinive dhe kështu që si “Nismë” edhe me prirje për avancim të vlerave demokratike në shoqëri, por edhe barazi mes gjinive, natyrisht se do të japim kontributin tonë deri në leximin e dytë edhe nëpërmjet anëtarëve në Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Shabani e ka fjalën.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem, predsedavajući!

I Parlamentarna Grupa „6+“ razmatrala je nacrt zakona i izmenu i dopuno zakona o nasleđivanju na Kosovu i Parlamentarna Grupa „6+“ podržace zakon, svoj dopuno daćemo kroz rad komisije. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me diskutimet sipas radhës së paraqitur nga deputetët. Zonja Drita Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Përshëndetje, të nderuar deputetë dhe qytetarë që jeni duke na ndjekur! E drejta e trashëgimisë në Kosovë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Legjislacioni i paqartë, i cili rregullon të drejtat mbi pronën e paluajtshme, shkalla e gjerë e informalitetit në sektorin e pronave dhe zbatimimi jokonsekuent i të drejtave pronësore e ka dobësuar sigurimin e të drejtave pronësore në Kosovë.

Pasiguria e të drejtave pronësore ndikon në të drejtat e njeriut, e dobëson gjendjen e komuniteteve të marginalizuara duke penguar rritjen ekonomike. Kemi një varg faktorësh, të cilët ndikojnë në këtë zvogëlim, heqja dorë është një ndër kushtet e para të cilat mendojmë që ndikon negativisht. Domethënë, duhet të eliminohet, duhet të ekzistojë e drejta për të vendosur. Kur e dimë që 14% e grave, vetëm 14% pra kanë njohuri sa u përket të drejtave pronësore. Duhet të procedohet një seancë e veçantë me palët, të cilat shprehin interesim për të hequr dorë. Noteri duhet të jetë i obligueshëm t'i sqarojë të drejtat në trashëgimi. Palëve duhet t'u tregohet se sa është trashëgimia, çfarë vlere ka ajo pasuri, aspekti i heqjes dorë, masa e informimit publik, domethënë në të kundërtën konsiderohet si vepër penale.

Me lëndët që janë në kontestimore merret gjyqësia, ndërsa ato jokontestimore duhet të merret noteri. Domethënë, noteri duhet të verifikojë situatën sa i përket pronave apo grave, të cilat kanë të bëjnë me trashëgiminë. Harmonizimi mes ligjeve të mos ketë dualizëm, pra deri më tani ka qenë kështu dhe duhet të merret noteri me të gjitha këto. Heqja dorë, duhet pasur kujdes tash, për heqjen dorë deri tani nuk ka pasur asnjë masë ndëshkimore, domethënë nuk kanë pasur zbatueshmëri apo penalizim, pse nuk është respektuar ligji. Që të rregullohet e gjithë kjo, duhet të harmonizohen ligjet dhe ato të gjejnë zbatueshmëri.

Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë dhe plani i veprimit. Analiza e heqjes nga trashëgimia, problemi i çështjes gjinore, pronësore dhe mundësitë ekonomike në Kosovë, analizat për praktikat për Noterinë. Ne i jemi mirënjohës punës së palodhshme të Komisionit për Legjislacion për disa të arritura, të cilat të paktën janë munduar t'i realizojnë sa i përket këtij projektligji, por duke mos lënë asnjëherë anash USAID-in, i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme në këtë drejtim, duke bërë një hulumtim të mirëfilltë dhe duke bërë fushatë vetëdijesuese në këtë drejtim, e cila si rezultat i punës së tyre mendojmë që në të ardhmen të gjitha këto ndryshime të sjellin një progresivitet për të ardhmen dhe për çështjen e grave dhe trashëgiminë e pronës së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kajtazi. S'është këtu. Atëherë, zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj nuk ndryshon as esencialisht prej vitit 2004, më shumë përmendet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë se si fjala "gjykatë" do të zëvendësohet me "noter" apo "kompetente", por jo diçka më thelbësore.

Ligji për trashëgiminë në Kosovë duhet të ketë ndër prioritetet edhe trashëgiminë e cenuar të grave. Ligjet bëhen sidomos për të mbrojtur ato që dëmtohen më së shumti në Kosovë, qoftë për

shkak të traditës, mentalitetit patriarkal, sundimit mashkullor, inferioritetit historik të grave të shkaktuara nga diskriminimi nga burrat për kohë të gjatë.

Tipit të martesës patriarkale që nënkupton të jetuarit e bashkëshortëve, grave pranë apo në shtëpinë e bashkëshortit mashkull. Ligji për trashëgiminë duhet të ketë në fokus barazinë dhe trashëgiminë, e veçmas mbrojtjen e padiskutueshme të trashëgimisë së grave. Por, ndër nenet më problematike dhe shpesh të keqkuptuara e të keqinterpretuara është edhe neni 26.1, ku flitet për të drejtat e bashkëshortit. Në Ligjin nr. 2004/26 ky nen nuk është paraqitur për ndryshimin dhe plotësimin në vitin 2017, që në emërtim të këtij nënkapitulli diskriminohen bashkëshortët gra, pasi që thuhet të drejtat e bashkëshortit në gjininë mashkullore, e jo edhe të drejtat e bashkëshortes apo të drejtat e bashkëshortësisë, apo të drejtat në bashkëshortësi.

Versioni i fundit është më i duhuri, sepse nuk paragjykon gjininë e trashëgimisë apo trashëgimdhënësit, prandaj nëse kërkojmë ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji duhet të ndryshohet menjëherë neni 26.1, ngase duhet të vijë fundi i diskriminimit ligjor, gjuhësor e kulturor ndaj grave. Po ashtu, neni 26, paragrafi 1 thotë: “Bashkëshorti i trashëgimdhënës ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon me pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët në martesë”.

Ligji për trashëgiminë i Kuvendit të Kosovës 2004, faqe 12, ky nen është formuluar kryesisht për të favorizuar burrat në trashëgimi, ngase pikërisht në sistemin e të jetuarit në vendin tonë burrat janë më të punësuar dhe të gjitha të dhënat e Agjencisë të Statistikave të Kosovës papunësia e grave është gati dyfish më e madhe dhe më e lartë se sa e burrave.

Nëse gratë nuk janë të fuqizuara ekonomikisht, janë më të papunësuara se burrat, nuk trashëgojnë pronën e përbashkët familjare për arsyet nga më të ndryshme, qoftë edhe disa normave e zakoneve të ngulitura kulturore, e i bie se ligji nuk u ndihmon atyre në trashëgimi të përbashkët, sepse nisjen nuk e kanë të barabartë me bashkëshortët apo burrat e tyre. Gratë duhet të gëzojnë trashëgimi kur hyjnë në kurorëzim, kur bashkëjetojnë dhe nëse nuk punojnë fare, sepse ato duan punë, por nuk gjejnë dot, ato duan punë, por Kosova është vend i vështirësive të mëdha për punësimin e gruas, sidomos për gratë të cilat kërkojnë punë.

Si mund të kërkojnë pjesën që u takon grave në pasurinë e përbashkët të fituar me punë kur janë të papunësuara, prandaj ne si deputetë duke dashur që gjithmonë ta mbrojmë barazinë gjinore, të drejtat e barabarta të grave e të burrave, kërkojmë që të riformulohet edhe ky nen, e jo të mbetet i paprekshëm. E kemi rastin që këtë projektligj ta ndryshojmë dhe ta bëjmë ndryshe. Ja, për shembull, një riformulim i këtij neni: “Bashkëshortja i trashëgimdhënës ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me të drejtën e të jetuarit në bashkëshortësi, të verifikuar përmes bashkëjetesës, kurorëzimit apo martesës”. Ne duhet të mendojmë se ka edhe

forma të reja bashkëkohore të jetesës së përbashkët të çifteve dhe duhet të mendojmë edhe trashëgiminë pa kurorë apo edhe me të.

Mjafton dëshmia se dy persona jetojnë dhe veprojnë së bashku në një kulm të përbashkët. Besoj shumë që ky ligj do të bëjë ndryshimin e këtij neni. Faleminderit për vëmendjen!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slavko Simiq.)

KRYESUESI: Hvala koleginice! Za reč se javio poslanik gospodin Hajdar Beqa. Za reč se javio uvažena koleginica, Emilija Redžepi.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Nacrt zakona u izmeni dopuni zakona o nasledstvu na Kosovu, razvije stereotipe u društvu, da samo muškarac ima pravo na nasledstvo svoj roditelja. Ovaj zakon omogućuje ženama podjednak pristup tokom podeljen nasledstva, ali ovom slučaj je to zakonske regulisano, tako da se ne bi dešavali razni problemi i u porodici, stvareli konfuzije.

Ovaj zakon predviđa rodno ravnopravnost o napređenje prava žena, izmene koje su urađene da i žene koje su braku više od 5.godina imaju prava na nasledstvo bez obzira dali imaju decu ili ne, su jako dobre. Zatim brak bez venčanja, gde su žene bile zapostavljene a vanbračna deca nisu imali pravo na nasledstvo, to je takođe izvršenja dopuna, tako da se ovaj zakon treba podržati pre svega zato što je jako bitan za poštovanje rodne ravnopravnosti moderno demokratsko društva.

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

O ovom se zakona more stalno govoriti, medijski više prezentirati kako bi se patrijarhalni sistem razmišljenja društva počeo menjati, uvažavati pravo žena koje sada zakonski regulisano, a svedoci smo da u našu državu živi više od 50 posto ženske populacije koje po ovom pitanju i dalje diskriminisana. Ja ću podržati ovaj zakon i glasaću za. Hvala!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë pa dyshim se është një ligj i një rëndësie të veçantë dhe sigurisht se ka pasur nevojë të bëhen avancime të mëtejme të legjislacionit, ku nëpërmjet kësaj të forcohet edhe roli i gruas në trashëgimi.

Barazia gjinore do të arrihet një ditë vetëm nëpërmjet fuqizimit ekonomik të grave dhe ky fuqizim ekonomik duhet të jetë i pamundur, në qoftë se gratë në Kosovë jetojnë në rrethana ku nuk mund të posedojnë pronë. Pra, në qoftë se gratë nuk kanë pronë në emër të tyre, as nuk mund të marrin kredi për të hapur biznese, apo të jenë të fuqishme ekonomikisht. Ndryshimet ligjore sa i përket fuqizimit të të drejtave pronësore të grave janë mirëpritur nga të gjithë ne, prandaj duhet të punojmë bashkarish, deputetë e deputete, që t'i bëjmë këto ndryshime ligjore në emër të fuqizimit të gruas.

Nëpërmjet këtij projektligji kemi vërejtur që synohen të eliminohen pengesat, të cilat janë hasur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues dhe harmonizimin e dispozitave ligjore me Ligjin për procedurën jokontestimore dhe noterisë. Edhe pse janë adresuar disa ndryshime, megjithatë ne konsiderojmë se ka nevojë për disa plotësime. Me Ligjin për trashëgiminë rregullohet e drejta e trashëgimisë. Trashëgimia është kalimi me ligj ose në bazë të testamentit të pasurisë së personit të vdekur të një ose më shumë persona, në këtë rast, të trashëgimtarët. Të drejta të barabarta të grave në përgjithësi dhe në trashëgimi janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për trashëgiminë, Ligjin për procedurën jokontestimore dhe Ligjin për procedurën kontestimore.

Pavarësisht dispozitave ligjore, për shkak të traditës popullore, ndarja e pasurisë kryesisht bazohet në të drejtën zakonore, në këtë rast, një numër shumë i vogël i grave e realizojnë të drejtën e tyre të shfrytëzojnë pronën dhe trashëgiminë. Hapësirat që krijon ligji, duke mundësuar marrëveshjen e palëve dhe mundësinë e heqjes dorë nga trashëgimia, bëjnë që palët të merren vesh mes vete, e që në praktikë i bie që gratë dhe vajzat të heqin komplet dorë nga trashëgimia dhe pronë. Me ligjin aktual pranimi ose mospranimi i trashëgimisë varet nga vullneti i palëve, pra varet vetëm nga trashëgimtarët ligjorë nëse ata e pranojnë ose jo trashëgiminë që u takon. Në shumicën e rasteve, pra, siç e thamë, janë gratë ato që heqin dorë nga trashëgimia dhe ekzistimi i mundësisë së heqjes dorë shfrytëzohet maksimalisht në disfavor të grave pikërisht për shkak të epërsisë së ekzistimit të së drejtës zakonore.

Në këtë rast duhet të shqyrtohet mundësia që të krijohet një mbrojtje për gratë në raport me heqjen dorë nga trashëgimia. Po ashtu, duhet të shqyrtohet edhe mundësia e sanksionimit të heqjes dorë nga trashëgimia kur gratë apo familja e tyre është përfutuese e skemës sociale, pra t'u pamundësohet heqja dorë. Në shumë raste gratë heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë edhe në rastet kur e vendosin veten dhe familjen e tyre në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Prandaj, propozojmë që te Ligji për trashëgiminë, në nenin 8, pas paragrafit 2, të shtohet dhe një paragraf i ri me këtë përmbajtje: 1. "Nuk lejohet heqja dorë nga trashëgimia për trashëgimtarët që janë në asistencë sociale" dhe 2. "Noteri është i obliguar të konstatojë nëse trashëgimtarët janë nën asistencën sociale".

Një tjetër çështje shumë aktuale në Kosovë, e përmendi kolegja në këtë rast, ka shumë raste të tjera të ngjashme si ai i Shyhrete Berishës, është çështja e bashkëshortit pasjetues. Kjo vjen në shprehje sidomos në rastet kur njëri bashkëshort vdes dhe nuk ka pasardhës. Prona e përbashkët nuk është në emër të bashkëshortit, por është në emër të të afërmeve të tij. Ligji nuk parasheh që atë pasuri mund ta marrë gruaja për shkak se Ligji për trashëgiminë e parasheh një kufizim të tillë. Propozojmë që të rregullohet gjatë leximit të dytë që të drejtën në trashëgimi do ta ketë bashkëshorti pasjetues, edhe nëse gjatë jetës me bashkëshortin tashmë të ndjerë nuk kanë pasardhës.

Të nderuar kolegë deputetë, ne bashkarish mund të angazhohemi që në mes të dy leximeve të japim kontributin tonë për plotësimin e mëtutjeshëm të legjislacionit për trashëgiminë, Noterinë dhe procedurën jokontestimore. Shpresojmë shumë se Komisioni për Legjislacion do t'i marrë për bazë shqetësimet apo propozimet tona, po ashtu të organizojë dhe dëgjim publik, t'i ftojë përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, noterisë, OJQ-të dhe ekspertë të fushës. Mendoj se këto projektligje duhet të shqyrtohen me kujdes, të përpunohen mirë, në mënyrë që të mos kemi probleme të mëvonshme gjatë zbatimit. Vërejtjet apo rekomandimet tona do t'i përcjellim gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Mendoj që shumica e parafolësve dhanë komente shumë të rëndësishme për sa i përket një projektligji, i cili besoj i plotëson ato mangësi që i ka ligji ekzistues. Unë po e marr fjalën për të njëjtën gjë që e kam thënë edhe kur është miratuar para shumë muajsh në qeverisjen e kaluar ky ligj, për diçka jo shumë substanciale, ka të bëjë me titullin e ligjit.

Mendoj që nuk ka nevojë të thuhet “për trashëgiminë në Kosovë”, sepse ky Kuvend krejt ligjet i miraton për Kosovë, nuk i miraton për shtete të tjera dhe me këtë logjikë ne edhe në ligjet e tjera do të duhet të thoshim për ndërmjetësimin në Kosovës, shoqëritë tregtare në Kosovë, për standardizim në Kosovë, në pikat që i kemi më vonë. Kështu që nuk e shoh të nevojshme të specifikohet që ky ligj është për trashëgiminë në Kosovë, se ligjet e Kuvendit të Kosovës janë pikërisht për vendin tonë dhe, po e përsëris, e kam pas thënë edhe kur është miratuar drafti në Qeveri, sepse ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe shpresoj që komisioni ta marrë parasysh këtë koment dhe ta heqë prej titullit të projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e keni fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, ka ekzistuar një ligj, i cili i ka rregulluar të drejtat e grave në trashëgimi, por ky ligj ka qenë i paimplementueshëm dhe problemi ka qenë se gratë nuk kanë qenë të informuara se kanë të drejtë në trashëgimi.

Në këtë periudhë kohore është mbajtur një fushatë vetëdijesuese nga shumë organizata dhe OJQ të tjera të pavarura, të cilat dhe kanë bërë dhe anketime, duke i anketuar gratë, sidomos në vendet rurale, dhe nga ato anketime kanë dalë se shumica e grave nuk kanë qenë të informuara se kanë të drejtë në trashëgimi. Unë po mendoj që edhe ky plotësim-ndryshim dhe ligji në fund që do të miratohet, të jetë nen për nen i zbatueshëm dhe njëkohësisht të fillojë një fushatë vetëdijesuese për gratë të cilat duhet të informohen saktë për të drejtat e tyre që i kanë në trashëgimi.

Kjo është një e drejtë kushtetuese e grave dhe ato me ngulm duhet të kërkojnë që të trashëgojnë atë çka u takon dhe ne si legjislativ duhet t'ua mundësojmë me procedura shumë të zbatueshme, të bëjmë një ligj të zbatueshëm dhe të implementueshëm, në mënyrë se sa më lehtë ato të realizojnë të drejtën në trashëgimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Ministri tha që 62% e grave në Kosovë nuk trashëgojnë dhe normalisht që për këtë përgjegjëse janë institucionet e vendit. E drejta e trashëgimisë është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës. Gratë dhe vajzat janë qenie që në këtë Republikë duhet të jenë të barabarta me ne. Ligji për trashëgimi nuk përmirësohet nga ndërrimi, pra i një koncepti, nga gjykata në noter.

Atë e rregullon avancimi arsimor e kulturor dhe sigurisht që Ministria e Arsimit, institucionet tona shkollore duhet ta shtyjnë përpara këtë çështje me një program të posaçëm, pastaj asambletë komunale gjithandej duhet të hartojnë strategji për barazi dhe të trashëgimisë së posaçme në këtë aspekt dhe se sigurisht që edhe komunat duhet të participojnë dhe të ndihmojnë në këtë aspekt. Gruaja patjetër që duhet të trashëgojë edhe kur ka, edhe kur nuk ka fëmijë. Vajzat dhe motrat tona duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë me djalin dhe burrin. Kosova patjetër që do të avancojë edhe në aspektin kulturor e arsimor, mirëpo e drejta e trashëgimisë për gratë, pra patjetër duhet të sanksionohet, meqenëse sot megjithatë po kemi heqje dorë nga trashëgimia, e cila u takon, sepse në njëfarë forme ato paragjykojnë në mënyra të ndryshme dhe për ta hequr këtë, sigurisht që e vetmja formë është sanksioni mbi ligjin, në fakt sanksioni, i cili vendoset tek ligji. Ato nuk duhet të heqin dorë, meqenëse po heqin dorë, atëherë normalisht që heqja dorë vjen si perceptim edhe kulturor, mirëpo vjen edhe si perceptim i gjithmbarshëm social në shoqërinë tonë.

Hygoja në një moment pati thënë “ama nënën e shkolluar, unë ty ta falë kombin” dhe në këtë aspekt ne e dimë që përgjegjëse për të gjitha avancimet tona arsimore e kulturore është nëna, sepse ajo gjithmonë është më afër fëmijëve dhe sigurisht që për këtë duhet edhe ministri të mendojë për një sanksion brenda ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Konsideroj se Ligji për trashëgiminë duhej të vinte në Kuvend si një ligj, jo një ligj i amendamentuar. Arsyeja është se ky ligj, ligjin që po e plotësojmë, është i miratuar në vitin 2004. Flasim për 13 vjet, në të cilat Kosova ka më së paku progres në rajon. Në një vlerësim të përgjithshëm, të drejtën e trashëgimisë në Kosovë e realizojnë, ose prona të regjistruara në Kosovë në raport me rajonin janë vetëm 16% të grave, përderisa në Maqedoni janë 17%, në Bosnjë-Hercegovinë 25%, e Shqipëria është më mirë, me 29%.

Ligji dhe e drejta e grave në trashëgimi nuk lidhet drejtpërdrejt vetëm me çështjen se si konsiderohen ato në aspektin social kulturor në të drejtën e pronës. Sot rastisi që të fillojmë, ose të shënojmë në Kuvend, edhe ditën e sensibilizimit të ndalimit të dhunës ndaj gruas. Një dhunë e drejtpërdrejtë ndodh në familjet shqiptare kur mbi gratë sforcohet që të mos kërkojnë, ose të heqin dorë mbi drejtën e trashëgimisë. E njëjta vërehet edhe në tregun e punës. Ne kemi pasur një rënie të konsiderueshme të grave punëkërkuese, që do të thotë se faktorizimi ekonomik dhe fuqizimi i gruas në Kosovë e ka një përkeqësim. Nga 25% të punëkërkueseve në vitin 2010, që kanë qenë të regjistruara nga baza e përgjithshme e punëkërkueseve gra, në vitin 2016 ky numër ka rënë në 12,5%. Se fuqizimi i gruas ose pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje në cilindo proces është në gjendje të keqe, tregon edhe vet përkatësia gjinore e Kabinetit qeveritar, nga 22 ministra vetëm 2 gra, e ministrit të Drejtësisë do t’ia bëja pyetjen se sa prej zëvendësve i ka gra? Prej 64 sa i ka Qeveria e Kosovës, sa janë zëvendësministre janë të emëruara dhe a ka zëvendësministre? Do të më gëzonte fakti nëse ka zëvendësministre të Drejtësisë, nëse konsiderojmë ta kemi një përmirësim të konsiderueshëm në këtë ligj, ose në çfarëdo reforme të mirëfilltë shoqërore në Kosovë.

Ajo që është për t’u brengosur është fakti se ligji në fakt ende parasheh dispozita, të cilat janë sa për të qenë. Në Kosovë më tepër ka bërë angazhim në të drejtën e trashëgimisë ambasadori amerikan, Ambasada Amerikane dhe USAID-i, sesa që janë marrë vendimmarrësit.

Ligji për Noterinë në vetvete numër 3/L-10, neni 29, e parasheh që në pikën 1.4 trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore kryhet edhe me Ligjin e Noterisë. Do të thotë, nuk është ndonjë arritje shumë e madhe që në amendamentim neve na sillet autorizimi i noterëve në kryerjen e funksioneve në trashëgimi. Prapë në çështje kontestimore, unë besoj se referencë do të jetë Gjykata.

Çka ka nevojë në këtë ligj, janë masat afirmative për të drejtën trashëgimore. Ajo çfarë e tha deputetja Kalludra, e mbështes tërësisht, përveç kësaj shtesë, përveç moslejimit të heqjes dorë nga trashëgimia për trashëgimtarët që janë në asistencë sociale, duhet gjithashtu të përcaktohet një nivel, një normë e të ardhurave të grave që janë të punësuara, që nëse janë në shkallë të ulët nuk do t'u lejohet heqja dorë nga trashëgimia, si dhe një afatizim i procesit të trashëgimisë. Në këtë kuadër, nëse ligji do ta kishte seriozisht rritjen e përqindjes së grave që e shfrytëzojnë të drejtën e drejtpërdrejtë, ose vazhate në trashëgimi, atëherë është edhe raporti i BIRN-it, një raport shumë i thuktë me konkluzione, në të cilat paraqitet edhe baza elektronike e të dhënave që do t'i përshpejtonte procedurat e realizimit të trashëgimisë dhe do ta zvogëlonte mundësinë e deklaramit të rrejshëm.

Shpesh çfarë neve na ndodh tek rastet e trashëgimisë ka edhe deklaramit të rrejshme në raport me heqjen dorë të grave, ose vazhate, nga e drejta e tyre trashëgimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta tani në fund shkurohen edhe fjalët, ngase shumë gjëra u thanë. Por, ajo çfarë duhet ta kemi parasysh është se është bërë një investim i madh në këtë fushë të reformave legislative. Edhe më herët në vitin 2015 janë plotësuar e ndryshuar ligjet në favor të kësaj çështjeje, ligjet e quajtura të “Pakos së të drejtave të njeriut”, Ligji për barazi gjinore, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi. Edhe vetë Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë ai që e keni parë ndër rekomandime të shumta, që ka kërkuar që si derivim i këtyre të drejtave, qoftë atij të së drejtës pronësore dhe procedurave të stërzgjatura në gjykata, të cilën e kemi vërejtur bashkë edhe ne Komisioni i të Drejtave të Njeriut gjatë mandatit të kaluar. Kur e kemi monitoruar Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje e kemi parë se një problematikë e tillë është ajo që e shton, apo në njëfarë forme edhe përsërit rastet e dhunës në familje. Prandaj, pronësia si themel i ekonomisë funksionale sigurisht se do t'i shërbente forcimit të individit dhe shoqërisë, në përgjithësi.

Është punuar dhe është investuar mjaft në një strategji nacionale për të drejtat pronësore, me ç'rast ndoshta secili nga ne që kemi qenë të kyçur aty i jemi falënderues investimit të USAID-it apo Programit për të Drejta Pronësore, ndërsa natyrisht se Ministria e Drejtësisë e ka pasur përgjegjësinë e shtuar në këtë drejtim.

Mendoj se strategjitë e tilla nuk duhet të mbeten vetëm në letër, duhet të shikojmë gjithsecili. Kemi qenë të kyçura komplet edhe ne Grupi i Grave Deputete, prandaj ky le të jetë një rast ku duhet t'u bëjmë thirrje që gjatë amendamentimit të shikohet mirë se si do të dalin ligjet, që të mos lejojmë hapësirë për të ikur ata që dëshirojnë t'i shkelin.

Është tejet i rëndësishëm aplikimi i masave afirmative. Unë dua në këtë rast edhe t'ua rikujtoj njerëzve se Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve, një bartje falas e pronës tek të dy bashkëshortët, është në fuqi deri në prill të këtij viti për kohën sa ka qenë prej marsit të vitit të kaluar, tani do të thotë bëhen 2 vjet, ai i ka dhënë efektet e veta, ndoshta minimale, por e kemi një lëvizje progresive.

Prandaj, unë bëj thirrje që gjithsecili ta shfrytëzojë këtë masë afirmative, në mënyrë që të përmirësohet e drejta pronësore në favor të grave dhe përgjithësisht avancimit të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqenëse nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për ta votuar, për shkak se Kryesia ka mbledhje me urgjencë, vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës për të debatuar rreth kësaj. Pastaj, kur të kthehen anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare do të vazhdojmë me votimin edhe të kësaj pike të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin Gashi që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Dua të ju informoj që zoti Haradinaj ka pasur ta paraqesë, por e ka rekomanduar zotin Gashi. Zoti Gashi, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës paraqesim para jush për miratim Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Projektligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim nr. 04/05, më 29. 9. 2017.

Nevoja për ndryshimin e këtij projektligji konsiston në krijimin e një legjislacioni të barabartë, jodiskriminues sa u përket përfitimeve të Presidentit dhe ish-zyrtarëve të lartë, duke pasur parasysh që Presidenti është kreu i shtetit dhe e përfaqëson unitetin e popullit të Kosovës. Me këtë projektligj Presidentit do t'i jepet mundësia t'i krijohen kushtet që edhe pas periudhës

pesëvjeçare dhe pas mbarimit të mandatit, ai të mund ta japë kontributin e tij, duke u mbështetur nga stafi mbështetës, ashtu siç është paraparë edhe për zyrtarët tjerë të lartë të paraparë me Ligjin nr. 03/L-001 për përfitim të ish-zyrtarëve të lartë.

Kam nderin që pata rastin të ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Komisionit Funkcional nuk qenka këtu, atëherë fjalën e ka zoti Beqa në emër të komisionit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24. 10. 2017 e ka shqyrtuar projektligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Projektligji ka vetëm tri nene dhe e adreson vetëm një ndryshim, është ai që ka të bëjë me nenin 20, paragrafi 1, ku flitet për të drejtën e Presidentit të Republikës së Kosovës, për presidentë të cilëve u ka përfunduar mandati, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 18 të Ligjit bazik. Pas përfundimit të mandatit të tij apo saj, ka të drejtë në hapësirë zyre, në pajisje për zyrë dhe në personel profesional të zyrës, që nuk mund të jetë më shumë se tre persona, e që e konsiderojmë si ndryshim të arsyeshëm dhe që pothuajse kjo e drejtë ekziston në shumicën e shteteve. Andaj ne si komision i rekomandojmë Kuvendit që ta aprovojë në parim.

Nëse më lejohet, do të flisja edhe në emër të grupit tash apo kur të më vijë radha, nënkryetar. A mund tash? Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për plotësim-ndryshim të Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës, andaj edhe ne si grup parlamentar rekomandojmë miratimin e projektligjit në parim dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të projektligjit gjatë shqyrtimit në komision dhe ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka analizuar dhe shqyrtuar propozimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Nga diskutimet dhe nga gjetjet, që në fillim po them se Lëvizja “Vetëvendosje” ka vendosur të votojë kundër këtij ndryshimi, për arsye se nga të gjitha dokumentet dhe nga memorandumet shpjeguese dhe nga të ashtuquajturit aktorë, që gjoja kanë marrë pjesë në diskutimin e këtij ligji, nuk shihet asnjë arsyetim ligjor, apo i ndonjë natyre tjetër që të votohet për këtë ndryshim, sepse natyra e funksionit të Presidentit të Republikës së Kosovës ndryshon nga natyra e zyrtarëve të tjerë të lartë publikë, në faktin se për zyrtarët e tjerë të lartë publikë kemi të bëjmë me funksionarë dhe zyrtarë që i përkasin sistemit të drejtësisë dhe nuk mund të zgjidhen e të rizgjidhen në poste të ndryshme dhe në funksione të ndryshme.

Ne mendojmë se çështja e dytë këtu në të vërtetë është personalizuar dhe nuk flitet askund, as për forcën retroaktive të këtij ndryshimi, që do të mund ta kishte për presidentët tjerë. Dhe, çështja e tretë është se Presidenti i Republikës së Kosovës është i zgjedhur i një partie politike dhe ai mund të konkurrojë edhe në pozita të tjera dhe të rizgjidhet edhe në pozita të tjera.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë kundër këtij ndryshimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaliaj, në emër të AAK-së. S’është paraqitur! Zoti Imet Rrahmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

IMET RRAHMANI: Po besoj që radha është si grup i dytë më i madhi ne ta kemi...

KRYESUESI: S’mund të ju mbaj përmendsh ju krejt kush çka...

IMET RRAHMANI: Së paku, të na i lëshoni sytë dhe na vëren që e kemi çuar dorën dhe e shtypim...

KRYESUESI: Të paktën, të jemi korrektë, e sillni listën me diskutuesit e radhitur dhe ma lehtësoni mua.

IMET RRAHMANI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe në parim e mbështet.

Ne do të jemi afër edhe në komisionin përkatës me vërejtjet eventuale gjatë periudhës ndërmjet dy leximeve. Kështu që ne do ta mbështetim këtë ndryshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta japë kontributin e vet në amendamentimin e këtij projektligji dhe e përkrahim në parim, kryesisht në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim për këtë çështje. U paraqit Milaim Zeka, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

MILAIM ZEKA: Shkurt, edhe ne e mbështetim, si “Nismë”.

KRYESUESI: E kreve? Zoti Shabani e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem, predsedavajući!

I Parlamentarna Grupa “6+” razmatrala je zakon, i mi čemo takođe podržati ovaj zakon a svoj doprinos naravno daćemo kroz rad komisije. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj që do ta diskutojmë se kush është funksionar i lartë i këtij shteti dhe kush s’është. Praktikrat duhet të ndiqen të paktën në përputhje me vendet serioze, e jo të atyre që s’janë serioze.

Të tjerë të paraqitur s’ka. Besoj që gjatë amendamentimit deputetët do ta thonë fjalën e vet. Unë mendoj që ky Parlament ka gabuar që u ka siguruar pension të përjetshëm kryeprokurorit, kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Gjykatës... çfarë është ajo... me radhë. Kjo praktikë nuk është kurrkund, ndoshta në Amerikë kanë para boll, por në regjion nuk ka. Dhe, mendoj se më mirë është të diskutojmë që të mos merremi me pensionet, por të merremi me punë. Sidoqoftë, janë vendime të Parlamentit, unë s’mund t’i ndryshoj...

E kemi kaluar një ligj për Parlamentin dhe unë nuk e di që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë zyrtarë të lartë. Nuk janë çfarëdo, por pikërisht deputetët janë zyrtarët më të lartë të këtij vendi, sepse vendosin për gjithçka. E kemi refuzuar. Ua kemi mundësuar disa kategorive, të cilët janë nëpunës të këtij vendi. Nuk janë të zgjedhurit e popullit.

Prandaj, po them që Presidenti, kryeministri dhe kryetari i Parlamentit janë diçka krejt tjetër, krahasuar me disa kategori, që vërtet nuk e besoj që diku në botë i kanë këto privilegje që i gëzojnë në Kosovë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Dua të ju them, për të mos ju mbajtur të varur, që në orën 18:00 fillojmë votimin e këtyre ligjeve që i kemi kaluar me debat dhe pa debat. Faleminderit!

Zoti Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Plotësim-ndryshimi i Ligjit për procedurën jokontestimore është i rëndësishëm për afirmimin dhe zbatimin e Ligjit të trashëgimisë nëpërmjet qartësisë dhe thjeshtësisë të procedurave trashëgimore në rastin kur nuk ka konteste pronësore, si dhe fuqizon edhe më tutje të drejtat pronësore të grave dhe të vajzave.

Plotësim-ndryshim i Ligjit për procedurën jokontestimore ka për qëllim zbatimin e mirëfilltë të dispozitave ligjore për ndjekje penale të atyre që japin deklaratë të rrejshme gjatë procesit të trashëgimisë, apo atyre që nuk i verifikojnë ato. Kjo masë parandalon fshehjen e trashëgimtarëve, ku në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me fshehjen e trashëgimtarëve gra dhe vajza.

E dyta, sigurimin e verifikimit të listës së aseteve pronësore për të trashëguar, në mënyrë që trashëgimtarët potencialë të marrin vendim të informuar.

E treta, mbajtja e seancave të veçanta për ata trashëgimtarë që shfaqin interes të heqin dorë nga trashëgimia, duke ngushtuar mundësitë e keqpërdorimit të institutit të heqjes dorë në të mirë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa dallime gjinore.

Dua të ndalem te rastet e trashëgimisë, që nuk iniciohen menjëherë pas vdekjes së trashëgimtarit. Si burim kyç i informalitetit të gjerë në sektorin e pronave të paluajtshme, rastet e trashëgimisë së vonuar janë ato të cilat i iniciojnë anëtarët e familjes së trashëgimtarit shumë vjet pas vdekjes së trashëgimtarit. Pra, ka raste kur edhe pas më shumë se 15 vjetësh janë iniciuar procese të tilla.

Në ndryshimet e Ligjit për procedurën jokontestimore propozojmë procedura efikase dhe masa mbrojtëse për palët për ta inkurajuar formalizimin e rasteve të trashëgimisë kur nuk ka kontest. Besoj që në rastin e shumë qytetarëve në Kosovë, duke përfshirë edhe ne që jemi këtu në këtë sallë, ende ka shumë procese trashëgimore, të cilat janë të papërfunduara, ndoshta me dhjetëra vjet. E them këtë, sepse në regjistrimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të dhënat kadastrale të rindërtuara tregojnë se përafërsisht 30% e parashtruesve të kërkesave për legalizim të regjistrimit të të drejtave të tyre pronësore nuk arrijnë ta bëjnë këtë për shkak se ata nuk e kanë filluar me kohë procedurën e trashëgimisë.

Pra, me këto plotësim-ndryshime nuk do të vjetërsohen dhe pavarësisht kohës së kaluar qytetarët kanë të drejtë që ta adresojnë një çështje të tillë.

Me këtë gamë të ndryshimeve në Ligjin për procedurën jokontestimore sigurojmë zbatimin e frymës së barazisë dhe mbrojtjen e të të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës para ligjit.

Edhe një herë, nëse më lejoher, i nderuar kryesues, t'i adresoj dy çështje që u lidhën me Ligjin për trashëgiminë, që u bisedua më herët, unë dua t'i përgjigjem zonjës Kusari që unë e kam një zëvendësministre që është femër dhe vjen nga komuniteti serb. Ndërsa, sa i përket çështjes që ngriti deputeti nga radhët e "Vetëvendosjes", rreth përqindjes 62%, thashë se 62% të qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk janë të njoftuar në rast se një grua apo një vajzë ka trashëguar pronë. Dhe, fatkeqësisht, më pak se 5% e grave në Republikën e Kosovës deri sot kanë trashëguar pronë, që është shqetësuese për ne si shtet, për shoqërinë tonë.

Kërkoj që t'i përkrahni këto plotësim-ndryshime në Projektligjin e procedurës jokontestimore, sepse ndërlidhen direkt me Ligjin për trashëgiminë. Po ia heqim atë të Kosovës, që më sugjeroi ministri Krasniqi. Faleminderit!

KRYESUESI: E ftoj përfaqësuesin e Komisionit Funkcional, zotin Hajdar Beqa, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit dhe rekomandime.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1. 11. 2017, e ka shqyrtuar Projektligjin 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Me këtë projektligj do të arrihet të eliminohen disa paqartësi, që ekzistojnë ndërmjet ligjeve, pengesat dhe vështirësitë në zbatim. Risi në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedura jokontestimore është bartja e kompetencave nga gjyqtarët te noterët lidhur me kryerjen e të gjitha procedurave jokontestimore dhe trashëgimore. Pra, ky është ndryshimi

substancial që e adreson ky projektligj dhe që duhet të kemi kujdes gjatë procesit të amendamentimit të këtij projektligji dhe të Projektligjit për Noteri, pasi secili ndryshim në njërin ligj prek edhe ligjin tjetër.

Prandaj, e përmenda edhe më herët, kjo është një pako ku duhet punuar paralelisht, edhe Ligji për trashëgimi, edhe Ligji për procedura kontestimore, si edhe Ligji për Noteri. Po ashtu, nëpërmjet këtij projektligji është trajtuar edhe çështja e trashëgimtarëve, të cilët deklarohen se do të heqin dorë nga trashëgimia. Andaj, ne si komision në këtë fazë i bëjmë thirrje Kuvendit dhe kolegëve deputetë që ta përkrahin, kurse kontributin do ta japim edhe në komision dhe ndërmjet dy leximeve.

Nëse më lejohet, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike do të flisja. Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën jokontestimore.

Ne si grup parlamentar ei përkrahim në parim dhe ftojme sot kolegët deputetë që ta votojnë, kurse kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore, që në fillim them se nga diskutimet e dala në Lëvizjen “Vetëvendosje” rekomandohet për abstenim për disa arsye. Njëra nga arsyet është se në projektligj janë përfshirë ndryshimet që kryesisht kanë të bëjnë me bartjen e autorizimeve ligjore në çështjen trashëgimore nga gjykatat te noterët. Pra, me këtë rregullim, procedura trashëgimore do të kalojë tërësisht te noterët, që ne e pamë veç gjatë diskutimeve për Ligjin për trashëgiminë se cilat janë problemet që lindin gjatë gjithë këtij raporti juridiko-ligjor.

Ne konsiderojmë se me këtë bartje do të rritet kostoja për qytetarët, që do të ballafaqohen me rastin e hapjes së trashëgimisë, përveç përgjegjësisë ligjore që bartet nga gjykata te noterët. Taksa gjyqësore në procedurën trashëgimore është shumë më e ulët sesa inicimi i së njëjtës te noteri.

Në projektligj, po ashtu, duhet krijuar mundësia që palët të mund t'i referohen edhe gjykatës, sepse në këto raste kemi të bëjmë me çështje shumë të komplikuar, nganjëherë jashtëzakonisht të komplikuar, që nuk mund të jenë në kompetencat e një noteri, që nuk bart as kompetencat profesionale, sepse s'e kanë as provimin e jurisprudencës. Është, po ashtu, e vërtetë që kjo bartje, tash ky ndryshim mund të krijojë raporte, ndryshime, komplikime, në raport me ndryshimet që janë paraparë, mirëpo në situatën aktuale, në gjendjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve, ose duhet zbritur taksat e noterëve që janë tash, edhe të monopolizuara, ose duhet lënë mundësia që procedura trashëgimore të iniciohet edhe pranë gjykatës kompetente.

Duke marrë parasysh këto që u thanë deri më tani, Lëvizja "Vetëvendosje" do të abstenojë nga votimi për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka kryer Hajdari. Zonja Mirjeta Kalludra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe me këtë projektligj, siç po e vërejmë, tentohet të arrihet zgjerimi i kompetencave...

Më falni, unë po flas si deputete dhe po e marr fjalën në emër të grupit parlamentar.

Edhe me këtë projektligj, siç vërejmë, tentohet të arrihet zgjerimi i kompetencave të noterëve në zhvillimin e procedurës jokontestimore, trashëgimore. Me ndryshimet aktuale, të iniciuara nga Ministria e Drejtësisë, është tentuar që të ndryshohet në atë formë, që të mos ekzistojnë mospërputhje të ligjeve me njëra-tjetrën. Me këtë ligj rritet kompetenca e zyrave të noterisë, duke u rregulluar në atë mënyrë, që të gjitha çështjet jokontestimore, si për shembull rasti i trashëgimisë, të rregullohen para noterit. Kjo bëhet me qëllim të mosprolongimit të rasteve trashëgimore edhe më shumë nëpër gjykata, pasi siç dihet vetëm në lëmin civil janë rreth mijëra raste ende të pazgjidhura nga gjykatat në Kosovë.

Propozoj që paragrafi 1 i nenit 10 të Projektligjit për procedurën jokontestimore të plotësohet, përkatësisht të përcaktohet afati kohor brenda të cilit obligohet Oda e Noterëve ta dërgojë te noteri tjetër dëshminë e vdekjes, në mënyrë që të shmanget prolongimi i procedurës gjatë shqyrtimit të trashëgimisë. Pra, pas vdekjes së një personi, ose shpalljes si i vdekur nga gjykata, të hartohet dëshmia e vdekjes nga Zyra e Gjendjes Civile sipas të dhënave të marra në mënyrë të pavarur nga Regjistri Civil në afat prej 15 ditësh nga dita e regjistrimit të vdekjes dhe t'i dërgohet Odës së Noterëve. Oda e Noterëve e dërgon te noteri kompetent sipas radhës alfabetike në afat prej dhjetë ditësh pas pranimit të dosjes nga organi kompetent komunal, që e ka hartuar dëshminë e vdekjes.

Një tjetër problematikë shumë e madhe është edhe mosfillimi i procedurës së trashëgimisë sipas detyrës zyrtare. Ndodh që procedura e ndarjes së pasurisë të bëhet shumë vite më vonë. Pra, edhe kjo çështje duhet të rregullohet, të qartësohet, në mënyrë që të mos zvarriten rastet e tilla.

Aktivdekja, bazuar në rëndësinë e hartimit të dëshmisë së vdekjes, po ashtu duke marrë për bazë rastet e mospërfshirjes së trashëgimtarëve në dëshminë e vdekjes, të cilat kanë ndodhur deri më tani. Pra, edhe kjo ka nevojë të rregullohet më mirë, që në të ardhmen të përfshihen të gjithë trashëgimtarët, pra mos të kemi fshehje apo përjashtim të tyre.

Tek neni 32 i projektligjit parashihet të shtohet një nen i ri lidhur me deklarin për heqjen dorë nga trashëgimia, bazuar në pasojat juridike që prodhon heqja dorë nga trashëgimia. Për ta krijuar një siguri më të madhe juridike, propozojmë që të shtohen edhe dy paragrafë, si në vijim:

165.1 - obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Noterëve që ta hartojnë një formë standarde, të njëjtë për të gjithë noterët, e deklarin për heqjen dorë nga trashëgimia;

165.2 - obligohet noteri dhe trashëgimtarët në rast kur pajtohen të heqin dorë nga trashëgimia që ta nënshkruajnë deklaratën sipas nënparagrafit 165.1;

Me këtë rast, e shfrytëzoj rastin ta falënderoj USAID-in që e ka dhënë një kontribut të çmuar për këto tri projektligje që i diskutuam sot, Noterinë, trashëgiminë dhe procedurat jokontestimore, si dhe ka mbështetur shumë organizata vendore që punojnë rreth të të drejtave të grave në përgjithësi dhe në veçanti të drejtat e grave në pronë. Po ashtu, falënderoj OJQ Polis dhe BIRN dhe organizata të tjera, që edhe gjatë legjislaturës së kaluar kanë dhënë kontribut të çmuar me propozime konkrete për këto tri projektligje, në mënyrë që të jenë sa më të kompletuara dhe më lehtë të zbatueshme.

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së do t'i japë përkrahje të plotë në parim këtij projektligji, kurse gjatë dy leximeve si grup parlamentar, me qëllim që të kemi një rregullim më të mirë ligjore, do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Bekë Berisha e ka fjalën.

BEKË BERISHA: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e përkrahim këtë projektligj në lexim të parë dhe do të japim kontributin tonë gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”, zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Kryesues, të meta borxh më parë të të them si person, jo në emër të grupit “Nisma”, e përkrah komplet atë mendimin tënd edhe propozimin, domethënë si individ nuk do ta votoj ligjin paraprak, po si grup i “Nismës” po, Ligjin për presidentin, është fjala.

E dyta, këtë ligj ne e mbështesim dhe do ta votoj edhe unë, edhe grupi “Nisma”.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues,
Kolegë,
Ne si AKR e mbështetim dhe e votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin, zoti Abelard, e ke fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që para jush të paraqes për miratim Projektligjin për ndërmjetësim.

Ky projektligj, i përcaktuar me programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, ka për qëllim krijimin dhe avancimin e kuadrit ligjor në fushën e ndërmjetësimit, me anë të të cilit do të ofrohen shërbime me cilësore dhe efikase për qytetarët e Kosovës.

Besoj se ndryshimet që propozohen në këtë projektligj do të ndikojnë dukshëm në shkarkimin e mëtejshëm të gjykatave nga lëndët dhe do të rritet shfrytëzimi më i madh i kësaj metode jashtëgjyqësore të zgjidhjes së kontesteve.

Ndër të tjera, ky projektligj realizon harmonizimin e plotë të procedurave të ndërmjetësimit si dhe do të sigurojë ndërlidhje më të mirë institucionale me gjyqësorin.

Me anë të këtij projektligji janë paraparë dispozitat me të cilat rregullohen ndërmjetësimi i detyrueshëm që nënkupton procedurën e ndërmjetësimit të iniciuar nga qytetarët kompetentë, i cili obligon palët që fillimisht si alternativë të aprovojnë procedurën e ndërmjetësimit.

Të nderuar deputetë,

Vlen të theksohet se ndërmjetësimi i detyrueshëm nuk mohon të drejtën e qasjes në gjykata apo në procedurën e arbitrazhit, nëse nuk arrihet marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.

Projektligji për ndërmjetësim, ndër të tjerra, rregullon: parimet dhe procedurat e ndërmjetësimit, kushtet dhe regjistrimin e ndërmjetësimit, të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe ndërmjetësuesve, njohjen e ndërmjetësuesit të huaj si dhe dispozitat ndëshkimore.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë konsultuar burimet e legjislacionit përkatës të BE-së, me të cilat Projektligji për ndërmjetësim është plotësisht në harmoni.

Hartimi i këtij projektligji ka rezultuar me një bashkëpunim të ngushtë me aktorët vendorë dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët kanë ofruar mbështetjen e tyre në hartimin dhe finalizimin e këtij projektligji.

Andaj, me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të legjislacionit të kësaj fushe si dhe me qëllim të eliminimit të pengesave dhe vështirësive që janë hasur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj.

Edhe një çështje, të mos ju mbes borxh.

Dua t'i falënderoj partnerët tanë ndërkombëtarë, mirëpo inicimi i këtyre ndryshimeve ka ardhur si rezultat i Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk ka ardhur si rezultat i asnjë organizate ndërkombëtare apo ambasade që vepron në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, respektivisht përfaqësuesin, zoti Beqa, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. A je nënkryetar, a përfaqësues?

HAJDAR BEQA: Zëvendëskryetar i parë.

Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8.11.2017 e shqyrtoi Projektligjin nr. 6/L-009 për ndërmjetësim dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ky ligj rregullon mënyrën, funksionimin, procedurën dhe organizimin e ndërmjetësimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve me qëllim të lehtësimit të qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes dhe kontesteve.

Risi në këtë projektligj, që vlen të theksohet, si e tha edhe ministri i Drejtësisë, është dispozita me të cilën rregullohet ndërmjetësimi i detyrueshëm, që nënkupton procedurën e ndërmjetësimin të iniciuar nga gjyqtari kompetent, i cili obligon palët të provojnë procedurën e ndërmjetësimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Mirëpo, ndërmjetësimi i detyrueshëm nuk mbron të drejtën e qasjes në gjykatë apo në procedurën e arbitrazhit.

Nëse nuk arrihet marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimin, atëherë palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës.

Ajo çka dua të adresoj gjatë shqyrtimit në grup punues dhe në komision, gjithashtu edhe si grup parlamentar është ta qartësojmë nenin 2, ku flitet për ndërmjetësimin në fushën penale, duke përcaktuar se për cilat vepra penale mund të referohen për ndërmjetësim palët.

Po ashtu, në nenin 21, nënparagrafi 7.1, ku flitet për kushtet që duhet t'i plotësojë një kandidat për t'u licencuar si ndërmjetësues, duhet të rishikohet ky kriter, sepse është shumë i lartë dhe nuk ka kufizim për asnjë lloj të veprave penale.

Konsideroj se duhet të thuhet të mos jetë i dënuar për veprë penale me dënim me burg më shumë se 6 muaj. Kështu do të shmanget vepra penale të kryerjes nga pakujdesia, kjo do të duhej të ishte e njëjta logjikë edhe për noterët, gjyqtarët dhe prokurorët.

Andaj, Komisioni për Legjislacionin i rekomandon Kuvendit për ta aprovuar në këtë fazë, kurse rekomandimet i japim mes dy leximeve dhe në komision.

Edhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, nëse më lejohet, e kemi shqyrtuar Projektligjin për ndërmjetësim, ku i rekomandojmë Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht deputetëve të Kuvendit që në këtë fazë ta votojmë projektligjin në parim dhe kontributin tonë ta japim gjatë amendamentimit të projektligjit gjatë shqyrtimit në mes leximit të parë dhe leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", është paraqitur zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ne kemi analizuar tekstin e Ligjit për ndërmjetësim, i cili parasheh zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konteksteve në mënyrë miqësore, me anë të ndërmjetësimit, për një varg veprash, edhe këto vepra mund t'i takojnë të drejtës juridiko-pasurore, tregtare, familjare, të punës, si dhe raste të tjera të kontesteve nga e drejta pronësore. Mandej kemi edhe të drejtat e trashëgimisë dhe përzihen ato me procedura të falimentimit ose me raporte të tjera administrative dhe civile, këtu hyjnë edhe të gjitha veprat penale, të cilat sanksionohen nën tre vjet burgim.

Pas analizimit, sidomos pas krahasimit që kemi bërë me Projektligjin për trashëgiminë, ne mendojmë se një çështje që nuk mund t'i lihet ndërmjetësimit në këto raste dhe ndërmjetësuesve të licencuar, edhe pse kemi të bëjmë me shkarkimin e gjykatave, janë çështjet pronësore ligjore të trashëgimisë.

Ne i dëgjuam diskutimet e deritashme, sidomos në çështjet familjare të trashëgimisë, sidomos kur është fjala për trashëgiminë për femrat.

Në asnjë rast këto çështje nuk mund t'i lihen ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesve, pa marrë parasysh si quhen ata dhe si konsiderohen ata për arsyet e cekura deri më tani.

Prandaj, ne kërkojmë që një pjesë e këtyre gjërave, domethënë thjesht të hiqen nga Ligji për ndërmjetësimin dhe sidomos çështjet e trashëgimisë në konfliktet familjare në baza gjinore.

Pikërisht duke u nisur nga këto parime dhe nga kjo analizë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" rekomandon që gjatë votimit të këtij ligji të abstenohet pa u marrë parasysh të gjitha këto çështje, sidomos çështja e trashëgimisë në raportet familjare në baza gjinore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! LDK-ja, e do dikush fjalën? Jo. Atëherë fjalën e ka Shkumbin Demaliaj, në emër të AAK-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

I japim rrugë edhe këtij projektligji kur kalon në lexim të dytë. E përkrahim projektligjin si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë fjalën e ka zonja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” në parim e mbështet Projektligjin për ndërmjetësim dhe ne deputetët e “Nismës” do të japim kontributin tonë në mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Sërish jam i detyruar ta bëj një ndërhyrje, të cilën e bëj pothuajse çdo vit, sepse çdo vit Qeveria e Kosovës nuk ndryshon dhe sjell ligje të cilat së paku për nga problematika e emërimit janë shumë të papranueshme.

Pra, ky ligj e ka emrin më të përgjithshëm të mundshëm dhe prej emrin nuk kuptohet asgjë, e ligjet duhet të kuptohen prej emrit.

Së pari ligjet duhet të kuptohen prej emrin. Përmbajtja e ligjit duhet të kuptohet prej emrit, së paku.

E në Republikën e Kosovës neve në çdo legjislaturë na ndodh të vijnë ligje shumë problematike për nga mënyra e emërimit, pra Ligji për ndërmjetësim, veç kaq. Kjo është njëjtë sikur të vijë një ligj, Ligji për veprim, qysh Ligji për veprim, qysh Ligji për ndërmjetësim, kjo është e pakuptueshme.

Këtu, për shembull, kur e shohim se çka zgjidh ky ligj, atëherë kuptojmë që kemi të bëjmë me kontestet e ndryshme sa i përket fushës juridiko-pasurore, të kontesteve të punës dhe të zgjidhjes së pasurive apo të trashëgimisë lidhur me pronën dhe pasurinë, të cilat nuk mund të zgjidhen në fushën civile. Atëherë, këtu do ta gjeni një emër, i cili edhe pse mund të jetë shumë i gjatë, është shumë mirë të bëhet, sepse është shpjegues. Edhe kur hyn qytetari, për shembull, të informohet më mirë në lidhje me kontestin që e ka dhe po do vetë ta gjejë edhe të hulumtojë ligjin, i cili ka të bëjë dhe e zgjidh kontestin, në të cilin ai është i përfshirë, ai të hyjë dhe të kërkojë e të hulumtojë vetë në arkivin e Kuvendit të Kosovës dhe të gjejë ligjin në fjalë. Kështu nuk mundet ta gjejë kurrë, nëpërmjet këtyre emrave të përgjithshëm, e na ndodh çdo vit në Kuvend të Kosovës të vijnë ligje me emra më të çuditshëm të mundshëm, të cilët kurrë nuk mund t'i zbulosh prej vetë emrit për çka është.

Në vendet e Bashkimit Evropian praktikohen që emrat të jenë edhe tre-katër rreshta të gjatë, tre rreshta i gjatë, nuk ka lidhje ligji, emri i ligjit duhet sa më i detajuar të jetë, aq më mirë është edhe për publikun, edhe për Qeverinë, edhe për Kuvendin.

Kështu që, ju lutem, mos na bini më ligje kështu, Ligji për ndërmjetësim. Ti nuk e di a i përket fushës së marrëdhënies ndërkombëtare, a është për negociata atje, kur përfundojnë, edhe ajo është ndërmjetësim, edhe aty është ndërmjetësuesi, janë palët kontestimore. Pra, ta ketë një emër

të saktë, një emër të hollësishëm, i cili e shpjegon krejt problematikën dhe i cili edhe vetë emri na tregon se për çka është përmbajtja e ligjit, mos i leni emrat kështu të përgjithshëm, ju lutem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë projektligj u mundësohet qytetarëve të shfrytëzojnë ndërmjetësimin si mundësi alternative në zgjidhjen e problemeve pa iu drejtuar gjykatës.

Pra, me këtë projektligj kemi vërejtur që synohet të rregullohet ndërmjetësimi i detyrueshëm, ku i obligon palët të provojnë procedurën e ndërmjetësimit si mundësi alternative në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.

E mira e ndërmjetësimit të detyrueshëm nuk mohon të drejtën e qasjes në gjykata apo në procedurën e arbitrazhit, nëse nuk arrihet marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

Fillimisht vlen të përmendet fakti se te ndërmjetësimi nuk është ndjekur praktika e njëjtë sikurse edhe te profesionet e tjera të lira, e cila ka të bëjë me themelimin e Odës së Ndërmjetësuesve, edhe vetë organizimin e tyre, sikurse që kemi rastin me Odën e Noterëve, përmbauesve, administratorëve, falimentuesve, e të tjera.

Pra, duhet të parashihet që me këtë ligj themelimi i Odës së Ndërmjetësuesve, të cilët nëpërmjet këtij organizimi do t'i ndihmojnë ministrisë, gjykatave dhe prokurorisë që kjo politikë e re të jetë më e zbatueshme dhe më e avancuar, për të cilën edhe vetë ligji ka po këtë qëllim, që t'i rregullojë këto procedura.

Ky plotësim i ligjit do të bënte që Oda e Ndërmjetësuesve, në bashkëpunim me departamentin përkatës brenda Ministrisë së Drejtësisë, të jenë partnerë dhe përgjegjës për përcaktimin e politikave zhvillimore lidhur me kushtin e ndërmjetësimit, siç janë organizimet e trajnimeve dhe kurseve për ndërmjetësues, informimin e publikut për mundësi të ndërmjetësimit si dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Po ashtu, kemi vërejtur se nuk është e rregulluar apo e qartësuar edhe efekti juridik i marrëveshjes së ndërmjetësimit, i arritur te rastet me vetë referime, pra me inicim të palëve. Ky shqetësim është shprehur edhe nga vetë ndërmjetësuesit, pra kanë pasur vështirësi palët që t'i përparojnë marrëveshjet e ndërmjetësimit të arritura me vetë referim.

Sipas tyre, edhe Ligji për procedurën përmbaimore nuk e rregullon fuqinë e marrëveshjes së ndërmjetësimi te rastet me vetë referim, mirëpo u referohet sipas Ligjit për ndërmjetësim. Në

këtë rast ne duhet të rregullojmë me këtë ligj ose edhe marrëveshjet e arritur me vetë referim, është titulli ekzekutiv dhe përmbush pa pasur nevojë të vërtetohet në gjykatë apo tek organi i noterisë.

Një çështje tjetër që e ka përcjellë procesin e ndërmjetësimit, janë të gjitha çështjet të cilat kanë ardhur si rekomandime nga ndërmjetësuesi, është edhe çështja e pagesave të ndërmjetësuesve. Pra, ka pasur shqetësime sa u përket shpenzimeve të procedurës dhe tarifa të ulëta për ndërmjetësues, të cilat konsiderojmë se duhet të jenë më të arsyeshme dhe të përshkallëzohen varësisht natyrës së rastit.

Nuk është aspak e dinjitetshme që një ndërmjetësues të paguhet për një rast 25 euro, ku ndoshta i duhen disa seanca të mbajë për një rast.

Tarifa të ulëta mund të dëmtojnë edhe procesin e ndërmjetësimit që ndërmjetësuesi mund të mos e marrin seriozitetin e duhur gjatë ushtrimit të tyre si ndërmjetësues.

Edhe pse kemi një numër të konsiderueshëm të ndërmjetësuesve, mendoj se për të pasur sukses procesi i ndërmjetësimit, duhet të kemi një proces rigoroz të certifikimit dhe licencimi për të garantuar ndërmjetësues me kredibilitet të lartë moral, intelektual e profesional.

Po ashtu, përveç kësaj duhet menduar edhe për një proces të edukimit të vazhdueshëm profesional nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të cilat duhet të jenë të obliguara për mbajtjen e licencës dhe avancimin e shkathtësive si ndërmjetësues.

Plan-programi i trajnimeve medoemos duhet të hartohet nga Oda e Ndërmjetësuesve, në bashkëpunim me Departamentin e Ministrisë së Drejtësisë për profesione të lira, trajnime që do të zhvilloheshin lehtësisht edhe nga Akademia e Drejtësisë.

Këto vërejtje apo rekomandime, e thashë edhe më herët, janë si rezultat i shqetësimeve që na kanë ardhur nga ndërmjetësues dhe i kemi vërejtur që janë bërë gjatë fazës së parapërgatitjes së këtij projektligji.

Edhe si Grup Parlamentar i LDK-së e përkrahim në parim këtë projektligj dhe do të kontribuojmë në dy lexime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!
Të nderuar deputetë,

Edhe unë mendoj që ligji është i rëndësishëm së veçantë, po me shumë interes për të zvogëluar barrën e institucioneve gjyqësore në zgjidhjen e rasteve.

As ministri nuk është prezent, e përgëzoj atë që po merr iniciativa, por unë e ftoj që ai të shikojë pak praktikën më të mirë evropiane në këtë drejtim, sepse ligji në vetvete ka plot kontradikta.

Për shembull, tek neni 3, pika 1.2, thotë: “Ndërmjetësimi i detyrueshëm nënkupton procedurën e ndërmjetësimit të iniciuar nga gjyqtari kompetent, i cili i obligon palët të provojnë procedurën e ndërmjetësimit, siç është paraparë me ligj”.

Ndërkaq në nenin 4, ku janë parimet e ndërmjetësimit, thotë: “Procedura e ndërmjetësimit zhvillohet me vullnetin e lirë të palëve, i shprehur gojarisht dhe me shkrim në pajtim me këtë ligj”.

Ka edhe disa raste të tjera ku ligji ka kontradikta. Unë besoj që nuk janë shqyrtuar përvojat më të mira, në veçanti të vendeve të BE-së në këtë drejtim, dhe besoj që ka shumë hapësirë për përmirësim.

Unë ftoj ministrinë, po edhe grupi ynë parlamentar do të japë sugjerime dhe vërejtje gjatë dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk dëshiron, besoj, të thotë ndonjë fjalë.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartës i këtij projekti legjislativ, të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për shoqëritë tregtare.

Arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për shoqëri tregtare është adresimi i nevojës për përafrimin e ligjit ekzistues për shoqëritë tregtare, me ndryshime dhe plotësime, me legjislacionin e BE-së në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit të MSA-së dhe planin e zbatimit për MSA-në.

Arsyeja e dytë për hartimin e Projektligjit për shoqëritë tregtare është rritja e mbrojtjes për investitorët e vegjël në korporata si dhe përmirësimin dhe thjeshtësimin e mëtutjeshëm të procedurave për regjistrimin e shoqërive tregtare, duke u bazuar në kërkesat e metodologjisë të Bankës Botërore në Raportin për të bërit biznes, respektivisht indikatorët e një fillimi të ri dhe mbrojtjen e investitorëve të vegjël.

Përveç dy çështjeve kryesore të shtjelluara më lart, në këtë projektligj janë adresuar edhe disa çështje, të cilat do ta përmirësojnë edhe më tutje procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare.

Këto ndryshime kanë të bëjnë me thjeshtësimin dhe qartësimin e gjuhës së përdorur në ligj, në mënyrë që ligji të kuptohet më mirë nga bizneset dhe qytetarët, unifikimi i koncepteve dhe harmonizimin më të mirë të dispozitave ligjore.

Po ashtu, në këtë projektligj është përfshirë edhe kërkesa për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të raportimit të performansës së regjistrimit të shoqërive tregtare nëpërmjet hartimit të raporteve të rregullta, të cilët paraqesin një pasqyrë të shërbimeve të regjistrimit të shoqërive tregtare.

Duke përfshirë të dhëna, si koha që nevojitet për regjistrimin e një shoqërie tregtare, numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara, shoqëri tregtare të regjistruara në bazë të gjinisë, e të tjera.

Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, projektligji po ashtu trajton edhe regjistrimin elektronik të shoqërive tregtare si një hap i rëndësishëm për lehtësimin e procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare.

Kjo do të lehtësojë regjistrimin e shoqërive tregtare nga aksionarët e huaj, gjë që ndikon në përmirësimin e mjedisit për investime të huaja.

Si çështje me rëndësi të madhe dhe që do të përmirësojë dhe do të lehtësojë dukshëm ambientin e biznesit në Kosovë, në projektligj është krijuar baza ligjore për krijimin e numrit unik identifikues për shoqëri tregtare.

Sipas kësaj kërkesë, shoqërisë tregtare që regjistrohen në ARBK i jepet një numër unik, i cili identifikon shoqëritë tregtare, para së gjithash institucionet shtetërore të Kosovës, si ARBK-ja, ATK-ja, Dogana e Kosovës, e të tjera.

Me anë të këtij numri shoqëria tregtare do të regjistrohet në ARBK dhe po i njëjti numër do të shërbejë për shoqëri tregtare për ndërveprime me ATK.

Për deklaratimet dhe pagesat e tatimeve si dhe për lëshimin e certifikatës së TVSH-së.

Po ashtu, me këtë projektligj rregullohet çështja e bashkimit të kompanive, bashkimit ndërkufitar të kompanive, ndarje të kompanive dhe shndërrimi i kompanive në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, ky projektligj rregullon detyrimin për besnikëri, konflikt të interesit dhe paditë për ortakëri dhe korporatat të përputhshme me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Projektligji për shoqëri tregtare është paraparë në programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit, planin e punës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara në Rregulloren 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime shtesë buxhetore dhe opinionin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe me qëllim që të përmirësohet ambienti i bërjes së biznesit dhe duke pasur parasysh që projektligji i propozuar është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj në këtë mbledhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zonjën Sala Berisha-Shala, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. Zonja Shala, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Ju të pranishëm,

Ministra,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7. 11. 2017 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të këtij projektligji vlerësoi se projektligji i plotëson pushtetet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Do të dëshiroja një përmirësim të vogël të ministrit në ekspozenë e tij, se është fjala komplet për një ligj të ri dhe jo për plotësim-ndryshimin e ligjit.

Ju ftoj, të nderuar kolegë deputetë, ta miratojmë në parim, vërejtjet dhe sugjerimet i japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është përfaqësuesve të grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk është paraqitur askush.

Grupi Parlamentar i LDK-së, janë paraqitur Hykmete Bajrami dhe Korab Sejdiu. Fjalën e ka znj. Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës t’i jap komentet për Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Në fakt, ligji në fjalë është sponsorizuar nga Qeveria paraprake dhe gjithashtu është finalizuar komplet nga legjislatura e kaluar.

Ky ligj ka qenë i gatshëm për lexim të dytë në fund të muajit prill të këtij viti.

Neve na vjen keq, sepse sikur të kishte kaluar dhe të ishte aprovuar para datës 31 maj, Banka Botërore do ta kishte marrë për bazë si reformë edhe sigurisht që do të kishim pasur edhe një rezultat më të mirë, përkundër që rezultati nuk ka munguar.

U tha edhe më herët që ligji ka për qëllim të marrë parasysh të gjitha ndryshimet që janë bërë në legjislacionin evropian, në mënyrë që të barten ato ndryshime dhe të adresojë gjithashtu të gjeturat e raportit të Bankës Botërore për disa vjet, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e investitorëve të vegël dhe gjithashtu me indikatorët të fillimit të një biznesi.

Ministri e përmendi që ligji në fjalë krijon bazën për regjistrimin me numër unik të biznesit. Unë ju bëj me dije që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia për Regjistrim të Bizneseve, në kuadër të kësaj ministrie, ka filluar regjistrimin e bizneseve me numër unik, numër i cili, siç u tha, shërben para të gjitha institucioneve, si ATK-së, Doganës dhe të gjitha institucioneve të

tjera, e ka filluar këtë regjistrim me numër unik që nga fillimi i këtij viti. Megjithatë, me ligj është dashur që të çimentohej kjo bazë, në mënyrë që të vazhdohej si e tillë.

Meqenëse është edhe në plan, edhe ka qenë prioritet i ministrisë, dhe është obligim që është marrë nga Marrëveshja e stabilizim-asocimit, i cili është dashur faktikisht në tremujorin e dytë të aprovohet dhe duke marrë parasysh që është punuar shumë edhe nga Qeveria, po edhe nga legjislacioni i kaluar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah ligjin dhe gjithashtu është i gatshëm, në qoftë se do të ketë vërejtje të tjera nga gjithë aktorët, palë të interesit, në mënyrë që ne të përmirësojmë këtë ligj në mes të dy leximeve, por besoj që nuk do të marrë shumë kohë edhe në komision, meqenëse është i gatshëm dhe do të aprovohet.

Kështu si grup parlamentar ne japim mbështetje në parim për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për shoqëritë tregtare dhe duke pasur parasysh që ligji në parim dhe në përgjithësi është i pranueshëm edhe për politikën tona, ne do ta mbështesim në lexim të parë dhe plotësime dhe vërejtjet që i kemi besoj që do të adresohen ndërmjet leximit të parë dhe leximit të dytë, në koordinim edhe me ministrinë përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për shoqëritë tregtare është një prej projektligjeve që është miratuar edhe nga Qeveria e kaluar dhe ka qenë, siç tha edhe kolegja Bajrami, parafolësja, një nga ligjet që kanë qenë ligje prioritare edhe për të lehtësuar dhe për përmirësuar ambientin e të bërit biznes në Kosovë, pjesë të disa prej obligimeve ndërkombëtare të Kosovës në këtë fushë.

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar dhe në këtë fazë e mbështesim aprovimin e këtij ligji për të vazhduar pastaj kontributin e mëtutjeshëm aty ku është e domosdoshme në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Grupi Parlamentar Lista Serbe, nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe e përkrahim në parim. Normalisht, edhe kontributi i grupit tonë parlamentar do të jepet nëpërmjet deputetit tonë në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Po edhe Grupi Parlamentar i “Nismës” në parim e mbështet këtë projektligj dhe deputetët e “Nismës” do të japin kontributin e tyre mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje edhe një herë,

Ne veç e kemi një ligj për shoqëritë tregtare dhe në parim e përkrah këtë nismë, sepse shkon në drejtim të duhur.

Vetëm që kisha pasur dëshirë të potencoj për të gjithë ne këtu që është, nëse jo ligji më bazik dhe më i rëndësishëm, atëherë një prej dy-tri ligjeve më të rëndësishme për ekonominë e vendit, pasi që të gjitha ndërmarrjet afariste operojnë duke u bazuar në këtë ligj.

Dhe duhet të kemi kujdes të veçantë, sepse unë kam parë që edhe në këtë ligj, sikurse edhe në ligjin, i cili është në fuqi aktualisht, ekzistojnë disa të meta, të cilat nuk e marrin parasysh do të thotë praktikën, po flas për çështje që janë paraqitur para gjykatave. Po flas për konteste të ndryshme që mund të lindin mes aksionarëve e kështu me radhë.

Rrjedhimisht vërtet ju kisha inkurajuar të gjithëve, duke pasur parasysh nevojën e ekonomisë tonë për zhvillim dhe duke pasur parasysh nevojën që bizneseve tona t’u mundësohet një operim sa më i lehtë dhe një bazë ligjore sa më e mirë, të japim përkushtimin tonë më të madh në përmirësimin e këtij versioni.

Unë në këtë drejtim kam kërkuar komente edhe nga grupet e ndryshme të interesit që janë edhe Oda e Avokatëve edhe organizata të ndryshme të biznesit e kështu me radhë dhe shpresoj që brenda dy leximeve të kem mundësi t’i marr edhe rekomandimet e tyre.

Po flas si një person që ka kaluar pjesën dërmuese të jetës profesionale duke punuar me të drejtën korporative, shumë prej të metave të cilat duhet adresuar tani do të na nxjerrin problem në të ardhmen nëse i lëmë mënyrën se si janë.

Tash këto të meta mund të flasim prej çështjeve që ndërlidhen me aspekte teknike, do të thotë disa pjesë shihet qartë që janë përkthime joadekuate nga anglishtja, e deri te ato vazhdimësi teknike, do të thotë moskonsistenca sa i përket terminologjisë që përdoret në ligj, deri te ato përmbajtjesore sa i përket të drejtës korporatave.

Kështu që vërtet i kisha inkurajuar të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët, në fakt, që të japin një përkushtim pak më të madh këtij ligji dhe të mundohen që të konsultohen edhe me njerëz të lëmit të së drejtës së korporatave, me qëllim që të kemi një ligj sa më të përsosur, duke pasur parasysh gjithmonë jo vetëm rangimet ndërkombëtare, po lehtësimin e të bërit biznes për të gjithë ata që synojnë të bëjnë biznes në Kosovë, duke filluar prej ndërmarrjeve ose bizneseve individuale, deri te shoqëritë aksionare që janë pak më të mëdha.

Duke mos dashur që të fillojmë prapë me secilin komentim, sepse ato do të paraqiten nga unë nëpërmjet amendamenteve të ndryshme, por edhe vetë titulli do të thotë ka njëfarë lloj pakuptimësie, sepse biznesi individual ka vetëm një pronar, ndërsa këtu flitet për shoqëri tregtare, pra do të ishte më e arsyeshme të thirren ndërmarrjet afariste, për shembull, Ligji për ndërmarrjet afariste.

Kështu që me këtë edhe një herë ju lus që të kemi kujdes të veçantë lidhur me këtë dhe të shfrytëzojmë këtë kohë maksimalisht për të rezultuar me një ligj që vërtet i bën nder komunitetit të biznesit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht ne e kemi shqyrtuar Projektligjin për shoqëritë tregtare dhe normalisht e mirëpresim, kemi dëshirë që kjo të trajtohet ende, sigurisht që ka hapësirë për ndryshime dhe besoj që komisioni do ta bëjë punën e vet. Përndryshe, është i mirëseardhur dhe ne e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI: Faleminderit!

Gjithashtu e përshëndes sjelljen e këtij ligji në parlament si të domosdoshëm për të gjitha ato që u cekën më herët, edhe për ankimin e Kosovës, po gjithashtu edhe për përparimet, të cilat duhet të bëhen pas miratimit të ligjit, në veçanti për regjistrimin online të bizneseve si dhe për sforcimin dhe aplikimin e gjerë të numrit unik.

Megjithatë sot dua ta përmend një çështje, e cila është lënë jashtë këtij ligji dhe ne do ta propozojmë edhe me amendamentet e drejtpërdrejta në Komisionin Funkcional, por gjithashtu

edhe në një debat të gjerë publik me shoqatat e bizneseve, odat ekonomike, por edhe shoqatat për barazi gjinore, që në raport me përfshirjen e grave në vendimmarrje, në bordet e shoqërive aksionare dhe bordet e korporatave, të përfshihet edhe kuota gjinore në emërimin, gjegjësisht në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të shoqërive aksionare.

Neni 34 paraqet në kuadër të ligjit dorëzimin e listës së anëtarëve të bordit, gjegjësisht të drejtorëve të bordit të shoqërive aksionare në ligjin i cili është para nesh.

Prandaj, në kuadër të këtij neni ose në kuadër të ligjit të parashihet gjithashtu edhe përfshirja e domosdoshme e kuotës gjinore.

Përderisa vendet si Belgjika, Franca, Gjermania, Islanda, India, Izraeli, Italia, Norvegjia dhe Spanja kanë kuota të ndryshme gjinore, prej 30 në 40%, ose rasti i Norvegjisë që ka kuotën e barazisë, gjegjësisht të mosdiskriminimit në të dy gjinitë, qoftë për gjininë femërore ose gjininë mashkullore, në Kosovë mund të fillohet me aplikimin ose me afatizimin e aplikimit të kuotës gjinore prej 30%, njëjtës siç është përfaqësimi gjinor në kuadër të parlamentit dhe kjo të bëhet normativë, e cila fillon aplikimin të themi në gjysmën e vitit 2018 ose fillimin e vitit 2019, që të ketë mundësi që shoqëritë aksionare të përgatiten për ato të cilat nuk kanë drejtorë të bordit gra ose vajza. Konsideroj që si ligj bazë, i cili përcakton qeverisjen korporative dhe përcakton praktika bazë të të bërit biznes në Kosovë, është tepër e rëndësishme që në fuqizimin e drejtpërdrejtë të gruas të ndikojmë në procesin e vendimmarrjes. Nuk mund të kemi korporata të suksesshme nëse në shumicën prej tyre qeverisjen ose janë përgjegjës vetëm burrat, ndërsa 50% e popullatës ose trurit të Kosovës mbetet jashtë.

Prandaj, të njëjtën do ta bëjmë edhe në Komisionin Funkcional, edhe nëpërmjet debatit të gjerë, por rekomandoj që kjo të jetë në përfshirje dhe gjithashtu me elemente të sanksionimit në kuadër të Ligjit për shoqëritë tregtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Shkurt, atë që e tha zonja Kusari, mendoj që është ide e mirë që të përfshihet kuota gjinore, veçanërisht në Projektligjin për shoqëritë tregtare. Duhet të theksohet fakti që në legjislaturën e kaluar, deputetja Sala Berisha-Shala ka kërkuar asokohe dhe ka kaluar që në Ligjin për ndërmarrjet publike të zbatohet kjo kuotë gjinore, veçanërisht në bordet e ndërmarrjeve publike, që të kemi përfaqësim gjinor dhe mendoj që në këtë vazhdë kjo i kontribuon edhe vetë fuqizimit të gruas.

Po ashtu, e mbështes idenë që edhe në Projektligjin për shoqëritë tregtare ta kemi një kuotë gjinore, duke marrë parasysh faktin që fuqizimi i gruas nënkupton edhe pjesëmarrjen e saj të

fuqishme, jo vetëm në tregun e punës, por gjithsesi edhe në ndërmarrjet publike, normë që është vendosur nga legjislatura e kaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë personalisht këtë çështjen e kuotave të përcaktuara me ligj e shoh pikërisht si diskriminim, sepse nuk mund ta rregullojmë me ligj asnjëherë barazinë gjinore. Duhet një emancipim i shoqërisë, duhet së pari shikuar për të hapur sa më shumë çerdhe, që atje të fillojë edukata për barazi gjinore. Unë në formë hipotetike, po ta kisha ndonjë fuqi magjike, për shembull në Ministrinë e Shëndetësisë krejt femra i kisha lënë, edhe në borde, edhe në ministre, edhe krejt, por e kam një pyetje për ministrin Hasani: Gjatë diskutimeve me biznesmenë të ndryshëm ndërkombëtarë, që vijnë edhe i regjistrojnë bizneset në Kosovë, është një problem shumë i madh te regjistrimi i biznesit, pothuajse inekzistues në vendet Evropiane dhe për mua shumë banal, se në qoftë se një i huaj regjistron ortakëri me një kosovar dhe e sheh që nuk po ecën biznesi, ky i huaj nuk mund vetvetiu ta bëjë shlyerjen e biznesit dhe kjo është arsyeja kryesore pse të huajt frikësohen ta bëjnë regjistrimin e biznesit në ortakëri me një vendor kosovar. Si do të rregullohet kjo, sipas jush, në ligjin aktual, të cilin ne po e diskutojmë?

KRYESUESI: Nuk ka tjerë të paraqitur. Shpresoj që të mos na shpërthejë edhe ne si në Kroaci ajo puna e asaj kompanisë me 7 miliardë humbje për shtetin e për bankat. Tjerat janë pak më mirë.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin në fjalë. Zoti ministër Hasani, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Të mos ju mbetem borxh nga pika tjetër, domethënë u tha plotësim-ndryshimi i ligjit, ne e patëm fjalën për përafrim të Legjislaturës së BE-së, se ne e dimë që më 2007 ka qenë ligji, ka hyrë në fuqi më 2008, është bërë ndryshimi në korrik 2011, por e patëm fjalën për ndryshim-plotësimet në përafrim të Legjislacionit të BE-së.

Kurse, sa i përket rëndësisë, që u tha nga deputetja, realisht ne mendojmë që me miratimin e këtij ligji dhe hyrjes në fuqi, edhe pse nuk jemi keq në renditje në nivel botëror sa i përket hapjes dhe procedurave, domethënë të hapjes së biznesit, ku merr pjesë ndër parametrat e të bërit biznes,

besoj që me miratimin e këtij ligji tanimë jemi në vendin e 10-të në hapjen e biznesit në botë, kurse me miratimin e tij besoj që vitin tjetër, besoj që ndoshta vitin tjetër do të jemi në vendin e pestë, qysh parashihet nëse jetësohet ky ligj.

Sa i përket pyetjes së deputetit për rregullimin e kësaj çështjeje, unë e thashë edhe gjatë fjalimit që natyrisht është e precizuar edhe kjo pikë. Janë të detajuara në Ligjin për shoqëritë tregtare dhe besojmë që pas miratimit të këtij ligji nuk do të ketë probleme të tilla.

Po vazhdoj me Projektligjin për standardizim. Më lejoni që shkurtimisht ta paraqes qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për standardizim. Arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për standardizim është adresimi i nevojës për përafrimin e Ligjit ekzistues për standardizim me Legjislacionin e BE-së në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, MSA-së, dhe Planit për Zbatimin për MSA.

Agjencia Kosovare e Standardizimit është i vetmi organ kombëtar i pavarur standardizues në Kosovë. Përgjegjës për plotësimin e nevojave të vendit për standardet teknike, që është mjet i fuqishëm për ngritje të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Agjencia Kosovare e Standardizimit është autoriteti shtetëror i nostrifikimit dhe pikë e referimit në Organizatën Botërore të Tregtisë për standarde siç kërkohet me marrëveshjet relevante ndërkombëtare. Me këtë projektligj parashihet që Agjencia Kosovare e Standardizimit mund të ofrojë shërbime tjera plotësuese për të përkrahur përdorimin dhe zbatimin e standardeve.

Këto shërbime përfshijnë trajnime, informacione dhe certifikime. Ky projektligj është në harmoni me aktet ligjore të BE-së në këtë fushë, respektivisht me Rregulloren 1025/2012, e cila ka hyrë në fuqi më 25 tetor 2012. Me harmonizimin e Ligjit për standardizim, me Rregulloren e BE-së 1025/2012, Agjencia Kosovare për Standardizim do t'i plotësojë të gjitha kërkesat dhe do të jetë në nivel të njëjtë me organizmat tjerë të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Përpos kësaj, avancimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë e ka ndikimin e vet praktik, reduktimin e barrierave teknike, si në tregun e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm.

Ky projektligj gjithashtu hap rrugë për implementimin e direktivave evropiane, të cilat rregullojnë fusha të ndryshme, duke marrë për bazë standardet e harmonizuara evropiane. Projektligji për standardizim është paraparë me programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associimit, planin e punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09/ 2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime shtesë buxhetore dhe opinioni i pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së.

Agjencia Kosovare e Standardizimit me këtë projektligj bëhet më funksionale dhe më e fuqishme në kumtimin e implementimit të standardeve, ngaqë standardet e adaptuara deri më tani nga agjencia nuk janë implementuar në shkallën e dëshiruar. Projektligji i standardizimit i zgjeron kompetencat e agjencisë për adaptim të standardeve për fushat e reja, të përfshira më herët, për ta rritur numrin e standardeve kosovare në nivel që kërkon BE-ja për vendet që pretendojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në organizimin dhe funksionimin e standardizimit në Kosovë, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Sala Berisha-Shala, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit. Zonja Berisha, fjala për ju.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar Haliti!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë dhe deputete,

Edhe unë para se të hyj për ta paraqitur rekomandimin, i them ministrit se është me rëndësi që po kuptohet se është fjala për një ligj të ri dhe jo për plotësim-ndryshim, sepse ky ligj disa herë u është nënshtruar plotësim-ndryshimeve dhe tani na vjen si ligj i ri.

Tani e kemi në rend dite Projektligjin për standardizim. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7. 11. 2017, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06 L-019 për standardizim.

Pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për standardizim, Komisioni ka vlerësuar se ky projektligj i plotëson kushtet e parapara të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Ju ftoj ta votoni dhe ju ftoj që vërejtjet dhe sugjerimet t'i paraqitni gjatë fazës së amendamentimit ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Molliqaj është paraqitur.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Projektligjin për standardizim, pas shqyrtimit që e kemi bërë në organet e Lëvizjes “Vetëvendosje”, e mbështetim në parim dhe do të votojmë për këtë ligj, për shkak se besojmë që është edhe i duhur edhe i mirë për fushën të cilën e mbulon. Kështu që e konfirmoj votën tonë për.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar projektligjin, në fakt është versioni të cilin e ka dorëzuar Kabineti i kaluar. Objektiv i këtij projektligji është krijimi i bazës së mirëfilltë ligjore për rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve dhe shërbimeve, shfrytëzimi racional i materialeve dhe energjisë, si dhe zvogëlimi i barrierave teknike në tregti.

Ligji është më se i nevojshëm edhe për shkak të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sepse synim i të gjitha institucioneve duhet të jetë ngritja e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, në mënyrë që ato të depërtojnë në tregjet e Bashkësisë Evropiane. Projektligji në masë të madhe e adapton Rregulloren e Bashkësisë Evropiane, e cila ka hyrë në fuqi pas aprovimit të këtij ligji, më 25 dhjetor 2012, andaj njëra nga arsyet shtesë ka qenë pikërisht edhe ky. Projektligji synon që ta fuqizojë rëndësinë edhe Agjencisë Kosovare të Standardeve si organ i vetëm vendor i standardizimit, i cili do të merret më pas, jo vetëm me miratim të standardeve, por edhe me implementimin e tyre në të gjitha format. Me këtë qëllim, unë po e përmend edhe projektin e Bankës Botërore, të cilin e ka hartuar Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e kaluar. Është një projekt prej 14,3 milionëve, i cili synon faktikisht që t'i ngrëjë kapacitetet në të gjitha agjencitë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që ato të arrijnë që ta ofrojnë shërbimin e certifikimit të produkteve dhe shërbimeve për standardet e cilësisë, por gjithashtu projekti duhet të përfundojë me anëtarësimin eventuale të Agjencisë së Standardeve në unionet simotra në Bashkësinë Evropiane.

Ne si grup do ta përkrahim ligjin në parim dhe do ta japim kontributin ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, zonja Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar Haliti!

Ministra,

Kolegë deputetë dhe deputete,

Edhe Grupi Parlamentar e ka analizuar dhe e ka shqyrtuar Projektligjin për standardizim dhe e mbështet në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për standardizim dhe e përkrah këtë projektligj, duke pasur parasysh rëndësinë e tij, ndërsa angazhimi i deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë në procedurat në vijim deri në leximin e dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Po, “Nisma për Kosovën” e mbështet edhe këtë ligj, pra Ligjin për standardizim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë e ka thënë fjalën e vet. Kemi thënë në orën 18:00 do ta bëjmë votimin, unë kisha kërkuar mirëkuptim që t’i shqyrtojmë edhe tri pika të rendit të ditës kështu telegrafikisht, që të na mbeten pastaj vetëm këto rekomandimet dhe votimet që i kemi për nesër. Nëse ka mirëkuptim.

Dua të ju njoftoj që ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, nuk është dhe e ka autorizuar ministren për Integritet, më duket edhe më është paraqitur, më ka thënë për ta njoftuar. Po e njoftojmë tash nëse është afër vjen.

Po vazhdojmë me pikën e 15 të rendit të ditës, ndërsa po i shtyjmë pikat 13 dhe 14, meqenëse s’kemi referues.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e ke fjalën.

Edhe njëherë i lus deputetët që nuk janë në sallë, ose janë afër diku, le të kthehen në sallë për të votuar. Faleminderit!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që ta paraqes para jush për shqyrtim Projektligjin për Noterinë. Nëpërmjet këtij projektligji kemi për qëllim ta avancojmë më tutje Legjislacionin e Noterisë, duke u mundësuar

noterëve kuadër ligjor të përshtatshëm për lehtësimin e punës së tyre, por krahas kësaj edhe rritjen e përgjegjësive të tyre, si dhe rritjen e llogaridhënies.

Nëpërmjet këtij projektligji qartësohen çështjet e përgjegjësisë së noterëve në raport me gjykatën, si dhe synohet zgjerimi i kompetencave të noterëve në zhvillimin e procedurës jokontestimore trashëgimore, rritjen e numrit të zyrtarëve noterialë nga 1 në 20 mijë banorë, sa është aktualisht, 1 në 10 mijë banorë. Mundësia që për një numër të caktuar të dokumenteve të hartuara nga palët apo përfaqësuesit të tyre, të kërkohet solemnizim tyre nga noteri.

Për noterët e rinj është paraparë edhe një trajnim tremujor i tyre pas emërimit dhe para fillimit të ushtrimit të detyrës së tyre, pra si noter. Është caktuar një masë sigurie, e cila ka të bëjë me transaksionet e paluajtshmërisë, kompetencë ekzekutive e noterëve, meqë çdo transaksion që ndërlidhet me paluajtshmërinë duhet ta ketë edhe vlerësimin e vlerësuesit të paluajtshmërisë.

Hartimi i këtij projektligji është bërë në konsultim me aktorët vendorë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë në asistencën teknike që kemi pas gjatë hartimit të këtij projektligji. Bazuar në rëndësinë dhe nevojën për avancimin e mëtutjeshëm të legjislacionit të kësaj fushe, të dashur deputetë, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj me këto plotësime-ndryshime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional. Nuk është. Zoti Hajdar Beqa, si zëvendëskryetar i parë, e keni fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përhëndetje për përfaqësuesit e Qeverisë,

Kolegë deputetë.

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14. 11. 2017, e shqyrtoi Projektligjin nr. 06 L-010 për Noteri dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim - të miratohet në parim Projektligji nr. 06 L-010 për Noterinë.

Vlen të theksohet se Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur, i ka ngrehur disa shqetësime nga anëtarët e komisionit, siç janë, për shembull: tarifa e noterëve, kriteret për noterë. Për shembull, shumica e shteteve e kanë edhe provimin e jurisprudencës, kurse në Republikë të Kosovës nuk është provimi i jurisprudencës. Ne e dimë që Kosova këtë shërbim e ka nga viti 2008. Nga viti 2008 deri në vitin 2012, do të thotë tre vjet ka qenë një tranzicion i ligjit, pastaj tash nga viti 2012 e kemi si shërbim efikas Noterinë dhe konsideroj që ky ligj ka vend për t'u plotësuar edhe nga deputetët, por edhe nga sponsorizuesi i ligjit.

Kontrolli apo inspektimi i noterëve, mosha e noterëve, kufizimi në aktivitete tjera, do të thotë këto janë disa paqartësi, zoti ministër, të cilat janë ngrehur në komision, megjithatë Komisioni

për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, para shqyrtimit të parë të projektligjit, në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim. Për këtë arsye ia rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Edhe nëse më lejohe, nënkryetar i Kuvendit, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Grupi i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për Noterinë të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit, respektivisht deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta aprovojnë në parim, kurse kontributin tonë si deputetë dhe si grup parlamentar do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ne kemi shqyrtuar Projektligjin për Noterinë dhe një pjesë e vërejtjeve u thanë, këto që i kemi identifikuar edhe ne, dhe ndër vërejtjet kryesore domethënë janë se Ministria e Drejtësisë deri tani ka dështuar në kontrollin e veprimtarisë së noterëve, dhe kjo nuk është rregulluar sa duhet, dhe ajo që është edhe më e rëndë është se për shkak të mungesës së këtij kontrolli kemi një numër të noterëve që janë arrestuar e akuzuar për marrëveshje të ndryshme, edhe kriminale.

Çështja e provimit të jurisprudencës nuk është rregulluar, ndërsa në anën tjetër noterëve u lejohe zgjidhja ose trajtimi i çështjeve që kalojnë edhe në kompetenca të gjykatave, dhe kjo për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” është e papranueshme. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” rekomandon që të abstenohej gjatë votimit të këtij projektligji dhe në leximin e dytë mandej, para se të nxirret para Kuvendit, të pranohen të gjitha vërejtjet që kanë të bëjnë dhe që janë në lidhje edhe me ligjet tjera, sidomos sa u përket kompetencave të noterëve, çështjet që i trajtojnë edhe sidomos duke marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe sociale në Kosovë, çmimet me të cilat punojnë noterët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Korab Sejdiu është paraqitur.

KORAB SEJDIU: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne mendojmë se Projektligji 06 L-010 për Noterinë i plotëson kushtet që të procedohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim në parim dhe në parim e përkrahim. Edhe pse duhet theksuar

se shumë nga ato vërejtjet që u theksuan edhe shumë të tjera janë ngrehu edhe gjatë shqyrtimit tonë në Grupin Parlamentar lidhur me këtë projektligj, duke filluar prej mbikëqyrjes së çështjes së numrit të noterëve, ushtrimit të profesionit, ankesat e qytetarëve, e kështu me radhë, sa u përket çmimeve e shumë gjëra të tjera, mirëpo thënë të drejtën ankesat janë shumë më të shumta me gjendjen aktuale dhe me Ligjin aktual të Noterisë, kështu që besoj me përkushtimin tonë edhe me vërejtjet tona, të cilat mund të procedohen si amendamente, do të kemi mundësi që këtë ligj ta përsosim deri në atë nivel që vërtet t'i shërbejë edhe profesionit të Noterisë, e aq më tepër edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Zoti kryesues!

Gjatë trajtimit në komision, përpos vërejtjeve, që i dhanë kolegët nga pozita dhe opozita, e kemi trajtuar edhe një rast që të rritet mundësia që ky numër të mos jetë një noter në 20 mijë banorë, por të bëhet në 10 mijë banorë. Nuk u theksua më herët, por edhe përpos vërejtjeve tjera që i kemi pasur në Komisionin për Legjislacion ishte edhe kjo. Andaj, si grup parlamentar e përkrahim dhe gjatë amendamentimit do t'i japim vërejtjet dhe sugjerimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe, zonja Jasmina Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Srpska lista vrlo pažljivo razmatrala Zakon o Javnom beležništvu, i kao jedan od zakona koji je vrlo važan i koji uređuje odnose u svakodnevnom životu i zakon koji utiče vrlo na svakodnevni život građana, obratili smo posebnu pažnju na sadržinu ovog zakona. I ono što je vrlo važno, ono što će Srpska lista tokom amendamentiranja zakona insistirati jeste na prisustvo predsednika Srpske zajednice u Komisijama za izbor, zatim na pravo na polaganje na Srpskom jeziku zapravo na jednom od službenih jezika ispita javno beležničkog, i da u svim komorama takođe koji su predviđena ovim zakona budu predsednici Srpske zajednice.

Znači u tokom drugog čitanje, zapravo pre drugog čitanja će amandmani biti predati. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Nisma", zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Projektligjin për Noterinë e kemi shqyrtuar në grup parlamentar dhe e mbështetim. Besojmë që në procesin e mëtutjeshëm gjatë dy leximeve do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Drita Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit! Sipas analizës që e kemi bërë sa i përket kësaj fushe i kemi dhënë disa prej vërejtjeve, të cilat duhet të plotësohen sa i përket këtij projektligji. Konkretisht është neni 4, paragrafi 1.5 dhe paragrafi 1.6. Te paragrafi 1.5 ku thuhet “ të ketë përvojë, konkretisht të ketë përvojë pune në fushën juridike së paku tre vjet”. Duhet të shtohet: “Personi i cili ka punuar si gjykatës duhet së paku të ketë një vit përvojë ose praktikë te noteri”. Detyrimisht këtu, për ta konkretizuar, është edhe institucioni ku duhet ta kryejnë përvojën, pra detyrimisht me qenë te noteri, të cilët janë të licencuar.

Pra, t’i shtohet këtij projektligji kjo që e ceka. Ndërsa, te paragrafi 1.6 “ta ketë të dhënë provimin për noter në Kosovë”, t’i shtohet “edhe provimin e jurisprudencës”. Arsyeimi është, sepse kur e ke të dhënë provimin e jurisprudencës, nënkuptohet se ka njohuri përkatëse në trashëgiminë dhe në civile, që nënkupton se vetëm provimi për noter nuk e lë të nënkuptojë që noterët e ardhshëm do të jenë produktivë.

Për ta forcuar këtë mendim duhet të futet edhe si propozim, që edhe noterët aktualë brenda afatit prej tre vjetëve ta përfundojnë provimin e jurisprudencës dhe ndryshimi te neni 2, paragrafi 4, duhet detyrimisht të bëhet: “Noteri nuk mund të vendosë për llojin e biznesit”. Pra, detyrimisht, çdo noter duhet të jetë si biznes individual në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, dhe kjo duhet të thuhet më saktë, të konkretizohet se jo çdo lloj biznesi mund të jetë biznese i ndryshëm. Pra, biznesi të jetë i konkretizuar dhe mendoj që edhe te neni 42, paragrafi 1, pika 1.8. duhet të hiqet detyrimisht, aty ku ceket “vlerësuesit e licencuar”. Duhet të hiqet kjo për arsye se bie në kundërshtim me vetë Ligjin e Noterisë dhe Ligjin për marrëdhëniet e detyruara.

Dhe, në fund, propozoj të ndryshohet edhe neni 8, paragrafi 4, të hiqet nga ligji dhe i njëjti të harmonizohet me praktikën e vendeve fqinja. Pra, sipas numrit të banorëve, të jetë edhe vëllimi, “përveç numrit të banorëve, të jetë konkret edhe vëllimi i punëve”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj, por është kërkesa që të shqyrtohet që të mos jetë një numër i caktuar, për arsye që noterët të mos jenë monopol, por nëse shtohet edhe numri i noterëve sigurisht që do të jenë edhe tarifatat më të pranueshme për qytetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë kthehemi te pika 13-të, por ministri ka kërkuar fjalën në emër të Qeverisë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Më duhet të ju njoftoj se gjatë kësaj kohe jemi në themelimin e sipër të departamentit që do të merret me mbikëqyrjen e profesioneve të lira dhe më konkretisht me mbikëqyrjen e punës së noterëve dhe si ministër i Drejtësisë do të ju ftoj juve dhe në veçanti Komisionin për Legjislacion që së bashku ta hartojmë organogramin e kësaj zyre, në mënyrë që ta rritim llogaridhënien dhe efikasitetin e punës së noterëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Atëherë siç ju thashë edhe më herët, e kemi një njoftim për arsye se ministri i Punëve të Brendshme, zoti Flamur Sefaj, ndodhet në udhëtim zyrtar, ju njoftoj se prezantimi i dy projektligjeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Projektligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, pika e 13-të e rendit të ditës, dhe Projektligji për Infrastrukturën kritike, pika e 14-të e rendit të ditës, do të bëhet nga zonja Albena Reshitaj, ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Faleminderit!

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / I-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren zonjën Albena Reshitaj që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. E keni fjalën, zonja ministre!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Meqë është hera e parë që e marr fjalën para jush, më lejoni të ju uroj të gjithë juve të pranishëm këtu, të gjithë shqiptarëve kudo që janë brenda dhe jashtë trojeve shqiptare 105-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe njëherësh ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari, si dhe daljen në skenë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Projektligji është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, në pajtim me Kushtetutën dhe me Legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me Legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon disa përkufizime, shprehje të përdorura, të drejtat themelore të njeriut me rastin e kalimit të kufirit, korsitë e veçanta, informatat mbi shenjat dhe vendosjen e vulës katrore në dokumentet e udhëtimit gjatë kryerjes së kontrollimit kufitar të hyrjes dhe daljes nga Republika e Kosovës, si dhe lehtësimin e kalimit të shërbimeve emergjente në pikën kalimtare kufitare. Ndryshim-plotësimi i këtij projektligji është paraparë me masat legjislative afatshkurtra në kuadër të planit për zbatim të MSA-së, përkatësisht në kuadër të objektivave, Kapitulli i 24-të i “acquis” të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj e ka transpozuar Rregulloren 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datës 9 mars 2016, për krijimin e një kodit të unionit për rregullat që e rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve. Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat përkatëse, opinioni për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe opinioni ligjor i përputhshmërisë me Legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integritimit Evropian.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, më duket se zoti Shala nuk është këtu. E zëvendëson dikush? Po, zoti Xhelal Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2017, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Ky projektligj ka për qëllim inkorporimin e Legjislacionit të ri të BE-së për rregullat që e rregullojnë lëvizjen e personave, për të drejtat themelore, korsitë e veçanta dhe informata për shenja, vula dhe vendosja e tyre, si dhe lehtësimi i kalimit të shërbimeve emergjente.

Prandaj, në emër të komisionit i ftoj deputetët ta miratojnë në lexim të parë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, ky projektligj pati ardhur edhe në Legjislaturën e kaluar, por për shkaqe të zgjedhjeve të parakohshme ka kaluar dhe në këtë Legjislaturë dhe edhe në atë kohë Komisioni për Punë të Brendshme, respektivisht edhe grupi ynë parlamentar e patëm shteruar si të thuash këtë temë.

Por, duke e parë edhe një herë prej këtij pozicioni dhe duke e parë edhe problematikën që e trajton ky ligj, atëherë unë mendoj që ndërmjet dy leximeve, Komisioni për Punë të Brendshme, respektivisht grupi punues i cili do të formohet do të ketë punë dhe besoj që do të kalojmë edhe përtej kufijve ndoshta të pritur të amendamentimit të kësaj. Po i përmend disa problematika për shkak se në këtë rast është projektligj, i cili ka të bëjë me kontrollin e kufirit shtetëror, por gjithsesi edhe tematikat aktuale na kanë dhënë shumë më shumë që ne të kemi kujdes dhe t'i trajtojmë këto problematika që kanë të bëjnë me kufirin. Kjo ndoshta do të dukej në plan të parë si diçka teknike, por përveç përmbushjes së direktivave të Bashkimit Evropian që ne i kemi pothuajse të gatshme të amendamentuara këto nga Legjislatura e kaluar, do të shohim edhe përtej kësaj dhe mendoj që Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta japë kontributin e vet në komision, respektivisht në grupin punues i cili do të formohet nga komisioni në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Vërejmë që ky projektligj ka për qëllim përafrimin me Rregulloren e BE-së nr. 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016, për krijimin e një Kodi të Unionit për rregullat për lëvizjen e personave përtej kufijve, që ndërlidhet me Kodin e Kufijve Shëngen, mandej të drejtat themelore, korsi të veçanta dhe informata të ndryshme, vulat dhe vendosja e tyre, lehtësimin e kalimit të shërbimeve emergjente dhe çështje të tjera.

Ne vërejmë se ky ligj është i rëndësishëm së veçantë për ta përafruar Kosovën me BE-në, prandaj si Grup Parlamentar i LDK-së do ta mbështetim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zoti Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me kujdes plotësim-ndryshimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit dhe besoj se do ta japë kontributin e vet në grupin punues në komision, që ky ligj të përafrohet me direktivat e Bashkimit Evropian dhe krijimin e një kodi unik për mënyrën e qarkullimit, lëvizjes dhe shenjëzimit të vijave kufitare, por edhe

problematikat tjera që shkojnë me këtë ligj, në mënyrë që të jetë i përafërt me legjislaturën e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Fatmir! Lista serbe nuk është paraqitur. Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Projektligjin për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, së paku ky ligj e plotëson një standard, ai është standardi i Glaukut, e ka gjatësinë e emrit dhe e qartëson edhe fushën.

E përshëndesim Glaukun dhe në vërejtjet që u bëri edhe ligjeve tjera, se vërtet kemi pasur sot ligje me emërtime shumë të shkurtra.

Po ashtu, ne do ta përkrahim në parim këtë ligj, por kemi vërejtje apo mendojmë se ky ligj është i ngarkuar me elemente të cilat mund të rregullohen edhe me akte nënligjore, sidomos neni 11, shtojca 1 dhe 2. Por, do ta japim kontributin tonë gjatë leximit të dytë, pra në komplet procesin deri në miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Meqë shoku Haxhi nuk është këtu, unë kam qenë në legjislaturën e kaluar në këtë komision, është ligj i rëndësishëm së veçantë dhe natyrisht se ne do të kontribuojmë siç kemi kontribuar edhe deri më tash në këto ligje. Edhe Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror është me rëndësi.

Pajtohem me Blerimin, në mungesë të profesorit Sabri Hamiti, ne tani po kemi disa telashe këtu me emërtime të ligjeve, e edhe më vonë do të kemi, për shkak të paqartësisë. Glauku po mundohet me profesorin Sabri, po ja që profa me më shumë vëmendje i ka shikuar këto gjëra dhe unë po mendoj, për të mos e zgjatur, se ky ligj i plotëson krejt kriteret dhe natyrisht do të ndihmojmë edhe ne me ndihmë shtesë, që të jetë më adapt për fushën që mbulon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Këtë sustën e kam prekur para se të flasim ata dy, kështu që nuk ka të bëjë fare me replikë.

Prapë po dua të flas për ligjin, por kësaj radhe jo për emrin, se emri është i mirë. Por, është një ligj shumë i rëndësishëm, në të cilin duhet të kemi kujdes me terminologjinë, ma merr mendja,

për shkak se konceptet dhe kategoritë që përdoren këtu, meqenëse kemi të bëjmë me çështjen e kufijve dhe të qarkullimit nëpër kufij të njerëzve dhe të mallrave, besoj se sidomos sa u përket njerëzve, ma merr mendja që nuk janë standardizuar termat që përdoren për kategorinë e individëve që kalojnë nëpër kufij.

Meqë, kur arrin në kufi dokumenti kryesor nëpërmjet të cilit ti kalon është qoftë pasaporta, apo letërnjoftimi, atëherë aty ti definoresh si shtetas i Republikës së Kosovës. Në këtë sektorin e modeleve, pra të cilat i paraqesin këto shenjat e kalimeve kufitare, sa i përket emërimit shqip këta janë “shtetas” dhe është në rregull kjo. Ja ku e keni këtu “shtetasit e Kosovës”, këtu te pika ku kalohet, mirëpo serbisht e kemi “qytetarët”, “Qytetarët” dhe “shtetasit”! Shqip “shtetasit”, serbisht “qytetarët”.

Unë mendoj se edhe për serbisht duhet të jetë “shtetasit”. Nuk e di a ka pasur dikush problem me shtetësinë e Kosovës në këtë rast dhe ka bërë një ndërhyrje këtu, që të mos prejudikohet shtetësia e Kosovës në kufijtë e Kosovës, ama unë mendoj që është shumë me rëndësi që edhe serbisht të jetë “shtetasit”, e jo që të ketë dallim në shqip dhe serbisht. Pra, në shqip të jetë vetëm për neve “shtetasit”, kurse për serbët të jetë vetëm “qytetarët”.

Besoj që kjo duhet të përmirësohet. Nuk e di, ndoshta Albena... Më mirë sikur të ishte ministri, sepse ai ndoshta ai, meqenëse është marrë me çështjen drejtpërdrejt, do të mund të na shpjegonte më në hollësi qysh kanë ardhur deri te këta terma. Mirëpo, i konsultova edhe disa njerëz që e njohin shumë më mirë serbishten, nuk është kjo kategoria e qytetarëve e barabartë me shtetasit. Më duket që “državljeni” është për “shtetasit”. Kështu që kërkoj që kjo të përmirësohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që gjatë amendamentimit secili mund ta shqyrtojë dhe të bëjë amendamente. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Po, është vërejtje parimore. Këtu duhet të kujdeset Zyra për Standardizim e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Por, sido që të jetë, po qe se ka dikush problem me interpretimin ligjor, atëherë vlen gjuha shqipe. Gjuhët tjera janë vetëm për përdorim zyrtar të personave që jetojnë me të drejta të barabarta në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Po kalojmë në pikën e katërbëdhjetë, pastaj do të futemi në votim.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për infrastrukturën kritike

Në bazë të nenit 56 të rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren Albena Reshitaj që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA ALBENA REXHITAJ: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për infrastrukturë kritike.

Në këtë projektligj janë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike, kombëtare dhe evropiane, mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës, parandalimin e incidenteve dhe minimizimin e dëmit potencial për infrastrukturën kritike, pasurinë e përgjithshme, humbjet ekonomike dhe sociale, sigurinë dhe stabilitetin e Qeverisë, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë.

Qëllimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për ta propozuar këtë nismë ligjore është se Projektligji për infrastrukturën kritike do ta rregullojë infrastrukturën kritike kombëtare të Republikës së Kosovës dhe ofron udhëzime për identifikimin e infrastrukturave, që do të përcaktohen si infrastrukturë kritike evropiane.

Gjithashtu, ky projektligj identifikon sektorët dhe kriteret e infrastrukturës kritike, kombëtare dhe evropiane, dhe ofron udhëzime për menaxhimin e tyre, duke përfshirë analizën e rrezikut, karakteristikat e planeve të sigurisë për pronarët apo operatorët, rolet dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të sigurisë së infrastrukturës kritike, si dhe gjobave për moszbatim.

Zhvillimi i kornizës ligjore për identifikimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike është paraparë në planin e veprimit për zbatimin e planit të Qeverisë 2015/2018, më saktësisht në objektivin 2.13 luftimi dhe parandalimi kundër terrorizmit. Kështu është e lidhur ngushtë me prioritetet e Qeverisë për t'i ndërtuar masat kundër sulmeve terroriste, që rrezikojnë nga ekstremistët e dhunshëm dhe si e tillë është e lidhur drejtpërdrejt me strategjinë kombëtare kundër terrorizmit dhe planin e reagimit kombëtar.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, si dhe faktin që infrastruktura kritike është e vendosur në tërë Republikën e Kosovës, çfarëdo sulmi terrorist apo fatkeqësi natyrore mund të shkaktojë pasoja në gjithë territorin, kërkoj nga ju miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Reshitaj! Tani vazhdojmë me fjalën e përfaqësuesit të komisionit, zoti Sveçla. Zoti Sveçla e keni fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, konform Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor, e shqyrtoi në parim Projektligjin për infrastrukturën kritike.

Ky projektligj vlerësohet i rëndësishëm për faktin se e rregullon infrastrukturën kritike kombëtare të Republikës së Kosovës dhe identifikon sektorët dhe kriteret e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane dhe ofron udhëzime për menaxhimin e tyre, duke përfshirë analizën e rrezikut, karakteristikat e planeve të sigurisë për pronarët, operatorët, rolet dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të sigurisë së infrastrukturës kritike, si dhe gjobat për moszbatim.

Prandaj, në emër të komisionit i ftoj deputetët ta miratojnë në lexim të parë Projektligjin për infrastrukturën kritike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zoti Selimi apo zonja Drita Millaku. Zonja Drita Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Të nderuar deputetë,

Projektligji për infrastrukturë kritike është një projektligj shumë i nevojshëm dhe emergjent për nga rëndësia dhe për nga nevoja, i cili hyn në ligjet të cilat e forcojnë bazamentin e sigurisë kombëtare. Si diçka e tillë duhet trajtuar me seriozitet të madh dhe me një nguti, me qëllim të daljes të një ligji sa më të dobishëm dhe sa më cilësor, duke e dhënë kontributin e duhur për këtë gjë nga të gjithë ne.

Kosova deri më tani nuk ka mundur ta trajtojë me ligj një temë të tillë, pasi qeveritë tona e kanë neglizhuar duke i dhënë një vend të gabuar një problematike kaq serioze dhe kaq të rëndësishme për sigurinë kombëtare dhe mirëqenien e qytetarëve në këto rrethana të sigurisë. Në rajon dhe në aspektin global, Qeveria jonë me nguti do të duhej të mendonte për një veprim të shpejtë në këtë drejtim, andaj do të doja që Ekzekutivi ynë t’i hapë sytë dhe të mendojë me emergjencë kur janë në pyetje gjërat serioze si kjo, dhe e ngjashëm.

Në qoftë se shihet gjendja e infrastrukturës kritike kombëtare, ajo është në një gjendje pa përkujdesje dhe në kuptimin e mbrojtjes ligjore të ligjeve pozitive, pasi nuk ka seriozitet nga ata që janë thirrur për ta mbrojtur apo siguruar atë, pasi ata të cilët e kanë për detyrë këtë janë aty për ta dhënë kontributin e vet në këtë drejtim, por këtë e marrin si privilegj dhe kjo praktikë do të duhej të përfundonte njëherë e mirë.

Unë mendoj që në këtë ligj duhet të parashihet përgjegjësia penale, jo vetëm disiplinore e personelit që është ngarkuar për ta identifikuar dhe kontrolluar sigurinë e planifikimit të planeve për siguri. Gjithashtu, mendoj se pjesa e cila ka të bëjë me gjobat është e butë dhe ajo duhet të

ashpërsohet për aq sa do të lejonte aspekti ligjor, gjithmonë duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe rëndësinë e infrastrukturës.

Siç jeni në dijeni, shumë nga kjo infrastrukturë është keqpërdorur, keqmenaxhuar, uzurpuar, privatizuar dhe ka shumë raste të tilla, si për shembull rasti i privatizimit, uzurpimit, shpronësimit, apo nuk di si ta cilësoj ndryshe, i Hekurudhës në Prizren. Rasti në të cilin është përfshirë një grup klanor i stilit mafioz, e ku objekt duhet të jetë Komuna e Prizrenit për veprim, pra vendim antiligjor, Prokuroria dhe gjykata për mosveprim, të shtyrë nga militantët e PDK-së dhe mafia ndërtimore në Prizren.

Kemi edhe shumë raste të tjera në Prizren, por besojmë që tani me qeverisjen e Mytaher Haskukës të gjithë do të japin llogari. Një shembull tjetër, një rast është edhe Stacioni i Hekurudhave në Drenas, që është kthyer në hotel dhe me këtë nuk është marrë as Prokuroria, as gjyqësia, por as vetë Komuna. Mendojmë se Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta shfrytëzojë ekspertizën e Republikës së Shqipërisë dhe kjo do të duhej të krijonte standarde, sidomos për çështje të ndjeshme si kjo. Pra, asnjëherë ne nuk do të duhej ta neglizhoni për asnjë arsye që të bashkëpunoni me Shqipërinë për çështje të tilla, pasi ne duhet të shohim në drejtim të integritetit të shumë aspekteve, e sidomos të çështjeve të kësaj natyre. Por, kjo pasurohet me njohurinë e shteteve mike evropiane dhe perëndimore, me qëllim që ky ligj të zbatohet profesionalisht.

Pra, mendojmë që këtë ligj duhet patjetër ta koordinojmë në bashkëpunim të ngushtë me Republikën e Shqipërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së Armend Zemaj, ose zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerëson se ky projektligj është i rëndësishëm së veçanti, pasi i trajton çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane, mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës, parandalimin e incidenteve dhe minimizimin e dëmit potencial për infrastrukturën kritike, mandej pasurinë e përgjithshme, humbjet ekonomike dhe sociale që mund të ndodhin në sigurinë, stabilitetin e Qeverisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë.

Mendojmë se edhe ky ligj është kritik për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me BE-në, por në veçanti për sigurinë e qytetarëve në vend. Rrjedhimisht, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta mbështesë këtë projektligj në parim. Kemi disa vërejtje, sugjerime, që do të mundohemi t'i inkorporojmë gjatë dy leximeve, në veçanti sa i përket rolit të sektorit privat në rastet kur sektori

privat operon me infrastrukturë kritike, ta zëmë tek ushqimet, furnizimi me karburante dhe disa çështje të tjera, si dhe disa vërejtje që i kemi te neni 21 që lidhen me masat ndëshkimore, për të cilat besoj se deputeti Zemaj do të flasë më konkretisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Fadil Bekaj e ka fjalën.

FADIL BEKA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për infrastrukturën kritike dhe konsideron që ky projektligj është i një rëndësie të veçantë dhe si të tillë ne do ta mbështetim në parim dhe kontributin do ta japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Projektligjin në fjalë grupi ynë parlamentar do ta votojë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Po, tash në emër të Haxhiut, unë po e marr fjalën. Edhe Grupi Parlamentar i “Nismës” e mbështet edhe këtë ligj në lexim të parë, ashtu siç i ka mbështetur të gjitha ligjet që i kemi diskutuar sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti, Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Për nevojën e këtij ligji normalisht që mund të flasim edhe sot, por duke e parë që ekziston një infrastrukturë e ligjeve të tjera, atëherë ky ligj del shumë i nevojshëm, që ta përmbyllë njëfarë cikli. Pra, është njëra prej hallkave të këtij cikli të nevojshëm, që infrastruktura jonë kritike pastaj të jetë e mbrojtur.

Është mirë që ky të ishte shumë më herët dhe të bëhej paralelisht edhe me ligjet tjera. Po i përmend disa ligje: Ligji për Policinë, Ligji për kompanitë private të sigurisë, Ligji për armët e tjera, ku në mungesë të këtij ligji, që sot e kemi si projektligj, ka mbetur gjithë kjo infrastrukturë edhe e palistuar, po ka mbetur edhe e pambrojtur. Unë mendoj se ky projektligj në momentin kur të bëhet ligj do ta ketë një impakt shumë të mirë në përmbylljen e krejt këtij cikli dhe mendojmë

se infrastruktura kritike e Kosovës, pastaj edhe në harmoni me ligjet e tjera do të jetë shumë i mbrojtur.

Kështu që është shumë i mirë dhe mendoj që grupet parlamentare do të kontribuojnë që në grupin punues ta japin kontributin maksimal, por sa më shpejt që ky projektligj të bëhet ligj do ta plotësonte këtë infrastrukturë dhe infrastruktura kritike e Kosovës do të ishte shumë më e mbrojtur. Të mos harrojmë, bëhet fjalë jo vetëm për hekurudhat, bëhet fjalë për objekte të veçanta, bëhet fjalë për diga, bëhet fjalë për..., edhe për institucione tjera shtetërore. Kështu që do ta ndihmonte edhe Policinë që ta kishte shumë më të qartë dislokimin edhe të forcave të veta, ose në këtë rast dislokimin në kuptimin e kundërt, sepse ne e dimë që shumë policë i kemi të angazhuar në mungesë të këtij ligji në mbrojtje të infrastrukturës dhe shumë pjesë tjera të infrastrukturës kritike nuk janë të mbrojtura.

Prandaj, edhe një herë po dua t'u jap kolegëve të mi rëndësinë për miratimin e një ligji të tillë që ta japin kontributin maksimal për ta miratuar një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Është evidente që kur të kemi legjislacion të ri edhe mënyra, të mos e quaj e kopjimit që bëhet dhe të përgatitja e infrastrukturës ligjore kërkon edhe vëmendje për të mos lënë zbrazëti, sepse është i rëndësishëm së veçantë dhe sidomos që ka të bëjë me masat ndëshkuese dhe organet mbikëqyrëse të saj.

Te neni 21, besoj që te masat ndëshkuese duhet të parashihet organi i cili, tash nuk e kemi ministrin këtu, dhe besoj që ministrja nuk mund të japë përgjigje, por kjo duhet të rregullohet me amendament, sepse nuk flet nëse e rregullon ndonjë inspektorat në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre kritereve dhe ajo që është e domosdoshme dhe që i mungon këtij ligji është dispozita për zbatueshmërinë e këtij ligji, që ka të bëjë me nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse vetë neni 2 te fushëveprimi ka të bëjë me identifikimin e sektorëve dhe kritereve të infrastrukturës kritike kombëtare dhe kjo domosdoshmërisht duhet të mbulohet me aktet nënligjore për zbatueshmërinë e plotë të këtij ligji.

Personalisht do të kontribuoj që t'i kemi dy amendamente shtesë, që do t'i ofrojnë Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri që ky ligj të jetë i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konstatoj që sipas planit që e diskutuam kemi ardhur deri te pika e 15-të. Nga pika e shtatë e kemi votimin, të tjerat i kemi kryer.

7. Projektligji për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë e Kosovës

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Në sallë janë 71 deputetë. Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 69 deputetë. 53 janë për, kundër asnjë, kanë abstenuar 16 deputetë.
Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 67 deputetë. 39 për, 13 kundër, 15 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-04 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore

Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Diskutimi është kryer. Votojmë tani!

Kanë votuar 68 deputetë. Për janë 53 deputetë, kundër asnjë, kanë abstenuar 15 deputetë.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurë jokontestimore.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Atëherë, e kemi shteruar diskutimin, kërkohet votimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në rregull, atëherë nuk kalon... s'ka kuorum dhe presim kur të ketë kuorum për të votuar.

Pika e njëmbëdhjetë... Urdhëro! Unë e kthej për ju, por në qoftë se s'doni të votoni... se kot nuk është ndonjë pikë që ku ta di çka ndikon në procedurat dhe proceset tona. Kur të vijë koha, mos i votoni disa të tjera që janë më interesante...

Atëherë votojmë edhe një herë. Votojmë tani!

E paskemi një pa kartelë. Atëherë, 60 vota me kartelë, një pa kartelë bëjnë 61, për kanë votuar 47, kanë abstenuar 13.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-09 për ndërmjetësim.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Të nderuar deputetë, diskutimet janë kryer. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Votojmë tash!

Atëherë votojmë edhe një herë. Lus regjinë dhe deputetët ta përsërisin votimin. Votojmë tash!

Atëherë, nuk ka kuorum. 59 veta kanë votuar.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizim

Diskutimet kanë përfunduar. Përgatitemi për votim. Votojmë tani!

Njëjtë është, 58 vota. Nuk ka kuorum.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-112

Votojmë tani! Prapë kemi 59 vota. Nuk ka kuorum.

Veç dua të ju them diçka. Në parlamentet serioze, kur deputetët janë në sallë llogaritet kuorum. Ata që nuk votojnë s'prish punë hiç. Shumica e votave e miraton ligjin, por ne i kemi ato vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që na i ka ngatërruar punët dhe... kalojmë...

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për infrastrukturën kritike

Diskutimi ka përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

59 janë. Sërish s'ka kuorum.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë

Diskutimet kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!
Faleminderit!

59 deputetë kanë votuar. Nuk e kemi kuorumin e duhur.

Vazhdojmë nesër në orën 11:00. Mirupafshim!

* * *

E enjte, më 30 nëntor 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23, 24, 29 nëntor

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,
Po fillojmë vazhdimin e seancës së djeshme.
Kemi ngelur te pika e gjashtëmbëdhjetë:

16. Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Ne nuk e kemi akoma kuorumin e duhur për të votuar, së pari dhe për të diskutuar. Unë mendoj që të fillojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë, e cila ka hapësirë dhe ka mundësi të fillojmë me raportin dhe pastaj t'i kthehemi kësaj pike, po duhet pasur kuorum për të votuar.

Në qoftë se doni, ne e fillojmë menjëherë, unë nuk e kam atë problem, nuk po them ta shtyjme për një ditë tjetër, po them ta shqyrtojmë pikën e shtatëmbëdhjetë dhe pastaj mund të bëhet kuorumi i duhur, sepse besoj që ka edhe të tjerë të interesuar për të debatuar për këtë çështje.

Megjithatë, nëse doni, e fillojmë, 55 deputetë i kemi në sallë. Unë mendoj që është më mirë të fillojmë me pikën 17 dhe pastaj i kthehemi pikës 16.

Po më duket që është njëfarë gatishmërie për ta aprovuar propozimin tim që të mos e nxjerr në votim.

17. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Abdixhiku, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin dhe rekomandimet. Zoti Abdixhiku, e keni fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet,

Të nderuar deputetë,

Banka Qendrore e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ia ka dorëzuar Kuvendit raportin vjetor të punës për vitin 2016 brenda afatit ligjor.

Raporti i BQK-së ofron të dhëna për gjendjen ekonomike në përgjithësi, përfshirë edhe sektorin real, sektorin fiskal, sektorin e jashtëm dhe sektorin financiar.

Përveç kësaj raporti përmban shërbimet e siguruar për autoritetet dhe komunitetin financiar si dhe publikun, si dhe për zhvillimet e brendshme dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë nga BQK.

Në bazë të të dhënave të pasqyruara në raport shihet se në vitin 2016 ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritjen e aktivitetit ekonomik kundrejt vitit paraprak.

Sipas vlerësimeve të BQK-së, norma reale e rritjes së bruto-produktit vendor ishte 3,4% në vitin 2016.

Rritja ekonomike e vitit 2016 u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, përderisa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike.

Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara rezultoi në zvogëlimin e shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksportin në 11.1%.

Vlera gjithsej e remitencave në vitin 2016 ka arritur në 691 milionë euro, pra ka një rritje vjetore prej 3,8%.

Kategoria e investimeve të huaja direkt në vitin 2016 ishte 215,9 milionë euro, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vitin paraprak, që ishin 308,8 milionë euro.

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë në vitin 2016 është karakterizuar me një rritje mesatare prej 0,3%.

Eksporti në vitin 2016 arriti vlerën prej 309 milionë euro, që përkon një rënie vjetore, rënie të eksporteve prej 4,8%.

Rënia e vlerës së eksportit të mallrave kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, rënies së prodhimit të nikelit si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare.

Ndërsa vlera gjithsej e importeve në Kosovë arriti 2,8 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5,9%.

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 79,7% të gjithsej detyrimeve.

Vlera gjithsej e depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2,9 miliardë euro në vitin 2016, që paraqet një rritje vjetore prej 7,2%.

Normat e interesit në kredi gjatë vitit 2016 shënuan rënie më të theksuar.

Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 7,2%, ndërkaq norma mesatare e interesit në depozita arriti në 1,2%.

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2016 shënuan rritje vjetore prej 5,9%, duke arritur vlerën prej 161,8 milionë eurove.

Për fund, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë raport të Bankës Qendrore dhe ka vlerësuar se i njëjti është gjithëpërfshirës dhe përmban të dhëna dhe informata që kërkohen me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë.

I nderuar kryesues, a mund të shpreh edhe mbështetjen në emër të LDK-së.

Atëherë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e japim mbështetjen për raportin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, dëshiron dikush të diskutojë? Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, edhe ne pajtohemi që paraqet në mënyrë të saktë sektorin të cilin e rregullon, pra industri të cilat në këtë Republikë pothuajse tash e 15 vjet janë në një kontroll të mirë.

Në anën tjetër, gjithashtu shpërfaq edhe nevojën për një qasje më aktive sa i përket orientimit dhe kredihënies që e japin bankat. Mendoj që këtu Banka Qendrore mund të luajë një rol të rëndësishëm, sido që të jetë, raporti në vete paraqet në mënyrë të saktë dhe të mirë sektorët të cilat i rregullon kjo bankë.

Ne si grup parlamentar do ta përkrahim këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe kemi ardhur në përfundim se Banka Qendrore e Kosovës ka përmbushur detyrën ligjore, duke afruar raport të përgatitur mirë dhe sipas kërkesave të Ligjit për bankën.

Nga analiza e raportit vjetor vërejmë se Banka Qendrore ka një performansë të mirë, ka kryer funksionin e saj mbikëqyrës, ka kontribuar në promovimin e stabilitetit ekonomik dhe financiar në vend, ka kontribuar në krijimin e një ambientit të përshtatshëm për rritjen ekonomike.

Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4,1% si rezultat i rritjes së konsumit për 3% dhe investimeve për 9,1%.

Sipas raportit, aktivitetet kredidhënëse të sektorit bankar kanë pasur ndikim në financimin e rritjes së aktivitetit të sektorit privat.

Rritja ekonomike gjatë vitit 2016 ishte edhe si rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e bujqësisë, tregtisë dhe aktiviteteve financiare.

Sipas raportit, numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vitin 2016 ishte 10 mijë e 424 ndërmarrje, 592 ndërmarrje me shumë se në vitin 2015.

Në sektorin e tregtisë u regjistruan 2 738 ndërmarrje të reja, në sektorin e prodhimit 1 181, në bujqësi 1 090, në hoteleri 1 017 ndërmarrje, ku vërehet se në sektorin e bujqësisë ka pasur më së shumti ndërmarrje të regjistruara, prej 145 më shumë krahasuar me vitin 2015.

Është në interes të zhvillimit ekonomik të vendit rritja dhe zhvillimi i sektorit privat, ku një rol të rëndësishëm në këtë drejtim do të ketë trendi i uljes së mëtejme të normave të interesit për t'i dhënë mundësi rritjes së prodhimit të brendshme, për të ulë papunësinë e madhe dhe disbalancën e madhe ndërmjet eksportit dhe importit.

Në institucionet e Republikës së Kosovës në vazhdimësi është punuar për të gjetur mënyrën më të mirë për të përkrahur sektorin privat. Janë hartuar ligje dhe janë nxjerrë udhëzime administrative.

Nuk them se nuk ka të arritura në këtë drejtim. Mirëpo institucionet duhet të bëjnë më shumë në krijimin dhe lehtësimin e mundësive për të rritur këtë sektor dhe për të bërë atraktiv për të punësuarit.

Mosrespektimi i Ligjit të punës ka bërë që ky sektor të mos jetë tërheqës për të punësuarit aty.

Shkelja e të drejtave të tyre ka bërë që armata e të papunëve të orientohet drejt sektorit publik, sepse nuk e shohin perspektivën e tyre në sektorin privat.

Biznesit duhet t'i krijohet dhe lehtësohen mundësi për t'u rritur dhe për të hyrë në sistem, sepse kështu krijohet mundësia për rritjen e prodhimit brendshëm që reflekton uljen e deficitit tregtar dhe uljen e papunësisë së madhe, me të cilën përballemi ne si Kosovë.

Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e shtuar e prodhimit në vend ende mbetet e ulët, kurse rritja e kërkesës së brendshme ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të importit.

Ritmet e larta të deficitit tregtar e pengojnë arritjen e një norme më të lartë të rritjes ekonomike.

Mbulueshmëria e importeve me eksporte është vetëm 11,1% krahasuar me vitin 2015, që ishte 1,2%

Bazuar në këtë situatë Qeveria duhet të rishikojë politikat e saja zhvillimore. Se cilat do të jenë politikat strategjike të Kosovës për të ulur disbalancën e madhe në mes të eksporteve dhe importeve, janë çështje që imponojnë nevojën për analizë nëpërmjet vendosjes së dialogut ndërinstitucional për të gjetur modelin më të mirë për zhvillim ekonomik të Republikës së Kosovës, për të krijuar mundësinë për implementimin e politikave ekonomike që promovojnë rritjen ekonomike në afate të gjata në përputhje me integrimin ekonomik rajonal si dhe në përputhje me obligimet që vijnë nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim përballë procesit të globalizimit, e ku Banka Qendrore e Kosovës luan një rol shumë të rëndësishëm.

Edhe gjatë vitit 2016 deficiti i madh në llogarinë rrjedhëse për vite të tëra mbulohet nga remitencat, të cilat kanë qenë më të larta për 3,8%, duke arritur vlerën prej 691 milionë eurosh.

Qeveria duhet t'i qaset më seriozitet kapitalit që vjen nga diaspora, në mënyrë që të reflektojë ky kapital në zhvillimin ekonomik të vendit dhe, në anën tjetër, të përfitojnë edhe bashkatdhetarët tanë.

Rënia e investimeve të huaja nga 308,8 milionë në 215,9 milionë, pra 92,9 milionë më pak, është një sinjal i fuqishëm për t'iu qasur më me seriozitet stabilitetit politik dhe shifrave të larta të informalitetit, dukurive të tjera negative, në mënyrë që Kosova të bëhet vend atraktiv për investime të huaja direkte, të cilat mund të sjellin deri te zhvillim ekonomik.

Sektori financiar, sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore, ka performuar suksesshëm gjatë vitit 2016.

Profiti i realizuar në këtë sektor është 75,5 milionë, kurse treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është 19%, që tregon performansë të mirë të sektorit bankar.

Rreziku kreditor shihet se është zvogëluar, nisur nga fakti se pjesëmarrja e kredive joperformuese në raport me gjithsej kredi është 4,9%.

Kreditë në bankat komerciale kanë pasur rritje për 10.4%, kurse norma e interesit të kredive ka qenë 7,2%, depozitat kanë pasur normë të interesit 1,2%.

Të nderuar deputetë,

Dua t'i theksoj edhe dy çështje, të cilat kërkojnë zgjidhje më të shpejtë në interes të qytetarëve tanë.

Çështja e parë ka të bëjë me sektorin e mikrofinancave, i cili ka pasur rritje të aktivitetit kredidhënës.

Vlera e aseteve të këtyre është rritur në 148,2 milionë euro, çka do të thotë që ka pasur rritje vjetore prej 23,7%.

Këto institucione që ende veprojnë si OJQ me status të organizatës joprofitabile dhe nuk paguajnë tatimin në fitimin e realizuar, kanë arritur të dyfishojnë profitin e tyre nga 2,4 në 4,1 milionë euro.

Mikro-financat u japin kredi kryesisht ekonomive familjare me normë shumë të lartë të interesit prej 21,3%.

Fushëveprimtaria e këtyre institucioneve ka mbetur e parregulluar, në mungesë të ligjit që rregullon funksionimin e tyre. Është e pakuptueshme mosgatishmëria e institucioneve dhe reagimet e OJQ-ve sa herë merret një nismë për të rregulluar me ligj fushëveprimtarinë e këtyre institucioneve. Duke u dhënë mundësi që të vazhdojnë të realizojnë profit dhe të mos paguajnë tatim dhe duke vazhduar kështu të dëmtojnë kategorinë e varfër të shoqërisë tonë me dhënien e kredive me kamata shumë të larta.

Çështja e dytë që dua ta ngre ka të bëjë me Kartonin e Gjellbër.

Në Kuvendin e Kosovës e kemi miratuar Ligjin për sigurime të detyrueshëm të autopërgjegjësish në vitin 2011 me procedurë të shpejtuar për të krijuar kushtet ligjore që të vijmë te Kartoni i Gjelbër.

Ende nuk u krijuan mundësitë që të sigurohet Kartoni i Gjelbër dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të rrisin profitin e tyre, kurse diaspora jonë vazhdon të dëmtohet edhe më tutje.

Është më se e domosdoshme të rritet angazhimi që të gjendet zgjidhja për këto dy çështje të ndjeshme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka vlerësuar se Banka Qendrore ka pasur një punë të suksesshme në rregullativën ligjore, për të krijuar një numër të kërkesave për bankat në pajtim me Kornizën e Bazelit për kapital për të realizuar objektivat afatgjate të Kosovës për integrim evropian.

Ka kryer aktivitetet e saj për licencim dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar si dhe aktivitete të tjera mbikëqyrëse për sigurimet dhe përqendrueshmërinë e tregut të sigurimeve.

Ka kryer me sukses punën dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciar dhe institucioneve financiare jobankare, si dhe mbikëqyrjen e pensioneve dhe tregjeve të letrave me vlerë.

Bazuar në këto vlerësime, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për votimin e këtij raportit dhe i ftoj deputetët e këtij Kuvendi që ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Kuçi është paraqitur.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Pas debatit dhe sqarimeve të nevojshme në komision dhe miratimit të këtij raporti në komision, pastaj konsultimeve në grupin tonë parlamentar, ne jemi dakorduar si grup ta miratojmë këtë raport të rregullt dhe të paraparë me ligj.

Pra, ne do ta miratojmë si grup parlamentar këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin me rekomandime në lidhje me raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016 me rekomandimet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe të njëjtin do ta miratojë dhe do të votojë për të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma” e ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore për vitin 2016 dhe po ashtu ka konstatuar se ky është një raport i strukturuar mirë dhe i plotëson të gjitha kriteret për ta shqyrtuar dhe miratuar.

Po ashtu dëshiroj t’i theksoj disa çështje, të cilat i pasqyron ky raport.

Raporti në mënyrë të saktësuar evidenton se gjatë vitit 2016 kemi rënie të eksportit dhe rritje të importit, po ashtu raporti paraqet se kemi rënie të investimeve të huaja direkte në masë prej 21,5% në krahasim me vitin 2015 dhe mendojmë se është ai i cili pasqyron jashtëzakonisht qartë zhvillimin dhe trendin e zhvillimit ekonomik.

Po ashtu mendoj se duhet të theksohet se në raport evidentohen edhe rënia e sigurimeve të regjistruara në vlerë prej 25,6 milionë eurosh, kjo mendoj se duhet të trajtohet dhe të shihet se çka është duke ndodhur në kompanitë e sigurimeve.

Raporti evidenton qartë se remitencat janë trajtuar i vetmi burim apo stabilitet, i cili pak a shumë e stabilizon ekonominë familjare të vendit. Ndërsa burimet e tjera ende na përcjellin, do të thosha kështu, me një varfëri, me një fukarallëk dhe papunësi të madhe.

Mendoj që ajo që u ngrit edhe nga deputetja parafolëse, që ka të bëjë me Kartonin e Gjelbër, i cili u trumbetua dhe u dha një premtim i madh se do të realizohet në vitet dhe në afate sa më të shkurtra, ende po fillon të pengohen. Mendoj sepse ky ka të bëjë me çështje dhe me njerëz të fuqishëm politik që nuk po realizohet. Duhet të krijohet një qasje dhe ftoj që Qeveria të ketë një qasje reale ndaj kësaj gjendjeje, e cila po vazhdon edhe më tutje të rëndojë xhepin e atyre, të cilët janë shndërruar në bazament dhe në mirëmbajtës të familjeve tona.

Ne do ta mbështesim si raport, por vlerësoj se Qeveria duhet t’i marrë të gjitha këto evidencime që i ka sjellë raporti i Bankës Qendrore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Në raportin e BQK-së për vitin 2016 thuhet që fokusi i Bordit të BQK-së ishte rishikimi i rregullativës aktuale ligjore, por edhe plotësimi i kësaj rregullative me akte të reja të nevojshme.

Në vitin 2016 Bordi i BQK-së ka aprovuar 32 rregullore të reja në fushën e rregullimit të sektorit financiar, atë të pensioneve, të sigurimeve, pagesave dhe të bankingut qendror.

Unë dua të ndalem te sigurimet, më konkretisht te policat kufitare, kjo çështje u përmend edhe nga disa diskutues të mëhershëm.

Dua të theksoj këtë çështje për shkak që, edhe pse kanë kaluar gati 18 vjet pas përfundimit të luftës, mërgimtarët shqiptarë vazhdojnë të plaçkiten në mënyrë të organizuar, në mënyrë mafioze, me mbështetjen e institucioneve kryesore të vendit, duke filluar nga institucionet, pra nga mafia e sigurimeve, shoqatat e sigurimeve, të cilat kanë krijuar monopol, e pastaj edhe tek organet e tjera, te BQK-ja e kështu me radhë.

Gjatë këtyre viteve janë plaçkitur rreth 200 milionë nga mërgimtarët shqiptarë pa asnjë mbulesë. I vetmi shpenzim që kanë bërë kompanitë e sigurimeve është shtypja e policave.

Kompanitë e sigurimeve na japin letra pa vlerë në kufij, pra ata na japin letra, na marrim para dhe nuk kryejnë kurrfarë shërbimi. Këto janë shpenzime që i bëjnë kompanitë e sigurimeve. Pra, shtypin letra, ky është shpenzimi i tyre dhe ne ju japim para për letrat që ata na japin neve, pra letra pa vlerë.

Ndërsa, dihet që dëmet që janë bërë nga mërgimtarët janë diku prej 5 deri në 11%, varësisht nga viti.

Po nuk janë vetëm mërgimtarët ata që plaçkiten, janë edhe qytetarët e Kosovës, për shkak që kompanitë e sigurimeve nuk e kanë rregulluar çështjen e Kartonit të Gjellbër kushdo që udhëton nga Kosova nëpër vendet perëndimore, në vendet e Bashkimit Evropian paguan shumëfish më shumë se sa që do të duhej të paguanin sikur të ekzistonte çështja e Kartonit të Gjellbër.

Në raport nuk thuhet asgjë për këtë çështje. Unë dua të shtroj pyetjen: Çfarë ka bërë BQK-ja në rolin e saj mbikëqyrës për çështjen e policave kufitare?

Ajo që ka ndodhur deri më tani, pas reagimeve tona të shumta në Kuvend dhe jashtë tij, Banka Qendrore e Kosovës, duke shfrytëzuar kompetencën e saj ligjore ka përgjysmuar për 50 për qind çmimin e policave të sigurimit kufitar.

Këtë ulje e konsideroj jo si përpjekje të vullnetit të mirë të BQK-së për ta mbrojtur konsumatorin nga një plaçkitje publike me mbështetje të institucioneve, por si presion të opinionit publik, karshi të cilit Banka Qendrore është detyruar ta bëjë këtë ulje.

Në fakt, nuk ka ndryshuar asgjë, është ulur për 50% plaçkitja e mërgimtarëve.

Në vend se autorët e krimit të hetoheshin, në vend se atyre t'u merrej licenca për të shtruar këtë veprim kriminal, Banka Qendrore e Kosovës u doli në ndihmë duke u mundësuar për ta vazhduar edhe më gjatë këtë plaçkitje.

Unë e pyes Bankën Qendrore të Kosovës publikisht: pse i bëni shërbim krimit të organizuar? Pse nuk e kryeni detyrën që ju takon me ligj? Pse nuk ua merrni licencat kompanive të sigurimeve për shkak të shkeljeve të shumta të Ligjit të konkurrencës dhe Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve? Për këtë hap janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.

Ju e dini shumë mirë që neni 4, pika 1.1 e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës i konsideron të ndaluara ato marrëveshje, të cilat caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes apo çdo kusht tjetër tregtimi. Dihet se kjo marrëveshje pikërisht këtë e ka.

Sipas pikës 1.2 të të njëjtit nen, janë të ndaluara të gjitha ato kontrata të cilat kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin tregtar, zhvillimin teknik ose investimet.

Ndërsa sipas nenit 4, pika 1.5, ndalohen edhe të gjitha kontratat, të cilat kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera konkurruese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

Pra, tri nga rrethanat e përshkruara me ligj e bëjnë praktikën e kompanive të sigurimeve për inkasimin e përbashkët si të ndaluar.

Në anën tjetër, kompanitë e sigurimeve kanë bërë shkelje flagrante, duke shkelur dispozitat e nenit 11, pika 1, 1.1 dhe pika 1.2, i cili thotë. “Abuzimi i pozitës dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar veçanërisht nëse sipas pikës 1.1 në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vendos çmimin joreal të blerjes apo shitjes, ose kushte të tjera të padrejta tregtare” dhe pika 1.2 kufizon prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve.

Praktika e kompanive të sigurimeve bie ndesh edhe me nenin 13, pika 1 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Të gjitha këto shkelje, të nderuar deputetë, kanë ndodhur para syve të Bankës Qendrore dhe me miratimin e heshtur të saj.

Aq më i rëndë bëhet fakti që Banka Qendrore është e autorizuar dhe e detyruar ta mbrojë shoqërinë dhe konsumatorët pikërisht nga këto shkelje.

Me këto veprime të saj, ajo është vënë në mbrojtje të krimit ekonomik dhe është bërë pjesë e tij. Karshi shkeljeve të lartpërmendura kanë heshtur edhe Autoriteti i konkurrencës dhe Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë. Rasti i kompanive të sigurimeve, implikimi i politikës, i familjeve të fuqishme në njërin prej krimeve më të mëdha ekonomike të pasluftës, heshtja e Autoritetit të konkurrencës dhe Departamentit për mbrojtjen e konsumatorit në Ministrinë e Industrisë e Tregtisë dhe inkriminimi i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm i BQK-së, flet sa thellë i ka futur rrënjët krimi dhe sa shumë është i përfshirë gjithë sistemi ynë në të.

Sot në emër të 800 mijë mërgimtarëve protestoj para këtij Kuvendi për trajtimin dhe plaçkitjen që u bëhet mërgimtarëve të Kosovës me policat kufitare. Protestoj kundër të gjitha atyre institucioneve që janë përgjegjëse për ta zgjidhur këtë çështje dhe nuk kanë marrë asnjë hap deri më tani për ta zgjidhur. Mos na gënjeni as ne, as opinionin publik se nuk e kemi Kartonin e Gjellbër për shkak që nuk jemi pjesë e OKB-së. Zvicra është bërë anëtare e OKB-së tek në vitin 2002, pra Kartoni i Gjellbër ka shumë dekada më herët që është përdorur nga Zvicra.

Këtë çështje keni pasur mundësi ta rregulloni gjithsesi nëpërmjet marrëdhënieve bilaterale me shtetet e veçanta, nuk e keni bërë. Keni pasur mundësi dhe keni mundësi ta rregulloni nëpërmjet Shqipërisë, Sllovenisë apo ndonjë vendi tjetër. Keni mundësi ta ktheni këtë çështje tek shteti, pra që shteti t'i lëshojë policat kufitare deri në rregullimin e kësaj çështjeje. Mos harroni, mërgimtarët ju sjellin 700 deri 800 milionë euro në vit. Të gjithë përdorin fjalë të mira, sa të mirë janë mërgimtarët e çfarë roli të rëndësishëm luajnë në politikat sociale. Por, në të njëjtën kohë, askush nuk është i gatshëm t'i mbështesë, po ndodhin plaçkitjet para deputetëve, para BQK-së, me mbështetjen e Kuvendit, me mbështetjen e Qeverisë. Kur vijnë mërgimtarët në kufi, ata do të hynin sikur t'i lejonte policia të hyjnë, po policia në këtë rast pavarësisht që bën vetëm punën e saj, u bën shërbim pikërisht bandave kriminale të sigurimeve, të cilat përfitojnë vetëm për vetvete.

Ju siguroj që mërgimtarët e Kosovës janë të gatshëm të japin nga 10 euro, 20 euro, 100 euro sa herë të vijnë në kufi, por këto para të shkojnë për zhvillimin e Republikës së Kosovës, e jo për t'i bërë fitimtarë disa organizata, të cilat janë të përfshira në krim. Pra, mërgimtarët janë të gatshëm të japin para, por mos na e prishni, mos na e qitni kaq poshtë dinjitetin tonë duke na plaçkitur. Nuk janë 10 euro, 15 euro shumë për të paguar për policat kufitare, por janë shumë kur e di që

vendi yt po të plaçkitë, që institucionet e vendit tënd janë bërë pjesëmarrje, janë pjesë e kësaj plaçkitjeje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Desha të them që pajtoj 98% me fjalimin e Faton Topallit dhe është një fakt i padiskutueshëm që kjo plaçkitje e mërgimtarëve për Kartonin e Gjellbër dhe shumë plaçkitje të tjera që vijnë nga Vala, nga Post Telekomit i Kosovës, nga ndërhyrjet e ndryshme publike, nga KEK-u, vijnë si rezultat i mosfunksionimit të Parlamentit të Kosovës.

Parlamenti i Kosovës ka detyrë ligjore të bëjë kontrollin e ekzekutivit, kontrollin e Qeverisë dhe ky kontroll nuk ka ndodhur në asnjë mandat të kaluar. Deputetët e Parlamentit të Kosovës përpos që kanë aprovuar ligje lidhje e pa lidhje, që kanë nënshkruar ligje, nuk kanë bërë kontrollin e Qeverisë dhe të ministrive të qeverive të kaluara të Kosovës. Ne e dimë se të ardhurat nga Kartoni i Gjellbër brenda një viti arrijnë shumën në 15 milionë euro dhe 15 milionë euro janë shuma marramendëse për grupet e ndryshme mafioze në këtë vend që t'i ndajnë ato para në dëm të mërgimtarëve tonë.

Prandaj, pa e zgjatur këtë, pa folur për maltretimin e madh që u bëhet mërgimtarëve, dhe pa folur për mënyrën se si kompanitë e sigurimeve i trajtojnë klientët e tyre bash si të ishin skllëvër dhe në këtë drejtim nuk ka marrë asnjë masë as Banka Qendrore, as Qeveria e kaluar e Kosovës. Unë, si deputet i Parlamentit të Kosovës, deklaroj publikisht se në qoftë se Qeveria aktuale në krye me kryeministrin Ramush Haradinaj, për të cilin kam besim absolut se do ta marrë këtë vendim, në qoftë se në vitin 2018 nuk do të marrë vendim për heqjen e Kartonit të Gjellbër që përtej dëmit material, është dëm marramendës fizik që u krijohet mërgimtarëve tonë të vijnë për ta vizituar vendin e vet, unë personalisht nuk do ta mbështes këtë qeveri. Prandaj, Faton i nderuar, për të mos e zgjatur e t'i ripërsëris ato gjëra, të cilat i the në renditje të jashtëzakonshme, unë në mënyrë absolute pajtoj me fjalimin tënd. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë desha të vë në pah një praktikë, e cila ka ndodhur zakonisht në të kaluarën, kur ne e kemi diskutuar raportin e Bankës Qendrore. Praktika e besoj ka qenë edhe kërkesë ligjore është që guvernatori i Bankës Qendrore ka ardhur në Kuvend dhe e ka prezantuar dhe e ka arsyetuar raportin. Kësaj here nuk ndodhi kështu, sepse Banka Qendrore aktualisht nuk ka një guvernator të zgjedhur. Në fakt, guvernatori i cili ka qenë përgjegjës për kohën kur është bërë ky raport është këtu, por tani është në një cilësi tjetër, ai është ministër i Buxhetit dhe Financave.

Unë dua t'ia përkujtoj ish-gubernatorit, tani ministrit për Financa, nenin 43, të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe neni 43 thotë kështu: “Gubernatori dhe zëvendësgubernatorët mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Presidentin ose Bordin e Bankës Qendrore, përkatësisht të paktën 3 muaj përpara”. Zoti ish-gubernator dhe ministër ka dhënë dorëheqje një ditë përpara se të emërohet ministër, tani këtu kemi një ministër, i cili ka ardhur në detyrë duke bërë një shkelje ligjore të një pozite të mëhershme. Nëse ai paska dhënë dorëheqje tre muaj më herët para se të bëhet ministër, pse ne nuk i kemi filluar procedurat për zgjedhjen e guvernatorit të ri, atëherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hamza, në emër të Qeverisë.

Zoti Hamza, a ka mundësi vetëm edhe unë të bëj një pyetje, më intereson veç kush bën kontrollin e qarkullimit të parasë nëpërmjet sigurimeve në Kosovës? Cili institucion e bën këtë kontroll?

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Pantina, e lexove ligjin, e lexove mirë, është jashtëzakonisht mirë që në këtë Kuvend ka edhe juristë shumë të mirë, të cilët i respektoj, por ka dallim mes asaj ‘mundet’ edhe ‘duhet’, edhe këtë juristët na sqarojnë dhe kur ‘mundet’ edhe ‘duhet’ është goxha dallim i madh në aspektin juridik. Nuk e kam bërë asnjë shkelje, sepse kur është ‘mundet’ nuk e dinë, nuk ka mundësi, që juristët po na tregojnë. Kështu që në aspektin ligjor gjithçka është në rregull, po të siguroj dhe pyeti juristët, ata të tregojnë.

Sa i përket çështjeve të tjera për Kartonin e Gjelbër nuk kam qëllim tash si ministër të dal në rolin i cili nuk më takon, por përgjegjës me ligj është Byroja Kosovare e Sigurimeve. Për t'u anëtarësuar në Kartonin e Gjelbër dhe të jesh anëtar i Kartonit të Gjelbër, e di që Zvicra nuk ka qenë anëtare e OKB-së, po është anëtarësuar, por Zvicra është një rast tjetër, një shtet që dallon prej të gjitha shteteve të tjera. Kosova këtë kusht legal nuk e ka plotësuar.

Çështja tjetër, kemi tentuar nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, mirëpo po e them këtu, për shkak se ka probleme, ka telashe në raport me Byronë Evropiane të Kartonit të Gjelbër, një gjë e tillë nuk është pranuar. Është tentuar nëpërmjet Sllovenisë, prapë një gjë e tillë nuk ka mundur të arrihet, por po dua të them për hir të opinionit, por edhe deputetëve dhe një çështje tjetër. Ne si vend kemi nevojë t' i bëjmë disa përmirësime të tjera. Numri i automjeteve të paregjistruara në Kosovë është mjaft i lartë, edhe me këtë përqindje të numrit të automjeteve të paregjistruara, që silltet diku rreth 25% dhe sa standardet në vendet e BE-së është 4 deri 5%, është vështirë që një shtet tjetër të na e japë në shfrytëzim Kartonin e Gjelbër.

Prandaj, besoj që Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilës i takoj edhe unë, duhet të bëjë këtë përmirësim që të zvogëlohet numri i automjeteve të paregjistruara.

Çështje tjetër, a janë dënuar kompanitë e sigurimeve, unë ju siguroj dhe ju garantoj pa dashur të mbroj as ta amnistojë prej përgjegjësisë, asnjë shkelje, kudo që ka ndodhur, kompanitë e sigurimeve asnjë nuk ka që s'është dënuar, ndërsa sa u përket ligjeve të tjera, të cilat u përmendën edhe nga deputetët që Agjencia e Antikonkurrencës, e tjera, duhet të hulumtojë, unë jam shumë në favor të asaj, gjithçka çka s'është në përputhje me ligjin, të zbatohet. Prandaj, këto ishin disa sqarime të nevojshme, por mbi të gjitha, e pashë të arsyeshme të jap sqarimin e nevojshëm që dorëheqja ime ka qenë në përputhje të plotë me Ligjin për Bankën Qendrore, nenin 43 dhe të gjithë juristët i kam pyetur dhe i kam konsultuar para se të ndodhë kjo, do të thotë është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka kërkuar zoti Topalli, edhe Shqipja të njëjtën gjë.

FATON TOPALLI: Po, faleminderit!

Në fakt, Zvicra nuk është rast i veçantë, për arsye se edhe brenda Bashkimit Evropian janë një varg shtetesh, të cilat kanë marrëdhënie bilaterale.

Pra, Kosova ka pasur mundësi, kompanitë e sigurimeve kanë pasur mundësi të bëjnë marrëdhënie bilaterale me shtete të veçanta: Zvicra, Gjermania, Franca, Anglia, ku një numër i konsiderueshëm i mërgimtarëve jetojnë atje. Pra, nëpërmjet marrëdhënieve bilaterale me ato shtete të cilat neve na njohin që të rregullohet çështja e Kartonit të Gjelbër. Pra, nuk është rregulluar sepse nuk ka vullnet. Nuk është rregulluar për arsye se në krye të kësaj drejtorie është vëllai i Hashim Thaçit, pra nuk mund të prisni që ai do ta rregullojë këtë çështje dhe që pastaj 200 milionë që janë fituar deri tash të heqin dorë nga një fitim, i cili është marramendës.

5,6 deri 11%, ju e dini shumë mirë sa janë dëmet që i bëjnë mërgimtarëve, pra i bie që gati 90%...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, ka kundër-replikë, një minutë!

SHQIPE PANTINA: Zoti ministër, secili jurist që i ka dhënë provimet me dije, nuk e ka blerë diplomën, e di po ashtu shumë mirë kur përcaktohen kushtet kur duhet dikush të japë dorëheqje, sepse kur thuhet “duhet”, atëherë duhet të përcaktohen arsyet pse ai duhet të japë dorëheqje dhe, në fakt, këtu më nuk flitet për dorëheqje, sepse duhet të shkarkohet. Mund të thuhet atëherë kur ti nuk e ke të obligueshme, por ligji ta lejon ta bësh edhe këtë veprim në bazë vullnetit tuaj të mirë.

Në këtë rast ju e keni shfrytëzuar të drejtën duke pasur mundësinë për ta dhënë dorëheqjen, sepse kurrkush nuk ju ka detyruar ta jepni atë dorëheqje dhe kur e keni pasur mundësinë, ligji ju ka treguar se si dhe sa kohë përpara duhet ta bëni atë. Kështu që atyre juristëve, të cilëve ju u jeni

drejtuar, më vjen keq, por këshillat jua kanë dhënë gabim, ose pse s'e kanë ditur, ose pse kanë dashur që kjo është përgjigjja që ti ke dashur ta marrësh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Si ministër, ke të drejtë që ta marrësh fjalën sa herë të duash, por të tjerët kanë në replikë me ty.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Do të jem i shkurtër, nuk e kam qëllimin ta zgjas këtë punë. Zonja Pantina, po më vjen mirë që po flet me kaq kompetencë, si juriste shumë e zonja, mirëpo e di që s'je, për atë po të them. Edhe lexoji do nene pak më poshtë se ai nen, se nuk përfundojnë aty. Unë kam vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, doni replikë edhe ju? Zoti Hoti, replikë.

ENVER HOTI: Një pyetje për ministrin. Unë më herët e mora fjalën në cilësinë e përfaqësuesit të Grupit "Nismës", tani do ta pyes ministrin diçka më direkt në cilësinë e deputetit. Ministër, në Komisionin për Buxhet kur e kemi shqyrtuar raportin e BQK-së njëri nga zyrtarët e BQK-së ka deklaruar se në takim që ka qenë në Slloveni marrëveshja ka qenë afër për t'u realizuar për Kartonin e Gjelbër, por Qeveria nuk e ka plotësuar një kusht që e kanë pasur sllovenët. Sllovenia e ka pasur një kusht që ta garantojë një fond, po na intereson të dimë publikisht pse nuk ka garantuar Qeveria apo lobimi i kompanive ka qenë më i fortë se Qeveria?

Dhe, pyetja e dytë është tjetër: të na shpjegoni pak rënien e sigurimeve që kanë ndodhur në sektorin e sigurimeve në vlerë prej mbi 25 milionë eurosh për vitin 2016.

KRYESUESI: A mund të na e përsërisësh pyetjen, se nuk e ka kuptuar ministri.

ENVER HOTI: Cilën pyetje, të parën a të dytën, ministër? Mirë të dytën: raporti evidenton se rënia në sektorin e sigurimeve është në vlerë mbi 25 milionë eurosh, pse?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sa u përket bisedave me Slloveninë, ka pasur biseda, ka pasur kërkesë që ne të kemi mundësi ta shfrytëzojmë Kartonin e Gjelbër të Sllovenisë, mirëpo përmenda arsyen kryesore pse ka ngecur kjo. Arsyeja kryesore është numri i madh i automjeteve të peregjistruara në Kosovë që shkon prej 25-30%. Ndërsa, Fondi për kompensimin është i themeluar dhe është fond që mbahet brenda Byrosë Kosovare të Sigurimeve.

Sa i përket humbjes, e cila është prezantuar në pasqyrat financiare të sigurimeve për vitin 2016, nuk i referohen vetëm periudhës të vitit 2016, por janë humbje, të cilat janë bartur edhe nga periudhat e viteve të kaluara dhe kjo kryesisht ka ardhur si rezultat i shpalosjes jo të drejtë dhe jo të vërtetë të pasqyrave financiare nga kompanitë e sigurimeve dhe pas ekzaminimeve dhe auditimeve të jashtme dhe përsëritjes së auditimeve të jashtme, ka ardhur deri te prezantimi i drejtë dhe i vërtetë i gjendjes financiare te kompanitë e sigurimeve. Për informatë, ky raport për shkaqe se e dimë që nuk ka punuar Kuvendit për shkak të zgjedhjeve, është raport i vonuar, mirëpo viti 2017 është viti i parë që kompanitë e sigurimeve fillojnë të afarojnë dhe ta mbyllin me afarizëm pozitiv.

Do të thotë, vlera prej 25 milionëve, i nderuar deputet Hoti, është si rezultat i humbjeve të bartura edhe nga periudhat e kaluara, por edhe si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Ne sot po e shqyrtojmë raportin e Bankës Qendrore për vitin 2016 dhe unë vlerësoj që duhet t'i bashkohemi vlerësimin pozitiv të disa prej deputetëve për punën e Bankës Qendrore gjatë vitit 2016, me disa përjashtime, sigurisht. Duke qenë se tash në fund u hap çështja e sigurimeve, unë kam thënë edhe në kapacitete të tjera kur kam qenë që nëse diçka mbetet e patrajtuar si duhet, e paadresuar nga institucionet përkatëse, është sektori i sigurimeve.

Vetëm një nga aspektet është këtu që e përmendi deputeti Topalli, problemi i Kartonit të Gjellbër që është sa teknik, pra mungesë i një konsistence në ndjekjen e të gjitha procedurave për t'u bërë pjesë e Kartonit të Gjellbër ose për të gjetur rrugë alternative të përkohshme që mërgimtarët tanë të mos vuajnë nga mungesa e Kartonit të Gjellbër, po aq është edhe problem politik. Po atë që unë dëshiroj të theksoj është kjo që sektori i sigurimeve ka mbetur brenda Bankës Qendrore, pak vende së paku në BE e kanë brenda Bankës Qendrore. Kam një përshtypje që nuk ka pasur ndoshta vëmendje të nevojshme nga Banka Qendrore që ky sektor të zhvillohet sa duhet, në veçanti te likuiditeti i këtij sektori, por edhe kontributi që ky sektor mund të japë në sektorë të tjerë të ekonomisë. Pjesëmarrja e këtij sektori, nëse nuk gaboj, është rreth 3-4% e krejt kapitalit financiar të sektorit bankar të sigurimeve në nivel vendi.

Pra, nuk është duke kontribuar fare në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, duke qenë se nuk po diversifikohet aspak. Ne duhet të mendojmë për një zgjidhje shumë më afatgjate, ndoshta duke ndryshuar ligjin dhe duke hequr sigurimet nga Banka Qendrore, duke krijuar autoritet të veçantë, qysh e kanë plot vende të BE-së, jashtë Bankës Qendrore dhe jashtë Qeverisë, nën mbikëqyrje të organeve kompetente, por ajo që është shqetësuese për mendimin tim, unë besoj që edhe ministri

tash si ish-gubernator pajtohet që nuk ka pasur mbikëqyrje adekuate ndaj këtij sektori, duke qenë se ka plot kompani që sot nuk janë likuide, ka plot qytetarë që nuk arrijnë të realizojnë të drejtat e tyre për kompensim të dëmit me kohë nga këto kompani. Ka kompani të sigurimeve në treg që janë jolikuide nga viti në vit dhe vazhdojnë të funksionojnë ende, tani skemat se si funksionojnë unë nuk i di dhe nuk dëshiroj të spekuloj. Por, që duhet të kemi një vëmendje të veçantë në këtë fushë duhet, sepse ky sektor nuk po diversifikohet, nuk po zhvillohet, nuk po ndihmon zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë. Krejt janë koncentruar tek sigurimet e detyrueshme të automjeteve, duke i marrë në qafë mërgimtarët tanë, duke mos gjetur asnjë rrugë alternative.

Normalisht ne mund të shfajësohemi që është Byroja Kosovare e Sigurimeve, por këtu duhet të bëhen hapa konkretë dhe duhet të ketë vendosmëri në të gjitha institucionet e përfshira në këtë drejtim. Unë nuk pres ndonjë përgjigje tani nga ministri aktual si ish-gubernator, por po e ngriti si shqetësim personal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes juve deputetë kolegë, media,

U hap një temë, një çështje e sigurimeve, është punuar një kohë e gjatë për sigurimet, sigurisht që një pjesë dërrmuese nuk e dinë edhe saktësisht si funksionon kjo.

Mendoj që për pranimin e Kartonit të Gjellbër, Kosova ende duhet të ketë njohje për t'u pranuar në OKB, pastaj të pranohet kjo. Ka pasur tentime për heqjen komplet të taksës së mërgimtarëve, sigurisht që ne e dimë çka është ajo, ne e paguajmë atë, por ka qenë e pamundur. Tani ministri, që ishte atëherë në krye të Bankës Qendrore, me kërkesë të kompanisë "Siguria", me kërkesë të drejtorit Rrahim Pacolli që t'u përgjysmohen tarifat mërgimtarëve, e ka aprovuar këtë dhe e ka zbutur tarifën.

Ajo ka qenë një përpjekje domethënë e vazhdueshme. Unë mendoj që Qeveria mund të shqyrtojë që ende ta zbutë këtë tarifë, por për ta hequr komplet, edhe pse ne kemi dëshirë dhe e përkrahim fuqishëm, mendoj që ende të gjithë kartonët e gjellbër nuk e mbulojnë Kosovën dhe po më duket këtu nuk kanë njohuri për këtë.

Do të thotë, të gjitha sigurimet që i kanë kartonët e gjellbër në Evropë nuk e mbulojnë Kosovën, prandaj duhet ta gjejmë një zgjidhje ose t'i mbulojë Qeveria e Kosovës ato dëme, ose të jetë një taksë, edhe pse mundet të jetë shumë më e ulët se kjo. Unë kisha kërkuar, nuk i di kompetencat e ministrit, por të bëhet një zgjidhje për beneficionet e Byrosë, të shqyrtohen që të jenë më të vogla, se ka mundësi të reduktimit të kostos. Ajo mendoj që është e mundur për momentin të bëhet, por përndryshe, derisa ne nuk arrijmë të futemi në Kartonin e Gjellbër, heqja në tërësi

mund të ndodhë vetëm në rast se garanton Qeveria e Kosovës, përndryshe nuk do të ishte e mundur.

Por, zvogëlimi i tarifës, zbutja për mërgimtarët është e mundur, mendoj. Përndryshe unë e kisha përkrahur fuqishëm, për arsye se ne të gjithë i paguajmë këto sigurime në kufi, prandaj është e nevojshme që kjo të shqyrtohet, edhe nëse ishte marrë kjo, në tërësi nëse ishte hequr, kur të shikosh shpenzimet që bën Byroja, do të ishte më e leverdishme të hiqen komplet këto dhe t'i mbulojë Qeveria, se të mbahet Byroja me sa punëtorë atje, sa njerëz, sa shpenzimet janë, jashtëzakonisht të mëdha. Prandaj, është mirë që edhe ministri vjen prej një dikasteri, i cili është tamam i profesionit që ta shqyrtojë këtë çështje së bashku edhe Bankën Qendrore dhe ta gjejë një zgjidhje, ose të largohet komplet, ose të reduktohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, të nderuar kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Nuk e kisha ndërmend të përfshihem në debat në këtë pikë, por më tërhoqi ajo që tha ministri se 25 deri 30% të veturave në Kosovë janë të peregjistruara.

Kjo, rrethana lufte gati, çdo e katërta e veturë në rrugë qenka e peregjistruar, kjo është tmerr, nëse është kjo e vërtetë. Po tash unë nuk do ta kisha pranuar kështu të them të mirëqenë këtë pa një referencë statistikore. Shembull, prej nga erdhën sllovenët në përfundim që ky numër kaq i madh i veturave qenka i peregjistruar në Kosovë? Kam një pyetje tash unë: sa vetura kanë qenë të përfshira në aksidentet në Kosovë, të cilat nuk kanë qenë të regjistruara? Sepse sa vetura nuk regjistrohen dhe njerëzit i mbajnë nëpër oborret e garazhet e tyre, ajo nuk është statistikë, nga ajo nuk mund të nxirret statistika, se unë mund ta mbaj apo të gjithë ne mund ta mbajmë veturën të peregjistruar, por kur del në rrugë vetura llogaritet se e përfshin rrezikun apo hyn në atë sferën e rrezikut për sigurimet.

Për aq sa unë kam informacione, diku 1 deri 2% e veturave, të cilat kanë qenë të përfshira në aksident s'kanë qenë të regjistruara. Kjo është statistikë për të cilën sigurimeve do të duhej t'u interesonte, por jo sa vetura njerëzit i mbajnë nëpër shtëpi dhe nuk regjistrohen. Kjo ndodh edhe në Zvicër, nuk e regjistron, nuk do, nuk jep para, ku ta di unë për çfarë arsye dhe nuk mund të kalkulohet dhe të llogaritet si shkalla e rrezikshmërisë qenka e madhe për Kartonin e Gjellbër.

Ministër, a keni nxjerrë ju si Kosovë, pa i pyetur sllovenët apo këdo tjetër, se sa nga ato vetura që nuk regjistrohen dalin në rrugë? E vetmja mënyrë për të ardhur në një përfundim se sa është shkalla e rrezikshmërisë nëse përfshihet Kosova në Kartonin e Gjellbër do të mund të nxirrej vetëm nëpërmes kësaj që thashë: sa vetura, po e përsëris, të cilat kanë dalë në rrugë pa u

regjistruara, kanë qenë të përfshira në aksidente, qoftë të vogla, qoftë në dëme vetëm materiale, qoftë edhe me fatalitet. Faleminderit, ministër!

KRYESUESI: Faleminderit! E kemi bërë sistemin zviceran, Bilall, që me një palë tabela mund të vozitësh dy vetura, kështu që në rregull është. Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi duke e shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nga komisionet kompetente i dhanë vlerësimet e tyre për një punë të mirë pothuajse në pjesën dërmuese të sektorëve, konform kompetencave kushtetuese dhe ligjore, që i ka Banka Qendrore. Por, këtu jo pa të drejtë u hap një temë e sigurimeve, në përgjithësi, e monitorimit të tyre, e ngecjeve në atë sektor, e tjera, e tjera...

Jemi dëshmitarë kohëve të fundit që Banka Qendrore është detyruar të dërgojë administratorë në kompani të caktuara të sigurimeve, për shkak të moslikuiditetit të tyre, apo edhe ato kuotat, që një kompani e tillë e rrezikon tregun e sigurimeve. Në këtë kuptim, te çështja e Kartonit të Gjellbër, te problemet që po ua shkaktojmë mërgimtarëve, ka probleme politike dhe konform kësaj duhet të gjenden alternativa të vendimeve politike në favor të mërgatës sonë, e cila e ka një meritë të jashtëzakonshme për ditët që e kemi sot, për lirinë, për pavarësinë, për kontributin e parzervë që e kanë dhënë ata njerëz me dekada dhe janë duke e dhënë edhe sot.

Sa u takon veturave të paregjistruara, ekzistojnë dokumentet unike doganore. Janë futur veturat në Kosovë. Ka vetura që nuk janë regjistruar për vite të tëra. Minimumi me të cilin mund të na pranojnë në Kartonin e Gjellbër të gjitha shtetet që kanë rezerva, jo pa të drejtë, ndaj Republikës së Kosovës, duhet të jenë 2%. Dhe, tani, ka informata të sigurta që njerëz që janë nëpër institucione, njerëz të sektorëve të ndryshëm institucionalë, i kanë nga dy dhe tri vetura. Janë futur në Kosovë, janë doganuar dhe nxirret statistika sa vetura janë futur në Kosovë, numri i atyre sa janë të regjistruara dhe del një diskrepancë e madhe, mbi 25%. Në këtë kuptim, Qeveria duhet të marrë vendim, që thjesht ta zgjidhë këtë problem me një udhëzim administrativ me afat ligjor maksimum gjashtë muaj, që ato vetura të konfiskohen apo pronarët e atyre veturave të dënohen. Sepse dikush i ka tri ose katër vetura, dy i le te vila, një në bjeshkë, një në Brezovicë, në Sharr, apo Rugovë, dhe realisht nuk paguan sigurime për vetura. Kështu po dëmtohen edhe mërgimtarët, edhe qytetarët, dhe po bie serioziteti i kompanive të sigurimeve.

Në këtë kuptim, zoti ministër, mendoj që do të ishte e një rëndësie të veçantë që Qeveria ta trajtojë me urgjencë. Të dalim seriozë edhe para bashkësisë ndërkombëtare, që jemi popull dhe shtet, që funksionon rendi dhe ligji, dhe që në këtë sektor thjesht shteti dhe ligji të vërë dorë mbi të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë i kam dy çështje. Njëra është pyetja e parë: Nëse qenkan diku rreth 25% të automjeteve të peregjistruara, kush i lejon ato të qarkullojnë në Kosovë?

Një pyetje shumë e thjeshtë! Domethënë, i lejon Policia. Sa pjesëtarë të Policisë mbajnë vetura të tilla? Kjo është çështja, sepse rreziku është nga automjetet që qarkullojnë dhe mund të shkaktojnë dëme në rrugët e Kosovës, për të cilat paguhen tatime, dhe paguhen krejt këto taksa. Kjo pyetje duhet t'i shtrohet Qeverisë, edhe kësaj Qeverie, edhe qeverive të mëparshme. Domethënë, këtu dikush është jashtëzakonisht i interesuar që ta shkaktojë këtë problem, sepse Kartoni i Gjelbër mund të bëhet, ka siguri nga Banka Qendrore, ka siguri financiare.

Kartoni i Gjelbër është shitje dhe blerje e sigurisë, dhe në këtë botë nuk ka diçka që lidhet me financat, nuk mund të shitet dhe nuk mund të blihet. Krejt këto, jo anëtarësia në OKB, jo... krejt këto janë mbyllje e syve të njerëzve, sepse kjo blihet, Kartoni i Gjelbër blihet nga Qeveria, ose nga Banka Qendrore, ose nga kompanitë. Por, nuk ka asnjë arsytim të vetëm që të thuhet. Duhet të nxirret çështja se kush i lejon automjetet e peregjistruara, që janë rrezik për të gjithë qytetarët tjerë që qarkullojnë nëpër rrugët legale, sepse ato rrugë i kemi, s'kemi tjera, publike të Kosovës. Kjo është një pyetje që vlen për Qeverinë dhe duhet t'i shtrohet.

Çështja e dytë, që unë dua ta ngre, megjithatë zoti ministër e vuri një pikë në interpretimin e ligjit. Unë u frikësova njëherë para se ta shoh pjesën e ligjit, ku e vuri pikën zoti ministër dhe e pashë që e ka vënë krejtësisht gabimisht për një arsye, sepse guvernatori dhe zëvendësguvernatorët mund të japin dorëheqje në çdo kohë, kurrkush nuk ua ndalon këtë. Mirëpo, atë duhet ta bëjnë në mënyrë ligjore, duke e njoftuar presidentin, ose Bordin e Bankës Qendrore, të paktën tre muaj përpara. Në çdo kohë, një ditë pasi të zgjidhen, mund të japin dorëheqje, kurrkush nuk ua ndalon, i kanë arsyet personale, politike apo arsye të tjera. Po, një kusht tjetër është, të paktën tre muaj përpara duhet të njoftojnë, për të mos i lënë vendet vakante.

Zoti ministër, këtë pikë që e vendose në cilësinë e guvernatorit, tash po them, në të vërtetë është e padrejtë, sepse ligji nuk interpretohet ashtu siç e interpretuat ju dhe juristët e juaj, po interpretohet në mënyrën se ju keni pasur një obligim tre muaj më përpara ta njoftoni edhe presidentin, edhe Bordin e Bankës Qendrore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dreshaj e ka fjalën.

GANI DRESHAJ: Unë po i dëgjoj këto çështjet e sigurimit dhe të Kartonit të Gjellbër, jam shumë i interesuar, meqë më tepër është çështje ekonomike sesa politike zgjedhja e problemit të tij.

I nderuar ministër Hamza,

Unë po dëgjoj që automjetet që janë më të vjetra se 10 vjet nuk kanë të drejtë të hyjnë pas 1 janarit në Kosovë. Unë jam i bindur që në Kosovë ato 25% të mjeteve i kanë blerë veturat njerëzit fukara të Kosovës, se ne s'jemi qytetarë milionerë. I kanë blerë 4 mijë euro, e dogana u bëhet 7 mijë. Kjo është arsyeja pse nga ju do të kërkoja, para se të fillojë ky ligj, t'u bëhet një amnisti fukarenjve. Nëse milioneri ka të drejtë të mos paguajë, asnjë fukara i Kosovë nuk mund ta blejë veturën 100 mijë euro dhe ai s'pagan doganë. Unë e di që e dëmtojnë ambientin, por nëse kemi vetura me katalizatorë dhe nëse Ministria e Punëve të Brendshme ia kalon afatin e regjistrimit veturës, për dy ditë të vjen dënimi 500 euro. Diçka nuk jemi në rregull.

Unë të kisha lutur, dhe i kisha lutur të gjithë deputetë të kenë mëshirë edhe ndaj atyre që s'kanë para ta paguajnë doganën. Ndoshta ato automjete nuk qarkullojnë në rrugë, por unë e di se në fshatin tim janë mbi 100 automjete që s'kanë njerëzit. Ua ka dërguar vëllai mjetin 3 000 euro, u bën dogana 7 000, plus shikimi teknik, plus Kartoni i Gjellbër. Unë mendoj se si Qeveri, si deputetë, duhet ta kthejmë kokën pak edhe kah fukarenjtë, jo të mendojmë vetëm për milionerë. Kjo është një çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Realisht nuk do të flas për raportin e Bankës Qendrore. Po flas për nenin 43 të Ligjit për Bankën Qendrore, guvernatori dhe zëvendësguvernatori mund të japin dorëheqje, duke e njoftuar me shkrim Presidentin, ose Bordin e Bankës Qendrore, përkatësisht të paktën 3 muaj më parë.

Realisht, zoti ministër tha që është konsultuar me juristë dhe mendoj që ia kanë dhënë këshillën shumë të mirë dhe shumë profesionale. Ne duhet ta kemi parasysh se norma kur thotë "mund", po i drejtohem edhe ish-Avokatit të Popullit, i cili ka pasur të bëjë me shumë palë dhe realisht është dashur t'i mbrojë të drejtat e qytetarëve, kjo normë nuk është imperative, Te çështjet juridike nuk merret si imperative. E para, kjo e ka vetëm një sqarim se nuk është ndonjë shkelje ligjore te kjo. Veç një sqarim desha ta them. Informata me shkrim, realisht ka pasur mundësi të informojë tre muaj më herët, po edhe nëse nuk e informon tre muaj më herët, nuk është shkelje ligjore, sepse nuk prodhon shkelje ligjore. Veç desha ta them këtë si anëtar i Komisionit për Legjislacion. Nuk është imperative.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Jo, nga tri herë s'ka të diskutohet. Nuk ka tri herë diskutim. Jo, jo! Për çka? Nuk ka tri herë të diskutohet. I ke bërë pyetje ministrit, e ka kryer, u krye ajo punë.

Atëherë, konsideroj se debati për këtë pikë të rendit të ditës ka përfunduar. E futim në radhë për ta votuar.

Zoti Kurteshi, 1 minutë, se s'mund ta kthej ty.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues për nderimin!

Megjithatë, si juristë duhet ta sqarojmë, ta bëjmë të saktë.

Folja "mund" ka të bëjë me mundësinë për të dhënë dorëheqje. Në këtë rast "mund" nuk ka të bëjë me afatin dhe lidheni këtë drejt gjuhësisht. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët mund të japin dorëheqje, ky nuk është kusht. Kushti është "të paktën tre muaj përpara". Ky është kushti dhe kjo nuk mund të lidhet me foljen "mund". Faleminderit!

KRYESUESI: Hajdar, hajde edhe ty po të toleroj. Shumë shkurt, 1 minutë dhe...

HAJDAR BEQA: Kryesues!

Nëse do të kishte ndodhur "duhet", atëherë guvernatori ka pasur obligim ta japë informatën me shkrim tre muaj më përpara, asnjë ligj nuk mund ta gjejë ndryshe. Fjala "mund" nuk është imperative dhe nuk bën shkelje ligjore. Atëherë, kur është përpiluar ligji është dashur të mos e ketë fjalën "mund", ka mundur të jetë "duhet". Aty më shumë duhet të flasin ata që e kanë hartuar ligjin. Në atë kohë nuk kam qenë pjesë e atij komisioni.

Çdo kund ta marrim në interpretim, deri në Gjykatë Kushtetuese, fjala "mund" nuk është imperative me asnjë ligj në botë. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë mendoj që në rend dite nuk është dorëheqja, ose mosdorëheqja e guvernatorit, prandaj ta ndërpresim këtë lojë "cic-mic", por të hyjmë në temë.

Unë mendoj se kemi kushte për t'i votuar ligjet që kemi miratuar dje në parim. Kuorum kemi. Nëse doni t'i votojmë, i hedh në votim. Sidoqoftë, ne duhet ta votojmë raportin e Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2016.

17. Votimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Ju lus të përgatitemi për votim! Albulenë, a do të votosh, a jo... Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 89 deputetë, për 67, kundër 10, abstenuan 12.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Po e votojmë pikën e 11-të të diskutuar dje, që është: *Projektligji për shoqëritë tregtare*:

11. Votimi i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. E dini që debati ka përfunduar dje. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 89 deputetë. Për janë 89 deputetë, kundër s'ka, abstenim s'ka.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e 12-të e rendit të ditës është votimi i *Projektligjit për standardizim*:

12. Votimi i Projektligjit për standardizim

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë marrë pjesë 92 deputetë. Për janë 91 deputetë, një ka abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për standardizim.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214

Të nderuar deputetë, diskutimet kanë përfunduar në ditën e djeshme. Kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 93 deputetë. Për kanë votuar 80, kanë abstenuar 13.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportet me rekomandime.

14. Votimi i Projektligjit për infrastrukturën kritike

Të nderuar deputetë, diskutimet kanë përfunduar. Ka mbetur vetëm votimi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 94 deputetë. 93 deputetë janë për, asnjë kundër, një deputet ka abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për infrastrukturën kritike.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta ndryshojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Votimi i Projektligjit për Noterinë

Diskutimet kanë përfunduar. Ka mbetur vetëm votimi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 93 deputetë. 72 janë për, asnjë kundër, 21 deputetë kanë abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Noterinë.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e 16-të e rendit të ditës është ajo që e filluam dhe për shkak të kuorumit unë nuk desha ta fus në shqyrtim. Tani besoj se e ka radhën. Kemi kohë për të debatuar dhe për ta diskutuar çështjen.

16. Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie i ka rekomanduar Kuvendit shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, zonjës Mimoza Hasani-Pllana.

Për sqarim shtesë dhe për të hapur diskutimin rreth kësaj çështjeje unë ia jap fjalën zëvendëskryetares së Komisionit FunkSIONAL, zonjës Shqipe Pantina, që ta paraqesë dhe arsyetojë rekomandimin e komisionit.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, në bazë të nenit 61 të Rregullores së Kuvendit, nenit 28, paragrafit 2 të Ligjit 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhjet e mbajtura më 11 tetor dhe 1 nëntor 2017 diskutoi lidhur me shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, zonjës Mimoza Hasani-Pllana.

A r s y e t i m

Komisioni, në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës e ka iniciuar procedurën për shkarkimin e anëtares së Bordit të RTK-së. Shkarkimi i anëtarit të Bordit të RTK-së bëhet kur anëtari i RTK-së që mban post publik të zgjedhur dhe të emëruar është i angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit, konform nenit 8, paragrafi 1 dhe 2, të përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ushtrimin e funksionit publik.

Komisioni në dy mbledhje ka diskutuar lidhur me shkeljet e anëtares së Bordit të RTK-së, e cila është emëruar nga Kuvendi i Kosovës më 30 korrik 2015 me mandat trevjeçar. Gjatë ushtrimit të funksionit si anëtare e Bordit në të njëjtën kohë e ka ushtruar detyrën e nëpunësit civil, zyrtare për të drejtat e fëmijëve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe këtë pozitë nuk e ka pezulluar konform nenit 89, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendimin e datës 20 korrik 2017, nr. 103/2017, ka rekomanduar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që t'i zbatojë rekomandimet e Këshillit me afat prej 15 ditësh.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk i ka zbatuar rekomandimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 15 ditësh, të përcaktuar me vendimin e këshillit, por për të njëjtin rast ka marrë vendim më 12 tetor 2017, nr. 2.3443.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 1 nëntor 2017, me 6 vota për dhe një abstenim vendosi t'i rekomandojë Kuvendit shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, pasi e njëjta me veprimin e saj e ka shkelur ligjin në fuqi.

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin, ose jo, të anëtares së Bordit. Tani zonja Hasani ka dërguar një varg letrash te deputetët, me të cilat, në fakt, ajo veçse e konfirmon faktin se e ka shkelur Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për RTK-në, sepse pezullimin e vendit të punës e ka bërë vetëm më 20 korrik 2017, përderisa ajo është emëruar si anëtare e Bordit të RTK-së më 30 korrik 2015. Pra, për dy vjet me radhë ajo ka qenë në shkelje të Ligjit për RTK-në dhe Ligjit për Shërbimin Civil.

Në njërin nga arsyetimet e saj ajo thirret në faktin se nuk ka qenë e njoftuar se duke mbajtur dy pozita, një të shërbyesit civil dhe një të funksionarit të lartë të emëruar, ka bërë shkelje ligjore dhe kjo e përbën edhe një fakt të paditurisë dhe të panjohurisë, sepse një zyrtar, një shërbyes civil, patjetër që duhet ta njohë Ligjin për Shërbimin Civil, e i cili i ndalon shërbyesit civil të mbajë pozita të tjera të zgjedhura, apo të emëruara. Në të njëjtën kohë, anëtarët e Bordit të RTK-së, në këtë rast zonja Pllana si anëtare, janë të thirrur për ta zbatuar Ligjin për RTK-në.

Si mund të presim që dikush ta zbatojë Ligjin për RTK-në kur ajo vetë deklarohet publikisht, me letër u drejtohet anëtarëve të Kuvendit që nuk e njeh, nuk e ka ditur Ligjin për RTK-në, i cili po ashtu nuk i lejon të mbajë pozita të tjera dhe në këtë rast ajo, gjithashtu, ka qenë edhe në konflikt interesi.

Tani, për një pozitë të ngjashme, në rrethana të njëjta, Kuvendi bile nuk e ka lejuar të vihet për t'u votuar në seancë një anëtare tjetër të Bordit, zonjën Besa Bytyqi, për të cilën Zyra Ligjore e

Kuvendit ka dhënë rekomandimin se si shërbyese civile nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë të ushtrorë edhe pozitën e anëtarit të Bordit të RTK-së, që është funksion i lartë i emëruar. Po ashtu, për raste të njëjta, ky Kuvend më herët ka shkarkuar anëtarë të Bordit, në këtë rast jo të RTK-së, por të KPM-së dhe kanë qenë dy anëtarë që ky Kuvend i ka shkarkuar, zotin Shefki Ukaj dhe zonjën Vesna Jovanović. Pra, ka precedentë të ngjashëm, kur anëtarët e bordeve të institucioneve të ndryshme që i emëron Kuvendi, me rastin e gjetjes së shkeljeve i shkarkon vetë.

Tani unë, në këtë rast, i drejtohem Komisionit për Legjislacion që ta thërrasë në përgjegjësi edhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, e cila e ka për detyrë t'i evidentojë rastet e konfliktit të interesit. Një rast të ngjashëm komisioni e ka shqyrtuar dhe ka ardhur në përfundim se nuk ka pasur konflikt të interesit dhe të njëjtin rast, për të njëjtat arsye, Zyra Ligjore e Kuvendit ka gjetur shkelje. Po ashtu, Agjencia Kundër Korrupsionit asnjëherë nuk ka ardhur në Kuvend, me gjithë faktin që ata kanë dalë në publik dhe kanë folur për numrin e madh të njerëzve, të zyrtarëve të ndryshëm, që mbajnë dy e më shumë pozita në sektorin publik, por nuk ka sjellë rekomandime se çfarë të bëhet me këta njerëz, të cilët natyrisht se nuk mund t'i mbajnë dy apo tri pozita në sektorin publik dhe ato pozita të jenë në përputhje me njëra-tjetrën.

Unë e kuptoj se në këtë rast, zonja në fjalë ka bërë shumë presion tek individët, te deputetët e ndryshëm, që të votojnë kundër shkarkimit. Tani deputetët, ne pra, jemi në një situatë, duam ta mbrojmë institucionin dhe t'i dënojmë ata që shkelin ligjet, apo duam të mbrojmë interesat e individëve të caktuar, të cilët në kundërshtim me ligjin vazhdojnë të mbajnë pozita publike në institucionet, të cilat edhe ashtu kanë probleme. Pra, tani e kemi të qartë se pse në Radiotelevizionin e Kosovës kemi aq shumë probleme, sepse njerëzit e thirrur për ta zbatuar ligjin janë vetë në kundërshtim me ligjin të emëruar në ato pozita.

Unë u kërkoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit, deputetëve, që të votojnë pro shkarkimit të zonjës Hasani dhe në të njëjtën kohë i kërkoj Komisionit për Legjislacion që t'i bëjë thirrje Agjencisë Kundër Korrupsionit që t'i hetojë të gjitha rastet që janë në konflikt interesi dhe, po ashtu, mbajnë pozita të dyfishta në sektorin publik në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deklaramit të grupeve parlamentare. Nuk është paraqitur askush akoma. Po i thërras me radhë, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, apo e the ti në emër të Grupit Parlamentar? Në rregull! Grupi Parlamentar i LDK-së? Nuk dëshironi të diskutoni...

Grupi Parlamentar i PDK-së, nuk dëshirojnë të flasin.

Lista serbe, nuk dëshirojnë të flasin.

Grupi Parlamentar i AAK-së, nuk është paraqitur askush.

Grupi Parlamentar “Nisma”, Milaim Zeka është paraqitur.

MILAIM ZEKA: Vetëm desha të them një diçka, është e vërtetë që në Komisionin për Media kemi marrë një vendim për këtë rekomandim, të cilën e tha Shqipe Pantina, por ne si Grup Parlamentar i “Nismës” dëshirojmë të themi një diçka që njoftimin të cilin na e ka bërë Mimoza Hasani nuk e konsiderojmë presion, sepse njoftimi është njoftim, por në anën tjetër, do i rekomandonim Sekretarisë së Kuvendit të Kosovës që të na sjellë biografinë e të gjithë anëtarëve të bordeve të emëruara, sepse ne kemi hasur që edhe dy anëtarë të tjerë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës janë me vepër të njëjtë, me konflikt të interesit sikurse Mimoza Hasani.

Dhe, një fenomen i tillë është pothuajse nëpër të gjitha bordet. Prandaj, do t’i rekomandoja Kuvendit të Kosovës që në vend të shkarkimit, të krijojmë një komision hetimore për t’i hetua të gjithë anëtarët e bordeve në çfarë forme janë emëruar ata, a i plotësojnë kriteret dhe a kanë shkelje të ligjit dhe konflikt interesit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin,

Kolegë deputetë,

Që nga data 11 tetor kam qenë pjesë e një angazhimi për zgjedhjen e këtij problemi të kësaj vajze në Kuvend të Kosovës, kur ka ardhur në komision te ne dhe ka kërkuar çfarë të bëjë me kërkesën.

Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është obligativ, është një Këshill i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, është mbikëqyrës, po ashtu, i shërbimit civil dhe ka gjetur të shkelurat e Mimoza Hasanit-Pllanës në Bordin e RTK-së.

Ata thonë obligohet sekretari i përgjithshëm i ministrisë që më 27.7.2017 dhe as sekretari e as kjo nuk e kanë bërë veprimin e duhur dhe po ashtu në këtë datë i dërgohet arkivit, sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, zonjës Mimoza, parashtruesit të kërkesës për trajtimin e rastit dhe arkivit po ashtu.

Kjo tregon që nga kjo datë asnjë veprim nuk e kanë marrë dhe askush nuk është përgjigjur. Prandaj, kjo është një shkelje që Kuvendi i Kosovës ka shkarkuar më herët me rekomandim Shefki Ukën, Nevzat Hydaverin e Vesna Jovanoviqin.

Nëse këta deputetë atëherë kanë kërkuar të shkarkohet, të mbrohet ligjshmëria, edhe deputetët e Partisë Demokratike, edhe deputetët e Lidhjes Demokratike, edhe të “Vetëvendosjes” kanë kërkuar të mbrohet ligjshmëria dhe shkeljet. Unë mendoj që e nderuara ka bërë shkelje, e ka

konfirmua komisioni, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës Civil, po ashtu e ka konfirmuar edhe Antikorrupsioni, ku thotë se ka konflikt interesi, të gjithë e kanë konfirmuar.

Prandaj, ajo me vendimet e veta, që kanë insistuar ta vërë në lajthitje komisionin duke shkuar te sekretari, se gjoja po e pezullon vendin e punës, duke nxjerrë vendime që e ka pezulluar, këto tregojnë se ajo ka bërë një presion të jashtëzakonshëm ditët e fundit edhe nëpërmjet burrit të saj, duke i detyruar të votojnë kundër e të mos shkarkohet.

Nëse ne e dimë në këtë gjendje si Kuvend, është dikush në këtë vend që është femër, të kem një konsideratë, kemi mundësinë ta mbrojmë, është nënë, e tjerë e tjerë. Nëse ne i trajtojmë raste kështu dhe bëjmë një precedent të tillë, mendoj që Kuvendi nuk e meriton të ekzistojë.

Bordet kanë konflikte, po para se të zgjidhen t'i sqaroni. Kjo kur ka ardhur këtu, ka treguar që është një vend i punës dhe mund ta pezullojë vendin e punës. Për dy vjet e gjysmë ajo nuk e ka pezulluar vendin e punës, për dy vjet e gjysmë ajo i ka marrë dy paga, një nga shërbimi civil, një e ka marrë nga Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, ky është konflikt interesi. Nëse ajo i ka bërë të gjitha këto, cila është arsyeja ta mbrojmë?

Unë po kërkoj që ajo të shkarkohet, deputetët ta votojnë shkarkimin e saj, t'i hetojnë edhe ato të tjerat që po kërkon Milaimi, se në komision të gjithë kanë votuar për shkarkimin e saj, përveç unë që kam abstenuar. Tani, ajo tjetra është që vlera e asaj pune që e ka kryer në dy vende është një konflikt dhe është një vlerë e madhe dhe unë kisha kërkuar dhe kisha lobuar të mos më shkarkonin po t'i kisha pasur 28 mijë a 30 mijë euro të m'i japë dikush.

Prandaj, sikur të më kishit dhënë edhe ju 30 mijë euro, edhe unë kisha lobuar të mos shkarkohem. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Pajtohem plotësisht me fjalën e Shqipës, në radhë të parë, mirëpo lajthitja e deputetëve në Kuvend se a do të kemi shkarkim apo jo, për mua është një shqetësim.

U përmendën disa raste, po ka edhe shumë raste të tjera qysh në mandatin e parë, pra kur ne edhe kemi kërkuar prej kandidatëve, të cilët janë intervistuar në Komision për KPM-në apo RTK-në, kur e kemi parë që kanë konflikt interesi, edhe pse nuk na janë prezantuar dokumentet qysh në atë kohë, po megjithatë ne menjëherë kemi kërkuar nga ta tërheqje, qoftë i kemi shkarkuar në Kuvend, po ka pasur raste edhe që janë tërhequr vetë.

Shqetësuese është pikërisht ajo se sa raste të tjera të ngjashme janë. Prandaj, Kuvendi që është pikërisht vendi ku nxirren ligjet që janë të obliguara institucionet për t'i zbatuar, nëse ne e vejmë në lajthitje shkarkimin ose jo, është diçka që i ul reputacionin vetë Kuvendit.

Megjithatë, unë kisha bërë thirrje që të gjitha bordet të hetohen sipërisht dhe të shihet se sa raste të tilla janë, po mbi të gjitha kemi edhe raste të tjera, të cilat e marrin punë dytësore apo tretësore punën nëpër borde apo nëpër këshilla, siç e kemi edhe për Këshillin për Trashëgimi Kulturorë, ku sipërisht si anëtare e Komisionit për Arsim jam shumë e shqetësuar me punën që bëhet në atë këshill dhe në shumë këshilla të tjerë apo institucionet të cilat i nxjerr vetë Kuvendi.

Prandaj, është momenti i fundit që seriozisht të punojmë në këtë çështje dhe të mos na vijnë rastet të tilla pas disa vjetësh, në qoftë se edhe një muaj në pyetje të ishte, është edhe një problem, edhe një gabim i Kuvendit, e aq më tepër kur janë në pyetje dy vjet e gjysmë.

Prandaj, pajtohem njëqind për qind, por thirrja edhe imja është që të hetohen raste të tjera në përpikëri, ama të gjitha pos politizimit, të shikohen se kush po e keqpërdor Buxhetin e Kosovës, e të mos jetë ligji për dikë të vlejë e për dikë jo.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni i Pavarur i Mediave duhet të jetë në funksion sikurse parasheh edhe ligji, në promovimin e zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audio-vizuale që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, zgjedhja e një anëtari duhet të jetë zgjedhje e një anëtari me integritet të plotë profesional e njerëzor, i aftë për të ruajtur harmoninë e të gjithë konkurrentëve medialë dhe për të ruajtur pavarësinë e mediave.

Jemi në shekullin e lajmit dhe duke qenë se Kosova është prapa vendeve të zhvilluar në avancim të lëndës, edukimi medial dhe jemi zënë befasues në zhvillimin marramendës të teknologjisë mediatike.

Kemi më shumë nevojë të përzgjedhim njerëz të duhur në vendin e duhur dhe kemi shumë nevojë që këta njerëz të japin mendimet e tyre dhe të kryejnë punën e tyre profesionale, pa u ndikuar dhe pa anime, të jenë njerëz të duhur që shoqëria demokratike dhe mediat të jenë të pavarura nga të gjitha ndikimet personale apo edhe partiake.

Madje, pa nevojë edhe aq të shpikjes së kritereve të tjera për anëtarin e ri, duhet t'i rikthehemi ligjit dhe të kërkojmë këto kritere për të përzgjedhur njërin anëtar të komisionit.

Në faqen 56 të ligjit të komisionit thuhet: “Anëtarët e komisionit duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme, si kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënia e publikut, marrëdhëniet ndërkombëtare, mediat dhe teknologjia informative”.

Anëtarët e komisionit duhet të jenë individ me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral.

Gjatë punës së tyre anëtarët duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm.

Anëtarët emërohen dhe veprojnë me kapacitetet e tyre personale, nuk përfaqësojnë asnjë interes.

Atyre nuk duhet t'u lejohet të kërkojnë apo të pranojnë asnjë udhëzim në lidhje me aktivitetet nga asnjë person apo subjekt.

Pesë, përbërja e anëtarëve të Komisionit e pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinorë të Kosovës, së paku dy anëtarë të emërohen nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe së paku dy anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore. Të paktën dy anëtarë të Komisionit duhen të kenë kualifikime profesionale në fushën e financimit, menaxhimit biznesor e të drejtësinë.

Anëtarëve u ndalohet të keqpërdorin pozitën e tyre për përfitim personal apo familjar të ngushtë.

Prandaj, ta zgjedhim një anëtar me këto cilësi që na kërkon edhe ligji, duke mos u habitur askush nëse themi se do të doja të ishte femër. Kur e kemi parasysh se ligji kërkon që dy anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore dhe nëse edhe një më tepër nuk na ndalon ligji. Përkundrazi, sikur e kemi thënë, do ta themi shumë shpesh në këtë Kuvend se sa herë e lejon ligjin do ta apelojmë për punësimin e grave, për përzgjedhjen e grave, për emërimin e grave, për anëtarësimin e grave në komisione përkatëse.

Dhe, unë mendoj që sot është mirë të bëhet shkarkimi dhe të emërohet një anëtar i cili meriton të jetë pjesë e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Izmaqu. Ligjin e dëgjuam, kështu që mos na e përsërit prapë.

XHEVAHIRE IZMAKU: I nderuar nënkryetar,
Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si anëtare e Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Media dhe Qeverisje Lokale nuk mund të hesht para kësaj pike, të cilën më parë e diskutoi kolegja Shqipja dhe Naiti, ndërsa kolegja po më duket deri në fund nuk ishte në temë, sepse nuk e ka dëgjuar që është fjala për Bordin e RTK-së dhe nuk është për KPM-në.

Rasti në fjalë, zonja Mimoza, më shumë e kam të sqaroj për deputetët të cilët janë të rinj, sepse po shihet që ende janë në dilemë, nuk e dinë çka ka ndodhur.

Pra, çdo kandidat kur konkurren për një post në borde ka të drejtë, edhe pse është pozicion edhe shërbyes civil edhe kudo të jetë, mirëpo në momentin kur ai emërohet apo zgjidhet, duhet të zgjedhë mes pozitës së emëruar dhe pozitës si shërbyes civil.

Për t'u sqaruar, zgjidhet, zonja në fjalë, Mimoza, edhe mund të them që e ka kryer një punë shumë të mirë, mirëpo kjo nuk e justifikon qëndrimin e mëtutjeshëm në rastin kur bëhet shkelje ligjore. Pra, nuk është rasti i parë kur ne kemi bërë shkarkime të tilla dhe nuk mund të vendosim në mënyra të ndryshme për një rast të njëjtë. Mimoza e ka marrë pagën si shërbyese civile dhe si anëtare e bordit, pra shkurt e shqip, është shumë e thjeshtë kjo punë dhe për këtë vendim ka reaguuar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, i cili është një agjenci kushtetuese, të cilin ne e kemi votuar dhe janë persona dhe anëtarë, të cilët kanë kridibilitet dhe e kryejnë punën në mënyrë shumë të mirë.

Pra, ne votojmë për shkarkim në rast të shkeljes së ligjit ose jo dhe unë si anëtare e komisionit nuk mund t'i mbyll sytë në këtë rast, por me gjithë respektin dhe punën e mirë që e ka bërë zonja Mimoza deri më tani, votoj me bindje për shkarkimin e saj. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, zonjës Pantina i takon fjala përfundimtare.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Unë dua ta mbështes Milaim Zekën në kërkesën e tij. Ai tha që janë edhe dy anëtarë të tjerë të Bordit të RTK-së që kanë konflikt interesi. Zoti Zekaj, të lutem na i sill në komision ose këtu në seancë dhe na arsyeto shkeljen dhe unë personalisht ta garantoj votën për shkarkimin e tyre.

Kërkesa e dytë që ai pati është për krijimin e komisionit hetimor.

Në legjislaturën e kaluar ne e patëm deponuar kërkesën për krijimin e komisionit hetimor për RTK-në, por atë botë PDK-ja dhe LDK-ja asnjëherë nuk i kanë dërguar emrat e anëtarëve për krijimin e këtij komisioni.

Unë e mbështes kërkesën e zotit Zekaj në këtë rast që ne si Kuvend të themelojmë një Komision hetimor për të gjitha parregullsitë që ndodhin në RTK. Qoftë nëse ka nevojë të mblidhen 40 nënshkrime, qoftë ta hedhim tani në diskutim dhe ta votojmë, natyrisht se jemi të gatshëm të hetojmë të gjitha shkeljet dhe parregullsitë që ndodhin brenda RTK-së, domethënë e bërë thirrjen qysh në fillim, por mbështes edhe deklaratimet e zotit Hasani edhe zonjës Izmaqi që nuk ka asgjë personale me zonjën në fjalë, ajo ka bërë shkelje ligjore dhe shkeljet ligjore nuk duhet të tolerohen nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur për të diskutuar.

Po hyjmë në votim, a erdhën deputetët, ju lutem.

Faleminderit!

Në sallë janë 81 deputetë.

Po fillojmë të futemi në procesin e votimit.

Atëherë vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e zonjës Mimoza Hasani-Pllana, anëtare e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Edhe një herë konstatoj që në sallë janë 81 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Konstatoj që kanë votuar 74 deputetë, për shkarkimin e zonjës Hasani-Pllana kanë votuar 56 deputetë, kundër kanë votuar 2, kanë abstenuar 16 deputetë.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e zonjës Mimoza Hasani-Pllana nga pozita e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zoti Bedri Hamza, ministër i Financave, të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Zoti Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjin e Buxhetit po paraqes para juve raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2016.

Ky raport prezanton ekzekutimin e Buxhetit nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2015 Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 numër 05/L-071 si dhe në korrik 2016 Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik të Buxhetit numër 05/L-109.

Fillimisht sipas buxhetit fillestar, plani vjetor i pranimeve sipas Buxhetit për vitin 2016 ka qenë një miliard e 895 milionë euro, ndërsa me rishikimin e Buxhetit dhe planifikimi për total pranimet ishte rritur në një miliard e 978 milionë euro, apo një rritje prej rreth 83 milionë euro.

Në anën tjetër, plani vjetor i pagesave sipas buxhetit fillestar ka qenë një miliard e 773 milionë euro, duke përfshirë edhe të hyrat vetjake të bartura nga viti 2015 në vitin 2016.

Ndërsa sipas rishikimit të buxhetit total, pagesat ishin planifikuar të rriten në një miliard e 864 milionë euro, një rritje prej 91 milionë eurove.

Tani në vazhdim më lejoni të paraqes një përmbledhje të raportit për të pasqyruar të dhënat finale në formë analitike për janar-dhjetor 2016.

Pranimet: Pranimet gjatë vitit 2016, duke përfshirë huamarrjet, grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet me mirëbesim ishin në shumë prej një miliardë e 778 milionë eurosh.

Kjo shumë paraqet 90% të pranimeve të planifikuara sipas rishikimit të Buxhetit, ndërsa krahasuar me Buxhetin e vitit 2015 në total kemi një rritje prej 4%.

Të hyrat tatimore të mbledhura nga doganat e Kosovës kanë qenë në shumë prej një miliard e 51 milionë euro.

Në totalin e përgjithshëm të pranimeve këto të hyra marrin pjesë më 59%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak realizimi është rritur për 9,4%.

Të hyrat tatimore të mbledhura nga Administrata Tatimore ishin në shumë prej 386 milionë eurosh, në totalin e përgjithshëm pranimeve marrin pjesë me 22%. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak realizimi ka qenë më i lartë 14%.

Gjatë vitit 2016 janë rimbursuar 38 milionë euro për tatimpaguesit, prej tyre nga Doganat e Kosovës 7,37 milionë euro, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës 31 milionë euro.

Të hyrat jotatimore ishin në shumë prej 175 milionë euro, në totalin e përgjithshëm të pranimeve këto të hyra marrin pjesë me 10%, ndërsa përmbushja në raport me planin ka qenë në shkallë prej 83%.

Të hyrat vetjake te niveli qendror ishin në shumë prej 92 milionë euro, ndërsa të hyrat vetjake të komunave 70 milionë euro.

Tatimi në pronë në vitin 2016 ka qenë në shumë prej 25 milionë euro, ose një rritje prej 21% në raport me vitin paraprak.

Të hyrat nga taksat koncesionare kanë qenë në shumë 7,7 milionë euro.

Të hyrat nga renta minerare në shumë prej 31 milionë euro.

Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike 7,2 milionë euro.

Të hyrat nga dividenda gjatë vitit 2016 kanë qenë zero.

Të hyrat e dedikuara ishin në shumë prej 9 milionë eurosh.

Total pranimet nga huamarrjet ishin në shumë prej 154,4 milionë eurosh, ose rreth 9% të totalit të përgjithshëm të pranimeve, nga të cilat institucionet financiare ndërkombëtare 53,2 milionë euro, kurse letrat me vlerë 101,2 milionë euro.

Pagesat: Pagesat gjatë vitit 2016, duke përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit si dhe fondet në mirëbesim ishin në shumë prej një miliard e 763 milionë euro dhe paraqesin 95% të pagesave të planifikuara sipas rishikimit të Buxhetit, ndërsa në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 9%.

Pagat në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve marrin pjesë me 31%, ndërsa në shumë totale ato ishin 544,8 milionë euro, ose 99% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 3,5%.

Mallra dhe shërbime në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve marrin pjesë me 10%, ndërsa si shumë ato ishin 179,9 milionë euro, ose 99% të planit vjetor.

Krahasuar me vitin paraprak për këtë kategori kemi një ulje prej 2,8%.

Shpenzimet komunale marrin pjesë me 1% në shpenzimet e përgjithshme, apo 23,4 milionë euro, ose 94% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një ulje prej 3,4%.

Subvencionet dhe transferet: Në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve marrin pjesë me 27%, janë në shumë prej 475 milionë euro, ose 99% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 11%.

Shpenzimet kapitale marrin pjesë me 26%, që janë në shumë 452,3 milionë euro, ose 90,5% të planit vjetor krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 10,8%.

Shpenzimet për servisimin e borxhit në total të përgjithshëm të shpenzimeve morën pjesë me 5%, janë një shumë prej 85,2 milionë eurosh, ose 93% të planit vjetor.

Grantet e përcaktuara të donatorëve: Buxheti i granteve të përcaktuara të donatorëve për vitin 2016 ishte në 22,15 milionë euro, duke përfshirë 8,74 milionë euro të pranuar gjatë vitit 2016, 10,1 milionë të bartura nga viti paraprak, si dhe 3,3 milionë euro donacione në formë të pagesave direkt.

Nga ky fond gjatë vitit 2016 janë bërë shpenzime në shumë prej 14,9 milionë euro, që rezultojnë me bartjen prej vitit 2017 prej 7,3 milionë eurosh.

Gjendja e parasë së gatshme më 31. 12. 2016: Pasuria financiare me para të gatshme më 31. 12. 2016 ishte 271,2 milionë euro. Pjesë e këtij bilanci ishin edhe fondet për qëllime specifike, si: Fondi i Donatorëve 7,3 milionë euro, të hyrat vetjake të bartura 27,2 milionë euro, të hyrat e dedikuara 0,8 milionë euro, Fondi Zhvillimor në Mirëbesim 10,1 milionë euro dhe fondet e tjera 13,1 milionë euro. Fondet e pashpenzuara më 31. 12. 2016 ishin 212,8 milionë euro. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër,

Tash i jap fjalën kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin në emër të komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, i dërguar nga Qeveria në Kuvend është hartuar në pajtim me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, të bazuara në parat e gatshme dhe është në pajtim me kërkesat ligjore të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti pasqyron të dhënat për realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve totale, krahasimin e tyre me planin buxhetor dhe vitin paraprak.

Po ashtu, raporti përmban të dhëna për llojin e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara, përfshirë të hyrat nga doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës, të hyrat vetjake të komunave dhe të hyrat e nivelit qendror.

Po ashtu, raporti prezanton edhe nivelin e deficitit në raport me bruto-produktin e brendshëm.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe ka vlerësuar se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas radhës ftoj që të deklarohej kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Së pari, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, nuk ka. Lidhja Demokratike e Kosovës, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Ministër i Financave,

Deputetë,

Raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 pasqyron gjithsej të hyrat gjatë vitit 2016, duke mos përfshirë premitë nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe mjetet nga fondi i depozitave që kanë qenë gjithsej domethënë buxheti një miliard e 778 milionë e 885 mijë euro.

Të hyrat, normalisht gjithnjë duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondin e depozitave, kanë shënuar një trend të rritjes krahasuar me vitin 2015 për 5% dhe krahasuar me vitin 2014 për 21%.

Sa i përket burimit të të hyrave, të hyrat nga tatimet direkte që inkasohen nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë qenë 232 milionë e 121 mijë euro dhe janë për 34,4 milionë euro më të larta se në vitin 2015.

Ndërkaq nga tatimet indirekte që mblidhen nga doganat janë realizuar një miliard e 227 milionë euro, apo 123,9 milionë euro më shumë se në vitin 2015, të keni parasysh po flasim gjithnjë për të hyrat që mblidhen në kufij, duke përfshirë edhe TVSH-në.

Në rritjen e të hyrave, përveç rritjes së importeve, ka ndikuar edhe ndryshimet në normën e akcizës për disa produkte dhe zbatimi i Ligjit për pakon e re fiskale. Sa i përket nivelit të inkasimit të të hyrave, të hyrat vetjake në nivelin qendror kanë shënuar rritje për 33 milionë e

956 mijë euro, që krahasuar me vitin 2015 është 9% më shumë, ndërsa të hyrat vetjake të komunave kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak prej 6%.

Tatimi në pronë i grumbulluar është 25,1 milionë euro, apo 5,4 milionë më i lartë se në vitin 2015. Inkasimi i të hyrave për shumicën e komunave, krahasuar me vitin paraprak, ka shënuar rritje. Të hyrat tjera të rëndësishme për Buxhetin e Kosovës kanë qenë nga taniema prej 30,5 milionë euro, apo 854 mijë euro më shumë se në vitin 2015. Nga akciza koncesionare 7,6 milionë euro, nga renta minerare 30,5 milionë euro, apo 26 mijë euro më shumë se në vitin 2015, dhe kthimi i huadhënies nga ndërmarrjet publike 7,2 milionë euro.

Grantet e premive nga përkrahja e buxhetit kanë qenë 8 milionë e 735 mijë euro dhe kanë shënuar rënie prej 4,575 milionë euro krahasuar me vitin paraprak. Sa u përket huazimeve të jashtme, pra janë të hyrat që kanë ardhur nga institucionet financiare ndërkombëtare, si nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, UniCredit, apo KFW-ja në shumën prej 53,2 milionë euro, krahasuar me vitin 2015 janë për 7,7 milionë euro më të larta, ndërsa huazimet e brendshme janë pranimet nga emetimi i letrave me vlerë në shumën prej 101,189 milionë euro, krahasuar me vitin 2015 janë për 20,73 milionë euro më të ulëta.

Pagesat apo shpenzimet gjatë vitit 2016, duke mos përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe fondin e depozitave, kanë qenë 1 miliard e 749 milionë e 958 mijë euro, ndërsa pagesat, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve dhe fondin e depozitave, kanë shënuar rritje nga viti paraprak për 12,5%.

Shpenzimet sipas kategorive kryesore janë realizuar, si në vijim: pagat dhe mëditja janë realizuar në shumën prej 544,8 milionë euro, apo 99% e planit, dhe paraqesin një rritje prej 3,5% krahasuar me vitin paraprak. Mallrat dhe shërbimet janë realizuar 179,8 milionë euro, apo 86% e planifikuar dhe paraqesin një rritje prej -2,6% krahasuar me vitin 2016. Faktikisht, ky është një tregues se kjo periudhë fillon me kursime në institucionet shtetërore si rezultat i menaxhimit të mirë.

Shpenzimet komunale janë realizuar 23,3 milionë euro, apo 93,69% planifikuar dhe paraqesin një rënie prej -3,3% krahasuar me vitin 2015, domethënë si rezultat i njëjtë. Subvencionet dhe transferet janë realizuar 475 milionë euro, apo 98% krahasuar me planin dhe janë për 12,5% më të larta se në vitin paraprak. Shpenzimet kapitale janë realizuar 403,8 milionë euro, apo 90,4% krahasuar me planin, apo 10,8% më pak se në vitin 2015.

Në raportin e deficitit buxhetor për vitin 2015, deficitin i përgjithshëm, duke përfshirë shpenzimet dhe të hyrat vetjake të bartura dhe shpenzimet e AKP-së ka shënuar shumën prej -53 milionë e 872 mijë, apo 0,9% e GDP-së. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do

ta votojë raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën i jap deputetes Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin financiar të vitit 2016 dhe është i mendimit që ky raport e pasqyron rrjedhën e pranimeve dhe shpenzimeve ashtu siç e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti financiar si tërësi duket që e ka një ekzekutim relativisht të mirë të të hyrave dhe të shpenzimeve. Nëse hyjmë në brendinë e analizës së pozicioneve buxhetore shohim se ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve për planifikimin e buxhetit, në mënyrë që ta kemi një realizim më të mirë të zërave buxhetorë. Për një menaxhim të mirë të financave publike është shumë e rëndësishme që burimet e kufizuara buxhetore të planifikohen mirë, në mënyrë që të përmbushen kërkesat gjithnjë në rritje të qytetarëve tanë, si dhe kërkesat që dalin nga strategjia integruese e vendit tonë në Bashkimin Evropian. Meqenëse këtë raport të shpenzimeve po e analizojmë me vonesë për shkak të rrethanave në të cilat u ndodh vendi ynë, për shkak të zgjedhjeve, ne kemi pasur mundësi ta analizojmë edhe raportin e Auditorit, ku përpos rrjedhjes së shpenzimeve dhe të hyrave kemi pasur mundësinë ta analizojmë edhe efektshmërinë dhe efikasitetin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, e gëzon fakti që në vitin 2016 Auditori i Përgjithshëm ka dhënë raport të mirë, të pamodifikuar me theksim të çështjes, për dallim prej vitit 2015 kur e kemi pasur një raport jo të mirë nga Auditori, raport të modifikuar dhe me theksim të çështjes.

Të nderuar deputetë,

Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit janë rritur për 4% krahasuar me vitin 2015, mirëpo nëse e krahasojmë me atë që është planifikuar, atëherë e kemi një realizim vetëm 90% të të hyrave të planifikuara. Në mosrealizimin e të hyrave në nivelin e duhur ka ndikuar sidomos trendi negativ i arkëtimit të të hyrave nga komunat. Komunave më lehtë u duket t'i realizojnë objektivat e tyre programore nëpërmjet grave qeveritare dhe nuk e kanë angazhimin e duhur për t'i realizuar të hyrat vetjake.

Nuk janë realizuar të hyrat e planifikuara për t'u realizuar edhe nga financimi nga huamarrjet e jashtme, të hyrat e njëhershme të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të hyrat nga deidentata e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, që dëshmon se nuk ka pas një planifikim edhe aq real, por sa për t'i ngritur shifrat e Buxhetit. Realizimi i të hyrave vërehet se nuk ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të informalitetit dhe luftës kundër evazionit fiskal, por si rezultat i normave

të rritura të tatimit, të cilat e dëmtojnë tatimpaguesin e rregullt. Siç vërehet nga raporti, pjesa më e madhe e të hyrave është realizuar nga të hyrat indirekte, nga TVSH-ja 693 milionë euro dhe nga akciza, 403 milionë euro.

Për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, Kosovës i duhet të bëjë hap pozitiv më të shpejtuar në luftimin e ekonomisë informale, të bëhet më shumë në futjen e biznesit në sistem, duke e luftuar evazionin fiskal, të krijohet partneritet me bizneset sa u përket deklaratave që të reflektohet në rritjen e të hyrave të brendshme, në mënyrë që Buxheti të mos të varet nga të hyrat doganore. Ajo që mbetet si objektiv i kësaj Qeverie është të bëjë më shumë në këtë drejtim.

Të nderuar deputetë,

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2016 janë realizuar 94,5%. Nga 1 miliard e 864 milionë euro të planifikuar kanë mbetur të porealizuar 101 milionë euro, nga të cilët 75 milionë euro janë të porealizuar tek investimet kapitale. Në nivelin qendror, shpenzimet kapitale janë realizuar 89%, kurse në nivelin lokal ka pasur një realizim më të ulët të investimeve kapitale, vetëm 75%. Për shembull, Komuna e Prishtinës i ka realizuar investimet kapitale vetëm 58%, nga 33,9 milionë sa kanë qenë të planifikuara, janë realizuar vetëm 19,7 milionë euro, duke ndikuar në uljen e trendit të shpenzimeve për investime kapitale në organizatat lokale.

Shkaku i mosrealizimit të investimeve kapitale sipas konstatimeve të Auditorit kanë qenë pothuajse të njëjta prej vitit në vit, procedurat e prokurimit jo në pajtim me kornizën ligjore, mungesa e projekteve të detajuara apo mosmbikëqyrja e projekteve se si po realizohen. Vonesa në procedurat e prokurimit ka bërë që të ketë shkurtime buxhetore, sidomos me rishikimin e Buxhetit, gjë që e ka vështirësuar edhe më shumë realizimin e investimeve kapitale. Në Buxhetin e vitit 2016 ka pasur ngecje në shpenzimet për investime kapitale me financim me huamarrje të jashtme. Janë shpenzuar vetëm 5 milionë e 701 mijë euro nga 24 milionë e 675 mijë euro të planifikuar. Është shqetësues mosrealizimi i projekteve nga vonesat e finalizimit të procedurave të prokurimit, apo për shkak të vonesës për formimin e njësisë për menaxhimin e projektit për komunikim ndërmjet financuesit, konsulentëve apo kontraktuesve.

Mosrealizimi i investimeve për shkak të moskrijimit të një llogarie të veçantë për transferin e mjeteve, apo për shkak të mosthemelimit të linjës së veçantë buxhetore për grantin për shëndetësi, si dhe mosfunktionalizimit të sistemit të informimit shëndetësor dhe fondit të sigurimit shëndetësor janë si rezultat i mosangazhimit të duhur, mospunës së duhur të institucioneve dhe si pasojë e kësaj ka pasur mosrealizimin të projekteve kapitale në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Infrastrukturës.

Ministritë përgjegjëse duhet të jenë më efikase në shfrytëzimin e mjeteve të marra kredi, në mënyrë që të mos fillojnë t'i paguajnë kreditë pa i realizuar projektet për të cilat vendi ka hyrë në borxh.

Të nderuar deputetë,

Nga raporti vjetor financiar shohim se ka rritje të numrit të punësuarve për atë që është planifikuar në organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe të nivelit lokal. Punësimet me kontrata në vepër pa e përfillur rregullativën ligjore janë bërë në shumicën e organizatave buxhetore. Nga raporti financiar shohim se ka tejkalim të numrit të punësuar për 710 punonjës. Rritja e numrit të punësuar mbi numrin e planifikuar me Ligjin për Buxhetin është shkelje ligjore. Qeveria duhet të krijojë lehtësi dhe mundësi për rritjen e fuqizimit të sektorit privat për të krijuar mundësi më të mëdha të punësimit, të ndërtojë mekanizma që të respektohen ligjet, në mënyrë që ky sektor të bëhet atraktiv për të punësuarit dhe të zvogëlohet numri i të punësuarve në institucionet publike, kërkesë kjo që bëhet vazhdimisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në faqen 74 të raportit vërehet se obligimet e papaguara të organizatave buxhetore po vijnë duke u rritur, nga 200 milionë, sa kanë qenë në vitin 2015, në 211 milionë, në vitin 2016. Këto obligime të papaguara e dëmtojnë biznesin tonë dhe po ashtu ua vështirësojnë organizatave buxhetore t'i realizojnë prioritetet e tyre, sepse vendimet e gjykatave ua shkurtojnë mjetet në projekte, të cilat janë me interes për realizimin e objektivave të tyre, shkaktojnë efekte negative në menaxhimin e buxhetit, si dhe i ngarkojnë buxhetet e viteve të ardhshme. Ne presim që të adresohen të gjitha këto shqetësime që u ngrëhen, në mënyrë që të jemi shembull i mirë i menaxhimit të financave publike. Kosova ka bërë shumë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies. Mbetet që të bëjmë edhe më shumë në shfrytëzimin e parasë publike me efikasitet dhe efektshmëri, në mënyrë që t'i plotësojmë standardet në drejtim të integritimit në Bashkimin Evropian, si dhe të ndikojmë që me këto mjete të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve tanë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financave për miratimin e raportit financiar për vitin 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe s'është paraqitur askush dhe me sa shoh asnjëri nga ata s'është në sallë. Tani ia jap fjalën deputetit Blerim Kuçi, i cili do të flasë në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Pra, ky raport është shqyrtuar gjerë e gjatë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe është një raport tashmë i vonuar dhe jo shumë aktual, sepse ky raport, përveç të tjerave, paraqet performansën e Qeverisë së viteve 2014, 2015, 2016.

Edhe këto vite veçohen për shkak të performansës së realizimit të të hyrave gjatë këtyre viteve, sidomos në vitin 2015, por kjo ka ndodhur dhe qytetari duhet ta dijë, edhe si delegatë duhet ta dimë që kjo ka ndodhur për shkak të rritjes së TVSH-së, pra Tatimit të Vlerës së Shtuar, edhe atë

për 12,5%. Pra, qytetari i Kosovës është ngarkuar me tatim më shumë për 12,5%. Ne edhe në komision e kemi votuar këtë raport dhe do ta votojmë edhe si grup parlamentar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti nga Grupi Parlamentar “Nisma” e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti financiar i Qeverisë për vitin 2016 është i strukturuar mirë dhe siç e thanë parafolësit është me vonesë, por këtu kemi disa fakte dhe me keqardhje duhet ta themi se edhe në këtë raport janë konstatuar në fushën e planifikimit dhe realizimit dobësi permanente, të cilat e kanë përcjellë dhe këtu shihet qartë se as rekomandimet e Auditorit nuk janë përfillur nga organizatat buxhetore.

Vlen të theksohet ndoshta se planifikimi prej 15 milionë euro nga dividenda e PTK-së nuk ka asnjë të hyrë. Kjo duhet të na shërbejë se çka është duke ndodhur në PTK dhe atje punësimet ende vazhdojnë, ndërsa kemi 0 realizim nga ajo çka është planifikuar nga Qeveria. Po ashtu, në raport shihet një numër enorm i të punësuarve me kontrata të veçanta, për shërbime të veçanta, siç thuhet mbi 1 376 të punësuar. Po ashtu, është një vlerë e cila tejkalon mbi 6 milionë euro paga sipas vendimit të gjykatave. Mendoj që kjo është një tërheqje e vërejtjes për organizatat buxhetore pse janë këto pagesa që duhet t'i paguajnë për shkak të vendimeve të marra nga gjykatat. Po ashtu, Qeveria pranon se rreth 30% ka informalitet dhe kjo është një shenjë, një tregues, që e pengon zhvillimin e mëtutjeshëm dhe ne bëjmë thirrje që të ndërmerren masa.

Mosrealizimi i investimeve kapitale në nivelin lokal dhe në nivelin qendror, edhe një herë po e theksoj, është një tregues se në planifikim dhe në realizim të këtyre investimeve ende përcillen dobësi, të cilat japin edhe elemente tjera shtesë në realizimin e sistemit të menaxhimit të financave.

Ne do ta mbështetim raportin, por mendoj se duhet të merren të gjitha këto parasysht për të mos u përsëritur edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+” nuk është lajmëruar askush, nga deputetët s’ka të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në qoftë se nuk e kemi kuorumin, kishim vazhduar në pikën e radhës, në momentin kur të kemi kuorum e bëjmë votimin. 60 deputetë janë aktualisht në sallë, e kisha lutur Administratën që t’i

bjerë ziles, në qoftë se në bufe është një deputet a dy. I kisha lutur kolegët deputetë, të cilët janë në bufe, ose brenda ndërtesës, që të kthehen në sallë.

Po, erdhën edhe dy deputetë, tre deputetë, në fakt. Mund të procedojmë në votim atëherë.

Të nderuar deputetë,

Jemi në pjesën e votimit të raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Aktualisht në sallë janë 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 47 janë për, 17 kundër.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

19. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me rekomandimet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Driton Selmanaj, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit me rekomandimet e propozuara.

Mërgim Lushtaku e paraqet dhe arsyeton raportin e komisionit me rekomandimet e propozuara.

MËRGIM LUSHTAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike e paraqes raportin me rekomandime lidhur me raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në nenin 69, paragrafi i 5 dhe shtojcën numër 2 pika 13 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në bazë të nenit 6, paragrafi 6.2, pika “h” të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe në bazë të nenit 8 pika 1.2 të Ligjit për auditimin e brendshëm, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2017, e shqyrtoi raportin vjetor për

funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këto:

R e k o m a n d i m e :

1. Të miratojë raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Njësia qendrore harmonizuese e auditimit të brendshëm të raportojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike për masat e ndërmarra ndaj institucioneve që nuk i kanë plotësuar formularët e vertëvlerësimit, si dhe ta njoftojë komisionin se menaxhmenti i cilave institucione nuk ka ndërmarrë veprime të nevojshme për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Brendshëm.
2. Funkcionalizimi i njësive të auditimit i të gjitha subjekteve të sektorit publik,
3. Ngritja e kapaciteteve dhe mbajtja e trajnimeve për auditorët e brendshëm të njësisë së auditimit dhe komunitetit të auditimit nga njësia qendrore harmonizuese e auditimit të brendshëm.
4. Përmirësimi i procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor i auditimit të brendshëm i bazuar në rrezik nga njësitë e auditimit të brendshëm,
5. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve për të vërtetuar se janë ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve në afat të paraparë nga njësia harmonizuese e auditimit të brendshëm.

Në raportin e radhës së njësisë qendrore harmonizuese të auditimit të brendshëm të bëhet saktësimi i institucioneve që nuk kanë bërë adresimin e rekomandimeve të dhëna. Njësia qendrore harmonizuese e auditimit të brendshëm të vazhdojë me skemën e certifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik.

Raportit vjetor të Qeverisë për funksionimin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik t’i bashkëngjitet formulari i vetëvlerësimit për vitin 2017 në afatin kohor kur të dorëzohet raporti. Të bashkëngjitur i keni edhe arsyetimet në këtë raport, ndërsa rekomandimi i këtij komisioni është që të miratohet ky raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve ose kryetarëve të grupeve parlamentare. Faton Topalli, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka kërkuar fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,
Të nderuara deputete,
Qytetarë të Kosovës,

Ne e kemi para nesh një raport vjetor të Ministrisë së Financave, i cili na tregon se si ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm të financave publike te ministrinë, komunat e subjektet tjera, të cilat e shpenzojnë paranë publike.

Kjo është bërë, në njërën anë, nga vetë organizatat buxhetore, pra ministrinë, komunat e subjektet tjera publike, nëpërmjet vetëvlerësimit të punës së tyre dhe, në anën tjetër, nëpërmjet auditimit të brendshëm. Pra, po flasim për një raport, i cili ka për qëllim ta informojë Qeverinë, Kuvendin, Auditorin e Përgjithshëm për problemet, të cilat shfaqen në procesin e kontrollit të brendshëm të financave publike. Pra, për t'u siguruar, ndërmjet tjerash, se a po kryhet puna si duhet, a ka konflikte interesi, a janë të ndara përgjegjësitë ashtu siç duhet, si po realizohet zbatimi i detyrave, a po arrihen qëllimet e parapara, a janë paraparë rreziqet, a ka strategji të caktuara, e kështu me radhë.

Më duhet të them në fillim se kontrolli i brendshëm është menduar si një instrument shumë i mirë për përmirësimin e punës së Qeverisë, ministrive, komunave dhe të gjitha subjekteve që e harxhojnë paranë publike, i cili mjerisht po shfrytëzohet keq. Pse po shfrytëzohet keq? Qëllimi i vetëvlerësimit është për t'i evidentuar problemet dhe për t'i treguar Kuvendit se ku qëndrojnë organizatat buxhetore në fushën e vetëkontrollit, për ta ndihmuar Qeverinë që ta sigurojë një qeverisje të mirë.

Raporti thotë se ato e vlerësojnë jashtëzakonisht mirë punën e tyre. Në fushën e kontrollit të mjedisit, pra këtë e kam marrë vetëm si shembull, prej tri pikave të mundshme sa mund të vlerësohet puna e tyre, i kanë dhënë vetvetes notën 2,62%. Nëse këtë vlerësim e kthejmë në përqindje, i bie që 87% të punës së tyre e kryejnë mirë, e nëse kthejmë këtë në nota shkollore, shkollë fillore, shkollë të mesme prej notës 1 deri në notën 5, i bie që këta po e kryejnë punën shumë mirë, madje më shumë se shumë mirë, sepse nota i bie 4,3.

Në raport ka kontradikta të shumta. Kontradikta e parë është kjo: si është e mundur që Auditori i Përgjithshëm në shumë organizata buxhetore nxjerr probleme të mëdha në menaxhimin e pasurisë e parasë publike, ndërsa subjektet që e shfrytëzojnë paranë publike e vlerësojnë kontrollin e brendshëm, pra punën e tyre me notë shumë të mirë. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ky instrument i mirë i kontrollit të brendshëm të financave publike po përdoret për mashtrim. Kjo do të thotë që organizatat buxhetore prej ministrive, komunave e më poshtë po i hedhin hi në sy Kuvendit se kontrolli i brendshëm është shumë i mirë. Kjo i bie që subjektet po e mashtrojnë Qeverinë, Kuvendin dhe vetveten. Dhe, në fund, kjo i bie që kështu siç po veprohet tani, duke e mashtruar vetveten dhe të tjerët, nuk do të ketë përmirësim të kontrollit të brendshëm në kohën që ky përmirësim është shumë i nevojshëm për të siguruar që shpenzimet e parasë publike do të bëhen në mënyrë të drejtë.

Kontradikta e dytë është që menjëherë pas vlerësimit që na jepet vijnë konkluzionet. Konkluzionet janë në disproporcion të madh me vlerësimin, sepse tregojnë që kemi shumë probleme në fushën e kontrollit të brendshëm, të cilat duhet të zgjidhen. Kontradikta e tretë vjen nga vlerësimi i Auditorit të Brendshëm, po citoj: “ të gjeturat kryesore, pra problemet kryesore nga auditimet e brendshme ishin në sistemin e menaxhimit financiar, kontrollin, zbatimin e kornizës ligjore, prokurimit publik, menaxhimin e rreziqeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi”, e kështu me radhë.

Unë e shtroj pyetjen: Si është e mundur që notat e vetëvlerësimit janë aq të larta dhe konkluzionet për problemet, të cilat duhet të zgjidhen, aq të shumta? Në mënyrë indirekte, njësi qendrore harmonizuese po tregon nëpërmjet konkluzioneve që fjala është jo për vetëvlerësim, por për vetëmashtrim. E nëse ne mashtrojmë vetveten atëherë, nuk do të ketë ndryshime në sistemin e kontrollit të brendshëm të financave, nuk ka shpenzim më të mirë të parasë publike, dhe nuk ka qeverisje të mirë.

Ne kërkojmë nga Ministria e Financave, respektivisht nga njësi qendrore harmonizuese që brenda tre muajve të ardhshëm t’ia dërgojë një raport apo një analizë shtesë Kuvendit të Kosovës për secilën fushë të vetëvlerësimit, për të shpjeguar dallimin ndërmjet vetëvlerësimit pozitiv dhe konkluzioneve, dhe për të treguar se cilët hapa do t’i ndërmarra për t’i detyruar organizatat buxhetore, respektivisht njësitë raportuese, për ta bërë një vlerësim real.

Në raportin për vitin 2017, njësi qendrore harmonizuese ta shtojë edhe një rubrikë për masat e ndërmarra për ta siguruar një vetëvlerësim të drejtë për t’i caktuar kriteret e vetëvlerësimit, nëse ato nuk ekzistojnë dhe për t’ia bashkëngjitur ato këtij raporti. Ne nuk duhet të lejojmë të vetëmashtrohemi, por as nuk duhet të lejojmë që ata që janë përgjegjës për t’i kryer punët e tyre të mbeten pa kritikë dhe, në fund të fundit, edhe pa dhënë përgjegjësi për moskryerjen e punëve që u takojnë.

Sa i përket auditimit të brendshëm, mendoj se edhe këtu ka shumë për t’u bërë. E konsideroj shumë problematik faktin që akoma mungojnë komitetet e auditimit me arsyetimin se ka mungesa buxhetore. Unë këtij argumenti dua t’ia shtoj faktin se nuk mund të mendojmë se po kursejmë para, duke mos i krijuar komitetet e auditimit dhe në të njëjtën kohë të humbim shumë para për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm.

A ka dikush interes që të mos funksionojë kontrolli i brendshëm? Ka! Pra, ka shumë që dëshirojnë që ky kontroll të mos funksionojë, të mos jetë efikas, në mënyrë që të vazhdojnë keqpërdorimet, por ka edhe shumë të tjerë që janë të interesuar që kontrolli i brendshëm të funksionojë.

Ne e miratojmë raportin e njësisë qendrore harmonizuese. Kërkojmë që raportit të ardhshëm t'i shtohet dimensionin e vlerësimit të vetëvlerësimit dhe që raporti ta ketë një gjuhë të qartë, të jetë analitik dhe t'i paraqesë edhe divergjencat që ekzistojnë.

Zoti ministër i Ekonomisë,

Nëse jeni i interesuar të keni qeverisje të mirë, për çfarë ne si opozitë jemi shumë të interesuar, analizojeni me qetësi dhe thellësisht, e jo sipërfaqësisht raportin e Auditorit të Përgjithshëm, raportet e auditorëve të brendshëm, raportin e njësisë qendrore harmonizuese, për ta parë sa e dobët është qeverisja, sa të mëdha janë problemet dhe sa shumë duhet të ndryshojmë në gjithë sistemin e kontrollit të brendshëm për ta pasur një qeverisje të mirë.

KRYETARI: Grupi Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Më lejoni ta prezantoj vlerësimin e Grupit tonë Parlamentar për raportin që u prezantua.

Ne e kemi shqyrtuar brenda Grupit tonë Parlamentar dhe kemi vërejtur që gjatë vitit 2016 ka përmirësime në kontrollin e brendshëm të financave publike. Është përgatitur ligji i ri atëherë, tash është në procedura të Kuvendit, në përputhje me kërkesat që dalin nga agjenda e reformave evropiane dhe MSA-ja. Është përgatitur atëherë Udhëzimi Administrativ për programin kombëtar për trajnim dhe certifikim të auditorëve të brendshëm dhe është bërë progres, sepse sot kemi shumë më tepër auditorë të brendshëm të certifikuar, sesa më përpara.

Normalisht, ne i mbështetim rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe do të kujdesemi që në raportin e ardhshëm të vitit 2017 të adresohen rekomandimet e dala në këtë komision. Ne do ta mbështetim këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Partia Demokratike e Kosovës nuk e ka kërkuar fjalën. Andin Hoti. Ju lus që të mos lodheni, vetëm kërkojeni fjalën, më lehtë e kam.

ANDIN HOTI: Faleminderit! Kërkoj falje, kryetar, se nuk e kam ditur.

Shumë i respektuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës i kemi shqyrtuar rekomandimet e dhëna në raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të vitit 2016, si dhe arsyetimet e dhëna dhe bazuar në këto, ku shihet që edhe mbi 90% të rekomandimeve të kaluara janë plotësuar.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës parimisht e mbështetim këtë raport dhe kontributin do të vazhdojmë ta japim në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe? S'ë ka kërkuar askush fjalën. Zonja Verica Ceraniq e ka fjalën.

VERICA CERANIĆ: Poštovani,

Parlamentarna grupa Srpska lista razmatrala je dostavljeni godišnji izveštaj o funkcionisanju sistema unutrašnje kontrole javnih finansija u javnom sektoru za 2016.-u godinu. Na osnovu informacija iz izveštaja zaključno da je unutrašnja kontrola sprovedena sa ciljem uspostavljanja veće efikasnosti rada subjekata javnog sektora, uspostavljanja bolje fiskalne discipline, uz poštovanje pravila ponašanja od strane subjekata javnog sektora i povećanja nivoa usluga prema korisnicima.

Informacije o aktivnostima centralne jedinice za harmonizaciju unutrašnje revizije, koje su predstavljene u izveštaju, pokazuju da u 2016-oj godini došlo do poboljšanja sistema unutrašnje kontrole javnih finansija u odnosu na rezultate iz 2015.-e godine. Uz napomenu postoje i preporuke koje u cilju efikasnije kontrole finansijskih upravljanja trebalo u budućnosti rešavati.

Takođe na osnovu funkcionisanja sistema interne kontrole u subjektima javnog sektora postoje ta pitanja na koje bi trebalo posebno obratiti pažnju, kako bi ovaj sistem bio unapređen kao što su i oblasti: proces planiranja i izvršenja budžeta; upravljanje imovinom; upravljanje rizikom; podela dužnosti i odgovornosti; sopstveni prihodi i ljudski resursi.

Parlamentarna grupa Srpska lista nakon uvida i razmatranja podržava godišnji izveštaj o funkcionisanju sistema unutrašnje kontrole javnih finansija u javnom sektoru za 2016.-u godinu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës? Nuk ka të lajmëruar. Nga "Nisma", Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Para se të flas për këtë raport, i ngela pak borxh ministrit Hamza, sepse nganjëherë kartela me ju më funksionon, me Xhavit Halitin s'po funksionon. Po ma bllokun fjalën, por s'ka rëndësi.

Desha të them kështu publikisht, që në të gjitha mandatet për mua ministri Hamza ka qenë nga ministrat më korrekt dhe e di që me mund të madh e ke marrë këtë post, se më mirë e ka pasur në Bankën Qendrore shumë, sesa të jesh ministër. Por, sidoqoftë, te raporti për të cilin ne po diskutojmë, unë do të mundohem pak para publikut ta thjeshtoj këtë punë.

Nuk mund të ketë kurrfarë kontrolli nga asnjë institucion në vendin tonë, përderisa nuk thjeshtohen gjërat. Në vendet perëndimore mund ta kontrollojë edhe një gazetar i thjeshtë, se lëre më një deputet, mënyrën se si një ministër, ose një funksionar i lartë i shtetit e menaxhon kartelën e vet qeveritare, zyrtare. Ne kemi informacione se shumë ministra kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë keqpërdorim të jashtëzakonshëm të kartelave të tyre qeveritare, duke blerë dhurata paushall. Ne kemi informacione dhe dihet edhe prej auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm se ka keqpërdorim të jashtëzakonshëm të derivateve të naftës, ku një zyrtar komunal, ose një shofer i ministrit, për shembull, brenda një muaji i bën 20-30 mijë kilometra rrugëtim. Dhe, unë e kam më tepër si deputet një rekomandim, sepse ne do ta aprovojmë këtë dhe është fat i mirë që edhe Lidhja Demokratike do ta aprovojë, sepse ky raport më shumë flet për punën e Qeverisë së kaluar. E kam një rekomandim që t'u bëhet e mundur edhe deputetëve, edhe gazetarëve, që ta arrijnë ta kontrollojnë faturën e një ministri, ose të Presidentit, ose të kryetarit të Parlamentit, se:

1. Me çfarë bilete udhëton, a udhëton me biznes klasë, a udhëton me biletë të thjeshtë?
2. Të arrijmë ta kontrollojmë ne se në çfarë mënyre e menaxhon kartelën zyrtare?
3. Në çfarë hotelesh flenë këta njerëz?
4. A kanë të drejtë ministrat tanë, zyrtarët, të përdorin pije alkoolike në vizita zyrtare?

Për shembull, ne kemi këtu edhe drejtorë të kompanive të ndryshme publike që e menaxhojnë paranë publike, që brenda një nate me paratë publike pinë alkool deri në 5 mijë euro.

Në qoftë se do të krijohet një hapësirë e tillë, zoti ministër, e ju e dini fort mirë se në Qeverinë e Agim Çekut, e "Riinvesti" së bashku me ministrat e asaj Qeverie i kanë keqpërdorur 1,8 milion euro para të DIFID-it anglez dhe para të SID-as suedeze dhe krejt kjo, krejt keqmenaxhimi, e t'i thuhet shqip është hajnia e parasë publike në Kosovë ndodh, sepse ne nuk kemi qasje, nuk kemi mundësi t'i kontrollojmë këto gjëra. Prandaj, ne këtë e japim si rekomandim.

Përndryshe, me terma të përgjithshëm mund të diskutojmë edhe dy muaj dhe do të vazhdojë prapë hajnia dhe keqpërdorimi i parasë publike. Faleminderit, ministër!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin me rekomandimet lidhur me raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016. Duke pasur parasysh përmirësimin e dukshëm dhe shumicën e rekomandimeve që janë miratuar, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë raport me rekomandime dhe do ta japim votën pro këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, koleg deputet! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Nuk kemi deputetë.

Shkojmë në pjesën e votimit të raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016 bashkë me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. 73 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar. 65 janë për, 1 kundër, 2 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016 bashkë me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

I lus deputetët në qoftë se ka mundësi, le të qëndrojnë, mund ta përfundojmë shpejt seancën.

20. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t’i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb

Ftoj kryetarët, përkatësisht përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që t’i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.

E ftoj Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që t’i propozojë tre anëtarë. Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne propozojmë që Xhelal Sveçla të jetë drejtues i këtij komisioni, kurse Arbër Rexhaj dhe Saranda Bogujevci të jenë anëtarë të këtij komisioni.

KRYETARI: Më fal, jepi vetëm emrat, tre emra, e kryesuesi qenka me rotacion. Po jepi tre emra, s'prish punë. Glauk, a i dhe tre emra?

GLAUK KONJUFCA: Po, i dhashë.

KRYETARI: Jepi tre emra, pastaj komisioni e përcakton vetë, të mos marrim ne ngarkesë.

Derisa po flas, unë jam i obliguar ta dëgjoj edhe Administratën. Nuk është çështje e vullnetit politik, se krejt ua lëmë në dorë thjesht udhëheqësve dhe mos u ndalni duke e udhëhequr këtë komision, po puna është se derisa po flas unë në bazë të procedurave, Administrata po më thotë se qenka me rotacion. Nuk është pjesë... Tek e fundit, seanca vendos. A jeni të gatshëm t'ua japim? Pse...? Po, mos e bëni problem, se çështje e vogël është.

LDK-ja dhe PDK-ja i ka dhënë emrat, unë do t'i them. Të mos e bëjmë problem çështjen e kryesuesit. E keni kryetarin e komisionit këtë herë, por mos e bëni problematike. Le ta kenë, se na mbyten me... thjesht. LDK-ja e ka propozuar Imet Rrahmanin, Lirije Kajtazi qenka çështje e interpretuar. Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar Nait Hasanin zëvendëskryetar i parë, Blerta Deliu. Më fal, këtu tash po e shoh, LDK-së ia morëm hakun, se kryetar e paska pas LDK-ja. Mendova se PDK-ja e paska... Urdhëro, Avdullah Hoti edhe Albulena Haxhiu... Avdullah Hoti e ka fjalën, shefi i Grupit Parlamentar, pastaj Albulena Haxhiu. Tek e fundit, e çojmë edhe me votim, skam çfarë të bëj.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar,
Ne e kemi pranuar shkresën zyrtare dhe jemi përgjigjur zyrtarisht ne Grupi Parlamentar. Në shkresë nuk është kërkuar që t'i propozojmë dy anëtarë dhe njëri prej tyre si kryesues i këtij komisioni dhe këtë e kemi bërë. Prandaj, unë pres që të respektohet kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Disa herë në mandatin e kaluar si Grup Parlamentar e kemi ngrehur këtë çështje. E kemi ngrehur çështjen për faktin se komisionet ad hoc çdo herë i takonin PDK-së, që në atë kohë ishte grupi më i madh parlamentar. Dhe tash, kur PDK-ja është grupi i tretë parlamentar, po thuhet se kjo çështje shkon me rotacion.

A bën sekretari i Kuvendit, pasi u thirre te sekretari i Kuvendit, sepse që sa kohë je kryetar dhe nuk është puna ta mësosh Rregulloren e Kuvendit, a bën të na tregoni se ku shkruan "me rotacion"? Pra, Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" i propozon...

KRYETARI: Vetëm pak, sekretari nuk është pjesë e seancës, mos e thuaj këtë, tek unë drejtoje fjalën.

ALBULENA HAXHIU: ...për kryetar në të dyja komisionet ad hoc. Pra, ne i propozuam tre anëtarë, njëri prej tyre, që është Xhelal Sveçla, do të jetë kryetar i komisionit, sepse kështu tashmë është krijuar precedent. Ne e kemi kundërshtuar në parim më përpara, mirëpo meqë keni vepruar njësoj, është mirë që edhe tash të veproni dhe ne këmbëngulim në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Ju kolegë deputetë, zonja Time Kadrijaj dhe Armend Zemaj, a ka mundësi ta kryejmë radhën. Aleanca ashtu-kështu, e paska propozuar, por kështu ne do të shkojmë, në fund të fundit, në votim për kryetarin. Edhe aprovimin e kësaj, edhe kryetarin, po e shoh që s'ka konsensus, edhe për grupin, edhe për këtë, dy votime i bëj, një del propozim Imet Rrahmani, kryetar, tjetri del përfaqësuesi i “Vetëvendosjes” për kryetar dhe komisioni. S’kam çka ju bëj, s’po mund të merreni vesh, tash mos më keqkuptoni. Po nuk e kam ndërmend unë ta vendos, seanca le ta vendosë. Tash, po të kishte konsensus, personalisht jua kisha dhënë ju, por si kryetar i Kuvendit s’e bëj këtë. Thjesht! Tash s’dua ta luaj rolin e arbitrit. Më fal, koleg Armend dhe... a ka mundësi të vazhdoj njëherë vetëm emrat t’i marrim. T’i marrim emrat, ju kisha lutur!

Grupi Parlamentar PDK: Nait Hasani, zëvendëskryetar i parë; Blerta Deliu, anëtare. Asnjë nuk është as zëvendëskryetar, ta kemi parasysh, Nait Hasani, Blerta Deliu, të gjithë janë anëtarë.

Lista serbe: Igor Simiq, i vetmi prej komuniteteve, i cili duhet të jetë zëvendëskryetari dytë, u takon.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Rasim Selmani.

“Nisma”, ju lutem mq jep një emër!

SHERIF BILALLI: Milaimin e kemi në atë komision, le të vazhdojë Milaimi.

KRYETARI: Milaim Zeka! “6+”-i , ju lutem bëjeni propozimin!

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se predsedavajući!
Parlamentarna grupa “6+” predlaže gospodina Alberta Kinolija. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tash në votim, në princip, unë do të duhej në bazë të këtij rregulli, te këta që i kemi nga dy kandidatë, “Vetëvendosja” ma jep propozimin edhe një herë. Urdhëro Memli, po shkojmë në votim dhe e përfundojmë me votim, të mos e zgjasim. Urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar dhe kolegë deputetë,

Kur kanë ardhur kërkesat prej Administratës për dy komisione që i kemi ad hoc për t'i formua një pas një, kemi qenë shumë të kujdesshëm që t'i pyesim saktësisht nëse po na kërkojnë anëtarë, a po na kërkojnë kryetarë, apo na kërkojnë zëvendëskryetarë. Zyrtarisht! Shkresat prej Administratës i kemi për Partinë Demokratike të Kosovës, në komisionin që e kemi tash në rend dite është kërkuar një zëvendëskryetar një anëtar. Ndërsa, në komisionin e radhës, që e ke në votim pas kësaj, saktësisht na është kërkuar një kryetar dhe një anëtar.

Ta kemi një sqarim, a është ky vendim në fuqi apo jo, sepse edhe shkresat tona zyrtare për të dyja komisionet janë bërë në formën e shkresës që e kemi pranuar prej Administratës, për t'i emëruar në pozita të sakta. Prej Kryesisë, po normalisht, ne komunikojmë me Administratën, Armend! Dhe, mendoj se është mirë kjo të sqarohet para votimit. Nëse krejt i kanë marrë shkresat dhe sqarimet prej Administratës nëpërmjet vendimit të Kryesisë, apo sido që të jetë, është mirë veç emrat të jepen bashkë me pozicionet dhe të mos krijohet tash një precedent i ri për të votuar për dy-tre kandidatë, se atëherë edhe ne po e nxjerrim një kandidat për kryetar, e mandej s'po e zgjedhim hiç. Faleminderit!

KRYETARI: Me aq sa po e shoh, kjo çështje po komplikohet pa fare nevojë. Një gabim, kolegët e Kryesisë, nuk qenka Aida, po Glauku qenka si shef i Grupit Parlamentar. Në mbledhje të Kryesisë e paskemi marrë kështu vendim kur kemi kërkuar. Tash Administrata shkoi që ta marrë protokollin. Do të thotë, vendimin, Glauk, se kjo më tepër vlen për ty dhe për ne që kemi qenë në Kryesi. Vendimin e paskemi marrë në këtë formë. Në bazë të vendimit tonë në Kryesi paskemi proceduar. Ne mund të vonohemi, por më mirë është ta bartim këtë pjesë këtë herë e ta përfundojmë kështu, por herët tjera e bartim në Kryesi. Temë debati, të mos bëhemi horë në seancë. Urdhëro, zonja Albulena Haxhiu. Armend, edhe ti e do fjalën, mandej bëhesh gati menjëherë.

ALBULENA HAXHIU: Edhe një herë, Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" i propozon tre emra për këtë Komision ad hoc. Janë: Xhelal Sveçla, në cilësinë e kryetarit; Arbër Rexhaj, në cilësinë e anëtarit dhe Saranda Bogujevci, në cilësinë e anëtares. Dhe tash, Kuvendi nuk ka të drejtë të votojë vetëm për kryetarin. Ku jeni kah i merrni këto rregulla kështu?

Kuvendi voton për komisionin në tërësi, në përbërje të plotë. Kështu kemi votuar edhe në mandatet e kaluara, kështu edhe tash duhet të votojmë. Andaj, ne kërkojmë që komisioni me emrat që u propozuan nga anëtarët, le të vendoset në votim, për secilin komision, propozimi ynë është që ta drejtojmë Xhelal Sveçla. Faleminderit!

KRYETARI: Armend, fjala për ty, pastaj e bëj edhe një herë një sqarim, për arsye se gjërat janë shumë të qarta, edhe si vendimmarrje, edhe si procedurë. Por, shpeshherë po e komplikojmë vetveten. Urdhëro, Armend Zemaj, pastaj e bëj edhe një sqarim procedurash.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

E para, këto janë komisione ad hoc, domethënë nuk janë komisione të përhershme dhe sigurisht që edhe në takimin e Kryesisë, ku kemi qenë të pranishëm, është vendosur me rotacion. E dyta, është një standard i kërkuar edhe në mandatin e kaluar dhe tash kjo është sikur të luajmë me dy standarde, të thuhet “është shkelur ligji, atëherë keni pranuar shkeljen e ligjit dhe tash duhet të vazhdojmë, sepse jemi me shkelje të ligjit”. Kjo është shumë e padrejtë. Dhe është mirë që komisionet ad hoc të jenë me rotacion, sepse ka shpeshherë që duhet t’u nënshtrohen edhe vendimeve këtu të Kuvendit dhe të seancës plenare dhe kjo është shumë normale, pavarësisht fuqisë politike, e cila është në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo është diçka shumë e mirë, nëse vetëm futet në procedurë. Ka qenë e gabuar në legjislaturat e kaluara, sepse i ka takuar vetëm një grupi parlamentar dhe kjo ka qenë e padrejtë.

Nëse dëshiron grupi tjetër tash ta vazhdojë këtë të padrejtë, atëherë i takon “Vetëvendosjes” kjo e padrejtë.

KRYETARI: Edhe një herë, unë ju kisha lutur për mirëkuptim, të mos i komplikojmë gjërat, se janë shumë të thjeshta. Kjo nuk ka fuqi politike diçka që do të demonstrojë në Kosovë për ta marrë pushtetin. Është çështje shumë e thjeshtë, duhet të zgjidhet një anëtar i Komisionit, ky është Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb. Unë kisha kërkuar mirëkuptim, prandaj të vazhdojmë. Në qoftë se ka ndodhur ndonjë gabim procedural, kemi vepruar, jemi në seancë. Po tash, këtë herë, ta përfundojmë me këtë formë si është.

Të mos i hedh në votim dy alternativa, se edhe para publikut nuk po dalim mirë. A ka mundësi të procedojmë me këtë? Glauk, edhe një herë, a ka mundësi të procedojmë me këtë? Pranojeni, në qoftë se është padrejtësi, pranojeni në qoftë se ju kemi bërë këtë herë padrejtësi, pastaj në mbledhje të Kryesisë e trajtojmë. Nuk po e vendosim emërimin e tyre. Po na komplikohet. Ose, më detyroni atëherë, edhe pse s’është e mirë, në publik i hedh dy propozime, jo i hedh të dyja, një me kryetar Xhelal Sveçlën, tjetrin me kryetar... kush është, Imet Rrahmanin e hedh dhe kjo kryhet. Glauk, urdhëro edhe një herë, ju kisha lutur për mirëkuptim.

GLAUK KONJUFCA: Problemi është ky, shefat e grupeve parlamentare kanë qenë në Bruksel në momentin kur është vendosur në Kryesi dhe ne i kemi pasur të deleguarit tonë që na kanë përfaqësuar, mirëpo Kryesia ka marrë vendime aty, ku ne i kemi pasur përfaqësuesit tonë, mirëpo Kryesia ka marrë vendime në bazë të një rendi të ditës, që na vjen këtu, ku nuk shkruan ashtu siç po e interpretoni ju. Duhet të realizohet kjo dhe të zgjidhen këta anëtarë të komisionit dhe kryetari, ashtu siç ka qenë precedenti edhe në mandatet e kaluara. S’kemi çka...

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Për hir të korrektesisë, pika 20 dhe 21 tërhiqen nga rendi i ditës, i rikthehen prapë Kryesisë së Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare, pastaj e qartësojmë ne. Më mirë në Kryesi, sesa ta maltretojmë seancën.

Jemi në pikën e fundit të rendit të ditës. Dy janë, më duhet të kërkoj mirëkuptimin tuaj, unë do ta bëj një propozim. Janë votim i fshehtë, pikat 22 dhe 23 mund të bëhen përnjëherësh votim, në qoftë se seanca pranon dhe ne votojmë, komisioni i cili krijohet pastaj kalon apo s'kalon, mund ta përfundojmë seancën dhe mbetet për seancën tjetër. Çka kalon, kalon, çka s'kalon mbetet për seancën tjetër, në qoftë se gjithmonë ju pajtoheni. Sot, tash po vazhdojmë... Sot? Edhe më mirë!

Atëherë, kisha dëshiruar vëmendjen. Unë i lexoj 22-shin dhe 23-shin, të njëjtat procedura. Po, shumë ide e mirë. A i lexoj njëherë, pastaj deklaroheni, veç t'i lexoj. Po futemi në votim. Deputetët votojnë e shkojnë në pauzë, se i kemi një orë e gjysmë ka mundësi të ju marrë votimi i dyfishtë.

Kryetarë të grupeve parlamentare, a doni të hyjnë në votim të dyja bashkë, a doni të shkoni në pauzë? Deklarimet, Glauk Konjufca, të lutem!

GLAUK KONJUFCA: Unë them që të shkojmë menjëherë në pauzë dhe pastaj të votojmë.

KRYETARI: Avdullah Hoti?

AVDULLAH HOTI: Po shkojmë në pauzë prej 30 minutash, ndoshta jo më shumë dhe kthehemi menjëherë.

KRYETARI: Për drekë, pauzë dreke, se s'mund t'i lirojmë deri në orën 15 e një çerek. Atëherë, pauzë deri në orën 15 e një çerek dhe pastaj e vazhdojmë seancën me votime. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Fillojmë me rendin e ditës:

21. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve

Komisioni ad hoc me përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve, nga dy kandidatët e propozuar. Ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, zonjën Shqipe Pantina, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e Komisionit ad hoc.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, neni 10.1 dhe neni 10.5 dhe 11 të Ligjit për KPM-në, në mbledhjet e mbajtura më 27 tetor dhe 2 nëntor 2017, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie me votim të fshehtë.

Për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar propozohen kandidatët si në vijim:

Driton Qeriqi dhe
Vlorë Berisha.

Kuvendi prej dy kandidatëve zgjedh një anëtar të KPM-së.

Anëtari i Komisionit të Pavarur për Medie emërohet me mandat trevjeçar.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur për Medie, në pajtim me nenin 11, paragrafi 2.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Medie ka bërë shpalljen publike për zgjedhjen e një anëtari të KPM-së.

Kuvendi i Kosovës ka pranuar aplikacionet e pesë kandidatëve për anëtarët e Komisionit të Pavarur për Medie.

Komisioni ad hoc, i themeluar me vendim të Kuvendit, më datë 25 tetor 2017, në mbledhjet e mbajtura më 27 tetor dhe 2 nëntor ka shqyrtuar listën e kandidatëve dhe nga pesë kandidatët, të cilët kanë aplikuar, ka investuar katër kandidatë, për arsye se një kandidat nuk i është përgjigjur ftesës për intervistim.

Në intervistë kanë marrë pjesë kandidatët, si në vijim:

Argjent Lleshi,
Driton Qeriqi,
Fehmi Ajvazi dhe
Vlorë Berisha.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të KPM-së konform nenit 11, paragrafi 2.4 i propozon Kuvendit zgjedhjen e një anëtari të KPM-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne e patëm më herët një pajtueshmëri. Unë do të vazhdoj pikën e 23-të, pastaj në procedura i bashkoj të dyja për votim të menjëhershëm.

23. Zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga kandidatët e propozuar.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit dhe t'i njoftojë deputetët me procedurën e votimit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, Komisioni për përzgjedhje në përbërje të guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Auditorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Financave i ka propozuar Kuvendit pesë kandidatë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, njëri prej të cilëve për përfaqësim dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë.

Kuvendi, në bazë të nenit 4, paragrafi 6 dhe paragrafi 11 të ligjit të lartpërmendur për Fondin Pensional emëron anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale me mandat katërvjeçar, bazuar në rekomandimet e Komisionit për përzgjedhje.

Pas konsultimit me Qeverinë, e cila i dorëzon opinionin Kuvendit brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës nga Kuvendi për konsultim. Për kandidatët e propozuar Kuvendi brenda afatit ligjor nuk ka pranuar ndonjë mendim nga Qeveria.

Me ligj nuk është e rregulluar mënyra e votimit në seancë plenare, pra nuk është e saktësuar votimi i hapur apo e fshehtë, gjithsesi Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhje dhe ka vlerësuar se kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet formale-juridike të parapara me Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që me votim të fshehtë të bëjë emërimin e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, njëri prej të cilëve emërohet për përfaqësim dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë me mandat katërvjeçar.

Sa i përket procedurës së votimit, komisioni i ka rekomanduar Kuvendit dy kandidatë për zgjedhjen e njërit nga kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit Drejtues:

1. Hajdar Korbi,
2. Mark Kreford,

Komisioni për Buxhet dhe Financa po ashtu i ka rekomanduar Kuvendit tre kandidatë për zgjedhjen e njërit nga kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për përfaqësim dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë, si në vijim.

1. Valdrin Kasumaj,
2. Flamur Keqa,
3. Ejup Qerimi.

Nëse në rundin e parë të votimit asnjëri nga tre kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit Drejtues për përfaqësim dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë nuk i merr votat e nevojshme, atëherë përsëritet rundi i dytë me dy kandidatët që kanë fituar më shumë vota. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tash jemi duke vepruar paralelisht në dy pikat e rendit të ditës. Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga një deputet prej secilit

grup parlamentar. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komisionin votues.

Lëvizja “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” propozon Saranda Bogujevcin.

KRYETARI: Lidhja Demokratike e Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne propozojmë deputetin Fidan Rekalju.

KRYETARI: Partia Demokratike e Kosovës?

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ne propozojmë deputetin Hajdar Beqa.

KRYETARI: Lista serbe, ju lutem, Slavko Simiq, e ka fjalën, nënkryetari.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče,

Parlamentarna grupa Srpske liste predlaže se Srđana Mitrovića. Hvala!

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Rasim Selmanaj.

KRYETARI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Enver Hoti.

KRYETARI: “6+”, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” propozon deputetin Bahrin Shabani.

KRYETARI: Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për formimin e komisionit votues, ngritje dore formale.

Shumica absolute është, nuk po pyes. Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e anëtarëve, do të thotë edhe të Komisionit të Pavarur të Medieve, edhe të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Kërkoj nga Komisioni votues që të fillojë procedimin e votimit, ndërsa deputetët të ftohen të votojnë sipas listës.

Ju kisha lutur për vëmendje, kolegë deputetë, i kemi vendvotimet me dy ngjyra, kolegët e administratës po i vendosin ngjyrat ku do të hedhet vota për votim, në bazë të ngjyrës që është jashtë, njëjtë hedhet vota në atë kuti. Kur i merrni dy fletëvotime, i kanë dy ngjyra të ndryshme.

Naser Rugova, Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Agim Aliu, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Albert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni...,

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Kosovës, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Bahrim Shabani, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evgjëni Thaçi, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalju, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Avdyli, Haxhi Shala, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Ismet Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku, Milaim Zeka.

Unë ju lus që të mos shkoni në shtëpi pa u bërë numërimi, sepse duhet të kryhet votimi. Në qoftë se nuk fitojnë me të parën herë, duhet të përsëritet lista e dytë.

Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufëra Srbica Shinik, Mytaher Haskuka, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nezir Çoçaj, Qëndron Kastrati, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku, Valon Ramadani, Verica Çeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri,

Vjosa Osmani, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsilović dhe Xhavit Haliti.

Filloni ju komisioni të numëroni, t'i rregulloni.

RASIM SELMANAJ: Të nderuar kolegë deputetë,
Për zgjedhjen e një kandidati anëtar të Komisionit të Pavarur për Media i kemi përpara 91 vota, tash do të fillojmë t'i numërojmë dhe të shohim se cili do të jetë fitues.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit! Po e fillojmë numërimin:

Vlorë Berisha,
Vlorë Berisha,
Vlorë Berisha,
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha

Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
E pavlefshme
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha
Driton Qeriqi
Vlorë Berisha
Vlorë Berisha

RASIM SELMANAJ: Të nderuar deputetë,
Për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës kanë votuar 91 deputetë. Tash të shohim se cili do të jetë fitues, dy nga këta:

HAJDAR BEQA:

Abstenim

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Flamur Keqa

E pavlefshme

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi, pjesa e parë është e vlefshme, ndërsa pjesa e dytë nuk është, për shkak se nuk ka votuar.

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Valdrin Kasumaj, vetëm pjesa e dytë.

Hajdar Korbi

Ejup Qerimi

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Ejup Qerimi

Hajdar Korbi

Flamur Keqa

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi

Valdrin Kasumaj

Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Valdrin Kasumaj, vetëm pjesa e dytë.
Mark Kreford
Ejup Qerimi
Hajdar Korbi
Flamur Keqa
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
E kemi vetëm Valdrin Kasumaj, pjesën e parë nuk ka votuar.
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Pjesën e parë nuk ka votuar, Flamur Keqa.
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Pjesa e parë nuk ka votim, pjesa e dytë është Ejup Qerimi.
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Mark Kreford
Valdrin Kasumaj
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Valdrin Kasumaj, pjesa e dytë, ndërsa pjesën e parë nuk ka votuar.
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj
E pavlefshme
Hajdar Korbi, pjesa e dytë e pavlefshme.
Hajdar Korbi, pjesa e dytë.
Ejup Qerimi
Hajdar Korbi

Ejup Qerimi
Hajdar Korbi
Flamur Keqa
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Mark Kreford
Ejup Qerimi
Hajdar Korbi
Flamur Keqa
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi
Hajdar Korbi...
Hajdar Korbi,
Flamur Keqa,
Mark Roved,
Valdrin Kasumaj,

Në pjesën e parë nuk ka votuar, ndërsa pjesën e dytë është Ejup Qerimi.

Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,

Në pjesën e parë nuk ka votuar, ndërsa pjesën e dytë është Ejup Qerimi.

Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,

Pjesën e parë e ka bërë të pavlefshme, ndërsa në të dytën Valdrin Kasumaj,

Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,

Pjesën e parë nuk ka votuar, ndërsa në të dytën ka votuar për Valdrin Kasumaj.

Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi
Flamur Keqa,
Hajdar Korbi
Flamur Keqa,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,

Pjesën e parë nuk ka votuar ndërsa pjesën e dytë ka votuar Ejup Qerimin.

Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,

Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,

Pjesën e parë nuk ka votuar, ndërsa në pjesën e dytë ka votuar për Ejup Qerimin.

Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Valdrin Kasumaj,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,

Në pjesën e parë nuk ka votuar, ndërsa në të dytën ka votuar për Ejup Qerimin.

Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi,
Hajdar Korbi,
Ejup Qerimi.

KRYESUESI: Regjia, zotit Beqaj fjalën.

HAJDAR BEQA: Disa kanë shkuar, disa kanë shkuar në balotazh. Tash në balotazh ka mundësi të bëhet gara më interesante. Faleminderit!

Faleminderit, të nderuar kolegë deputetë.

Komisioni Votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Fondit të Komisionit Pensional të Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më datën 30 nëntor 2017, konstatoi se në votim kanë marrë pjesë 91 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 3 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës janë:

1. Hajdar Korbi i ka fituar 70 vota, kurse

1. Mark Kroford i ka fituar 04 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë janë:

1. Valdrin Kasumaj i ka fituar 39 vota,
2. Flamur Keqa i ka fituar 09 vota dhe
3. Ejup Qerimi ka fituar 37 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 4.6 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, Ligji nr. 04/L-168 dhe Ligji nr. 05/L-116, si dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit, konstaton se zoti Hajdar Korbi emërohet anëtar i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, kurse për dy kandidatët tjerë, në këtë rast tre kandidatët për anëtarë të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë nuk i kanë marrë votat e mjaftueshme: zoti Valdrin Kasumaj, zoti Flamur Keqaj dhe zoti Ejup Qerimi.

Përsëritet votimi për dy kandidatët që janë më të votuar, zoti Valdrin Kasumaj dhe zoti Ejup Qerimi, kurse zoti Flamur Keqaj eliminohet në bazë të rezultatit të votave nga gara.

Andaj, deputetët në bazë të Rregullores duhet të votojnë edhe një herë për dy kandidatë, në këtë rast për dy kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë, për zotin Kasumaj dhe zotin Qerimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Regjia, shpresoj që i ka bërë gati dokumentet, fletëvotimet. Tani duhet të votohet vetëm për dy kandidaturat, që janë Valdrin Kasumaj dhe Ejup Qerimi. Flamur Keqa ka rënë nga kombinimi, sepse ka më pak vota. Kështu që besoj se Administrata shpejt do t'i sjellë fletëvotimet, ndërsa në mesin e dy kandidaturave që kanë qenë në pjesën e parë të fletës së votimit për të qenë anëtar i Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ka fituar Hajdar Korbi dhe Komisioni duhet ta firmosë fitoren e zotit Korbi.

Atëherë, unë po ju thërras me radhë, deputetë:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Agim Aliu, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Albert Kinolli, Andin Hoti, Anton Çuni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu, Bahrim Shabani, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton

Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evgjëni Thaçi, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Avdyli, Haxhi Shala, Kimete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Myfera Shinik, Mytaher Haskuka, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nezir Çoçaj, Qëndron Kastrati, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Salihu, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavleviq, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku, Valon Ramadani, Verica Çeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

Regjia, fjalën komisionit, ju lutem!

SARANDA BOGUJEVCI: Fillojmë tani numërimin:

Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
E pavlefshme,
Ejup Qerimi,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
E pavlefshme,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
E pavlefshme,

Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
E pavlefshme,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
E pavlefshme,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Ejup Qerimi,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
E pavlefshme,
Ejup Qerimi,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,

Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
E pavlefshme,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,
Ejup Qerimi,
Valdrin Kasumaj,
Valdrin Kasumaj,

Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Beqa për ta shpallur rezultatin.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor 2017 në raundin e dytë, konstatoi se

- në votim kanë marrë pjesë 74 deputetë,
- të pavlefshme kanë qenë 7 fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë janë:

1. Zoti Valdrin Kasumaj i ka fituar 41 votë, kurse
2. Zoti Ejup Qerimi i ka fituar 26 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 4.6 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, Ligjin nr. 05/L-116, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstaton se zoti Valdrin Kasumaj emërohet anëtar i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë, me mandat katërvjeçar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Këtu e përfundojmë seancën. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë